RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

(Auditim Përputhshmërie)

"AVOKATURA E SHTETIT"

Tiranë, 2021

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
"Auditim Përputhshmërie"

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**3-10**
1	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3-3
2	Një përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve	3-7
3	Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit	8-10
II	**HYRJA**	**10-13**
1.	Titulli	10-10
2.	Marrësi	10-10
3.	Qëllimi dhe Objektivat	10-10
4.	Identifikimi i çështjes	11-11
5.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	11-11
6.	Përgjegjësitë e audituesve	11-12
7.	Kriteret e vlerësimit	12-12
8.	Standardet e auditimit	12-12
9.	Metodat e auditimit	12-13
10.	Dokumentimi i auditimit	13-13
III	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	**13-135**
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	13-13
2.	Përshkrim i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	
	Drejtimi 1: Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.	14-25
	Drejtimi 2: Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave pasurorë të shtetit në gjykatat vendase dhe të huaja.	25-69
	Drejtimi 3: Përputhshmëria ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave, realizimi i fondit të pagave, shpërblimeve, sigurimeve shoqërore e të tjera personeli.	70-72
	Drejtimi 4: Auditimi i veprimeve financiare të institucionit.	73-79
	Drejtimi 5: Prokurimet e fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime.	79-115
	Drejtimi 6: Mbi veprimtarinë e Zyrës së Inspektimit si strukturë përgjegjëse për kryerjen e inspektimit të veprimtarisë së avokatëve të shtetit.	115-128
	Drejtimi 7: Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.	128-135
IV	**GJETJET DHE REKOMANDIMET**	**136-157**
V	**ANEKSE**	**158-183**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi ñAvokaturën e Shtetitò, më poshtë e emërtuar ñASHò, për periudhën për periudhën nga data 01.01.2018 deri në 31.12.2020 me objekt ñAuditim Përputhshmërieò. Auditimi kishte në fokus gjashtë drejtime kryesore sipas programit të miratuar dhe në të u angazhuan 6 (gjashtë) auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Nga auditimi mbi përputhshmërinë e aktivitetit me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), u konstatuan të meta dhe mangësi në veprimtarinë institucionale në disa prej drejtimeve të veprimtarisë, që lidhen kryesisht me detyrimet që institucioni ka në përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave kombëtare, ndërkombëtare dhe të huaja por edhe sa i përket mirëmenaxhimit të veprimtarisë së tij. Mangësi u konstatuan në proceset e ruajtjes dhe arkivimit të dokumentacionit të brendshëm, mungesën e mbulimit të plotë me veprimtari inspektimi të zyrave vendore të ASH, bashkëveprimit në nivel të pamjaftueshëm me prokuroritë e rretheve lidhur me ngritjen e padive civile në proceset penale, zvarritjen e procesit të regjistrimit në regjistrin elektronik të të disponuar nga ASH të çështjeve të zhvilluara në gjykatat e huaja, mosgarantimin e zbatimit të vendimeve të Gykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) brenda afateve përkatëse dhe në vlerën e përcaktuar të tyre, mosmarrjen pjesë në proceset gjyqësore për njohjen e vendimeve të gjykatave të huaja në disfavor të Shqipërisë, mbajtjen e standardeve të ndryshme lidhur me angazhimin e institucionit në njohjen e vendimeve të huaja në favor të, në procedurat e kontraktimit të përfaqësuesve/këshilluesve në profesion të lirë si dhe mungesën e një analize paraparake përpara nisjes së këtyre procedurave, etj. Në përfundim të veprimtarisë audituese referuar problematikave të sipërcituara dhe jo vetëm, ne konkluduam me dhënien e ***opinionit të kualifikuar*** për përputhshmërinë e aktivitetit të Avokaturës së Shtetit, trajtuar më hollësisht në seksionet më poshtë.

I.2 Një përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi paraqitet sa më poshtë:

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	Nga auditimi rezultoi se, në gjykatat e huaja ndërkombëtare dhe arbitrazhin ndërkombëtar Shteti Shqiptar ka qenë si Palë e Paditur në 14 çështje gjyqësore. Nga këto rezultoi se janë gjykuar dhe dhënë vendimet për 9 çështje ndërsa 5 prej tyre presin gjykimin pranë këtyre gjykatave. -Në 5 çështje të gjykuara, vendimi ka rezultuar në disfavor të Shtetit Shqiptar me një detyrim financiar prej rreth **388.5 milion Euro**. Thuajse për të gjitha rastet Avokatura e Shtetit nuk dispononte informacion të plotë mbi njohjen e këtyre vendimeve pranë Gjykatave të Apelit vendase, si dhe ecurisë së ekzekutimin të tyre. Kjo si rrjedhojë e mosthirrjes në gjykim nga këto gjykata apo dhe nga institucionet respektive si palë e interesuar. Vendimet të cilat zënë peshën më të madhe janë çështjet e gjykuara në ICSID, ñQendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve në Fushën e Investimeveò ARB/15/28 H S.r.l and others me një vlerë prej rreth 108+ milion Euro, si dhe çështjes në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit të ICC me qendër në Paris, 21349/GR V2015 B P A ltd, me vlerë prej rreth 221.7 milion Euro. Në këto raste ekziston risku për kërkime për	**Drejtimi nr. 2** *"Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave pasurorë të shtetit në gjykatat vendase dhe të huaja"* *Trajtuar më hollësisht në faqet*	E lartë	-Nga ana e Avokaturës së Shtetit të merren masat e nevojshme për rikuperimin e kostove të paguara në këto procese gjyqësore, përkatësisht çështja ARB/17/6 me palë paditëse A - A G Limited në vlerën **250,000 Euro** dhe vlerën e kostove gjyqësore të paguara më tepër çështja ARB/14/26 A A Sh.p.k në vlerën **59,504 Euro**, veç vlerave të tjera që rrjedhin nga vendimi për këtë çështje. - Nga ana e Avokaturës së Shtetit të merren masat e nevojshme për t`u njohur dhe reaguar në kohë në rastet kur gjyqfituesit e vendimeve të gjykatave të huaja apo arbitrazhit ndërkombëtar kërkojnë zbatimin e vendimit në vende ku Shteti Shqiptar gëzon të drejta, duke

	njohjen e vendimit edhe në gjykata të tjera ndërkombëtare ku Shteti Shqiptar gëzon të drejta. -Në 4 çështje të gjykuara, janë rrëzuar pretendimet e Palës Paditëse dhe vendimi ka rezultuar në favor të Shtetit Shqiptar. Edhe për këto çështje Avokatura e Shtetit nuk dispononte informacion mbi njohjen e këtyre vendimeve pranë Gjykatave të Apelit. Njohja e vendimeve të këtyre proceseve gjyqësore pranë këtyre gjykatave kanë të bëjnë me njohjen e të drejtës për rimbursimin e kostove të paguara më parë nga shteti shqiptar gjatë procesit gjyqësor dhe nuk janë vlera financiare shtesë të fituara. -Në **2 çështje**t e zhvilluara pranë ICSID konkretisht: Çështja ARB/17/6 me palë paditëse A -A G Limited, kostot e Arbitrazhit të cilat janë parapaguar në avancë prej saj, sipas pikës 299 të vendimit paraqiten në vlerën **250,000 Euro,** ndërsa shpenzimet gjyqësore janë deklaruar 1,020,000 Euro. Nga ana e ASH është lënë nuk ka pasur veprime të mëtejshme për njohjen dhe ekzekutimin e këtij vendimi. Ndërkohë që ky vendim duhet të ishte njohur nga ASH me qëllim kërkimin e kostove përkatëse të paktën prej 250,000 euro. Çështja ARB/14/26 A A Sh.p.k, M. A N and C S.r.l. gjykata ka marrë vendim më datë 20.03.2020 në të cilin ka vendosur detyrimin e palës paditëse për pagesë të kostove dhe shpenzimeve të gjykimit përkatësisht, Euro 1,857,000 USD 427,488.72, GBP 106,755 me një total të llogaritur sipas kursit të publikuar të Bankës së Shqipërisë datës 31.12.2020 rreth 2,323,292 Euro. Referuar pikës 565 të këtij vendimi evidentohet se, Shqipëria ka paguar 399,900 Euro kosto arbitrazhi nga 380,000 USD që duhet të paguante, pra një vlerë më të madhe se ajo të cilën duhet të paguante në fakt. Referuar kursit të këmbimit të datës 31.12.2020 vlera e paguar tepër llogaritet në **59,504 Euro** më tepër të paguara padrejtësisht për të cilën nga ASH duhet të merren masat në vijim për rikuperim. Ajo çfarë vihet re në këtë rast është investimi i vetë ASH për njohjen e vendimit pranë Gjykatës së Apelit ndryshe nga raste të tjera që për njohjen e vendimeve institucioni shprehet se nuk ka informacion pasi nuk thirret nga këto gjykatat. -Në **2 çështje**t e tjera të zhvilluara pranë ICC, çështja, H srl 20564/EMT/GR V2014 me vlerë vendimi 7,343,668 euro e cila ka marrë formë përfundimtare dhe H srl 22919/GR V2017, me vlerë vendimi 733,076 Euro, Avokatura e Shtetit nuk dispononte informacion mbi njohjen e këtyre vendimeve pranë Gjykatave të Apelit. Nëpërmjet të dhënave të disponuara nga auditime të KLSH pranë MIE, rezultoi se, Gjykata e Apelit, Tiranë me vendimin nr.202, datë 16.10.2018 ka njohur vendimin e çështjes së vitit 2014, ndërsa sa i përket vendimit të vitit 2017 kërkesa është regjistruar në gjykatë më datë 26.02.2020 dhe pritet njohja e tij.	*nr 25-69 të Raportit Përfundimtar*		analizuar në çdo rast përdorimin e mjetit ligjor më efektiv për mbrojtjen sa më të plotë dhe cilësore të interesit të vendit. - Avokatura e Shtetit për çështjet e humbura në arbitrazhin ndërkombëtar dhe gjykatat e huaja, të cilat kanë penalizuar taksapaguesit shqiptarë me një barrë mjaft të lartë financiare, të analizojë dosjet gjyqësore dhe të informojë Këshillin e Ministrave për të gjitha shkeljet dhe mosveprimet e institucioneve respektive vendase, të cilat duhen adresuar, me qëllim nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse dhe evitimin e veprimeve të padrejta dhe/ose abuzive në të ardhmen.
2.	Nga auditimi rezultoi se, nga ana e institucioneve shqiptare pjesë e procesit për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), nuk rezulton të jenë zbatuar afatet 3 mujore për zbatimin e këtyre vendime parashikuar në vendimet përkatëse por edhe nenin 19/4 të Ligjin nr. 10018 datë 13.11.2008 ñPër Avokaturën e Shtetitò, i ndryshuar. Gjatë periudhës nën auditim vitet 2018-2020 janë zbatuar 3 vendime në vlerën 109,962 Euro, ndërkohë që rezultojnë të pazbatuar 7 vendime të tjerë me vlerë të pagueshme 17,956,320 Euro, pa përfshirë këtu interesat e pagueshëm në rast vonesash referuar pikës 3 të nenit 19/4 në ligjin e sipërcituar. Vendimet e pazbatuar datojnë prej vitit 2015 deri në vitin 2020. Dy prej tyre të cilët përbëjnë dhe peshën kryesore të vlerës financiare për tu përballuar nga	**Drejtimi nr. 2** *"Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave pasurorë të shtetit në gjykatat vendase dhe të huaja"*	E lartë	-Avokatura e Shtetit në rolin e njësisë përgjegjëse për mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ por dhe të përfaqësuesit përpara Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për ekzekutimin e këtyre vendimeve, të informojë Këshillin e Ministrave për vendimet ende të paekzekutuar, si dhe vlerën e interesave financiarë të llogaritur për moszbatimin në afat të tyre, të cilat e ekspozojnë në vijimësi buxhetin e shtetit me vlera të konsiderueshme financiare.

	buxheti i shtetit përkatësisht **"Sh and oth v. Albania"** dhe **"D dhe N vs. Albania"**, me vlerat penalizuese për Republikën e Shqipërisë përkatësisht, 13,447,300 Euro dhe 4,417,750 Euro, nuk rezultojnë të jenë zbatuar brenda afateve të përcaktuara. Moszbatimi në afat i tyre krijon risk për aplikim interesash të pagueshme në vlera të konsiderueshme. Deri më datë 31.12.2020 interesat e pagueshme llogariten në vlerën rreth **1,675,938 Euro** dhe përbëjnë efekt financiar potencial në dëm të buxhetit të shtetit.	*Trajtuar më hollësisht në faqet nr 25-69 të Raportit Përfundimtar*		- Avokatura e Shtetit për dy çështjet kryesore **"Sh and oth v. Albania"** dhe **"D dhe N vs. Albania",** të cilat kanë penalizuar taksapaguesit shqiptarë me një barrë mjaft të lartë financiare, të analizojë dosjet gjyqësore dhe vendimet e GJEDNJ dhe të informojë Këshillin e Ministrave për të gjitha shkeljet dhe mosveprimet e institucioneve respektive vendase, të cilat duhen adresuar, me qëllim nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse dhe evitimin e veprimeve të padrejta dhe/ose abuzive në të ardhmen.
3.	Nga auditimi rezultoi se, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me shkresën nr. 2238 prot., datë 18.05.2016 i ka përcjellë Avokaturës së Shtetit kopjen e kërkesës për gjykim drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, në lidhje me procedimin penal nr.36, të vitit 2014. Kallëzimi penal ishte bërë për shkak se ishin dhënë AMTP në kundërshtim me ligjin 7501, ñPër tokënò. Sipërfaqe toke që realisht janë *"tokë pa fryt",* ranishte buzë detit ishin dhënë në pronësi si tokë bujqësore. Sipërfaqja e tokës përfituar në **kundërshtim** me ligjin ishte **985,900 m^2,** vlera e së cilës, sipas çmimit të hartës së tokës referuar VKM nr. 89 datë 03.02.2016 ñ*Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë*ò, Bashkia Rrogozhinë, zona Vilë-Bishtovë, ZK 3774 në zërin tokë bujqësore, arrin **371,684,300 lekë** (985,900 m^{2}x 377 lekë/m^2), ndërkohë që kjo tokë gjendet buzë detit dhe vlera e saj mund të jetë më e lartë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë me vendimin nr. 194, datë 21.10.2016 ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurve dhe **vazhdimin e sekuestros preventive** deri në zgjidhjen civilisht të konflikteve në lidhje me pronësinë e parcelave objekt sekuestroje. Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.576, datë 11.07.2017 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit penal nr. 194, datë 21.10.2016. Më datë 30.01.2018 Zyra e Inspektimit në Avokaturën e Shtetit i ka përcjellë Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, raportin e inspektimit tematik për trajtimin e këtij rasti. Referuar raportit të inspektimit, avokati i shtetit kishte kryer shkelje shume të rëndë pasi **nuk** është ngritur padia civile me objekt pavlefshmërinë e AMTP-ve të kundërligjshme, apo që janë konstatuar të falsifikuara, me vendim penal të formës së prerë. Me anë të shkresës nr. 1653 prot., datë 09.09.2020 Avokati i Shtetit në Zyrën Vendore Durrës, i ka drejtuar Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës në Kavajë, kërkesën për informacion me objekt ñ*Ekzekutimi i vendimit penal nr. 12-2016-1549/194, të datës 21.10.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë...*ò Nëpërmjet kësaj shkrese, Zyra Vendore Durrës, kërkonte informacion nëse masa e sekuestros preventive ishte ende në fuqi, dhe nëse po, sa është numri i pasurive mbi të cilat është ushtruar ekzekutimi i vendimit, si dhe gjendja juridike aktuale e këtyre pasurive. Nga dokumentacionet e vëna në dispozicion grupit të auditimit, **nuk** identifikohen hapa të tjerë të ndërmarrë për rivendosjen e te drejtave pasurore mbi këto pasuri me pronar Shtetin Shqiptar. Nga sa më sipër **konstatojmë** se, me daljen e: - vendimit të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Kavajë më datë 21.10**.2016**, mbi vazhdimin e sekuestros preventive deri në zgjidhjen civile të pronësisë për 985,900 m^2 tokë në zonën Vilë-Bishtovë, të regjistruara në kundërshtim me ligjin duke, cenuar interesat pasurore të Shtetit Shqiptar,	**Drejtimi nr. 2** *"Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave pasurorë të shtetit në gjykatat vendase dhe të huaja"* *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 25-69 të Raportit Përfundimtar*	E lartë	- Avokatura e Shtetit të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar kalimin në pronësi të shtetit të 985 900 m^2 sipërfaqe toke, e cila referuar regjistrimit në zërin tokë bujqësore arrin vlerën **371,684,300 lekë** dhe përdorimin e saj në interes të qytetarëve shqiptarë. - Titullari i Avokaturës së Shtetit, të ndërmarrë masat e nevojshme për analizimin e rastit të mësipërm me qëllim identifikimin e shkaqeve të cilat kanë ndikuar në mos ngritjen në vijim të padisë civile për mbrojtjen e interesave pasuror të shtetit në këtë çështje penale edhe pas daljes së vendimit penal të formës së prerë me qëllim adresimin e përgjegjësive konkrete dhe mos përsëritjen e tij në të ardhmen.

	-vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës që lë në fuqi vendimin e Gjykatës së rrethit Gjyqësor Kavajë 11.07.**2017**, **-** raportit të inspektimit në Avokaturën e Shtetit më datë 30.01.**2018** sipas të cilit Avokatura Shtetit **nuk** ka ngritur padi civile në këtë proces penal, komunikimet shkresore të ASH-së për kërkimin dhe rivendosjen e të drejtave pasurore të Shtetit mbi këto prona, janë të gjysmës së dytë të vitit **2020.** Avokatura e Shtetit **nuk** rezulton të ketë ndërmarrë masat e nevojshme për të mbrojtur interesat pasurorë të shtetit në këtë çështje.			
4.	Nga auditimi rezultoi se, në tre procedurat mbi përzgjedhjen e studiove ligjore të avokatisë të zhvilluara nga Avokatura e Shtetit gjatë periudhës vitet 2018-2020, zyrat e huaja të përzgjedhura, jorezidente në Republikën e Shqipërisë kanë ofertuar thuajse në të gjitha rastet me TVSH në masën 0%. Faturimet e tyre në vijim janë realizuar në të njëjtën mënyrë me ofertimin, ndërkohë që sipas dispozitave të legjislacionit fiskal, zyrat e huaja duhet të emëronin përfaqësues tatimor në Shqipëri për shërbimin e përfaqësimit/këshillimit ligjor që ato kryejnë si dhe lëshimin e faturës tatimore shqiptare me TVSH të aplikueshme në masën 20%. Caktimi i përfaqësuesit tatimor është një detyrim ligjor i cili buron nga nenet 86 pika 1 dhe 2, neni 87, të ligjit nr. 92/2014 ñPër Tatimin mbi Vlerën e Shtuarò, i ndryshuar, si dhe UMF nr. 6 datë 30.1.2015 neni 27 pika 1/b,d dhe 2/c, dispozita të cilat përcaktojnë se, <u>në rastet kur marrësi i shërbimit është një institucion publik që nuk është i regjistruar në TVSH, kërkohet emërimi i një përfaqësuesi tatimor për të paguar TVSH-në dhe në mungesë të tij, përfituesi vendas i shërbimit është përgjegjës për të paguar TVSH-në.</u> Pra në kriteret e vendosura në procesin e përzgjedhjes, dispozitat e kontratës së lidhur mes palëve, apo dhe përpara përcjelljes në MFE të faturave të këtyre subjekteve jorezidentë për likuidim, Avokatura e Shtetit duhet të kërkonte caktimin e përfaqësuesit tatimor nga ana e tyre. Sa më lartë, në mungesë të përfaqësuesit tatimor, përfituesit e shërbimit i ngarkohen nga legjislacioni fiskal kosto shtesë mbi vlerën e parashikuar për kontraktim, në masën prej 20% të vlerës së shërbimit që faturohet. Kjo vlerë duhet të llogaritej sipas pagesave individuale dhe duhet të paguhej në llogari të administratës tatimore. Efekti financiar shtesë i cili vjen nga mosnjohja apo keqinterpretimi i dispozitave ligjore në fuqi për TVSH-në sipas vlerës së kontratave të lidhura për të tre kontratat llogaritet rreth **34.5 milion lekë,** të cilat klasifikohen vlera shpenzimesh që kryhen jo në përputhje me parimet e efektivitetit, efiçencës dhe ekonomicitetit së fondeve publike.	**Drejtimi nr. 5** *"Prokurimet e fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime* *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 79-115 të Raportit Përfundimtar*	E lartë	- Avokatura e Shtetit, të kërkoj nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, si njësi e specializuar dhe kompetente për taksat dhe tatimet, interpretim teknik lidhur me aplikimin e TVSH-së apo dhe tatimeve dhe taksave të tjera për rastet e faturimit të shërbimeve të përfaqësimit/konsulencës nga personat jorezidentë drejt organeve publike. Pas përgjigjes së DPT, të ndërmerren masat e nevojshme administrative e ligjore për eliminimin e kostove shtesë të panevojshme në buxhetin e shtetit.
5.	Nga auditimi rezultoi se, për periudhën objekt auditimi, Avokatura e Shtetit, ka zbatuar gjithsej 7 vendime gjyqësore për ish punonjësit që kanë fituar procesin gjyqësor ndaj vendimit të largimit nga puna. Në gjashtë raste është ndjekur procedura në të gjitha shkallët e gjykimit deri në lëshimin e titullit ekzekutiv ndërsa në një rast, është kryer pagesa e 50 % të vlerës së Vendimit Gjykatës Administrative të shkallës së parë, pa pritur vendimin e Gjykatës së Apelit Administrativ. Vlera totale e detyrimit për periudhën objekt auditimi është 8,810,568 lekë, nga e cila është trashëguar nga periudha para vitit 2018 vlera 455,013 lekë dhe është krijuar gjatë periudhës së auditimit vlera **8,355,555 lekë**, nga e cila është paguar vlera 7,067,190 lekë, mbetet për tu paguar në vijim vlera.1,743,378 lekë. Aktualisht Avokatura e Shtetit, ka katër procese gjyqësore për punonjës të tjerë të larguar nga puna.	**Drejtimi nr. 3** *"Përputhshmëria ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave, realizimi i fondit të pagave, shpërblimeve, sigurimeve shoqërore e të tjera personeli"* *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 70-72 të Raportit Përfundimtar*	E lartë	-Avokatura e Shtetit, të marrë masat e nevojshme, për të eleminuar kostot me efekt financiar në buxhetin e shtetit, të krijuara si pasojë e largimit nga puna të punonjësve në kundërshtim me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 ñKodi i Punës i Republikës së Shqipërisëò, si dhe ligjin nr. 152/2013 ñPër nëpunësin civilò.

6.	Nga auditimi rezultoi se, Avokatura e Shtetit, gjatë periudhës 01.01.2018-31.12.2020 referuar relacionit të përcjellë prej saj me e-mailin e datës 18.01.2021(data e përfundimit të auditimit në terren), evidenton ndjekjen nga ana e saj të **32** çështje civile <u>në procese penale</u>, por më herët me e-mailin e datës 08.01.2021 Institucioni kishte referuar një listë me vetëm 22 çështje. Konstatohet se, në **1** nga çështjet e referuara të cilat paraqiten në ndjekje nga Zyrat Vendore, procedimi nr. 1440 i vitit 2019, përcjell nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr.10083 prot, datë 25.06.2019 dhe **në 1 rast** të evidentuar të identifikuar nga Zyra e Inspektimit të ASH në vitin 2018, trajtuar në vijim, nuk është ngritur padi civile në procesin penal, në kundërshtime me pikën 2 dhe 3 të nenit 14, i ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 ñPër Avokaturën e Shtetitò, i ndryshuar si dhe nenit 39 të Rregullores së Brendshme ñPër organizimin dhe funksionimin e Avokaturës së Shtetitò. Këto çështjet penale ishin përcjellë nga Prokuroritë pasi kishte përfunduar hetimi dhe materialet ishin dërguar për shqyrtim në gjykatën e rrethit gjyqësor përkatës, duke i lënë një periudhë të shkurtër kohe A.SH për të përgatitur paditë civile. <u>Për çështjet e tjera informacioni i paraqitur nga Avokatura e Shtetit për auditim ka qenë jo i plotë për të identifikuar kohën kur këto çështje janë përcjellë nga Prokuroria.</u> Midis institucioneve është lidhur edhe një marrëveshje bashkëpunimi, për të garantuar mbrojtjen e te drejtave dhe interesave pasuror të shtetit dhe të shtetasve nga veprimtaria kriminale e cila daton prej vitit 2015. Referuar të dhënave të publikuara në raportin vjetor të Prokurorisë së Përgjithshme mbi aktivitetin e ushtruar, rezulton se vetëm gjatë vitit **2019** ky institucion ka trajtuar 59,888 çështje penale, prej të cilave janë regjistruar **30,695** çështje. Megjithëse, jo në të gjitha rastet që ndiqen nga Prokuroria ka dyshime që janë cenuar interesat pasurore të vendit, <u>numri i **ulët** i çështjeve civile në procese penale të ndjekura nga Avokatura e Shtetit gjatë 3 viteve (32 çështje), krahasuar me numrin e çështjeve penale gjithsej të regjistruara vetëm për vitin 2019 (30,695 çështje), paraqet sinjal për një nivel jo të kënaqshëm bashkëpunimi</u> midis dy institucioneve me qëllim marrjen e masave të nevojshme në kohë, për të siguruar mbrojtjen e interesave të shtetit në çdo rast.	**Drejtimi nr. 2** *"Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave pasurorë të shtetit në gjykatat vendase dhe të huaja"* *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 25-69 të Raportit Përfundimtar*	E lartë	- Avokatura e Shtetit, mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi si dhe marrëveshjen ndërinstitucionale të lidhur, të kërkoj bashkëpunimin e Prokurorisë së Përgjithshme, mbi marrjen e masave të nevojshme për përcjelljen në kohë të çështjeve penale, në të cilat ka dyshime se janë cenuar interesat pasurorë të Shtetit Shqiptar, me qëllim sigurimin e efektivitetit dhe eficencës së procesit të mbrojtjes së tyre. -Avokatura e Shtetit, nëpërmjet Zyrës së Inspektimit, referuar informacioneve të përcjella nga Prokuroria për periudhën nën auditim vitet 2018-2020 në të cilat ka cenim të interesave pasurorë të institucioneve shtetërore ose të personave juridikë publikë, të evidentojë të gjitha rastet për të cilat nuk janë ngritur paditë civile dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme administrative e ligjore, për kërkimin/rikuperimin e tyre referuar legjislacionit në fuqi, duke nxjerrë për çdo rast përgjegjësitë individuale të punonjësve të ngarkuar me këtë detyrë.
7.	Nga auditimi rezultoi se, institucioni për vitin 2018 nuk ka plan inspektimesh të miratuar nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit (APSH). Praktikat e inspektimeve të kryera për vitin 2018 janë kryesisht tematike dhe të fokusuara mbi veprimtarinë e avokatëve të shtetit individualisht dhe jo mbi veprimtarinë e zyrave në tërësi. Inspektimet e evaduara gjatë kësaj periudhe i përkasin inspektimeve të paevaduara të vitit 2017 të cilat janë mbartur në vitin pasardhës. Inspektimet janë kryer në një afat tepër të shkurtër dhe kanë dalë me konkluzione vetëm me shkelje disiplinore. Në raportet e inspektimit nuk disponohet informacion lidhur me çështjet dhe pasojat të cilat kanë /mund të kenë sjellë dëm të interesave të shtetit Shqiptar, nga veprimet apo mos veprimet e avokatëve të shtetit. Për vitet 2019-2020, praktikat e inspektimeve janë të pa inventarizuara, ato përmbajnë vetëm emërtimin e dokumentit ligjor, por nuk është bërë numërimi i fletëve dhe numri total i tyre. Mos respektimi i kuadrit ligjor, lidhur me afatet e përcaktuara për kryerjen dhe evadimin në kohë të Inspektimeve, mos kryerja e Inspektimeve në kohë duke mos mbuluar për një periudhë të gjatë kohe me inspektim ZVASH-të ka rritur riskun në mos përmbushjen e detyrave funksionale nga avokatët e shtetit, pasoja të cilat janë në dëm të interesave të Shtetit. Mos inventarizimi i dokumenteve	**Drejtimi nr. 6** *"Mbi veprimtarinë e Zyrës së Inspektimit si strukturë përgjegjëse për kryerjen e inspektimit të veprimtarisë së avokatëve të shtetit"* *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 115-128 të Raportit Përfundimtar*	E lartë	- Avokatura e Shtetit të marrë masat e nevojshme për hartimin e planeve vjetore të inspektimit, programeve të plota të inspektimit, hartimin e raporteve me informacionet përkatëse të çështjeve në të cilat mbrojtja e interesave të shtetit nuk është kryer në përputhje me përcaktimet ligjore, për të vlerësuar përmbushjen e detyrave funksionale nga avokatët e shtetit si dhe efektet e mospërmbushjes apo keqpërdorimit të detyrës publike. - Avokatura e Shtetit të përfundojë inventarizimin e të gjitha dosjeve të inspektimit për periudhën nën auditim referuar ligjit nr. 9154 datë. 06.11.2003 ñPër Arkivatò, si dhe Normave Tekniko-Ligjore dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor.

	shtetëror sjell pasiguri si dhe mungesë transparence në lidhje me mënyrën e procedimit sipas ligjit, rreth procedurave të ndryshme te ndjekura për plotësimin e nevojave të institucionit, kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi të cilat rregullojnë veprimtarinë institucionale e procedurale.			

I.3. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit:

Nga auditimi i kryer pranë ñAvokaturës së Shtetitò për periudhën 01.01.2018-31.12.2020 lidhur me, përputhshmërinë e veprimtarisë me kuadrin ligjor e rregullator në fuqi rezultoi se:

-Institucioni paraqet mangësi të theksuara mbi arkivimin e dokumentacionit thuajse përgjatë gjithë proceseve të audituara si, praktika kontraktimi, prokurimi, inspektimi, etj, duke ekspozuar njësinë drejt risqeve të theksuara mbi ruajtjen dhe mbrojtjen e dokumentacionit shtetëror.

-Procesi inspektues i ASH rezulton i fokusuar mbi avokatë të veçantë dhe jo mbi veprimtarinë e zyrave vendore dhe periudhave të inspektimit duke mos arritur mbulimin e plotë të veprimtarisë së avokatëve të shtetit në të dyja nivelet e organizimit si dhe të garantoj efektivitetin e këtij sistemi kontrolli.

-Evidentohet bashkëveprim i dobët me prokuroritë e rretheve lidhur me ngritjen e padive civile në proceset penale, megjithëse në këtë kuadër ekzistojnë dispozita të qarta ligjore si dhe janë lidhur memorandume bashkëpunimi midis palëve.

-Në regjistrin elektronik të çështjeve ende nuk rezultojnë të regjistruara çështjet e GJEDNJ dhe apo çështje të regjistruara në gjykata të huaja, dokumentacionet e tyre si dhe fazat përkatëse ku ato ndodhen.

-Institucioni pavarësisht përpjekjeve nuk ka arritur të garantojë rolin caktuar nga ligjvënësi mbi marrjen e masave për zbatimin e vendimeve të GJEDNJ, moszbatimi në kohë i të cilave prodhon efekte financiare të vazhdueshme në dëm të buxhetit të shtetit.

-Avokatura e Shtetit, nuk dispononte informacion mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve të gjykatave të huaja në vend, megjithëse institucioni në nivel vendor ka avokatë shteti të dedikuar pranë ministrive përgjegjëse.

-Angazhimet e ASH-së mbi përfaqësimin në proceset e njohjes së vendimeve të huaja në favor të RSH, pranë gjykatave vendase të apelit paraqiten në standard të dyfishtë.

-Në përfundim të proceseve gjyqësore në gjykatat e huaja të cilët kanë rezultuar me penalitete të rënda financiare për Shtetin Shqiptar, nga ana e Avokaturës së Shtetit mungojnë analizat dhe vlerësimet mbi veprimet dhe mosveprimet e administratës publike, shkaqet, masat që duhet të merren ndaj shkaktarëve, apo sugjerimet/propozimet drejt Këshillit të Ministrave mbi hapat e nevojshëm për tu ndërmarrë me qëllim evitimin e veprimeve të padrejta dhe/ose abuzive në të ardhmen nga funksionarët publikë.

-Mungojnë veprimet e nevojshme administrative e ligjore për rikuperimin e vlerave financiare në rastet e vendimeve në favor të RSH.

-Evidentohen parregullsi administrative në procedurat e kontraktimit, ku si rrjedhojë e mosaplikimit të kritereve të nevojshme mbi lëshimin e faturave për shërbimet e kryera nga studio e huaja të përzgjedhura, prodhohen kosto shtesë të paparashikuara në buxhet për TVSH-në e pagueshme.

-Përpara vendimmarrjeve të kryera nga ASH për kontraktim avokatësh apo zyrash avokatie, vendase apo të huaj, nuk kryhet një proces paraprak dhe i mirë strukturuar, fillimisht për mbledhjen dhe analizimin e informacionit dhe arritjen e konkluzioneve të qarta mbi mundësinë e përfaqësimit nga zyrat përkatëse në ASH për gjykatat e huaja dhe eliminimin e kostove të panevojshme në buxhetin e shtetit, etj.

-OPINIONI I AUDITIMIT

-Nga auditimi mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Avokaturës së Shtetit, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky institucion realizon misionin e tij, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), janë konstatuar disa mangësi dhe parregullsi. Gjatë auditimit në terren janë të marrë të dhëna të mjaftueshme të cilat mundësojnë dhënien e opinionit.

Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë[1]

Sipas opinionit të KLSH-së, nga auditimi i përputhshmërisë[2], i mbështetur në ligjin nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Avokatura e Shtetit, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e ***një opinioni të kualifikuar të përputhshmërisë.***

Baza për opinionin e kualifikuar (ISSAI 4000[3])

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), ISSAI-n 4000 òStandardi i Auditimit të Përputhshmërisëò. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, mbështetur në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesve, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar.

Nga evidencat e marra mbi veprimtarinë e Avokaturës së Shtetit rezultoi se:

Institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë të cilat lidhen kryesisht me ndikimin që institucioni ka në përfaqësimin e interesave të vendit në proceset gjyqësore por edhe sa i përket mirëmenaxhimit të veprimtarisë së tij.

Problematikat e evidentuara i referohen kryesisht; proceseve të ruajtjes dhe arkivimit të dokumentacionit, mungesës së mbulimit territorial me proces inspektues, bashkëveprimit në nivel të pamjaftueshëm me prokuroritë e rretheve lidhur me ngritjen e padive civile në proceset penale, mospërmbushjes të procesit të regjistrimin në regjistrin elektronik të çështjeve të regjistruara në gjykatat e huaja, mosgarantimin e zbatimit të plotë të vendimeve të GJEDNJ, moskryerjes së analizave të posaçme lidhur me procedurat e ndjekura nga institucionet publike për çështjet e humbura të cilat kanë krijuar efekte financiare të konsiderueshme në buxhetin e shtetit dhe mos nxjerrjen e përgjegjësive individuale, mungesës së pjesëmarrjes pranë gjykatave shqiptare të apelit në proceset gjyqësore të njohjes së

[1] Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e KLSH-sëò

[2] Një opinion *i kualifikuar* shprehet kur efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa të justifikojnë dhënien e *opinionit të kundërt* ose një *refuzim të opinionit*

[3] **ISSAI 4000** ï Udhërrëfyesi i Auditimit të Përputhshmërisë

vendimeve gjyqësore të gjykatave të huaja dhe mbajtjes së dy standardeve lidhur me angazhimin për njohjen e vendimeve të dhëna në favor të RSH, mangësive në procedurat e kontraktimit të përfaqësuesve/këshilluesve në profesion të lirë si dhe mungesës së një analize paraprake përpara nisjes të këtyre procedurave, etj, të cilat më vete dhe së bashku kanë ndikime të konsiderueshme në veprimtarinë institucionale si dhe buxhetin e shtetit.

Ne arritëm në konkluzionin se, problematikat e konstatuara kanë ekspozuar institucionin drejt risqeve për përmbushjen e detyrimeve, në zbatim të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë së tij .

II- HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñMbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi ñAvokaturën e Shtetitò, më poshtë e emërtuar ñASHò, në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 1114/1 prot, datë 06.11.2020, ndryshuar me shkresën nr. 1114/3 prot, datë 18.12.2020, për periudhën nga data 01.01.2018 deri në 31.12.2020, me afat auditimi nga data 05.11.2020 deri më 18.01.2021, dhe lloj auditimi ñAuditim Përputhshmërieò i cili u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. K X *(Përgjegjës grupi)*
2. M L
3. J G
4. E K
5. R L
6. M K

Titulli:
Raport Përfundimtar Auditimi, ñMbi Përputhshmërinëò në Avokaturën e Shtetit, Tiranë.

Marrësi:
Ky Raport Përfundimtar i adresohet Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, Zj. B L .

Objektivat dhe qëllimi i auditimit:
Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e sistemeve të ngritura, procedurave të ndjekura nga ñAvokatura e Shtetitò, gjatë procesit të realizimit të tyre në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi: Vlerësimi i saktësisë së informacioneve në aspektet materiale në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator, nëse janë zbatuar parimet e profesionalizmit, të efiçencës, dhe sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik.
Qëllimi i auditimit është, dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional, e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve mbi të cilat është rënë dakord, mbi bazën e të cilave ushtron veprimtarinë ñAvokatura e Shtetitò. Vlerësimin e përputhshmërisë së veprimeve procedurale e administrative, të kryera mbi kriteret dhe kërkesat e legjislacionit. Evidentimi i shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, shfrytëzimin me efiçencë, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike, si dhe dhënia e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes në vijim. Raportimi i të gjitha çështjeve të tjera që dalin apo lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për tâu bërë publike.

Identifikimi i çështjes:
Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së ñAvokatura e Shtetitò, për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2018 deri më 31.12.2020, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni dhe konkretisht:
-Auditimi i veprimtarisë së institucionit mbi përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të shtetit shqiptar pranë gjykatave vendase, gjykatave të huaja si Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), dhe Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (I.C.C), Qendrës Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrveshjeve të Investimeve (ICSID) të Bankës Botërore, Komisionit të Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtën Ndërkombëtare të Tregtisë (UNCITRAL), etj. Vlerat e ekspozimit të Buxhetit të Shtetit nga këto çështje. Auditimi mbi marrëdhëniet e punës, pagave dhe shpërblimeve, procedurat e prokurimit për mallra, shërbime e investime, kontraktimi i studiove për përfaqësimin e interesave të shtetit në gjykatat ndërkombëtare, veprimet financiare të kryera, inventarizimit të pasurisë shtetërore, veprimtarinë e Zyrës së Inspektimit si njësi përgjegjëse për kryerjen e kontrollit të veprimtarisë së avokatëve të shtetit, zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimet e mëparëshme etj.

Përgjegjësia e Drejtimit për Përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi:
Është detyrimi i menaxherëve të njësive, që, në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë sipas përcaktimeve në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, i ndryshuar, Ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, i ndryshuar, si dhe akteve të tjera ligjore e nëligjore që rregullojnë veprimtarinë administrative e financiare.
-*Nëpunësi autorizues* është përgjegjës për veprimet dhe vendimet e nxjerra gjatë veprimtarisë funksionale .
-*Nëpunësi zbatues,* i caktuar, është personi përgjegjës sipas kuadrit normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të treguesve financiarë.

Përgjegjësia e Audituesit të KLSH për auditimin e Përputhshmërisë:
Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar;
-Të vlerësojë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (*ISSAI 4000*), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), bazuar në këto standarde ne aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.
-Të kryejë në mënyrë efektive auditimin (ISSAI 1300)
-Të vlerësojë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në ketë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse.(ISSAI 1500/ISA 300).
-Të kryeje procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objektivi.
Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 ñDeklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-tò, si dhe ISSAI 30 ñKodi Etikò, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me

standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të vlerësuar përputhshmërinë e aktivitetit. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar.

Kriteret e vlerësimit:
-Ligji nr. 10018 datë 13.11.2008 ñPër Avokaturën e Shtetitò ndryshuar me Ligjin nr. 86/2018 datë 22.11.2018 i ndryshuar.
-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar;
-VKM nr. 392, datë 08.04.2009 Për Miratimin e Rregullores ñPër Marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me Institucionet Shtetërore dhe Entet Publike, Rolin e Avokatëve të Shtetit në Gjykim, si dhe Normat e Posaçme Proceduraleò.
-Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò, i ndryshuar;
-Rregullore e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Avokaturës së Shtetit miratuar me Urdhrin nr. 68 datë 28.03.2019 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.
-Akte të tjera ligjore dhe nënligjore të detyrueshme për zbatim.

Standardet e Auditimit:
Auditimi u bazua në:
-Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñ*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*ò, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren ñPër Procedurat e Auditimitò miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 107 datë 08.09.2017, i ndryshuar, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit si:
-ISSAI 100 ñParimet themelore të auditimit të sektorit publikò ku përcaktohen parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
-ISSAI 4000 ñStandarti i Auditimit të Përputhshmërisëò;
-ISSAI 10 ñDeklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e - SAI-tò, si dhe
-ISSAI 30 ñKodi i Etikës:
-Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë. Referencë në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC.

Metodat e auditimit:
Metodat dhe teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit u bazuan kryesisht në metodologjinë e aplikuar gjatë fazës së planifikimit duke i ndërthurur me burimet e brendshme të institucionit, palëve të treta si dhe teknikave të tjera të auditimit ku përmendim:
-*Raporte dhe informacione* të marra nga subjekti i audituar që lidhen direkt me objektivat e auditimit të marra në formë elektronike dhe shkresore;
-*Konfimime* të marra nga palë të treta;
-*Analiza dhe llogaritje* të kryera për vlerësimin e saktësisë dhe plotësisë së transaksioneve;
-*Inspektim fizik* dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse.

-*Intervistimi i personelit* që ka patur role specifike.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit:
Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën, dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Në përfundim të auditimit në terren, mbi bazën e evidencave të marra gjatë auditimit, takimit përmbyllës në terren datë 18.01.2021, akt-konstatimeve të mbajtura, Projekt Raportit të Auditimit dhe observime të paraqitura, u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit.

III- PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Avokatura e Shtetit është person juridik publik, në varësi të Kryeministrit që ka për mision eskluzivitetin e dhënies së asistencës juridike, i cili përfshin shërbimin këshillimor dhe të përfaqësimit për personat juridik shtetëror. Ajo drejtohet nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe organizohet në dy nivele, në nivel qendror dhe vendor. Në nivel qendror përbëhet nga:
a) zyra e përfaqësimit ligjor në gjykatat kombëtare;
b) zyra e këshillimit dhe koordinimit ndërministror;
c) zyra e përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar;
ç) zyra e inspektimit;
d) Kolegji i Avokaturës së Shtetit:
Për periudhën nën auditim 01.01.2018-25.03.2019, Avokatura e Shtetit ka funksionuar sipas strukturës së miratuar me Urdhrin nr. 150 dt. 10.11.2015 të Kryeministrit, me **108** punonjës në total, **32** punonjës në nivel qendror dhe **76** punonjës në nivel vendor. Më pas me Urdhrin nr. 58, dt. 25.03.2019 të Kryeministrit u miratua struktura e Avokaturës së Shtetit e cila paraqitet në **Aneksin-I** pjesë e materialit të auditimit:
Megjithëse me miratimin e Urdhrit nr. 58 dt. 25.03.2019 numri total i punonjës të Avokaturës së Shtetit ka mbetur i njëjtë, **108** punonjës në total, struktura në nivel qendror është zgjeruar dhe ka **43 punonjës**, ndërsa ajo në nivel vendor është tkurrur dhe ka **65** punonjës.
Ndryshimet e fundit në strukturën e Avokaturës së Shtetit janë bërë me miratimin e urdhrit të Kryeministrit nr. 171, dt. 24.12.2019, sipas të cilit pozicioni i specialist IT është shkurtuar dhe numri total i punonjësve të Avokaturës së Shtetit është ulur në **107** punonjës.
Detyrat dhe funksionet parashikohen në rregulloren e brendshme të institucionit. Ndër funksionet bazë të institucionit janë mbrojtja e interesave pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave kombëtare, ndërkombëtare dhe të huaja, ku Republika e Shqipërisë është palë. Këtu përmendim Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim ñGJEDNJò) dhe ñAbitrazhin Ndërkombëtarò. Ligji nr. 10018 datë 13.11.2008 ñPër Avokaturën e Shtetitò ndryshuar me Ligjin nr. 86/2018 datë 22.11.2018 i ndryshuar, VKM nr. 392, datë 08.04.2009 Për Miratimin e Rregullores ñPër Marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me Institucionet Shtetërore dhe Entet Publike, Rolin e Avokatëve të Shtetit në Gjykim, si dhe Normat e Posaçme Proceduraleò, Rregullore e Brendshme ñPër Organizimin dhe Funksionimin e Avokaturës së Shtetitò, etj.

- **Drejtimi 1: "Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm"**

Për periudhën nën auditim në institucion janë zhvilluar dy auditime. Raporti i Auditimit të plotë miratuar me Vendimin nr. 95 datë 30.07.2018 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Raporti i Auditimit Tematik të zhvilluar gjatë vitit 2019 miratuar me vendimin nr.144 datë 14.12.2019 të Kryetarit të KLSH-së të cilët trajtohen si më poshtë vijon:

1.1 Mbi rekomandimet e lëna në Auditimin e zhvilluar gjatë vitit 2018:

Referuar rekomandimeve të lëna në Raportin Përfundimtar të Auditimit miratuar me vendimin nr. 95 datë 30.07.2018, KLSH ka kryer verifikimin e përmbushjes së tyre dhe masave të marra nga institucioni. Grupi i auditimit të KLSH në vijim të autorizmit nr. 450 datë 26.06.2019 ñ*Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna"*, ka mbajtur Aktverifikimin i cili është regjistruar pranë ASH me nr. 2661/1 prot, datë 02.07.2019. Referuar statusit të zbatimit të rekomandimeve pas Aktverifikimit me status, *pa zbatuar* ose *në proces zbatimi*, si dhe dokumentacionit dhe komenteve të paraqitura nga ASH lidhur me zbatimin e tyre, gjendja e tyre rezultoi si më poshtë vijon:

a) Rekomandime për Masa organizative janë lënë **2** rekomandime, të pranuara, **në proces zbatimi 1** dhe **pa zbatuar 1.**
b) Rekomandime për Masa për Zhdëmtim janë lënë **2** rekomandime për shumën 31,500 lekë dhe 385 euro nga të cilat, janë pranuar **2**, është **në proces zbatimi 1** dhe **pa zbatuar 1.**
c) Rekomandime të ardhura të munguara në dëm të buxhetit të shtetit janë lënë **2** rekomandime të cilat janë pranuar dhe janë **pa zbatuar 2**.
d) Masa disiplinore është lënë **1** rekomandim i pranuar **i pa zbatuar**.

Më hollësisht ecuria e zbatimit të rekomandimeve paraqitet si më poshtë vijon:

B. REKOMANDIME PËR MASA ORGANIZATIVE

Gjetje 1. Për periudhën objekt auditimi janë kryer shpenzime në vlerën totale prej **144,740 lekë** për dërgim nëpërmjet Postës Shqiptare të 11 materialeve zyrtare në disa zyra apo studio avokatie me seli në disa shtete të ndryshme si; Itali, Zvicër, Suedi, New York dhe deri në Singapor. Për këto korrespondenca u kërkua informacion në protokollin e institucionit me qëllim evidentimin e çështjeve për të cilat është interesuar Shteti Shqiptar, por nga protokolli nuk na u paraqit asnjë informacion për problemet e lindura dhe marrëdhëniet midis tyre dhe Avokaturës së Shtetit. Kjo mënyrë veprimi tregon mungesë transparence nga Avokatura e Shtetit në lidhje me marrëdhëniet që krijohen midis institucionit (ASH) me studiot avokatore me seli në shtete të ndryshme.

Rekomandimi:

Marrjen e masave për administrimin e kopjes së të dhënave për çdo korrespondencë me studiot e avokatisë si dhe krijimin e databass-eve të veçanta për çështje të ndryshme sipas nenit 22, pika 2 e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", ku përcaktohet se: "*Arkivat shtetërore vendore janë te detyruar te regjistrojnë çdo pasuri dokumentare jo administrative, qe ekziston ne territorin e njësisë se tyre...*".

Afati për zbatimin e rekomandimit ***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

Përgjigja e institucionit
Avokatura e Shtetit ka parashikuar specifikat e databases të rekomanduara më lartë në Rregulloren e Brendshme të miratuar me Urdhrin e Avokatit te Përgjithshëm nr. 68, datë 28.03.2019.

Qëndrimi i grupit të Auditimit:
Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe ***në proces zbatimi.***

Gjetje 2. Nga auditimi për zbatimin e rekomandimeve të mëparshme të KLSH (me shkresë të KLSH me nr.264/8, datë 12.10.2015), në lidhje me arkëtimin e garancisë së ofertës së paraqitur nga shoqëria ñV.E. P Ltdò për procedurën e zhvilluar për privatizimin e shoqërisë ñA.ò sha, Patosò, KLSH ka rekomanduar: ñTë vazhdojë me përparësi ndjekja e procedurave ligjore brenda dhe jashtë vendit, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në bashkëpunim të ngushtë me Avokaturën e Shtetit, për të mundësuar arkëtimin e kësaj shume, duke e detyruar subjektin përkatës të respektojë kushtet e tenderit dhe të gjitha detyrimet rrjedhojë e këtij procesi. Nga verifikimi pranë Avokaturës së Shtetit mbi statusin e zbatimit të këtij rekomandimi, rezultoi se midis Avokaturës së Shtetit dhe ish-(MZHETTS), sot Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka pasur korrespondencë në lidhje me këtë problematikë, sikurse shkresat me nr. 8276/2, datë 30.10.2015, me nr. 8291/2, datë 20.11.2015, nr. 2564/1 datë 30.05.2016 dhe nr. 7992/1, datë 14.10.2016, mirëpo në to Avokatura e Shtetit ka kërkuar thjesht marrje informacioni mbi dosjen e privatizimit të A. sh.a, dhe nuk ka këmbengulur të dijë mbi ecurinë për të përshpejtuar dhe mundësuar nga ana ligjore arkëtimin e garancisë së ofertës. Institucioni i Avokaturës së Shtetit ka pasur dijeni për mos arkëtimin e garancisë së privatizimit, në vlerën prej 85 milionë Euro nga kompania V.E. P Ltdò që nga viti 2012. Deri tani, ky institucion, ende nuk ka marrë asnjë veprim ligjor, në bashkëpunim me ish- METE, ish-MZHETTS, tashmë Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për arkëtimin e kësaj vlere, në bazë të ligjit 10018 ñPër Avokaturën e Shtetitò datë 13.11.2008 neni 5 pika 1 germa ñëò. Gjithashtu, Avokatura e Shtetit me shkresa zyrtare, duhej të kishte sensibilizuar dhe tërhequr vëmendjen, që strukturat e larta shtetërore të përfshira në këtë çështje, të mos humbnin kohë, duke iu propozuar atyre mundësitë ligjore për arkëtimin e garancisë së ofertës të paraqitur nga kompania ñV.E.P Ltdò. Kjo mënyrë veprimi nga Avokatura e Shtetit, ka sjellë tejkalimin e të gjitha afateve procedurale deri në atë fazë që çështja të kalojë në heshtje dhe të bëhet e pakërkuar, me justifikimin e artificave procedurale administrative të burokracisë së brendshme të institucioneve të Shtetit Shqiptar, trajtuar më hollësisht në faqen 24, të Raportit Përfundimtar të auditimit.

Rekomandimi:
Avokatura e Shtetit të veproj urgjentisht në përmbushje të detyrimeve të saj si dhe nëzbatim të rekomandimeve të mëparshme të lëna nga KLSH me shkresën nr.478/5, datë 05.09.2013. Për mos arkëtimin e vlerës prej 85 milionë euro të njoftohet Këshilli i Ministrave, në mënyrë që Avokatura e Shtetit, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të marrin masa dhe të përshpejtojnë finalizimin e hapave dhe procedurat ligjore për të mundësuar arkëtimin e garancisë së kontratës nga ñV.E.P ò Ltd, për llogari të Buxhetit të Shtetit.
Afati për zbatimin e rekomandimit ***Menjëherë***

Qëndrimi i grupit të Auditimit:
Veprimet e kryera nga institucioni mbi këtë çështje trajtohen më hollësisht më poshtë në pjesën C.II. Të ardhura të munguara në dëm të buxhetit të shtetit.

-Nga korrespondencat shkresore të kryera nga Avokatura e Shtetit me AKBN, MIE, MF dhe Kryeministrinë, si dhe trajtimit në observimin e paraqitur në fazën e Projektraportit, ku citohet se: ñ*Mbledhja e radhës shtyhet më datë **21.01.2021,** për marrjen e vendimit përfundimtar të këtij grupi*ò, si dhe mosparaqitjes së informacioneve të mëtejshme lidhur me këtë çështje, ky rekomandim konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe vlerësohet ***i pazbatuar.***

C.I. REKOMANDIME PËR MASA ZHDËMTIMI

Gjetje 1. Për vitin 2016 Avokatura e Shtetit ka marrë me qira një ambient pune për Degën e Avokaturës Rajonale Korçë nga subjekti fizik privat R T , (Bar-kafe,fast-fud) me numër nipti L E. Marrja me qira e objektit nga ASH është bërë pa procedure prokurimi, pa përcaktuar sipërfaqen e objektit në kundërshtim me ligjin nr. 9643 ñPër procedurat e prokurimit publikò, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.
Për këtë objekt, Avokatura e Shtetit ka xhiruar në llogarinë likuiduese të subjekti privat vlerën totale prej 210,000 lekë, pa ndalur tatimin në burim në masën 15 % ndaj subjektit përfitues në shumën **31,500 lekë** (210,000 x 15 %), në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 ñPër tatimin mbi të ardhuratò, i ndryshuar, neni 8 të ardhurat e tatueshme, kreu IV ñTatimi i mbajtur ne burimin e te ardhurave, neni 33 ñMbajtja në burim e tatimit mbi të ardhuratò.

Rekomandimi:
Marrjen e masave për të arkëtuar sipas dispozitave ligjore vlerën prej 31,500 lekë, nga subjekti privat R T dhe vlera e arkëtuar të xhirohet në Degën e Tatim Taksave.
Afati për zbatimin e rekomandimit ***Menjëherë***

Përgjigja e institucionit
Është dërguar shkresa zyrtare Nr. 3485 Prot, datë 26.12.2018, Degës së Tatimeve Korçë, ñMbi detyrimet që subjekti R T ka ndaj shtetit për tatimin në burimò. Si dhe kemi përgatitur një shkresë të dytë për të marrë konfirmim prej tyre.

Qëndrimi i grupit të Auditimit:
Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe ***në proces zbatimi.***

Gjetje 2.Me urdhër shpenzimin nr.184, datë 08.07.2016, nënshkruar nga znj. A H , në cilësinë e nëpunësit autorizues, është likuiduar agjencia ñA T &T ò Tiranë në shumën prej 361,950 lekë, për shpenzim udhëtim e dieta, (rast emergjent). Shërbimi jashtë shtetit është kryer sipas Autorizimit nr. 4160/1, datë 07.06.2016 nënshkruar nga Ministri i Drejtësisë, me të cilin autorizohet znj. A H dhe znj. B L për të marrë pjesë në zyrën e përfaqësimit në gjykatat e huaja dhe arbitrazhin ndërkombëtar në Londër. Sipas urdhrit miratuar datë 14.06.2016, komisioni i blerjeve me vlera të vogla (A H , E D dhe J D), po në datën 14.06.2016 ka realizuar këtë shërbim me ñ***procedurë blerje emergjente".***
Nga verifikimi i dokumentacionit krahasuar me Urdhrin e Ministrit, në praktikën e këtij shërbimi u gjend një biletë udhëtimi e znj. H në linjën ajrore Washington Londër, e cila nuk justifikon shpenzimin e kryer për linjën Tiranë-Londër.
Pagesa prej 385 Euro, për biletën e znj. H është e pajustifikuar me Autorizimin e Ministri i Drejtësisë nr. 4160/1, datë 07.06.2016 dhe është në kundërshtim me VKM nr. 870, datë 14.12.2011 ñPër trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit, pika 11, ku përcaktohet ñ*Shpenzimet e transportit, të fjetjes dhe pagesat e tjera, në të gjitha*

*rastet, njihen dhe paguhen sipas dokumentit përkatës justifikues*ò(në vend të biletës Tiranë-Londër, u gjend bileta Tiranë-Washington-Londër).

Rekomandimi:
Marrjen e masave sipas dispozitave ligjore për arkëtimin e vlerës prej **385 Euro** nga znj. A H , (në cilësinë e nëpunësit autorizues) pasi shpenzimet e udhëtimit në linjën Tiranë- Londër (dublim shpenzimi), nuk justifikohen me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. nr. 4160/1, datë 07.06.2016.
Afati për zbatimin e rekomandimit ***Menjëherë***

Përgjigja e institucionit:
Me urdhrin Nr. 156, datë 22.10.2018, të Kryeministrit, ñPër Lirim dhe Emërim në detyrëô, është bërë lirimi i znj. A H nga detyra e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit dhe është bërë emërimi i z. A M , Avokat i Përgjithshëm i Shtetit.

Qëndrimi i grupit të Auditimit:
Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe është ***i pazbatuar.***

C.II. TË ARDHURA TË MUNGUARA NË DËM TË BUXHETIT TË SHTETIT

Gjetje 1. Nga auditimi për zbatimin e rekomandimeve të mëparshme të KLSH (me shkresë të KLSH me nr.264/8, datë 12.10.2015), në lidhje me arkëtimin e garancisë së ofertës së paraqitur nga shoqëria ñV E P Ltdò për procedurën e zhvilluar për privatizimin e shoqërisë ñA ò sha, Patosò, KLSH ka rekomanduar:*"Të vazhdojë me përparësi ndjekja e procedurave ligjore brenda dhe jashtë vendit, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në bashkëpunim të ngushtë me Avokaturën e Shtetit, për të mundësuar arkëtimin e kësaj shume, duke e detyruar subjektin përkatës të respektojë kushtet e tenderit dhe të gjitha detyrimet rrjedhojë e këtij procesi.* Nga verifikimi pranë Avokaturës së Shtetit mbi statusin e zbatimit të këtij rekomandimi, rezultoi se midis Avokaturës së Shtetit dhe ish-(MZHETTS), sot Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka pasur korrespondencë në lidhje me këtë problematikë, sikurse shkresat me nr. 8276/2, datë 30.10.2015, me nr. 8291/2, datë 20.11.2015, nr. 2564/1 datë 30.05.2016 dhe nr. 7992/1, datë 14.10.2016, mirëpo në to Avokatura e Shtetit ka kërkuar thjesht marrje informacioni mbi dosjen e privatizimit të A sh.a, dhe nuk ka këmbengulur të dijë mbi ecurinë për të përshpejtuar dhe mundësuar nga ana ligjore arkëtimin e garancisë së ofertës.
Institucioni i Avokaturës së Shtetit ka pasur dijeni për ***mos arkëtimin e garancisë së privatizimit, në vlerën prej 85 milionë Euro nga kompania* V E P Ltd**ò që nga viti 2012. Deri tani, ky institucion, ende nuk ka marrë asnjë veprim ligjor, në bashkëpunim me ish- METE, ish-MZHETTS, tashmë Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për arkëtimin e kësaj vlere, në bazë të ligjit 10018 ñPër Avokaturën e Shtetitò datë 13.11.2008 neni 5 pika 1 germa ñëò.
Gjithashtu, Avokatura e Shtetit me shkresa zyrtare, duhej të kishte sensibilizuar dhe tërhequr vëmendjen, që strukturat e larta shtetërore të përfshira në këtë çështje, të mos humbnin kohë, duke iu propozuar atyre mundësitë ligjore për arkëtimin e garancisë së ofertës të paraqitur nga kompania ñV E P Ltdò. Kjo mënyrë veprimi nga Avokatura e Shtetit, ka sjellë tejkalimin e të gjitha afateve procedurale deri në atë fazë që çështja të kalojë në heshtje dhe të bëhet e pakërkuar, me justifikimin e artificave procedurale administrative të burokracisë së brendshme të institucioneve të Shtetit Shqiptar.

Rekomandimi:
Avokatura e Shtetit të marrë masa, dhe të analizojnë me grup pune të veçantë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mosveprimin me qëllim arkëtimin e të ardhurave në favor të buxhetit ***në vlerën 85 milionë Euro***, si dhe të investohet tërësisht dhe urgjentisht në këtë çështje.

Afati për zbatimin e rekomandimit ***Menjëherë***

-Nga verifikimi i mëparshëm i zbatimit të rekomandimeve me Akt-verifikimin nr.1 datë 02.07.2019 ka rezultuar se:
Avokatura e Përgjithshme e Shtetit në përmbushje të rekomandimeve të KLSH-së, i ka kërkuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me shkresat nr. 836, datë 13.02.2019 dhe nr. 836/2 datë 10.05.2019 një udhëzim të veçantë për marrjen e vendimeve takuese në ndërmarrjen e hapave të mëtejshëm për ngritjen e padisë.
Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 2594/4 prot, datë 14.06.2019 i janë deleguar të gjitha tagrat Avokaturës së Shtetit për ngritjen e padisë lidhur me ekzekutimin e garancisë bankare të paraqitur nga subjekti ñV E P ò Ltd.
Nisur nga rëndësia e madhe Avokatura e Shtetit për zgjidhjen e Çështjes dhe strategjisë së mbrojtjes, Çështjen e ka kaluar në Kolegjin e Avokatëve.

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Në proces zbatimi

Përgjigje e subjektit të audituar në observimin e paraqitur mbi Akt-verifikimin nr.1 datë 18.01.2021
-Nga ana e ASH janë paraqitur komente dhe shpjegime lidhur me Akt-Verifikimin e mbajtur ñPër zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSHò, të cilat konsistojnë në:
-Nga ana e Avokaturës së Shtetit ASH janë kryer një sërë korrespondencash me AKBN, MIE, MF, Kryeministrinë, nga ku statusi aktual i rekomandimit është në pritje të mbledhjes së grupi të punës më datë 21.01.2021, për marrjen e vendimit përfundimtar të grupit të punës. Shkresat si më poshtë vijon:
-shkresa nr.836 datë 13.02.2019 dhe nr. 836/2 prot., datë 10.05.2019 drejtuar MFE;
-shkresa nr.4057 date 04.09.2019 drejtuar AKBN;
-shkresa nr.4057/1 datë 04.09.2019 drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të MFE;
-shkresa nr.4057/4 datë 02.10.2019 ri-kujtuesë drejtuar MFE;
-shkresa nr.4057/5 datë 26.12.2019 drejtuar Sekretarit te Përgjithshëm të Kryeministrisë për informim dhe mbështetje. (grupi i auditimit konstatoi se vlera për ekzekutimin e detyrimit e shënuar paraqitet 85,000 euro dhe jo **85 milion Euro** sa është në fakt), çka mund të ndikoj negativisht në caktimin e përfaqësuesve të duhur nga ana e instiucioneve respektive;
-shkresa nr.1250/2 datë 22.04.2020 kërkese drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë;
-shkresa nr.1250/3 datë 23.04.2020 shkresë drejtuar AKBN.
-shkresa nr.1250/8 datë 26.05.2020 shkresë drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Qëndrimi i grupit të Auditimit:
Theksojmë se, fillimisht në lidhje me këtë çështje, grupi i auditimit gjatë fazës së auditimit në terren kërkoi informacion mbi zbatimin e rekomandimeve, nëpërmjet emailit më datë 17.12.2020 dhe deri në fund të auditimit ñPërfundimi i fazën në terrenò me datë 18.01.2020, subjekti apo personat **përgjegjës nuk kanë kthyer asnjë përgjigje në lidhje me këtë çështje**.

Më pas në fazën e hartimit të Projektraportit të Auditimit, Grupi i auditimit shqyrtoi observacionet e paraqitura nga ASH së bashku me shkresat shoqëruese të cituara më sipër. Këto shkresa paraqesin disa hapa të ndërmarra nga ASH në lidhje me rekomandimin e lënë por pavarësisht këtyre veprimeve rekomandimi rezultoi i papërmbushur.
Vlen të përmendim se në disa prej shkresave të cituara më sipër vlera e detyrimit paraqitet jo e saktë, kështu në shkresën nr. 4057 prot, dhe nr. 4057/1 prot, ajo paraqitet 85,000 euro ndërkohë në shkresën nr. 4057/5 prot, ajo paraqitet 80 milion lekë dhe jo **85 milion Euro** sa është në fakt çka mund të ndikoj edhe në nivelin e pjesëmarrjes nga institucionet pjesëmarrëse në këtë proces .
-Nga korrespondencat shkresore të kryera nga Avokatura e Shtetit me AKBN, MIE, MF dhe Kryeministrinë, si dhe trajtimit në observimin e paraqitur në fazën e Projektraportit, ku citohet se: ñ*Mbledhja e radhës shtyhet më datë* ***21.01.2021,*** *për marrjen e vendimit përfundimtar të këtij grupi*ò, si dhe mosparaqitjes së informacioneve të mëtejshme lidhur me këtë çështje, ky rekomandim konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe vlerësohet ***i pazbatuar.***

Statusi aktual i rekomandimit
Pazbatuar

Gjetje 2. Nga auditimi për respektimin e dispozitave ligjore për përzgjedhjen e 3 studiove avokatie të huaja, me objekt mbrojtjen e interesave të shtetit shqiptar me oferta në vlerën prej 2,340,000 euro (nga të cilat 1 kontratë nuk është lidhur), konstatohet se në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 ñPër tatimin mbi të ardhuratò, i ndryshuar, neni 8 të ardhurat e tatueshme, kreu IV ñTatimi i mbajtur ne burimin e te ardhurave, neni 33 ñMbajtja në burim e tatimit mbi të ardhuratò pika 1, nuk është parashikuar ndalesa e tatimit në burim në masën 15% në shumën **351,000 Euro** mbi të ardhurat që do realizohen, duke sjellë si pasojë evazion fiskal për të ardhurat tatimore në RSH.

Rekomandimi:
Avokatura e Shtetit të marrë masa, dhe të analizojnë me grup pune të veçantë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos arkëtimin e të ardhurave në favor të buxhetit ***në vlerën 351,000 Euro***.
Afati për zbatimin e rekomandimit ***Menjëherë***

Përgjigja e institucionit:
...Në planin e veprimit është përcaktuar që ASH të marrë masa të analizojë me grup pune situatën. Nuk rezulton të ketë grup pune të ngritur për këtë qëllim për analizimin e situatës e të nxjerrë konkluzione përkatëse. Detyra jonë është të mbikëqyri ekzekutimin e kontratave me studion ligjore sipas kushteve të përcaktuara në to, ne nuk zëvendësojmë institucionet që përfaqësojnë që të ngarkohemi dhe si institucion përgjegjës për të realizuar pagën në vështrim të legjislacionit tatimor...

Qëndrimi i grupit të Auditimit:
Rekomandimi i lënë nga grupi i auditimit të mëparshëm është i pranuar nga subjekti, referuar planit te veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve ardhur me shkresën nr.219/10 datë 18.02.2019 nga ASH, por situata ka vazhduar pa marrë asnjë masë në lidhje me zbatimin e këtij rekomandimi.
Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe është ***i pazbatuar.***

D. MASA DISIPLINORE DHE TË TJERA

1. Mbështetur në nenin 31 të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 ñPër Avokaturën e Shtetitò i rekomandojmë Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, që brenda muajit shtator 2018, të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësive, shkallën e përgjegjësisë për secilin nëpunës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të filloj procedurat për dhënien e masës disiplinore nga ñVërejtje me shkrimò, ñVërejtje me Paralajmërimò deri në ñShkarkim nga detyraò.
2. Duke pasur parasysh rëndësinë, specifikat dhe problematikat e institucionit të Avokatit të Shtetit në mbrojtjen e interesave të institucioneve dhe aseteve publike, si dhe të fondeve të Buxhetit të Shtetit, përmbi të gjitha parregullsitë dhe shkeljet e konstatuara nga ky auditim do të përcjellim pranë, Kryeministrit, Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Ministrave, Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet përkatëse.
Është e pa konceptueshme që një institucion si Avokati i Shtetit të angazhojë kompani private konsulence pa lidhur kontrata paraprake me to, në shkelje të plotë dhe flagrante të legjislacionit përkatës në fuqi, si dhe të angazhojë kompani private shërbimi, kur vetë i ka të gjitha burimet njerëzore dhe zotëron ekspertizën e duhur për fusha të caktuara të veprimtarisë shtetërore dhe publike.
Mbështetur në nenin 26 të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 ñPër Avokaturën e Shtetitò i rekomandojmë, Kryeministrit dhe Këshillit të Ministrave që, në varësi të shkallës së përgjegjësisë për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të analizoj Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Vendimin përkatës, dhe të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore nga, ñVërejtje me shkrimò, ñVërejtje me Paralajmërimò deri në ñShkarkim nga detyraò apo masa për ndjekje penale, për secilin punonjës, nga niveli më i ulët deri te Avokatit i Përgjithshëm i Shtetit.

Përgjigja e institucionit:
Titullari i institucionit ne gjykimin dhe vlerësimin e Tij, nuk ka ndërmarrë asnjë masë disiplinore.

Qëndrimi i grupit të Auditimit:
Për sa më sipër nuk është paraqitur asnjë dokument shkresor i cili të argumentoj dhe vërtetoj kryerjen e një analize mbi shkallën e përgjegjësive dhe më tej fillimin e procedurave disiplinore për zbatimin e rekomandimit të lënë. Ky rekomandim konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe është ***i pazbatuar.***

1.2 Mbi rekomandimet e lëna në Auditimin Tematik të KLSH gjatë vitit 2019:

Nga auditimi i ushtruar në Avokaturën e Shtetit, me objekt ñAuditim tematik, përputhshmërieò me fokus, vlerat e detyrimeve shtetërore rrjedhojë e vendimeve të formës së prerë të gjykatave ndërkombëtare dhe çështjeve në proces gjykimi për periudhën 01.01.2018 deri më 31.08.2019, me vendimin nr.144 datë 14.12.2019 të Kryetarit të KLSH-së, Avokatura e Shtetit është njohur me rekomandimet e lëna nga grupi i auditmit.
Avokatura e Shtetit, duhet të raportonte me shkrim pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi zbatimin e rekomandimeve **brenda 6-muajsh**, nga marrja e Raportit të Auditimit dhe Shkresës përcjellëse mbi rekomandimet e lëna. Avokatura e Shtetit, nuk e ka zbatuar këtë detyrim ligjor për raportimin, në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014 ñ*Për organizimin dhe*

*funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 30 "Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit*ò;
-Pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga ASH, lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëna, miratuar me **vendimin nr.144 datë 14/12/2019** të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, ecuria e zbatimit të rekomandimeve paraqitet:
Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **3** rekomandime për Masa Organizative, të cilat janë pranuar nga të cilat, **1** rekomandim është në **proces zbatimi** dhe **2** janë me status **pa zbatuar**, më hollësisht situata paraqitet si më poshtë vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi të dhënat e paraqituar nga Avokatura e Shtetit lidhur me çështjet e gjykuara nga gjykatat ndërkombëtare rezultoi se, ende nuk ka përfunduar regjistri i posaçëm për këto çështje, megjithëse nga ana e institucionit janë ndërmarrë hapa administrativë në këtë drejtim. Për këtë, Avokati i Përgjithshëm me Urdhrin nr. 259 datë 01.07.2019 ka përcaktuar personelin përgjegjës për plotësimin e tij. Sipas rregullores së brendshme të institucionit regjistri është detyrues referuar nenit 17 të saj, ku përcaktohet se, pranë zyrës së përfaqësimit krijohet, administrohet dhe përditësohet regjistri i posaçëm fizik dhe elektronik i çështjeve të trajtuara apo në trajtim të gjykatave të huaja, ndërkombëtare dhe arbitrazhit ndërkombëtar, i cili do të plotësohet nga juristi i Zyrës i ngarkuar me këtë qëllim me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit. Lidhur me këtë çështje KLSH në auditimin e mëparshëm pranë këtij institucioni, ka dhënë rekomandimet përkatëse. Sipas të dhënave të disponuara, vendimet e gjykatave ndërkombëtare të dhëna për periudhën nën auditim paraqiten si vijon:

1.1 Vendime të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Sipas informacionit të administruar rezultoi se, për periudhën objekt auditimi ecuria e vendimeve të mëparshme dhe vendimmarrjet e GJEDNJ paraqiten si vijon:

- *Viti 2018*, GJEDNJ ka dalë me tre vendime përfundimtare kundër Shqipërisë duke akorduar shpërblim dëmi në vlerën **13,452,860 euro** nga të cilat janë ekzekutuar vetëm 4,703 euro.
- *Periudha Janar-Gusht 2019*, GJEDNJ ka dalë me katër vendime përfundimtare, në dy prej të cilëve janë rrëzuar pretendimet e palës paditëse dhe dy vendime janë marrë kundër Shqipërisë, duke akorduar shpërblim dëmi në vlerën **117,050 euro.** Nga dy vendimet kundër është ekzektuar plotësisht një vendim dhe ka mbetur i paekzekutuar vendimi me vlerën 13,450 euro.

Shteti shqiptar për periudhën, Janar 2018-Gusht 2019 ka ekzekutuar edhe gjashtë vendime të GJEDNJ, të mbartura nga viti 2017 me një vlerë prej **26,923 euro**. Vendimet të mëparshme ende të paekzekutuar paraqiten katër vendime ndërmjet viteve 2015-2019 të cilat kapin një vlerë financiare prej **17,894,100 euro,** e cila për shkak të aplikimit të interesave në rast vonesash për ekzekutim ka tendencë rritëse.
Me ndryshimet e fundit në ligjin nr. 10018 datë 13.11.2008 ñPër Avokaturën e Shtetitò të cilat kanë hyrë në fuqi më datë 29.12.2018, janë përcaktuar hapat dhe afatet e institucioneve respektive lidhur me ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së të cilat përpara ndryshimeve ligjore nuk parashikoheshin me ndonjë akt ligjor, çka pritet të sjellë përshpejtim të veprimeve dhe uljen e kostove shtesë nga moszbatimi në kohë i tyre.

1.2 *Vendime të Arbitrazhit Ndërkombëtar*

Mbi bazën e të dhënave të administruara rezultoi se, prej vitit 2011 janë dhënë 10 vendime të formës së prerë nga gjykatat e arbitrazhit ndërkombëtar nga të cilët;

-*Tre vendime* janë dhënë në favor të Shqipërisë në shumën 8,168,523 euro për të cilët nuk ka përfunduar ende ekzekutimi i shumave përkatëse megjithëse datojnë prej vitit 2011.
-*Dy vendime* janë dhënë kundër pretendimeve të palës kërkuese.
-*Pesë vendime* janë dhënë në disfavor të Shqipërisë në vlerën **5,188,087 euro** nga të cilat 3 (tre) vendime në shumën e detyrimit 4,230,180 euro janë njohur nga gjykata dhe janë të zbatueshëm megjithëse është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë nga institucioni përkatës apo ASH, 1(një) vendim nuk është njohur nga gjykata dhe për 1(një) vendim Avokatura e Shtetit nuk disponon informacion për njohje nga gjykatat shqiptare. Këto vendime kundër i përkasin periudhave 2012,2015 dhe 2016.
Aktualisht evidentohen 9 (nëntë) çështje gjyqësore në proces ende pa vendim përfundimtar, nga të cilat 3(tre) çështje ndodhen në pritje vendimi dhe 4 (katër) çështje ndodhen në proces shqyrtimi ndërsa për dy çështjet e tjera vendimet janë jopërfundimtare ku përmendim.

-Çështja ñH SRL vs Ministry of Infrastructure & Energyò zhvilluar pranë ICC - Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë është përfunduar gjykimi në themel, **në favor të Shqipërisë** duke rrëzuar pretendimet e Paditësit dhe ngarkuar këtë të fundit me rimbursimin e kostove të Shqipërisë në vlerën 733,075 euro por vendimi konsiderohet jopërfundimtar, pasi Paditësi i ka kërkuar Tribunalit rishikim të Vendimit.

-Çështja ñH SRL, C SRL, F B , M de R , S G L C vs A ò, zhvilluar pranë ICSID - Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimit **ka dënuar Shqipërinë** me vlerën rreth **110,000,000 euro**. Shqipëria ka aplikuar për anulim të vendimit dhe Gjykata e ka pranuar aplikimin. Në përfundim vendimi bëhet i ekzekutueshëm pas njohjes nga Gjykata Shqiptare e Apelit.

Ndryshe nga vendimet e GJEDNJ, vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar bëhen të zbatueshëm në Shqipëri pas njohjes së vendimit nga Gjykata Shqiptare e Apelit. Për vendimet e zbatueshme Avokatura e Shtetit nuk disponon informacion lidhur me shumat e paguara nga institucionet respektive palë në gjykim, e si e tillë vlera e ekzekutuar dhe ajo për tu ekzekutuar nga buxheti i shtetit nuk mund të konfirmohet nga ky institucion, çka në vlerësimin tonë paraqet nevojën për një qasje ndryshe në dispozitat ligjore lidhur me këtë çështje.

1.1 Rekomandimi:

Kërkojmë edhe njëherë që, Avokatura e Shtetit të përfundoj krijimin e një databaze për të pasqyruar të gjitha të dhënat e çështjeve të filluara dhe të përfunduara, duke u angazhuar në zbatimin sa më parë të Urdhrit nr. 259 datë 01.07.2019 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.
Afati për zbatimin e rekomandimit ***Menjëherë***

Përgjigja e institucionit:

Megjithëse është kërkuar informacion, deri në këtë fazë të auditimit nuk ka asnjë përgjigje nga institucioni.

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Duke qenë se ky është rekomandim i përsëritur, trajtimi i tij është bërë më sipër në pjesën Masa Organizative, rekomandimi 1.1 të auditimit të mëparshëm.
Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet ***në proces zbatimi.***

1.2 Rekomandimi:
Avokatura e Shtetit të fillojë ndryshimet për plotësimin dhe përmirësimin e VKM nr. 392,datë 08.04.2009 për të parashikuar detyrimin e Avokaturës së Shtetit për regjistrimin e çështjeve të iniciuara për arbitrazh duke pasqyruar të dhënat mbi objektin e kërkesës, avokatit/studiove të avokatisë vendase/huaj të përzgjedhur për përfaqësimin e çështjeve në arbitrazh nga Avokati i Shtetit si dhe vendimin e arbitrazhit.
Afati për zbatimin e rekomandimit ***Menjëherë***

Përgjigja e institucionit:
Megjithëse është kërkuar informacion, deri në këtë fazë të auditimit nuk ka asnjë përgjigje nga institucioni.

Qëndrimi i grupit të Auditimit:
Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet ***i pazbatuar.***

1.3 Rekomandimi:
Avokatura e Shtetit, të ndërmarrë nismat e nevojshme administrative e ligjore për pjesëmarrjen e detyrueshme të këtij institucioni në të gjithë proceset gjyqësore për njohjen e vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar nga gjykatat shqiptare, si dhe plotësimin e regjistrit elektronik dhe fizik të çështjeve gjyqësore me vlerat e ekzekutuara nga institucionet përkatëse të ngarkuara për zbatimin e tyre.

Afati për zbatimin e rekomandimit ***Menjëherë***

Përgjigja e institucionit:
Megjithëse është kërkuar informacion, deri në këtë fazë të auditimit nuk ka asnjë përgjigje nga institucioni.
Qëndrimi i grupit të Auditimit:
Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet ***i pazbatuar.***

Me shkresën nr.4425/13 datë 26.01.2021 me objekt ñKomente dhe shpjegime mbi Akt Verifikimin Nr.1 të mbajtur nga grupi i auditimit të KLSH ñ*Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH*ò në kuadër të auditimit të ushtruar në ASH në bazë të programit të auditimit nr.1114/1 datë 06.11.2020 i ndryshuar, i miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, i mbajtur më datë 18.01.2021, Avokatura e Shtetit ngre pretendimet si më poshtë vijon:
Pretendimi i subjektit: Në lidhje me gjetjen nr.1 ñTë ardhura të munguara ne dëm të buxhetit të shtetit, janë kryer një sëre korespondecash nga ana e Avokaturës së Shtetit me AKBN, MIE, MF, Kryeministrisë, nga ku **statusi aktual është në pritje të mbledhjes së grupi të punës më datë 21.01.2021**, për marrjen e vendimit përfundimtar prej këtij grupi.

Qëndrimi i grupit te auditimit:
-Theksojmë se, ne lidhje me këtë çështje, nga grupi i auditimit është kërkuar informacion, mbi zbatimin e rekomandimeve, nëpërmjet emailit më datë 17.12.2020 dhe deri në fund të auditimit ñPërfundimi i fazën në terrenò më datë 18.01.2020, subjekti apo personat **përgjegjës nuk kanë kthyer asnjë përgjigje ne lidhje me këtë çështje**. Grupi i auditimit shqyrtoi observacionet të cilat ndryshojnë statusin në lidhje me trajtimin e gjetjes, pas mbledhjes se materialit vënë në dispozicion nga ana e subjektit dhe vënies në dijeni paraprakisht për gjetjet e konstatuara gjate fazës në terren të auditimit, nga ana e subjektit për periudhën e auditimit ñfaza ne terrenò nuk është kthyer asnjë përgjigje për neglizhence apo jo t tyre.

-Lidhur me çështjen dhe sa i përket masave të marra si dhe korrespondencave te kryera nga Avokatura e Shtetit me AKBN, MIE, MF si dhe Kryeministrisë, referuar observacionit i cili citon se: ñ*Mbledhja e radhës do të kryhet më datë **21.01.2021**, midis Avokaturës së Shtetit, Albetrolit si dhe dy përfaqësuesve të AKBN*ò, **priten konkluzionet e mbledhjes së grupit dhe Proces-verbali përkatës** i mbledhjes në lidhje me marrjen e vendimit mbi këtë çështje sensitive, pas njohjes tuaj me këtë ProjektRaport Auditimi.

Pretendimi i subjektit:
Në planin e veprimit është përcaktuar që ASH të marrë masa të analizojë me grup pune situatë. Nuk rezulton të ketë grup pune të ngritur për këtë qëllim për analizimin e situatës e të nxjerrë konkluzione përkatëse. Detyra jonë është të mbikëqyrim ekzekutimin e kontratave me studion ligjore sipas kushteve të përcaktuara në to, ne nuk zëvendësojmë institucionet që përfaqësojnë që të ngarkohemi dhe si institucion përgjegjës për të realizuar pagën në vështrim të legjislacionit tatimor.

Qëndrimi i grupit të auditimit:
Rekomandimi i lënë nga grupi i auditimit të mëparshëm është i **pranuar nga subjekti, referuar planit të veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve ardhur me shkresën nr.219/10 datë 18.02.2019 nga ASH** , por vijohet të mos merret asnjë masë në lidhje me zbatimin e këtij rekomandimi. *Sa më sipër observimi nuk merret parasysh.*

Titulli i Gjetjes 1	**Mos zbatim i rekomandime të lëna në auditimet e mëparshme.**
Situata:	**a.** Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ASH, lidhur me masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna, sipas **Vendimin nr. 95 datë 30.07.2018** të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, aktverifikimit të mbajtur ñ*Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna",* në vijim të autorizmit të KLSH nr. 450 datë 26.06.2019, dhe që kanë rezultuar me status, *pa zbatuar* ose *në proces zbatimi*, ecuria e zbatimit të mëtejshëm të tyre paraqitet si më poshtë vijon: -Rekomandime për Masa organizative janë lënë 2 rekomandime, janë pranuar 2, *në proces zbatimi*. -Rekomandime për Masa për Zhdëmtim janë lënë 2 rekomandime për shumën 31,500 lekë dhe 385 euro nga të cilat, janë pranuar 2, është *në proces zbatimi* 1 dhe është *pa zbatuar* 1. -Rekomandime të ardhura të munguara në dëm të buxhetit të shtetit janë lënë 2 rekomandime të cilat janë pranuar dhe janë *pa zbatuar*. -Masa disiplinore është lënë 1 rekomandim i pranuar dhe *i pa zbatuar*. **b.** Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ASH, lidhur me masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna, në Auditimin Tematik ñMbi përputhshmërinëò miratuar me vendimin nr.144 datë 14.12.2019 të Kryetarit të KLSH-së ecuria paraqitet si më poshtë vijon: -Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **3** rekomandime për Masa Organizative, të cilat janë pranuar nga të cilat, **1** rekomandim është në *proces zbatimi* dhe **2** janë me status *pa zbatuar.* Avokatura e Shtetit, duhet të raportonte me shkrim pranë KLSH mbi zbatimin e rekomandimeve brenda një afati prej 6-muajsh nga marrja e Raportit të Auditimit dhe Shkresës përcjellëse mbi rekomandimet e lëna. Nga ana e Institucionit nuk rezulton të jetë përmbushur detyrim ligjor për raportimin e ecurisë e zbatimit të masave të rekomanduara në auditimin tematik të ushtruar gjatë vitit 2019. Pavarësisht veprimeve të ndërmarra, institucioni nuk ka arritur të përmbush

	plotësisht rekomandimet e lëna, çka paraqet nevojën për vëmendje të shtuar në vijim.
Kriteri:	Ligji nr. 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, neni 30 ñRekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimitò, pika 2 e tij.
Ndikimi/Efekti	Moszbatimi i detyrimit ligjor mbi raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, si dhe mosmarrja në kohë e masave përkatëse, mbi rikuperimin e vlerave financiare të munguara në buxhet, vlerësimin e shkeljeve të konstatuara, etj, ka ndikime negative në përmirësimin e gjendjes në subjektin e audituar dhe përmbushjen e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndosh financiar të institucionit.
Rëndësia	E Lartë

(Për këtë drejtim auditimi është hartuar Akt-Verifikimi nr. 1 regjistruar në Avokaturën e Shtetit me nr. 4425/5 prot, datë 18.01.2021 mbajtur me drejtuesin e institucionit, Zj.Enkelejda Muça)

- **Drejtimi 2: "Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave pasurorë të shtetit në gjykatat vendase dhe të huaja"**

-Procedurat e ndjekura nga institucioni në proceset gjyqësore të zhvilluara.

-*Struktura, detyrat dhe përshkrimi i aktivitetit:*

Referuar pikës 1 dhe 2 të nenit 4 të Ligjit 10018, datë 13.11.2008 ñPër Avokaturën e Shtetitò, i ndryshuar, ñ*Avokatura e Shtetit drejtohet nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe organizohet në dy nivele, në nivel qendror dhe vendor.*ò ñ*Avokatura e Shtetit në nivel qendror përbëhet nga:*
a) zyra e përfaqësimit ligjor në gjykatat kombëtare;
b) zyra e këshillimit dhe koordinimit ndërministror;
c) zyra e përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar;
ç) zyra e inspektimit".

Sipas pikës 3 dhe 4 të nenit të mësipërm, ñ*Avokatura e Shtetit në nivel vendor përbëhet nga:*
a) zyrat vendore, të cilat veprojnë pranë çdo gjykate apeli, ku ushtrojnë dhe kompetencën tokësore;
b) avokatët e shtetit ose zyrat e Avokaturës së Shtetit pranë ministrive.
4. Avokatura e Shtetit ka në përbërjen e saj edhe administratën mbështetëse. Marrëdhëniet juridike të punës së punonjësve të administratës mbështetëse rregullohen sipas legjislacionit në fuqi për marrëdhëniet e punës."

Aktualisht, marrëdhëniet institucionale dhe ndërinstitucionale rregullohen me ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008 ñPër Avokaturën e Shtetitò, i ndryshuar, Rregullorja e brendshme ñPër organizimin dhe funksionimin e Avokaturës së Shtetitò, si dhe Vendim Nr. 381, datë 12.6.2019 ñ*Për përcaktimin e procedurave dhe të kritereve për përzgjedhjen, kontraktimin e pagesën e avokatëve ose zyrave të avokatisë vendase ose të huaja*ò.

Për periudhën nën auditim 01.01.2018-25.03.2019, Avokatura e Shtetit ka funksionuar sipas strukturës së miratuar me Urdhrin nr. 150 dt. 10.11.2015 të Kryeministrit, me **108** punonjës në total, **32** punonjës në nivel qendror dhe **76** punonjës në nivel vendor. Sipas strukturës së miratuar, gjatë kësaj periudhë:
- Zyra Vendore e Tiranës ka funksionuar me 12punonjës,
- Zyra Vendore e Durrësit ka funksionuar me 8 punonjës ,
- Zyra vendore e Vlorë ka funksionuar me 8 punonjës,
- Zyra vendore e Korçës ka funksionuar me 4 punonjës,

- Zyra vendore e Gjirokastrës ka funksionuar me 5 punonjës,
- Zyra vendore e Shkodrës ka funksionuar me 4 punonjës,
- Avokatët pranë ministrive kanë qenë 35 punonjës.

Më pas me Urdhrin nr. 58, dt. 25.03.2019 të Kryeministrit u miratua struktura e Avokaturës së Shtetit e cila paraqitet në **Aneksin-I** pjesë e materailit të auditimit:
Megjithëse me miratimin e Urdhrit nr. 58 dt. 25.03.2019 numri total i punonjës të Avokaturës së Shtetit ka mbetur i njëjtë, **108** punonjës në total, struktura në nivel qendror është zgjeruar dhe ka **43 punonjës**, ndërsa ajo në nivel vendor është tkurrur dhe ka **65** punonjës.
Referuar Urdhrit të Kryeministrit nr.58 dt 25.03.2019, strukturën në nivel vendor paraqitet si më poshtë:
- Zyra Vendore e Tiranës ka funksionuar me **7** punonjës,
- Zyra Vendore e Durrësit ka funksionuar me **8** punonjës ,
- Zyra vendore e Vlorë ka funksionuar me **8** punonjës,
- Zyra vendore e Korçës ka funksionuar me **4** punonjës,
- Zyra vendore e Gjirokastrës ka funksionuar me **5** punonjës,
- Zyra vendore e Shkodrës ka funksionuar me **4** punonjës,
- Avokatët pranë ministrive janë **29.**

Pra, me Urdhrin nr. 58, dt. 25.03.2019, numri i avokatëve të shtetit në Zyrën Vendore Tiranë është zvogëluar, nga **12** që ishte gjatë periudhës nën auditim 01.01.2018-25.03.2019, është bërë **7** ndërkohë që kjo zyrë regjistron një numër të lartë çështjes në rang kombëtar. Gjithashtu edhe numri i avokatëve të shtetit pranë ministrive është zvogëluar, nga **35** që ishin të miratuar me urdhrin nr. 150, dt. 10.11.2015, me miratimin e urdhrit nr. 58, dt. 25.02.2019 janë bërë **29**.
Ndryshimet e fundit në strukturën e Avokaturës së Shtetit janë bërë me miratimin e urdhrit të Kryeministrit nr. 171, dt. 24.12.2019, sipas të cilit pozicioni i specialist IT është shkurtuar dhe numri total i punonjësve të Avokaturës së Shtetit u bë **107** punonjës.

Për vitin 2018
Në raportin vjetor ñMbi analizën e punës për vitin 2018ò, vënë në dispozicion nga subjekti nën auditim, janë analizuar çështjet e ndjekura për vitin 2018 nga 6 zyrat vendore të Avokaturës së Shtetit. Të dhënat paraqiten si më poshtë:

Tabela 1: Çështjet e Zyrave Vendore për vitin 2018

Zyra Vendore	Mbartur	Ardhur	Gjithsej	Përfunduar	Në dorë	Fituar	Fituar pjesërisht	Humbur	Pushim gjykimi	Kthim aktesh	Mos kompetencë	J.juridik	Relatuar	Deleguar
Tiranë	133	1665	1798	1449	349	155	29	48	21	20			886	290
Durrës	481	1326	1807	1316	491	105	24	65	56	23			555	488
Vlorë	229	1344	1573	1014	559	135	23	81	36	51	191	503		
Shkodër	36	1307	1343	1241	102	65	9	44	31	33			21	1038
Gjirokastër	116	445	561	465	86	60	7	110	35	19			83	151
Korçë	213	970	1183	1021	162	86	21	94	32	10	0	37	18	723
Totali	**1208**	**7057**	**8265**	**6506**	**1749**	**606**	**113**	**442**	**211**	**156**	**191**	**540**	**1563**	**2690**

Burimi: Raporti i Analizës së Punës për vitin 2018, i Avokaturës së Shtetit, fq.65
Përpunoi: Grupi i auditimit

Gjatë vitit 2018 në zyrat vendore të Avokaturës së Shtetit, numri i çështjeve të mbartura në total ishte 1208, dhe ai i çështjeve të regjistruara gjatë këtij viti ishte 7057.

Pra, gjithsej për vitin 2018 zyrat vendore të Avokaturës së Shtetit kanë shqyrtuar në total 8,265 çështje prej të cilave, 6506 janë përfunduar brenda këtij viti, 1794 ishin në proces, ndërsa 2690 çështje janë deleguar. Delegimi është kryer mbështetur në urdhrat e brendshëm institucional të cilët rregullojnë delegimin e çështjeve organeve të interesuar. Për këtë vit, referuar të dhënave të paraqitura në raportin vjetor të punës së A.SH, 606 çështje janë fituar, 442 çështje janë fituar pjesërisht, ndërsa 442 janë humbur. Nga të dhënat rezulton se, Zyra Vendore e Tiranës dhe Zyra Vendore e Durrësit kanë patur numrin më të lartë të çështjeve në total, përkatësisht 1798 dhe 1807. Konstatohet se, në Zyrën Vendore Gjirokastër numri i çështjeve të **humbura** është **110**, ndërsa i atyre të fituara dhe të fituara pjesërisht është **67**.
Në total çështjet e trajtuara nga Zyrat Vendore dhe Avokatët në ministri, paraqiten si më poshtë:

Tabela 2: Çështje në Zyrat Vendore të Avokaturës së Shtetit dhe në Avokatët e Shtetin në ministri, për vitin 2018

Zyrat Vendore dhe Avokatët e Ahtetit në Ministri	Mbartur	Ardhur	Gjithsej	Përfund	Ne dore	Fituar	Humbur	Pushuar	Juridiksion/komp	Relatuar	Deleguar
Zyrat Vendore	1208	7057	8265	6506	1749	719	113	442	887	1563	2690
Av. Ministrive	461	5765	6226	5270	956	819	428	172	190	283	3425
Totali	**1669**	**12882**	**14491**	**11776**	**2705**	**1538**	**541**	**614**	**1077**	**1846**	**6115**

Burimi: Raporti i Analizës së Punës për vitin 2018, i Avokaturës së Shtetit, fq.67
Përpunoi: Grupi i auditimit

Nga të dhënat e vëna në dispozicion grupit të auditimit, evidentohet se për vitin 2018 numri total i çështjeve të trajtuara në Zyrat Vendore të Avokaturës së Shtetit dhe nga Avokatët e Shtetin në ministri, ishte 14,491. Ku më specifikisht, 8,265 ishin çështje të mbartura dhe të ardhura në Zyrat Vendore të Avokaturës së Shtetit, ndërsa 6,226 ishin çështje të trajtuara nga Avokatët e Shtetit në Ministri. Gjatë këtij viti në total janë fituar 1,538 çështje, 719 prej të cilave në Zyrat Vendore, ndërsa 817 nga avokatët e shtetit në ministri. Çështje të humbura gjatë këtij viti janë 541, prej të cilave 113 janë ndjekur nga zyrat vendore, ndërsa 428 janë ndjekur nga avokatët e shtetit në ministri. Në vitin 2018, në total janë deleguar 6,115 çështje.

Tabela 3: Dëmi i parandaluar dhe i ardhur në lekë dhe m2, për zyrat vendore në vitin 2018

Nr.	**Zyra Vendore**	**Dëmi i parandaluar lekë**	**Dëmi i ardhur lekë**	**Dëmi i parandaluar m2**	**Dëmi i ardhur ne m2**
1	Tiranë	702,792,032	6,164,830	654,370	219,294
2	Durrës	482.011.305	333,227,027	2,791,496	1,155,452
3	Shkodër	548,024,734	225,483,815	4,302,297	1,548,417
4	Vlorë	434,308,510	1,025,734,475	584,145	1,222,860
5	Korçë	201,196,141	253,619,321	106,279	87,959
6	Gjirokastër	5,677,593	4,505,847	2,719,000	4,084,000
Totali		**2,373,910,315**	**1,848,735,315**	**11,157,587**	**8,317,982**

Burimi: Raporti i Analizës së Punës për vitin 2018, i Avokaturës së Shtetit, fq.71
Përpunoi: Grupi i auditimit

Referuar tabelës së dëmit të parandaluar dhe dëmit të ardhur në lekë dhe m2, të paraqitur në Raportin e Analizës së Punës së Avokaturës së Shtetit për vitin 2018 evidentohet se, dëmi

total i parandaluar është në vlerë 2,373,910,315 lekë, ose 11,157,587 m2 , ndërsa **dëmi**[4] **total** i **ardhur** është në vlerë **1,848,735,315 lekë**, ose **8,317,982 m2**.
Për vitin 2018, nga analizimi i të dhënave sipas zyrave vendore konstatojmë se:
në zyrën vendore Vlorë, dëmi i ardhur në vlerën dhe m2 është ndjeshëm më i **lartë** se dëmi i parandaluar. Dëmi i ardhur është në vlerën **1,025,734,475 lekë ose 1,222,860 m2,** ndërsa dëmi i parandaluar është 434,308,510 lekë ose 584,145 m2.
Për vitin 2018, nga analizimi i të dhënave sipas zyrave vendore konstatojmë se:

- në vendore Vlorë , dëmi i ardhur në vlerë dhe m2 tokë është ndjeshëm më i lartë se dëmi i parandaluar. Dëmi i ardhur është në vlerën 1,025,734,475 lekë ose 1,222,860 m2, ndërsa dëmi i parandaluar është 434,308,510 lekë ose 584,145 m2.
- në zyrën vendore Korçë, dëmi i ardhur në vlerë **tejkalon** dëmin e parandaluar në vlerë, më specifikisht dëmi i ardhur është **253,619,321 lekë**, ndërsa ai i parandaluar është 201,196,141 lekë.
- në zyrën vendore Gjirokastër dëmi i ardhur në m2 tokë është rreth 2 herë më i lartë se ai i parandaluar, më specifikisht dëmi i ardhur është **4,084,000 m2**, ndërsa ai i parandaluar është 2,719,000 m2.

Tabela 4: Dëmi i parandaluar dhe i ardhur në lekë dhe m2, për zyrat vendore dhe avokatët në ministri, në vitin 2018

Nr.	Zyra Vendore/ Avokatët e Ministrive	Dëmi i parandaluar lekë	Dëmi i ardhur lekë	Dëmi i parandaluar m2	Dëmi i ardhur në m2
1	Zyrat Vendore	2,373,910,315	1,848,735,315	11,157,587	8,317,982
2	Avokatët e Ministrive	15,673,496,450	5,453,757,476	744,478	10,368
Totali		**18,047,406,765**	**7,302,492,791**	**11,902,065**	**8,328,350**

Burimi: Raporti i Analizës së Punës për vitin 2018, i Avokaturës së Shtetit, fq.72
Përpunoi: Grupi i auditimit

Nga analizimi i të dhënave të paraqitura në Raportin e Analizës së Punës së Avokaturës së Shtetit për vitin 2018, konstatojmë se dëmi i parandaluar për çështjet e trajtuara nga avokatët e shtetit në ministri është 15,673,496,450 lekë (744,478 m2), ndërsa dëmi i ardhur është në vlerë 5,453,757,476 lekë (10,368 m2). Në total për vitin 2018, për çështjet e trajtuara nga zyrat vendore dhe avokatët e shtetit në ministri, dëmi total i parandaluar është raportuar 18,047,406,765 (11,902,065 m2) , ndërsa dëmi i ardhur është 7,302,492,791 lekë (8,328,350 m2).

Për vitin 2019

Në raportin vjetor ñMbi analizën e punës për vitin 2019ò, vënë në dispozicion nga subjekti nën auditim, janë analizuar çështjet e ndjekura për vitin 2019 nga 6 zyrat vendore të Avokaturës së Shtetit. Të dhënat paraqiten si mëposhtme:

Tabela 6: Çështje në Zyrat Vendore të Avokaturës së Shtetit, për vitin 2019

Zyrat Vendore	Mbartur	Ardhur	Gjithsej	Përfund	Në dorë	Fituar	Pjesërisht	Humbur	Pushuar	Juridiksion/komp	Relatuar	Delegua r
Tiranë	142	1574	1716	1540	176	201	43	85	13	17	777	330
Durrës	455	1587	2402	1081	967	123	26	79	65	17	578	193
Shkodër	86	773	859	694	165	47	9	33	24	31	18	532
Vlore	253	1321	1574	1198	822	168	23	179	41	40	99	687
Gjirokastër	171	606	777	466	323	70	21	92	52	26	7	195
Korçë	145	793	938	725	213	75	25	68	33	22	65	437
Totali	**1252**	**6654**	**7906**	**5704**	**2202**	**684**	**147**	**536**	**228**	**153**	**1544**	**2374**

Burimi: Raporti i Analizës së Punës për vitin 2019, i Avokaturës së Shtetit, fq.107
Përpunoi: Grupi i auditimit:

[4] Termi Dëm i ardhur/Dëm i parandaluar, i referohet termnologjisë së përdorur nga Avokatura e Shtetit në treguesit statistikorë të veprimtarisë vjetore.

Gjatë vitit 2019 në zyrat vendore të Avokaturës së Shtetit, numri i çështjeve të mbartura në total ishte 1252, dhe ai i çështjeve të regjistruara gjatë këtij viti ishte 6654. Pra, gjithsej për vitin 2019 zyrat vendore të Avokaturës së Shtetit kanë patur në shqyrtim në total 7906 çështje prej të cilave, 5704 janë përfunduar brenda këtij viti, ndërsa 2202 ishin në proces. Për këtë vit, referuar të dhënave të paraqitura në raportin vjetor të punës së A.SH, 684 çështje janë fituar, 147 çështje janë fituar pjesërisht, 536 çështje janë humbur, ndërsa 2374 çështje janë deleguar. Nga të dhënat rezulton se, Zyra Vendore e Durrësit dhe Zyra Vendore e Tiranës kanë patur numrin më të lartë të çështjeve në total, përkatësisht 2402 dhe 1716. Konstatohet se, në Zyrën Vendore Gjirokastër numri i çështjeve të humbura është **92**, ndërsa i atyre të fituara dhe të fituara pjesërisht është **91**.
Në total çështjet e trajtuara nga Zyrat Vendore dhe Avokatët në ministri, paraqiten si më poshtë:

Tabela 5: Çështje në Zyrat Vendore të Avokaturës së Shtetit dhe në Avokatët e Shtetin në ministri, për vitin 2019

Zyrat Vendore dhe Avokatët e Shtetit në Ministri.	Mbartur	Ardhur	Gjithsej	Përfund	Ne dore	Fituar	Pjesërisht	Humbur	Pushuar	Juridiksion/ komp	Relatuar	Deleguar
Zyrat Vendore	1252	6654	7906	5704	2202	684	147	536	228	153	1544	2374
Av. Ministrive	764	5233	5977	3833	1476	789	-	340	149	173	218	2845
Totali	**2,016**	**11,887**	**13,883**	**9,537**	**3,678**	**1473**	**147**	**676**	**377**	**326**	**1,762**	**5,219**

Burimi: Raporti i Analizës së Punës për vitin 2019, i Avokaturës së Shtetit, fq.110
Përpunoi: Grupi i auditimit

Nga të dhënat e vëna në dispozicion grupit të auditimit, evidentohet se për vitin 2019 numri total i çështjeve të trajtuara në Zyrat Vendore të Avokaturës së Shtetit dhe nga Avokatët e Shtetin në ministri, ishte 13,883. Ku më specifikisht, 7,906 ishin çështje të mbartura dhe të ardhura në Zyrat Vendore të Avokaturës së Shtetit, ndërsa 5,977 ishin çështje të trajtuara nga Avokatët e Shtetit në Ministri. Gjatë këtij viti në total, janë fituar 1,473 çështje, 684 prej të cilave në Zyrat Vendore, ndërsa 789 nga avokatët e shtetit në ministri. Në 2019-ën janë fituar pjesërisht 147 çështje, Çështje të humbura gjatë këtij viti janë 541, prej të cilave 113 janë ndjekur nga zyrat vendore, ndërsa 428 janë ndjekur nga avokatët e shtetit në ministri. Në vitin 2019, në total janë deleguar 5219 çështje.

Tabela 6: Dëmi i parandaluar dhe i ardhur në lekë dhe m2 sipas zyrave vendore, në vitin 2019

Nr.	Zyra Vendore	Dëmi i parandaluar lekë	Dëmi i ardhur lekë	Dëmi i parandaluar m2	Dëmi i ardhur ne m2
1	Tiranë	2,493,183,998	69,117,587	623,863	253,061
2	Durrës	1,043,240,186	362,019,734	5,111,477	2,921,213
3	Shkodër	911,486,790	185,925,754	18,788,324	1,687,231
4	Vlorë	1,773,762,069	1,801,498,019	16,005,009	11,177,768
5	Korçë	134,748,018	238,389,305	3,601,944	130,599
6	Gjirokastër	61,485,100	127,984,069	8,566,768	15,982,279
Totali		**6,417,906,161**	**2,784,943,468**	**52,697,385**	**32,152,151**

Burimi: Raporti i Analizës së Punës për vitin 2019, i Avokaturës së Shtetit, fq.112
Përpunoi: Grupi i auditimit

Referuar tabelës së dëmit të parandaluar dhe dëmit të ardhur në lekë dhe m2, të paraqitur në Raportin e Analizës së Punës së Avokaturës së Shtetit për vitin 2019 evidentohet se, dëmi total i parandaluar është në vlerë 6,417,906,161 lekë, ose 52,697,385 m2 , ndërsa dëmi total i ardhur është në vlerë 2,784,943,468 lekë, ose 32,152,151 m2.
Për vitin 2019, nga analizimi i të dhënave sipas zyrave vendore konstatojmë se:

- në zyrën vendore Vlorë, dëmi i ardhur në vlerën 1,801,498,019 lekë është më i lartë se dëmi i parandaluar në vlerën 1,773,762,069 lekë;
- në zyrën vendore Korçë, dëmi i ardhur në vlerë tejkalon dëmin e parandaluar në vlerë, më specifikisht dëmi i ardhur është 238,389,305 lekë, ndërsa ai i parandaluar është 134,748,018 lekë;
- në zyrën vendore Gjirokastër dëmi i ardhur në vlerë dhe në m2 është rreth 2 herë më i lartë se ai i parandaluar, më specifikisht dëmi i ardhur në vlerë është 127,984,069 lekë ose 15,982,279 m2, ndërsa ai i parandaluar në vlerë është 61,485,100 lekë, ose 8,566,768 m2:

Tabela 7: Dëmi i parandaluar dhe i ardhur në lekë dhe m2, për zyrat vendore dhe avokatët në ministri, në vitin 2019

Nr.	Zyra Vendore/ Avokatët e Ministrive	Dëmi i parandaluar lekë	Dëmi i ardhur lekë	Dëmi i parandaluar m2	Dëmi i ardhur m2
1	Zyrat Vendore	6,417,906,161	2,784,943,468	52,697,385	32.152.151
2	Av. e Ministrive	33,604,941,322	22,733,850,693	18,620,565	1.020.236
Totali		**40.022.847.483**	**25,518,794,161**	**71,317,950**	**33,172,387**

Burimi: Raporti i Analizës së Punës për vitin 2019, i Avokaturës së Shtetit, fq.113
Përpunoi: Grupi i auditimit

Nga analizimi i të dhënave të paraqitura në Raportin e Analizës së Punës së Avokaturës së Shtetit për vitin 2019, konstatojmë se dëmi i parandaluar për çështjet e trajtuara nga avokatët e shtetit në ministri është 33,604,941,322 lekë (18,620,565 m2), ndërsa dëmi i ardhur është në vlerë 22,733,850,693 lekë (1,020,236 m2). Në total për vitin **2019**, në çështjet e trajtuara nga zyrat vendore dhe avokatët e shtetit në ministri, dëmi total i parandaluar është raportuar 40,022,847,483 lekë (71,317,950 m2), ndërsa dëmi i ardhur është 25,518,794,161 lekë (33,172,387 m2).

Për vitin 2020

Për këtë periudhë nga ana e grupit të auditimit u kërkua informacion mbi veprimtarinë e zyrave vendore dhe avokatëve pranë ministrive për vitin, por ky informacion nuk u vu në dispozicion me spjegimin se, institucioni ishte në fazë hartimi të analizës vjetore për vitin 2020.

Nga sa më sipër konstatojmë se, Zyrat Vendore të Avokaturës së Shtetit, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastër, të cilat për periudhën vitet 2018 dhe 2019 kanë ndjekur rreth 40% të çështjeve gjithsej të ndjekura në nivel zyrash, kanë patur dëm total të ardhur në vlerë, apo m2, ose të dyja së bashku më të lartë se dëmi i parandaluar.

2. Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave pasurorë të shtetit në gjykatat vendase dhe të huaja.

- Procedurat e ndjekura nga institucioni në proceset gjyqësore të zhvilluara
- Evidentimi i çështjeve të regjistruara në regjistrat përkatës të institucionit
- Mbikëqyrja mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë

-Ngritja e padive civile në procese penale

Referuar pikës 1 dhe 2 të nenit 4 të Ligjit 10018, datë 13.11.2008 ñPër Avokaturën e Shtetitò, i ndryshuar, ñ*Avokatura e Shtetit drejtohet nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe organizohet në dy nivele, në nivel qendror dhe vendor.*ò ñ*Avokatura e Shtetit në nivel qendror përbëhet nga:*
a) zyra e përfaqësimit ligjor në gjykatat kombëtare;
b) zyra e këshillimit dhe koordinimit ndërministror;

c) zyra e përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar;
ç) zyra e inspektimit".

Sipas shkronjave b dhe ç të pikës 1 të nenit 5 të ligjit 10018, 13.11.2008 të ndryshuar, Avokatura e Shtetit ñ*përfaqëson dhe mbron interesat pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave kombëtare, ndërkombëtare dhe të huaja, pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit në çështjet gjyqësore, në të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është pale.*ò, ñ *bashkërendon punën me prokurorinë për mbrojtjen, në gjykim, të interesave të shtetit për çështjet civile, zgjidhja e të cilave bëhet gjatë një procesi penal;".*

Referuar nenit 14, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 të ndryshuar, si dhe nenit 39 të Rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Avokaturës së Shtetit, të ndryshuar me urdhrin nr. 68, dt. 28.03.2019, Avokatura e Shtetit mbron interesat pasurorë të shtetit në gjykimet penal. Sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 14 të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, i ndryshuar dhe pikave 1 dhe 2 të nenit 39 të Rregullores së brendshme, date 28.03.2019, ñ*Drejtuesi i prokurorisë së rrethit gjyqësor njofton Avokaturën e Shtetit brenda 7* ***ditëve*** *nga data e regjistrimit të procedimit penal për vepra penale, nga të cilat ka dyshime se janë cenuar interesat pasurorë të institucioneve shtetërore ose të personave juridikë publikë". "Avokatura e Shtetit ngre* ***padi civile*** *në procesin penal për kërkimin e pasurisë ose shpërblimin e dëmit, që u është shkaktuar interesave të shtetit nga kryerja e veprës penale"*

Në vitin 2015, Avokatura e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave kanë lidhur një marrëveshje bashkëpunimi, protokolluar në Avokaturën e Shtetit me nr. 1733 prot, dt. 31.08.2015, me objekt forcimi i bashkëpunimit për të garantuar mbrojtjen e te drejtave dhe interesave pasuror të shtetit dhe të shtetasve nga veprimtaria kriminale e kryer nëpërmjet falsifikimit dhe përdorimit të dokumenteve të falsifikuara.

Referuar shkronjës a), b) dhe d) të nenit 2 të kësaj marrëveshje, Prokuroria angazhohet:

- ñ*Të iniciojë procedimin penal për çdo njoftim për vepra penale që lidhen me falsifikimin e dokumenteve të cilat prekin të drejtën e pronës ose nga të cilat lindin të drejtat e pronësisë duke drejtuar dhe kryer hetimet e nevojshme për mbledhjen e provave, ku përfshihen domosdoshmërisht kryerja e ekspertimeve, marrja e dokumenteve dhe çdo gjë tjetër që i shërben procesit penal*ò;
- ñ*Të njoftojë Avokaturën e Përgjithshme të Shtetit, për regjistrimin dhe procedimin penal kur preken interesat shtetëror sipas objektit të kësaj Marrëveshjeje dhe vendimmarrjen në përfundim të hetimeve paraprake*ò;
- ñ*Në rastin e gjykimit të çështjes, të ndjekë me përparësi ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë, për detyrimet që lindin në lidhjen me pasojat e deklarimit të falsitetit të dokumentit*ò.

Referuar shkronjave a), b) dhe c) të nenit 5 të kësaj marrëveshje, Avokatura e Përgjithshme e Shtetit angazhohet:

- ñ*Të bëjë kallëzim penal në prokurori kur merr dijeni për kryerjen e veprave penale objekt i kësaj Marrëveshje, duke vënë në dispozicion të prokurorit elementet thelbësore të faktit, burimet e provës dhe çdo gjë tjetër që vlen për hetimin e plotë të çështjes e për identifikimin e autorit*ò;
- ñ*Të ngrejë padi civile në proces penal kur konstatohet se preken interesat pasurore të shtetit nga veprimtaria objekt i kësaj Marrëveshjeje"*;

ñ*Me njoftimin e vendimit përfundimtar të prokurorit, të ushtrojë të drejtën e padisë në gjykatë, për mbrojtjen e interesave shtetërore*;

Me qëllim për të shqyrtuar rolin që Avokatura e Shtetit ka luajtur në mbrojtjen e **interesave pasurore** të Shtetit Shqiptar, grupi i auditimit ka kërkuar informacion lidhur me çështjet penale të dërguara nga Prokuroria, gjatë periudhës 01.01.2018-31.12.2020 duke drejtuar kërkesa të njëpasnjëshme verbale dhe shkresore (elektronike nëpërmjet e-mailit zyrtar) Avokaturës së Shtetit për vënin në dispozicion të çështjeve penale të përcjella nga Prokuroria, në të cilat mund të jenë cenuar interesat pasurorë të shtetit, dhe të praktikave të trajtimit të tyre nga Avokatura.
Më specifikisht, grupi i auditimit ka kërkuar këtë informacion nëpërmjet e-maileve zyrtare të dërguara në dt. 23.12.2020, 06.01.2021 dhe 14.01.2021 por pavarësisht kërkesave informacioni **nuk** u vendos në dispozicion.
Më datë 08.01.2021, Avokatura e Shtetit nëpërmjet e-mailit zyrtar i ka përcjellë grupit të auditimit një relacion sipas me 22 çështje, **7** çështje civile të ngritura në procese penale janë në ndjekje nga Zyra Vendore Tiranë, dhe **15** çështje civile të ngritura në procese penale janë në ndjekje nga Zyra Vendore Durrës.
Me anë të e-mailit të dt. 14.01.2021, grupi i auditimit ka kërkuar konfirmim nga institucioni **nëse** gjatë periudhës 01.01.2020-31.12.2020 kanë qenë në ndjekje vetëm **22** çështjet civile në proces penal, të përcjella me e-mailin e dt. 08.01.2021. Pas përfundimit të takimit përmbyllës në terren me subjektin e audituar më datë 18.01.2021, ASH i përcolli grupit të auditimit një relacion *të dytë* mbi çështjet civile në procese penale, të cilat kanë qënë në ndjekje prej saj gjatë periudhës 01.01.2018-31.12.2020. Referuar këtij relacioni, Avokatura e Shetit ka ndjekur **32** çështje civile në procese penale dhe jo **22** të tilla, paraqitur më parë.
Sipas pikës dhe) dhe e) të nenit 15 dhe pikës 1 të nenit 26 të ligjit ñPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, përcaktohet se,

---

ñKontrolli i Lartë i Shtetit, sipas rastit, në fillim, përgjatë dhe/ose në përfundim të veprimtarisë, duhet …
dh) të pyesë dhe të marrë përgjigje, me shkrim ose me gojë, nga subjektet e audituara ose punonjësit e tyre, ***brenda 1*** *jave nga data e paraqitjes së një kërkese paraprake;*
e) në përputhje me nenin 26 të këtij ligji, t'u kërkojë subjekteve të audituara që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej tij…".
*"Kontrolli i Lartë i Shtetit ka të drejtë për të pasur akses në të gjitha dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, në bazat elektronike të të dhënave si dhe në çdo informacion apo dokumentacion tjetër të subjekteve të audituara të parashikuar në këtë ligj, që mund të përbëjë sekret shtetëror apo konfidencial, dhe që konsiderohen të nevojshme në funksion të ushtrimit të kompetencave dhe detyrave të tij ligjore*ò .

Duke qenë se, Avokatura e Shtetit gjatë fazës së auditimit në terren **nuk** ka vënë në dispozicion të grupit të auditimit shkresat e përcjella nga Prokuroria gjatë periudhës 01.01.2018-31.12.2020, mbi çështjet penale në të cilat mund të cënoheshin interesat pasurorë të vendit, si rrjedhojë e këtij kufizimi, grupi i auditimit nuk mundi të verifikonte totalin e çështjeve të përcjella, mbi të cilin të ndërtonte një kampion dhe të kryente verifikimin e mëtejshme të tyre nga A.SH.
Relacionet e paraqitura në datat 08.01.2020 dhe 18.01.2021 (dita e fundit të auditimit në terren), janë të paplota dhe përmbajnë të dhëna të ndryshme mbi numrin e çështjeve përkatësisht 22 dhe 32 të tilla (pasi një çështje rezultonte e dubluar), si dhe janë përcjell me vonesë, duke bërë të pamundur analizimin e mëtejshëm të tyre.

Në përgjigje të observacionit të dërguar nga Avokatura e Shtetit me anë të shkresës nr. 1114/4, dt., 27.01.2021, me objekt ñObservacione për Akt Konstatimeò, sqarojmë si më poshtë vijon:
Pretendimi i subjektit: *" materiali për arsye objektive është vënë në dispozicion me vonesë, për shkak se, Avokatët e Shtetit të Zyrave Vendore, kanë qenë të angazhuara në kryerjen e përfaqësimit ligjor, në procese gjyqësore, duke patur parasysh edhe situatën e rënduar të pandemisë COVID-19. Duke ju kërkuar ndjesë, lidhur me materialin e dërguar me vonesë nga ana jonë, në rrugë elektronike në datë 18.01.2021, ka ardhur si rezultat i ngatërrimit të adresës së e-mailit, duke e dërguar materialin në emër të një avokati shtetit në vend të anëtarit të grupit të auditimit"*
Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në vijim të komentit të subjektit sqarojmë se, grupi i auditimit, duke mirëkuptuar situatën e krijuar nga COVID-19, e cila është një situatë e jashtëzakonshme për të gjithë, ka përsëritur disa here kërkesën për vënien në dispozicione të informacioneve të mësipërme në mënyrë verbale dhe shkresore, për më tepër se një muaj. *Sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë nga ana jonë.*

- *Çështjet civile në procesin penal*

Me e-malin e datës 08.01.2021, subjekti i ka përcjellë grupit të auditimit 22 çështje nga të cilat 7 çështjet civile në proces penal, në ndjekje nga zyra vendore e Tiranës dhe 15 çështjet civile në proces penal në ndjekje nga zyra vendore Durrës. Informacioni i cili u sigurua lidhur me këto çështje, paraqitet në tabelën në **Aneksin II** pjesë e këtij materiali auditimi.

Në përfundim të fazës së terrenit, pas takimit ballafaques me subjektin nën auditim, më datë **18.01.2021**, Avokatura e Shtetit i përcolli grupit të auditimit një **relacion tjetër** mbi cështjet civile në procese penale në ndjekje gjatë periudhës 01.01.2018-31.12.2020. Ky informacion u përcoll nga subjekti edhe me anë të shkresës n*r. 1114/4, dt., 27.01.2021, me objekt "Observacione për Akt Konstatime".* Sipas këtij relacioni, gjatë periudhës nën auditim Avokatura e Shetit ka patur në ndjekje **32** çështje civile në procese penale dhe **jo 22** sikurse paraqitej në relacionin e dërguar nga A.SH, grupit të auditimit me e-mailin e datës 08.01.2021.
Si rezultat se ky informacion është përcjellë pas përfundimit të fazës së terrenit grupi i auditimit nuk mundi të analizonte më tej rolin që ka luajtur A.SH në mbrojtjen e interesave pasurorë të vendit, në këto çështje penale. Çështjet civile në procese penale të ndjekura nga Avokatura e Shetit për periudhën 01.01.2018-31.12.2020, të përcjella me e-mailin e datës 18.01.2021 janë pasqyruar në **Aneksin nr. III** pjesë e këtij materiali auditimi.
Nga analizimi i relacionit të përgatitur nga Avokatura e Shtetit mbi çështjet civile të ndjekura në procese penale, përcjellë grupit të auditimit me e-mailin e dt. 08.01.2021, është vërejtur që në **1 nga 22** çështjet në ndjekje nga zyrat vendore konkretisht çështja nr. 1440 viti 2019 e përcjell nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr.10083 prot, datë 25.06.2019 (sjellim në vëmendje se për çështjet e tjera informacioni i përcjellë ka qenë jo i plotë për të identifikuar kohën kur këto çështje janë përcjellë nga Prokuroria), dhe **në 1 rast** procedimi nr. 36 viti 2014 e përcjell nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë me shkresën nr.2238 prot, datë 18.05.2016 (trajtuar në vijim) nuk është ngritur padi civile në proces penal të identifikuar nga zyra e inspektimit të Avokaturës, Prokuroria i ka përcjellë çështjet penale pasi ka përfunduar hetimi prej tyre dhe ishin dërguar për shqyrtim në gjykatën e rrethit gjyqësor përkatës, duke i lënë një periudhë të shkurtër kohe Avokaturës për të përgatitur paditë civile. Ndërkohë neni 14 i ligjit nr. 10018 datë 13.11.2018, ñPër Avokaturën e Shtetitò, i ndryshuar

obligon dërgimin e informacionit nga Prokuroritë brenda një afati 7 ditor nga data e regjistrimit të procedimit penal.
Në raportin vjetor të Prokurorisë së Përgjithshme ñMbi ngarkesën e punës së prokuroriveò të publikuar në mars 2020, mbi aktivitetin e ushtruar nga ky institucion gjatë vitit 2019 paraqiten të dhënat mbi volumin në hetim ku përfshihen çështjet e mbartura, çështjet e regjistruara, çështjet e rifilluara dhe ato të mosfilluara, për vitin 2019 sipas prokurorive të shkallës së pare. Volumi i çështjeve paraqitet si më poshtë:

Tabela 8: Nr. i çështjeve në ndjekje dhe të regjistruara në Prokurori, për vitin 2019

Prokuroria e shkallës së parë	Nr. i çështjeve në ndjekje në vitin **2019**[5]	Nr. i çështjeve të regjistruara në vitin **2019**
Berat	2212	994
Dibër	943	514
Durrës	5812	2819
Elbasan	4294	2551
Fier	2864	1727
Gjirokastër	1786	742
Kavajë	1101	552
Korçë	2864	1406
Krujë	1335	834
Kukës	666	402
Kurbin	898	470
Lezhë	1723	1042
Lushnje	1791	849
Mat	340	172
Përmet	224	108
Pogradec	1012	499
Pukë	299	137
Sarandë	2276	1065
Shkodër	3004	1671
Tiranë	19168	9612
Tropojë	390	181
Vlorë	4091	2078
për Krime të Rënda	795	270
Totali	***59,888***	***30,695***

Burimi: Raportin vjetor i Prokurorisë së Përgjithshme ñMbi ngarkesën e punës së prokuroriveò, mars 2020, fq 4-7. Përpunoi: Grupi i auditimit

Nëse do ti referohemi të dhënave të publikuara në raportin vjetor të Prokurorisë së Përgjithshme mbi aktivitetin e ushtruar, rezulton se gjatë vitit 2019 ky institucion ka trajtuar 59,888 çështje, prej të cilave 30,695 janë regjistruar në vitin 2019. Në vitin 2019, në Prokurorinë e Tiranës janë regjistruar 9,612 çështje, në prokurorinë e Durrësit janë regjistruar 2819 çështje, në prokurorinë e Elbasanit 2,551 çështje, etj.
Megjithëse, jo në të gjitha rastet që ndiqen nga Prokuroria ka dyshime që janë cënuar interesat pasurore të vendit, numri i **ulët** i çështjeve civile në procese penale të ndjekura nga Avokatura e Shtetit gjatë 3 viteve (32 çështje), krahasuar me numrin e çështjeve penale gjithsej të regjistruara vetëm për vitin 2019 (30,695 çështje), paraqet sinjal për një nivel jo të kënaqshëm bashkëpunimi midis dy institucioneve me qëllim marrjen e masave të nevojshme në kohë, për të siguruar mbrojtjen e interesave të shtetit në çdo rast.

[5] Përfshihet edhe nr. i çështjeve të regjistruara në vitin 2019

- Nga analizimi i të dhënave të vëna në dispozicion grupit të auditimit, u konstatua **një rast** në të cilin Avokatura e Shtetit **nuk** ka ngritur padi civile në proces penal, me objekt **985,900 m^2** sipërfaqe toke.

Përshkrimi i çështjes së përcjellë nga Prokuroria

Me anë të shkresës nr. 2238 prot., datë 18.05.2016 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë, i ka përcjellë Avokaturës së Shtetit kopjen e kërkesës për gjykim drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, në lidhje me procedimin penal nr.36, të vitit 2014. Grupi i auditimit konsultoi shkresën nr. 2238 prot., datë 18.05.2016, protokolluar në Avokaturën e Shtetit me nr. 386 prot., datë 19.05.2016. Sipas shkresës, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë i kishte përcjellë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë kërkesën për gjykim të 5 të pandehurve, të akuzuar për veprën penale të parashikuar nga nenet 186/3 dhe 248 të KP. Kallëzimi penal ishte bërë për shkak se ishin dhënë AMTP në kundërshtim me ligjin 7501, ñPër tokënò. Sipërfaqe toke që realisht janë ñtokë pa frytò, ranishte buzë detit ishin dhënë në pronësi si tokë bujqësore. Sipërfaqja e tokës përfituar në **kundërshtim** me ligjin ishte **985,900 m^2**, vlera e së cilës sipas çmimit të hartës së tokës referuar VKM nr. 89 datë 03.02.2016 ñPër miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisëò, Bashkia Rrogozhinë, zona Vilë Bishtovë, ZK 3774 në zërin tokë bujqësore arrin vlerën **371,684,300 lekë** [985,900 m^{2}x 377 lekë/m^2], ndërkohë që kjo tokë gjendet buzë detit dhe vlera e saj mund të jetë më e lartë.

Gjatë hetimit, ishte vendosur sekuestro preventive në lidhje me parcelën 295 dhe 310 në Zonën Kadastrale 3774 në fshatin Vilë-Bishtovë të Njësisë Administrativë Gosë. Kallëzimi penal ishte iniciuar nga Komisioni i Vlerësimit pranë Prefekturës së Tiranës, Njësia e Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsion pranë Kryeministrit, dhe KLSH.

- *Vendimet e gjykatave*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë me vendimin nr. 194, datë 21.10.2016 ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurve dhe **vazhdimin e sekuestros preventive** deri në zgjidhjen civilisht të konflikteve në lidhje me pronësinë e parcelave objekt sekuestroje.

Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.576, datë 11.07.2017 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit penal nr. 194, datë 21.10.2016, duke ndryshuar këtë vendim vetëm për një nga të pandehurit.

- *Inspektimi tematik mbi trajtimin e këtij rasti nga Avokatura e Shtetit*

Me anë të urdhrit nr. 11, datë 25.01.2018, Avokati i Përgjithshëm ka urdhëruar kryerja e inspektimit tematik në lidhje me trajtimin e shkresës nr. 2238 prot., datë 18.05.2016 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Në vijim të urdhrit nr. 11, datë 25.01.2018 të Avokatit të Përgjithshëm, Avokati i Shtetit i cili duhet të ndiqte çështje ka përgatitur relacionin nr. 166 prot., datë 26.01.2018 mbi praktikën e ndjekur për trajtimin e shkresës së dërguar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë. Referuar relacionit, Avokatura e Shtetit **nuk** ka ngritur padi civile në këtë proces penal. Disa prej argumenteve kryesore për mos njoftimin e Prefekturës së Tiranës dhe mos ngritjen e padisë civile në këtë proces penal, referuar relacionit ishin:

- Bazuar në ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 ñPër shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësoreò, i ndryshuar, të drejtën e kryerjes së hetimit administrativ dhe ngritjes së padisë e kishte Prefekti i Qarkut Tiranë, nëpërmjet Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të pronësisë, i cili në rastin konkret ishte kallëzuesi.
- Avokati i Shtetit nuk mundi të ngrinte padi civile në këtë proces penal dhe për një faktin se një pjesë e mirë e përfituesve të tokës bujqësore me AMTP-të e falsifikuar, nuk ishin të akuzuar dhe për këtë arsye nuk ishin pjesë e procedimit penal.

- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë, referuar nenit 14/1 të ligjit nr. 10018 ñPër Avokaturën e Shtetitò, duhej që të na komunikonte brenda 7 ditëve nga fillimi i procedimit penal nr.36 të vitit 2017 si dhe procedimeve të tjera të lidhura, në ngarkim të të pandehurve, dhe jo pasi i kishte përfunduar hetimet paraprake, duke na komunikuar kërkesën për gjykim të të pandehurve. Ne nuk mund të bëheshim pjesë e këtij procesi në këtë fazë.
- Është pritur vendimmarrja e Gjykatës në lidhje me fajësinë e të pandehurve, për të vijuar me zbatimin e ligjin për njoftimin e Prefektit të Tiranës, dhe ngritjen e padisë civile.
- Praktika ishte ngatërruar midis dokumenteve të tjerë dhe kishte mbetur e pa trajtuar.

Më datë 30.01.2018 Zyra e Inspektimit në Avokaturën e Shtetit i ka përcjellë Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, raportin e inspektimit tematik për trajtimin e këtij rasti. Referuar raportit të inspektimit, avokati i shtetit kishte kryer shkelje shume të rëndë pasi **nuk** është ngritur padia civile me objekt pavlefshmërinë e AMTP-ve të kundërligjshme, apo që janë konstatuar të falsifikuara, me vendim penal të formës së prerë.

Me anë të Urdhrit nr. 11/2, datë 01.02.2018, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit mbështetur në raportin e inspektimit tematik të përgatitur nga zyra e inspektimit për këtë çështje, ka urdhëruar marrjen e masës disiplinore ñShkarkim nga detyraò për avokatin e shtetit që kishte në ngarkim çështjen.

➢ *Hapat e ndërmarra në vijim nga Avokatura e Shtetit, për trajtimin e rastit*

Me anë të shkresës nr. 1653 prot., datë 09.09.2020 Avokati i Shtetit në Zyrën Vendore Durrës, i ka drejtuar Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës në Kavajë, kërkesën për informacion me objekt ñ*Ekzekutimi i vendimit penal nr. 12-2016-1549/194, të datës 21.10.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë...*ò Nëpërmjet kësaj shkrese, Zyra Vendore Durrës, kërkonte informacion nëse masa e sekuestros preventive ishte ende në fuqi, dhe nëse po, sa është numri i pasurive mbi të cilat është ushtruar ekzekutimi i vendimit, si dhe gjendja juridike aktuale e këtyre pasurive. Nga komunikimet me subjektin, grupit të auditimit iu bë me dije se, nuk ka patur përgjigje nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë lidhur me këtë shkresë.

Më pas, me anë të shkresës nr. 1304 prot., datë 09.12.2020, Avokati i Shtetit në Zyrën Vendore Durrës, i ka drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, kërkesën për informacion me objekt ñ *Ekzekutimi i vendimit penal nr. 12-2016-1549/194, të datës 21.10.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë...*ò. Nëpërmjet kësaj shkresë Zyra Vendore Durrës, kërkonte informacion nëse Prokuroria ka nxjerrë urdhrin për ekzekutim të vendimin penal të mësipërm.

Nga dokumentacionet e vëna në dispozicion grupit të auditimit, nuk identifikohen hapa të tjerë të ndërmarrë për rivendosjen e te drejtave pasurore mbi këto pasuri me pronar Shtetin Shqiptar.

Nga sa më sipër **konstatojmë** se, me daljen e:

- vendimit të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Kavajë më datë 21.10**.2016**, mbi vazhdimin e sekuestros preventive deri në zgjidhjen civile të pronësisë për 985,900 m^2 tokë në zonën Vilë-Bishtovë, të regjistruara në kundërshtim me ligjin duke, cënuar interesat pasurore të Shtetit Shqiptar,
- vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës që lë në fuqi vendimin e Gjykatës së rrethit Gjyqësor Kavajë 11.07.**2017**,
- raportit të inspektimit në Avokaturën e Shtetit më datë 30.01.**2018** <u>Avokatura Shtetit nuk ka ngritur padi civile në këtë proces penal,</u>

komunikimet shkresore të A.Sh-së për kërkimin dhe rivendosjen e të drejtave pasurore të Shtetit mbi këto prona, janë të gjysmës së dytë të vitit **2020.** Avokatura e Shtetit **nuk** rezulton të ketë ndërmarrë masat e nevojshme për të mbrojtur interesat pasurorë të shtetit në këtë çështje.

Arbitrazhi Ndërkombëtar me paditës Shoqërinë V I

Në vijim të çështjes së arbitrazhit ndërkombëtar, të iniciuar nga shoqëria ñV I ò, s.r.1, me objekt mosmarrëveshje ñ*shkelje të Traktatit, "Për promovimin dhe Mbrojtjen e Investimeve", të nënshkruara ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë si dhe shpërblimin e dëmit në formën e kompensimit të plotë për humbjet e saj në investimin e kryer, për krijimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së ndërmarrjes së përbashkët "A -G* ò, Avokatura e Shtetit ka kërkuar informacion në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, lidhur me veprimet e ndërmarra nga kjo e fundit, në zbatim të vendimit të Gjykatës së Lartë.

- *Vendimet e gjykatave*

a) *Gjykata e* Rrethit Gjyqësor Tiranë

Nga analizimi i dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, rezulton se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është zhvilluar një proces gjyqësor, me palë paditëse H K , N M , palë e paditur Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, me objekt ñShfuqizimin e vendimit nr.62, datë 09.04.2010 të Kryeregjistruesit të ZQPP, pasi është marrë në kundërshtim me ligjin. Shfuqizimin e vendimit nr. 01, dt. 07.01.2020 të ZVRPP Kavajë. Rregullimin e pasojave të krijuara nga ky vendim duke e kthyer situatën në kartelat respektive të secilit pronar për secilën pasurò, për të cilën gjykata ka vendosur vendimin Nr. 7736, dt. 20.10.2010 pranimin e padisë e ndër të tjera:

ñ*Shfuqizimin e vendimit të palës së paditur ZQRPP Tiranë nr. 62, datë 09.04.2010 dhe vendimin nr. 1, dt. 07.01.2010 të ZVRPP Kavajë. Udhëzimin e ZVRPP Kavajë të bëjë regjistrimin e pronave të paditësve për pasuritë e paluajtshme*é ò.

b) *Gjykata e Apelit Tiranë*

Ndaj këtij vendimi, ZQRPP ka ushtruar të drejtën e ankimimit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë e cila me vendimin nr. 2492, dt. 18.11.2011 ka vendosur: ñLënien në fuqi të vendimit të sipërcituarò.

c) *Gjykata e Lartë*

Kundër vendimin të Gjykatës së Apelit Tiranë, është ushtruar rekurs nga ana e ZQRPP-së, pas shqyrtimit të së cilit Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vendosi me vendimin nr. 00-2015-1875 (332), dt. 26.05.2015 të tij: ñ*Lënien në fuqi të vendimit nr. 2492, dt. 18.11.2011 të gjykatës së Apelit Tiranë përsa i përket shqyrtimit të vendimit nr. 62, dt. 09.04.2010 të Kryeregjistruesit të ZQRPP Tiranë, dhe Vendimit nr. 01. Dt.07.01.2010 të ZVRPP Kavajë. Ndryshimin e vendimit të mësipërm, përsa i përket kërkesës së tretë, rregullimit të pasojave të krijuara duke e rrëzuar këtë kërkim*ò

Ndër të tjera , në pjesën arsyetuese të saj, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë shprehet se: ñ*A G " sh.p.k ka transferuar tek paditësit një pronë për të cilën nuk ka patur titull në kuptim të ligjit të sipërpërmendur dhe u ka transferuar paditësve një të drejtë të cilën ajo nuk e ka vetë.*

Duke pasur parasysh sa sipër, prona e regjistruar në emër të paditësve, tej faktit që nuk mund të fshihet nga regjistrat në rrugë administrative, nuk mund të kthehet në gjendjen aktive, por duhet të qëndroje e kufizuar deri në momentin që paligjshmëria e origjinës se saj të bjerë, në të kundërt kontratat e paditësve për blerjen e pronës ne ankand janë të pavlefshme e nuk sjellin asnjë pasoje. Për ketë shkak, kërkimi i trete i paditësve ne objektin e padisë duhet rrëzuar duke u ndryshuar për këtë pjesë vendimet e gjykatave të faktit."

- *Hapat e ndërmarra për zbatimin e vendimit të Gjykatës së Lartë*

Me anë të shkresës nr. 2235/34 dt. 05.12.2018, Avokatura e Shtetit i ka drejtuar Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme kërkesën për informacionin dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit. Sipas kësaj shkrese, në kuadër të mbrojtjes dhe përfaqësimit të palës shqiptare në procesin e arbitrazhit të përmendur më lartë, ka kërkuar informacion lidhur me vendimet e ndërmarra nga ZQRPP për zbatimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, si dhe gjendjen juridike aktuale të pronave objekt gjykimi.
Në vijim të sa më sipër, nuk evidentohen përgjigje nga ZQRPP, apo hapa të tjerë të ndërmarrë nga Avokatura e Shtetit për identifikimin e gjendjes juridike të këtyre pronave.

- *T`kurrja e kuotave të shtetit shqiptar në shoqërinë A sh.p.*k

Më datë 16.04.2009 është regjistruar pranë qendrës kombëtare të regjistrimit, shoqëria **M -A.** me nipt K E, me ortak fillestar 100% shoqërinë P S M d.d.
Më datë 25.02.2014 është regjistruar pranë qendrës kombëtare të regjistrimit sot Q.K.B, shoqëria **P A sh.p.k**, me nipt L K, me objekt investime në kompani dhe konsulencë. Administrator dhe ortak i vetëm 100% i kuotave të kësaj shoqërie është Z. M C .
Më datë 07.04.2014, tek shoqëria **M -A.** me nipt K E është regjistruar shitje 100% e kuotave të cilat janë blerë nga shoqëria **P A sh.p.k.** Më datë 11.04.2014 pranë QKB-së për shoqërinë **M -A.** është regjistruar ndryshimi i administratorit dhe vendosja e administratorit të ri **po** Z. M C i cili në momentin e emërimit ishte Administrator i shoqërisë pronare të kuotave **P A sh.p.k**.

Shoqëria **A sh.p.k** me nipt J F, është një shoqëri e përbashkët, ku shteti shqiptar ka zotëruar një kuotë kapitali prej 17.27% dhe pjesën tjetër të kuotave e ka zotëruar shoqëria V I .
Më datë 23.06.2014 shoqëria **V I** ka shitur e kuotat e saj në shoqërinë M -A prej 82.73%, regjistruar në ish QKR sot QKB më datë 14.07.2014. Po në këtë datë, është regjistruar dhe ndryshimi në administratorin e ri të shoqërisë A G , ku si i tillë është emëruar Z. M C .
Sipas faqes zyrtare të ish-QKR sot QKB regjistrimi paraqitet:

Datë 14/07/2014
Numri i ceshtjes: CN-544114-07-14
Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitim i vendimit te asamblese se ortakeve date 23.06.2014, ku eshte vendosur:
1) shitja e 82,73% e kuotave nga shoqeria V I ne favor te shoqerise M -A;
2) aprovimi i raportit te ndermjetem te administrimit deri me 31.05.2014;
3) pranimi i doreheqjes te paraqitur nga administratori M C ;
4) lehtesimi i z. M C nga çdo pergjegejsi per gabime te mundshme ne kryerjen e detyres se tij dhe ne limitet e fuqise se tij.Shoqeria merr persiper edhe ne perballje me administraten publike o te enteve qe drejtojne kontributet,debitet per sanksione si rrjedhim te shkeljeve qe administratori mund te kete kryer;
5) emerimi i z.Ma C ne detyren e administratorit per nje afat pese vjeçar;
6) *ne lidhje me shitjen e 82,73% te kuotave te kapitalit ne favor te M -A perfaqesuesi i MZHTS z.A B kundershton shitjen e kuotave deri ne nje vendimmarrje perfundimtare nga organet gjyqesore kompetente per procesin gjyqesor ne te cilin shoqeria "A " sh.p.k dhe individe te tjere jane pale e paditur me kerkese padi te perfaqesuar nga Avokatura e Pergjithshme e Shtetit Shqiptar.Ne lidhje me piken 2, nuk disponojne material mbi prezantimin e situates pasurore dhe*

ekonomike te shoqerise deri ne daten 31.05.2014. Nuk miratohet doreheqja e administratorit te vetem dhe pikat e tjera.
Depozitim i vendimit date 09.04.2014 i shoqerise V I S.R.L.
Depozitim i vendimit te ortakut te vetem te shoqerise P A sh.p.k. date 19.06.2014.
Depozitim i vendimit te ortakut te vetem date 20.06.2014 te shoqerise M -A sh.p.k.
Depozitim i kontrates se shitblerjes Nr.3406 Rep. Nr.506 Kol. date 23.06.2014, per transferimin e 82,73% te kuotave te kapitalit ne favor te shoqerise M -A sh.p.k.

Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme tek ortaket juridik:
eshte shtuar ortaku: ("A C ") Numri i aksioneve "153.583,00 Perqindja ne kapital "82,73 Kontributi ne para "153.583.000,00
eshte larguar ortaku: ("V I ")
Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme tek administratoret:
eshte shtuar administratori: ("M C ") Nga data "23/06/2014 Ne daten "23/06/2019
eshte larguar administratori: ("M C ")

Në faqen zyrtare mungojnë disa vendime dhe dokumentacione të cituara në përshkrim.
Deri në këtë moment z. K është paralelisht administrator i të 3 shoqërive të sipërcituara.

Më datë 09.02.2015 emërtimi i shoqërisë **M -A** ndryshoi dhe u bë **A C** .
Më datë 27.05.2015 shoqëria **A C** ka vijuar procedurën për përthithjen e shoqërisë **P A sh.p.k**. dhe po në këtë datë është regjistruar dhe shitja e 100% të kuotave të **AC** të cilat zotëroheshin nga **PA** tek pronari i ri i kuotave Z. M C . Sipas dokumentacionit të publikuar në faqen zyrtare të QKB, të gjitha vendimet e shoqërive rezultojnë të firmosura nga z. K , ndërkohë që nuk rezulton e publikuar Deklarata Noteriale Nr.802 Rep, Nr.356 Kol, Date 27.04.2015 mbi kalimin e kuotave.

Më datë 15.06.2017, në QKR/QKB është publikuar ndryshimi i emrit të shoqërisë **A sh.p.k** në **A F ,** ndryshimi i administratorit ku është caktuar administrator i ri z.A A sipas vendimit datë 28.04.2017. Në këtë mbledhje ka marrë pjesë edhe MZHETS nëpërmjet përfaqësuesit të tij z. A B , me detyrën Drejtor në Drejtorinë e Administrimit të Pronës Publike, i cili ka mbajtur qëndrimin zyrtar referuar shkresës nr. 4130/2 prot, datë 25.04.2017 të firmosur nga Ministri M E . Sipas pikës 7 të procesverbalit të mbledhjes të frmosur nga përfaqësuesit e ortakëve mbledhja e rradhës është lënë më datë 19.05.2017.
Më datë 19.06.2017 është regjistruar pranë regjistrit tregtar vendimi sipas procesverbalit të mbledhjes të dt. 19.05.2017, në të cilin ka qenë pjesëmarrës vetëm përfaqësuesi ligjor i ortakut A C , ndërsa përfaqësuesi i MZHETS nuk ka marr pjesë. Në këtë mbledhje është vendosur ndryshimi i kapitalit ku pjesa e MZHETS është zvogëluar në 8.24%, nga 17.27% që ishte më parë. Ndërkohë është rritur në mënyrë të njëanshme kapitali për shoqërinë A C nga financimi i dhënë nga aksioneri si borxh pa interes dhe vlera e tij deri më datë 31.03.2017 paraqitej 234,936,419 lekë sipas parashtresës datë 21.04.2017. Përfaqësuesi ligjor i kësaj shoqërie, i cili ka firmosur vendimin e ndryshimit, është Z. M C . Në këtë rast nuk është publikuar asnjë dokument për thirrjen e mbledhjes, orarin dhe vendin e saj. Po kështu nuk evidentohet asnjë qëndrim zyrtar nga ana e Minsitrisë mbi këtë rast.
Referuar sa më sipër, **M A, A sh.p.k** dhe **P Sh.p.k.** vlerësohen si shoqëri të kontrolluara/ influencuara, referuar neneve 207 e vijues të ligjit 9901 dt.

14.04.2008, ñPër tregtarët dhe shoqëritë tregtareò, ndërkohë që sipas dispozitave të këtij ligji, pjesa IV, ñShoqëritë me përgjegjësi të kufizuaraò, Kreu II, Administratorët, neni 95, pika 2, përcaktohet se:

2.ñ*Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm".*

Pra emërimet e z.K në funksionin e administratorit të shoqërive **M -A** dhe **V I** sipas dispozitave të mësipërme janë të pavlefshme dhe nuk mund të prodhojnë pasoja juridike.
Kjo situatë përkon edhe me lidhjen e kontratës së blerjes së kuotave të shoqërisë V sh.p.k. ku ndryshimi i kuotave në disfavor të shtetit shqiptar miratuar me vendimin e datë 19.05.2017 jo vetëm është i njëanshëm por evidenton parregullsi lidhur me legjitimitetin e caktimit administrator në shoqëritë e kontrolluara, tagrat e përfaqësuesit të ortakut i cili me datë 19.05.2017 i cili rezulton zyrtarisht administrator i shoqërisë **A sh.p.k** dhe njëkohësisht ka firmosur si përfaqësues ligjor i **A C ortaku kryesor i A sh.p.k,** <u>në kundërshtim me</u> ligjit 9901, dt. 14.04.2008, ñPër tregtarët dhe shoqëritë tregtareò, pjesa IV, ñShoqëritë me përgjegjësi të kufizuaraò si dhe <u>statutin e shoqërisë A</u> , ku përcaktohet se:

Neni 20 i **Statutit**[6] të shoqërisë A G **Emërimi i Administratorit**

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, i cili caktohet në statut, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. ***Emërimi i administratorëve, hyn në fuqi pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit****.*

Neni 95 **Emërimi, shkarkimi, të drejtat dhe detyrimet** i ligjit nr. 9901, dt. 14.04.2008, i ndryshuar përcakton se:

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, i cili caktohet në statut, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve, i cili hyn në fuqi në datën e përcaktuar sipas aktit të emërimit, u kundrejtohet palëve të treta sipas përcaktimeve të nenit 12 të këtij ligji. ***Statuti mund të vendosë rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve.***

Po kështu në Nenin 85 **Përfaqësimi në asamble** të ligjit nr. 9901, dt. 14.04.2008, i ndryshuar përcaktohet se:

2. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Në dokumentacionin e publikuar në faqen e QKB mungon dokumenti i thirrjes zyrtare drejt Ministrisë Përgjegjëse ku të përcaktohet orari, vendi, rendi i ditës, etj në kundërshtim me nenin 83 të ligjit nr. 9901, dt. 14.04.2008, i ndryshuar, ku përcaktohet se,

[6] Statuti i regjistruar në QKB më datë 18.07.2011, i cili ka qenë në fuqi deri në regjistrimin e statutit të ri, pas tkurrjes së kuotave të Shtetit Shqiptar në këtë shoqëri.

Neni 83 **Mënyra e thirrjes**

*1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një **njoftimi me shkresë** ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet **postës elektronike**. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.*
2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Çështja më sipër, evidenton nevojën për një vlerësim më të gjerë dhe të plotë mbi veprimet e administrative e ligjore të marra apo të munguara nga të gjitha palët e përfshira, legjitimitetin e tyre me qëllim eliminimin e efekteve mbi cenimin e interesave pasurorë të shtetit shqiptar, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.

Evidentimi çështjeve në regjistrat përkatës të institucionit
Avokatura e Shtetit i regjistron çështjet e gjykatave kombëtare në regjistrin fizik dhe në sistemin elektronik të çështjeve i cili përdoret nga institucioni. Ndërsa sa i përket GJEDNJ dhe Gjykatave të Huaja dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar nuk disponohet një regjistër i posaçëm fizik i cili të përmbajë të gjithë elementët nga regjistrimi i çështjes, letërkëmbimet mbi çështjen si dhe të gjitha veprimeve të kryera me të deri në përfundimin e ekzekutimit. Megjithëse kjo mangësi është konstatuar nga KLSH edhe në auditime të mëparëshme ku janë lënë dhe rekomandimet përkatëse, nga ana e ASH nuk rezulton të jetë marrë masat e nevojshme për plotësimin e tyre.

Ndjekja në gjykatë e disa çështjeve gjyqësore të përzgjedhura për Tatimet dhe Taksat në gjykatat e vendit dhe hedhja e tyre në regjistrin elektronik
Grupi i auditimit ka përzgjedhur 13 tatimpagues të cilët kanë paditur Drejtoritë Tatimore, me objekt shfuqizimin e akteve të rivlerësimit tatimor të kryera nga këto të fundit. Këto të dhëna janë siguruar nga auditime të mëparshme të kryera nga KLSH në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.
Më specifikisht, këto çshtje paraqiten si më poshtë vijon:

1- Pala paditëse: B , pala e paditur DTM, me objekt: ñAnulimi i njoftim vlerësimit nr. 1384/14, dt. 31.05.2011, dhe 27.06.2011, vendimit nr. 13101, dt. 26.09.2011ò, vlera e padisë 868,892,582 lekë, rezultati në gjykatën e shkallës së II: pranim i padisë.
2- Pala paditëse: B , pala e paditur: DTM, me objekt: Shfuqizim pjesërisht i Njoftim Vlerësimit nr. 9684/11, dt. 25.01.2016ò, vlera e padisë 525,414,437 lekë, rezultati në gjykatën e shkallës së dytë: pranimi i padisë
3- Pala paditëse: R B , pala e paditur: DTM, me objekt: ñShfuqizim i pjesshëm i Njoftim Vlerësimit nr. 17198/8, dt. 30.05.2017ò, vlera e padisë 221,670,936 lekë, rezultati në gjykatën e shkalles së II : pranimi i pjesshëm i padisë.
4- Pala paditëse: T , pala e paditur: DTM, me objekt: ñShfuqizim i Njoftim vlerësimit për detyrime tatimore nr. 6280/8 dt. 17.11.2015ò, vlera e padisë 119,898,351 lekë, rezultati në gjykatën e shkallës së II: pranim i padisë.
5- Pala paditëse: Sh I P , pala e paditur: DRT-DAT, me objekt: ñShfuqizim aktiò, vlera e padisë 116,114,249 lekë, rezultati në gjykatën e shkallës së II: Pranim i pjesshëm i padisë.

6- Pala paditëse: A , pala e paditur: DTM, me objekt: ñShfuqizim i njoftim vlerësimit tatimor nr.14723/7 dt.22.07.2014; nr. 14723/9, datë 06.08.2014ò, vlera e padisë 68,080,308 lekë, rezultati në gjykatën e shkallës së II: pranim i pjesshëm i padisë.
7- Pala paditëse: A -I , pala e paditur: DTM, me objekt: ñAnulim i njoftim vlerësimit nr. 32592/5, dt. 01.04.2011ò, vlera e padisë 33,258,052 lekë, rezultati në gjykatën e shkallës së II: pranim i pjesshëm i padisë.
8- Pala paditëse: R F , pala e paditur: DTM, me objekt: ñShfuqizim të Njoftim Vlerësimit nr.11447/4 dt. 30.12.2015ò, vlera e padisë 26,239,213 lekë, rezultati në gjykimin e shkallës së dytë: pranim i pjesshëm i padisë.
9- Pala paditëse: A S , pala e paditur: DRT, me objekt: ñPavlefshmëri absoluteò, vlera e padisë: 1,296,246 lekë, rezultati në gjykatën e shkallës së II: pranim i pjesshëm i padisë
10- Pala paditëse: E H j, pala e paditur: DRT Sarandë, me objekt: ñPavlefshmëri absolute e Njoftim vlerësimit nr. 3756, dt. 08.04.2016ò, vlera e padisë : 16,755,140 lekë, rezultati në gjykatën e shkallës së II : pranim i pjesshëm i padisë
11- Pala paditëse: G -K , pala e paditur: DRTM-DAT, me objekt: ñPavlefshmëri absoluteò, vlera e padisë : 12,786,571 lekë, rezultati në shkallën e II : rrëzim i padisë
12- Pala paditëse: L IIV pala e paditur: DRT Durrës, me objekt: ñShfuqizim Akti Administrativò, vlera e padisë 12,625,803 lekë, rezultati në gjykatën e shkallës së II: pranim i pjesshëm i padisë.
13- Pala paditëse: L IIV pala e paditur: DRT Durrës, me objekt: ñPavlefshmëri absolute e aktit administrativò, vlera e padisë 11,237,603 lekë, rezultati në gjykatën e shkallës së II: pranim i pjesshëm i padisë.

Grupi i auditimit evidentoi në sistemin elektronik të Avokaturës së Shtetit, pjesëmarrjen e kësaj të fundit në çështjet në fjalë. Nga shqyrtimi në sistem i çështjeve rezultoi se, Avokatura e Shtetit ka marrë pjesë në 12 nga 13 çështjet e mësipërme, ndërsa çështjen A S - DRT e ka deleguar. Ky delegim është bërë mbështetur në urdhrin e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit nr. 34, datë 01.04.2010, sipas të cilit është urdhëruar: ñ*Delegimi i të drejtës së përfaqësimit dhe të mbrojtjes së interesave të shtetit në gjykim, organit të administratës publike apo entit publik të interesuar, në lidhje me çështjet e Avokatët e Shtetit pranë Ministrisë së Financave që kanë për objekt gjykimi kundërshtim akti administrativ dhe vlera e objektit e të cilave është nën kufirin sasior ligjor prej 2.000.000 lekë.*ò.

Në pikën 1 të nenit 36, të Rregullores së Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Avokaturës së Shtetit miratuar me urdhrin nr.68, dt. 28.03.2019, përcaktohet *"Një kategori e caktuar çështjesh të cilat do të trajtohen nga Avokatura e Shtetit do të konsiderohen Kodi "A", një kod i cili do të shënohet/pasqyrohet në krah të numrit të brendshëm identifikues që do të marrë dosja/çështja, si dhe çdo shkresë apo akt tjetër që lidhet me dosjen e kësaj çështje.* Sipas shkronjës f, të pikës 2 të këtij neni të gjitha çështjet me palë tatimet dhe doganat me vlerë mbi 10 milion do të kategorizohen Kodi ñA.

-Mbikëqyrja mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë:

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ):

Shteti Shqiptar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, , i ndryshuar, ka ratifikuar Konventën për Mbrojten e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Në vijim të kësaj konvente janë ratifikuar dhe protokollet shtesë. Ndërkohë Ligji nr.10018 datë 13.11.2008 ñPër Avokaturën e Shtetitò, i ndryshuar në nenin 9 të tij përcakton se Avokatura e Shtetit përfaqëson mbrojtjen e interesave të shtetit shqiptar pranë gjykatave të huaja dhe organizmave ndërkombëtarë, të cilat kryhen nëpërmjet Zyrës së përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në

arbitrazhin. Detyrat e kësaj zyre, përcaktohen më hollësisht në rregulloren e brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit.
Me ndryshimet ligjore të miratuara në ligjin oganik të ASH-së me ligjin nr. 86/2018, ky institucion është ngarkuar nga ligjvënësi të ndjeki dhe zbatimin e vendimeve të dhëna nga kjo gjykatë. Në nenin 19/1 të ligjit nr.10018, përcaktohet se, Vendimet e formës së prerë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim ñGJEDNJò), për çdo çështje ku Republika e Shqipërisë është palë, janë të detyrueshme për zbatim dhe ekzekutohen sipas procedurës së parashikuar. Konkretisht në nenet 19/1 deri 19/10 të tij përshkruhen veprimet të cilat ndërmerren nga Avokatura e Shtetit dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtyre vendimeve dhe afatet përkatëse.
Për periudhën nën auditim paraqiten 3 vendime gjyqësore të ekzekutuara si më poshtë:

Nr.	Vendimi	Pretendimi	Lloji	Data e vendimit	Dispozitivi	Vlera /Euro	Data e ekzekutimit
1	62907/16 M v. Albania	Neni 2 dhe neni 2/1 I Konventes	penale	05.03.2019	shkelje / Marreveshje Miqesore	104,237	13.08.2019
2	14816/08 T v. Albania	Neni 6 i Konventës	Penale	22/05/2018	shkelje	1,022	30.04.2019
3	74389/13 P v. Albania	Shkelje te nenit 3	Penale	13.02.2018	shkelje	4703	30.04.2019
Totali						**109,962**	

Burimi: ASH përpunuar nga grupi i auditimit

Sa i përket vendimeve gjyqësore të kësaj gjykate ende të paekzekutuara deri më 31.12.2020, sipas të dhënave të paraqitura nga Avokatura e Shtetit, situata paraqitet si më poshtë vijon:

Nr.	Vendimi	Pretendimi	Lloji	Data e vendimit	Dipozitivi	Vlera në Euro	Faza e Ekzekutimit	
1	6858/11 M D v. Albania	Shkelje e nenit 5/1, dhe 5/4 të Konventes	Penale	14.09.2015	Shkelje	15,600	Dërguar MD/KM	Në proces
2	48522/10 Dh dh N v. Albania	Shkelje e nenit 6/1, 13, neni 1 Protokolli nr. 1 I Konvenës	Civile	17.03.2016	Shkelje	4,417,750	Ka dalë VKM	Në proces
3	10613/16 Sh and others v. Albania	Shkelja te nenit 6, 13 dhe 1 te protokollit 1	Civile	11.01.2018	shkelje	13,447,300	Dërguar MD	Në proces
4	29309/16 P v. Albania	Neni 2/1 dhe neni 3 I Konventës	Penale	11.06.2019	shkelje	13,450	Dërguar KM	Në proces
5	34602/16 S v. Albania	Shkelje e nenit 3 dhe nenit 5/1,4,5 të Konventës	Penale	21.01.2020	Shkelje	17,500	Dërguar MD/KM	Në proces
6	1175/06 K v. Albania	Shkelje të nenit 17 dhe 18 të Konventës	Civile	23.06.2020	Shkelje	30,000	Ka dalë VKM	Në proces
7	48756/14 T v. Albania	Shkelje e nenit 2 të Konventës	Civile	04.08.2020	Shkelje	14,720	Dërguar KM	Në proces
Totali						**17,956,320**		

Burimi: ASH përpunuar nga grupi i auditimit

Sa më sipër vërejmë se, mbeten ende të paekzekutuar 7 vendime ku 2 prej tyre datojnë në vitet 2015 dhe 2016 ndërkohë 5 vendimet i përkasin periudhës vitet 2018-2020.
Referuar ligjit nr. 10018 datë 13.11.2008 ñPër Avokaturën e Shtetitò, i ndryshuar, Neni 19/4 ñAfatet e ekzekutimit nga institucionet përgjegjëseò përcakton se,
Vendimet e GJEDNJ-së që kanë vendosur kompensimin e drejtë, ekzekutohen nga institucionet përkatëse, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, brenda 3 muajve nga momenti kur vendimi i gjykatës merr formën e prerë.
Gjithashtu pika 3 e nenit 19/5 përcakton se, ñ*Në rast të moskryerjes së pagesës brenda afateve kohore, të parashikuara në nenin 19/4, të këtij ligji, mbi masën e detyrimeve përkatëse financiare* ***paguhet interesi****, sipas përcaktimeve në vendimin e GJEDNJ-së".*
Referuar tabelës më mësipër rezulton se të gjithë vendimet janë në tejkalim të afatit 3 mujor.

-Nga praktikat e cituara më sipër prej grupit të auditimit u përzgjodhën për trajtim procedurat e ndjekura për dy vendime të GJEDNJ, përkatësisht nr. 2 dhe 3 në tabelën më sipër, **"Sh and others v. Albania"** dhe **"Dh dhe N vs. Albania"**, nisur nga vlerat e konsiderueshme që këto çështje kanë për buxhetin e shtetit. Më poshtë paraqiten veprimet procedurale të ndërmarra nga ASH dhe institucionet përkatëse për zbatimin e këtyre vendimeve.

1. Kërkesa nr. 10613/16 "Sh dhe të tjerë k. Shqipërisë"
-Më datë 24.01.2018 pranë Avokaturës së Shtetit ka mbërritur Vendimi i GJEDNJ datë 11.01.2018 për çështjen ñSh dhe të tjerë k. Shqipërisëò regjistruar pranë ASH me nr. 151 prot.
-Me shkresën nr. 151/1 prot, datë 10.04.2019 dhe nr. 151/2 datë 11.04.2019 prot, (dita e fundit e afait për ankim) nga ASH janë paraqitur kërkesat ankimuese për kalimin e çështjes në Dhomën e Madhe të GJEDNJ.
-Me shkresën nr.151/3, datë 14.06.2018 (viti shkruar gabim në shkresë, 2016), i janë dërguar Ministrisë së Drejtësisë, materialet lidhur me ekzekutimin e masave individuale, përkthimin, publikimin dhe ekzekutimin financiar të vendimit, si dhe është dërguar projektvendimi dhe relacioni shoqërues i tij.
-Vendimi i gjykatës është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 120, datë 10.08.2018.
-Me shkresën nr. 151/6, datë 31.08.2018 (viti shkruar gabim në shkresë, 2017), i janë dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dokumentet e përfituesve dërguar nga përfaqësuesi i tyre me shkresën datë 01.08.2018.
-Me shkresën nr.6852/9, datë 26.10.2018, Ministria e Drejtësisë ka dërguar bashkëlidhur komunikimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Në shkresën e cila mban nr. 15879/1 prot, datë 17.09.2018 me lëndë *Mendim mbi projektvendimin,* MFE trajton mosdakordësinë për përdorimin e fondit rezervë për vitin 2018, për shkak të faturës së lartë financiare që implikon ky vendim, duke sugjeruar negocimin me përfituesit për pagesën me këste sipas mundësive të buxhetit.
-Me shkresën e administruar në ASH, nr.151/8 prot, datë 05.10.2018, Departamenti i Ekzekutimin të Vendimeve të GJEDNJ, ka përcjell pranë Avokatit të Përgjiithshëm të Shtetit shqetësimin e përfaqësuesve të palës paditëse duke kërkuar vëmendjen e Autoriteteve mbi çështjen dhe informimin në vijim mbi zhvillimet për këtë çështje.
-Me shkresën nr.151/12, datë 13.11.2018, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, Avokatura e Shtetit ka shprehur dakordësinë që të negociohet me përfituesin, duke propozuar që të bëhet me grup negocimi, me anëtarë nga MD, MFE dhe ASH.

-Me shkresën nr. 6852/11, datë 07.12.2018, Ministria e Drejtësisë, në përgjigje të shkresës nr.151/12, ka evidentuar kompetencën e ASH në vijim të ndryshimeve ligjore të cilat priteshin të hynin në fuqi duke u shprehur poztivisht edhe mbi negocimin e sugjeruar nga MFE.
-Në vijim, Avokatura ka paraqitur pranë Departamentit për Ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ, Planin e Veprimit mbi masat individuale dhe të përgjithshme.
-Me shkresën nr. 1564/1, datë 10.07.2019 i është dërguar Kryeministrisë dhe Ministrisë së Drejtësisë, komunikimi i Departamentit për Ekzekutimin e Vendimeve në GJEDNJ, lidhur me ankesën e paraqitur nga përfaqësuesi i kërkuesve, ku ndër të tjera nuk bien dakort me shlyerjen e pagesës me këste.
-Me shkresën nr. 1564/2, datë 06.08.2019 në përgjigjen e saj drejt ASH, MFE ri-mban qëndrimin e mëparshëm për mospagimin e plotë duke sugjeruar negocimin me përfituesit.
-Në vijim me shkresën datë 30.08.2019 Avokatura e Shtetit ka *ri*-përcjell situatën mbi ecurinë e këtij vendimi si dhe ka bërë me dije MFE, për dijeni Kryeministrisë, mbi kërkesën e Departamentit të Ekzekutimit të GJEDNJ-së nëpërmjet të cilës është kërkuar marrja e masave të menjëherëshme nga Qeveria Shqiptare për ekzekutimin e masave individuale dhe të përgjithshme të vendimit ñSh dhe të tjerë k. Shqipërisë. Në të kundërt kjo çështje do tô kalojë për ndjekje me procedurë të përshpejtuar Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës.
-Me shkresën nr. 15783/1, datë 27.09.2019, MFE ri-dërgon qëndrimin e mëparshëm duke sugjeruar negocimin juridik me përfituesit, për shkak të vlerës së madhe të detyrimit.
-Këshilli Konsultativ për çështjet e GJEDNJ me Vendimin nr. 9, datë 26.12.2019, vlerësoi shtyrjen e diskutimit për marrjen e masave individuale për çështjen Sh , pas përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme.
-Me shkresën nr. 1795/1, datë 22.06.2020 i është dërguar Kryeministrisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, komunikimi i të Departamentit për Ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ, lidhur me një ankesë të paraqitur nga përfaqësuesi i kërkuesve pranë Komitetit të Ministrave të KiE.

Sa më sipër konstatohet se, institucionet respektive të përfshira nuk rezultojnë të kenë marrë masat e duhura sipas përcaktimeve ligjore për zbatimin e vendimit, i cili ka pasoja të konsiderueshme në buxhetin e shtetit. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e cila sipas akteve shkresorë të përmendur më sipër, rezulton të ketë mbajtur një qëndrim bllokues për projektvendimin e paraqitur nga Ministria e Drejtësisë, pavarësisht se, vendimi i GJEDNJ ka formë të prerë, është botuar rregullisht në Fletoren Zyrtare dhe ky propozim është hartuar rregullisht nga dy institucione, MD dhe ASH të cilat janë dhe organet më kompetente shtetërore për çështjet ligjore. Sipas akteve shkresore të disponuara ende sot nuk kemi një vendim të KM i cili t`i hapi rrugën zbatimit të këtij vendimi, i cili përgjatë periudhës së moszbatimit të tij nga ana e institucioneve respektive akumulon në vijimësi kosto financiare shtesë për buxhetin e shtetit.
Nga ana e MFE prej vitit 2018 është propozuar arritja e një marrëveshje pagese me këste megjithëse negocimi i marrëveshjes me këste nuk përcaktohet shprehimisht në dispozitat e posaçme për zbatimin e këtyre vendimeve në ligjin organik të ASH. Deri në fund të auditimit në terren nuk nga ASH rezulton të ketë patur ecuri as mbi këtë proces.
Ndërkohë nga ana e saj, ASH pavarësisht përpjekjeve nuk ka arritur të përmbushë plotësisht kërkesat e ligjit mbi mbikëqyrjen e ekzekutimit të këtij vendimi, referuar nenit 19/3 e vijues të ligjit nr. 10018 datë 13.11.2008 ñPër Avokaturën e Shtetitò, i ndryshuar për aq kohë sa ky vendim nuk është përmbushur. Veç aspekteve financiare të padiskutueshme, vonesat e

krijuara kanë sjellë reagime të shtuara nga ana e KiE, për moszbatimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

2. Kërkesa "R dhe të tjerë k. Shqipërisë", kërkesa nr. 48522/10 "Dh dhe N k. Shqipërisë"

-Me shkresën nr.503/21 prot., datë 29.03.2016, Avokatura e Shtetit ka përcjellë pranë Ministrisë së Drejtësisë, shkresën lidhur me ekzekutimin e masave individuale, përkthimin, publikimin dhe ekzekutimin financiar të vendimit datë 17.03.2016, të GJEDNJ-së, për çështjen "Rista dhe të tjerë kundër Shqipërisë ".

-Në datën 31.08.2016 është miratuar VKM ñ*Për ekzekutimin e vendimit Rista k.Shqipërisë*ò.

No.	Aplikimi dhe numri	Dëmi Pasuror dhe dëmi jopasuror	Kostot dhe shpenzimet
1	*R* , nr. 5207/11	Nuk ka pretendime (ankesat janë paraqitur jashtë afatit)	Nuk ka pretendime (ankesat janë paraqitur jashtë afatit)
2	*Gj dhe M* , nr. 24468/10	1.562.100 (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e njëqind) euro	850 (tetëqind e pesëdhjetë) euro
3	*G dhe të tjerë* nr. 39492/10	216.600 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) euro	850 (tetëqind e pesëdhjetë) euro
4	*F and Others,* nr. 39495/10	3.330.500 (tre million e treqind e tridhjetë mijë e pesëqind) euro	850 (tetëqind e pesëdhjetë) euro
5	*Me and Others,* nr. 40751/10	1.171.800 (një milion e njëqind e shtatëdhjetë e një mijë e tetëqind) euro	Nuk ka pretendime (nuk është paraqitur pretendim specifik)
6	***Dh and N* , nr. 48522/10**	**4.416.900 (katër milion e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntëqind) euro**	**850 (tetëqind e pesëdhjetë) euro**

Nga ana e Ministria e Financave dhe Ekonomisë ky vendim nuk është zbatuar vetëm sa i takon çështjes ñDh N ò e cila është përbën dhe vlerën më të lartë financiare për buxhetin.

-Me shkresën nr. 22882/1, datë 17.01.2019, MFE shprehet se vazhdimi me procedurat e ekzekutimit lidhur me aplikimin nr. 48522/10 ñ*Dh dhe N k. Shqipërisë*ò, duhet të bëhet pas qartësimit të situatës ligjore nga të gjitha hallkat e sistemit gjyqësor vendas.

-Me shkresën nr. 384/1, datë 03.04.2019, Avokatura e Shtetit në përgjigje të shkresës nr. 22882/1 ka kërkuar nga MFE kopje të dokumentacionit të parashtruar që ka pezulluar ekzekutimin.

-MFE ka paraqitur pranë Avokaturës informacion mbi ekzekutimin e vendimit ñ*Dh dhe N k. Shqipërisë*ò, administruar me nr.384/2, datë 20.05.2019 dhe 384/3 datë 03.06.2019.

-Me shkresën nr. 18539/4, datë 31.05.2019 MFE ka përcjellë vendimet gjyqësore.

-Me shkresën nr. 384/4, datë 25.06.2019 ka paraqitur kërkesë për informacion Z. A Dh .

-Me shkresën nr. 384/6, datë 30.08.2019 Avokatura ka informuar MFE dhe për dijeni Kryeministrinë, në vijim të vendimeve të përcjella sugjeron kalimin e vlerës financiare në llogari të bllokuar dhe ta mbajë të ngrirë shumën deri në përfundim të gjykimit të mosmarrëveshjes me qëllim kufizimin e kamatave, si dhe është kërkuar pjesëmarrja e një përfaqësuesi të MFE në mbledhjen e Këshillit Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ pranë ASH.

-Me shkresën nr.15783/1, datë 27.09.2019, Ministria e Financave dhe Ekonomisë mban sërisht qëndrimin për zbatimin e vendimit, **pas qartësimit të situatës ligjore** nga të gjitha hallkat e sistemit gjyqësor vendas duke mos iu përgjigjur kërkesës për pjesëmarrje në Këshill.

Më datë 09.10.2019 ora 10:00 është zhvilluar mbledhja e Këshillit në të cilën MFE nuk rezulton pjesëmarrëse, ku është rimbajtur qëndrimi i ASH të datës 30.08.2019 drejtuar MFE mbi ngurtësimin e vlerës në një llogari të bllokuar.

Sa më sipër konstatohet se, nga ana e ASH janë ndërmarrë hapa konkretë mbi këtë çështje duke njoftuar edhe KM për moszbatimin e vendimit duke sugjeruar dhe këshilluar veprime konkrete të cilat mund të krijonin kufizim të interesave mbi këtë çështje si dhe është kërkuar pjesmarrja e përfaqësuesit të MFE. Këto propozime nuk rezultojnë të aplikuara nga MFE deri në fazën e auditimit në terren ndërkohë prej saj vihet re një qëndrim i prerë për zbatimin e vendimit vetëm pas përfundim të shqyrtimeve gjyqësore vendase, megjithëse VKM nr. 613, datë 31.8.2016, obligon zbatimin e tij brenda afatit 3 mujor të parashikuar.

Mosveprimi ose veprimet me vonesë nga ana e instiucioneve respektive në këtë çështje krijojnë risk të lartë për efekte të tjera shtesë në dëm të buxhetit të shtetit, çka kërkon vëmendje të shtuar në vijim nga ana e ASH-së si institucion përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre vendimeve por veçanërisht nga MFE e cila vijon me qëndrim të *veçuar* në mospërputhje me qëndrimet ligjore të njësive të specializuara siç është Avokatura e Shtetit dhe Këshilli Konsultativ për çështjet e GJEDNJ pranë saj.

-Kostot financiare potenciale nga moszbatimi në afat i dy vendimeve të GJEDNJ:
Dy vendimet e sipërcituara me vlera të konsiderueshme në buxhetin e shtetit rezultojnë **të pazbatuar**. Mosmarrja e veprimeve administrative në kohë e ka ekspozuar Shtetin Shqiptar ndaj detyrime potenciale shtesë rrjedhojë e kamatave të kërkueshme për moszbatim në afat të vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Sipas llogaritjeve të bëra vlera e interesave/kamatëvonesave për të cilën riskohet buxheti deri më datë 31.12.2020 kap shumën rreth **1,675,938 Euro** bazuar në llogaritjen si më poshtë:

Çështje të Gjykuara	Dëmshpërblimi i vendosur nga GJEDNJ ne Euro	Data për ekzekutim	Data e fillimit të kamatës	Interesi bazë	Interesi sipas BQE	Interesi vjetor	Periudha	Ditët	Interesi per 1 ditë	Interesi për tu paguar	Principali	Interes + Principal në Euro
48522/10 Dh dhe N v. Albania	4,417,750	17.03.2016	17.06.2016	3%	0.25%	3.25%	17.06.2016-31.12.2020	1658	0.0089041%	652,193	4,417,750	5,069,943
10613/16 Sh and others v. Albania	13,447,300	28.05.2018	28.08.2018	3%	0.25%	3.25%	28.08.2018-31.12.2020	855	0.0089041%	1,023,745	13,447,300	14,471,045
										1,675,938	**17,865,050**	**19,540,988**

Observacion mbi Projektraportin e Auditimit i paraqitur nga Avokatura e Shtetit me shkresën nr. 4425/15 prot, datë 30.09.2021, regjistruar në KLSH me nr. 1114/6, datë 06.10.2021.

Pretendimi i Subjektit*:*
7.1- ...Zyra e përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, sa i përket përfaqësimit në GJEDNJ mban regjistër fizik dhe elektronik për çështjet në GJEDNJ. Këto regjistra mbahen bazuar në Rregulloren e brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit, Urdhrin e Titullarit nr. 259 datë 07.07.2019. Zyra mban dhe regjistër elektronik, i cili ka shumë më tepër të dhëna, që mbahen për arsye statistikore...
Gjithashtu dëshirojmë të theksojmë se GJEDNJ, ka një program të posacëm në të cilën janë të

regjistruar të gjitha korrespondencat midis palëve dhe Gjykatës...

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:
Observimet e paraqitura janë thuajse identike me ato të paraqitura në fazën e mëparshme të auditimit për të cilat Grupi i Auditimit ka paraqitur sqarimet përkatëse (trajtuar më poshtë). Në mungesë të shpjegimeve apo të dhënave shtesë *observacioni juaj nuk merret në konsideratë.*

Observacion mbi Akt konstatimet nr. 7, date 18.01.2021, prot në KLSH me nr. 1114/4, datë 27.01.2021.
Pretendimi i Subjektit:
-Zyra e përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, sa i përket përfaqësimit në GJEDNJ mban regjistër fizik dhe elektronik për çështjet në GJEDNJ. Këto regjistra mbahen bazuar në Rregulloren e brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit, Urdhrin e Titullarit nr. 259 datë 07.07.2019. Zyra mban dhe regjistër elektronik, i cili ka shumë më tepër të dhëna, që mbahen për arsye statistikore.
Të gjitha kërkesat e specifikuara në aktin e kontrollit mbahen në regjsitrin e hyrje-daljeve të protokollit të institucionit. Mbajtja fizikisht dhe në një regjistër të posacëm e të njëtave të dhëna do të përbënte një punë të shtuar dhe të njëjtë me protokollin në thelb. Gjithashtu GJEDNJ ka një program të posacëm në të cilën janë të regjistrauar të gjitha korrespondencat midis palëve dhe gjykatës.
-Lidhur me çështjen Sh dhe të tjerë kundër Shqipërisë, sikundër rezulton nga faktet dhe provat e parashtruara, nga institucionet që do të kryejnë ekzekutimin e vendimit është pretenduar se nuk ka fond në Buxhetin e Shtetit për ekzekutimin e tij. Të njëjtën gjë ka konfirmuar dhe Minsitria e Finanacave me shkresën më të fundit të saj, për këtë çështje...Avokatura e shtetit nuk identifikon ndonjë veprim të caktuar, brenda fushës së kompetences së saj, të përcaktuar në ligjin Për Avokaturën e Shtetit që mund të ndërmerret në këto kushte. Avokatura e Shtetit e ka shtruar për këshillim këtë çështje edhe në Këshillin Konsultativ, i cili nuk ka arritur të dalë me ndonjë orientim konkret për mënyrën e trajtimit të kësaj çështje.....Gjithashtu, dëshirojmë tiu bëjmë me dije se, vendimet e gjykatave tona të faktit, në lidhje me këtë çështje janë në shqyrtim në Gjykatën e Lartë. Në datën 04.04.2017 palët kanë paraqitur rekurs në GJL. Për praktikën vendase në çështjet gjyqësore me objekt shpërblimin e dëmit nga shpronësimi, ka rëndësi të madhe që Gjykata e Lartë të shprehet me vendim në lidhje me këtë çështje.
Në kuadër të raportimit për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së pranë Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, dhe vlerësimit të të gjitha mundësive të institucioneve tona për ekzekutimin e vendimit, Avokatura e Shtetit në 8 janar 2021 i ka drejtuar një shkresë Ministrisë së Infrastrukturës dhe energjisë, ku i ka kërkuar informacion në lidhje me ekzekutimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 210 datë 09.04.2014, duke specifikuar çdo nismë që është ndërmarrë për ekzekutimin e tij dhe stadin e ekzekutimit.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:
Hedhja e të dhënave në regjistër elektronik të çështjeve është kërkuar nga KLSH në vijmësi, e megjithatë ky regjistërështë megjithëse është kërkuar është vënë në dispozicion vetëm në modelin pasqyrë excel. Sa i përket regjistrimit të çështjeve në regjistrat e protokollit ky është një detyrim specifik i cili parashikohet nga dispozita specifika të ligjit mbi arkivat dhe normës së arkivimit, ndërsa konstatimi ynë kishte të bënte me një regjistër përmbledhës të gjithë veprimeve si pranë GJEDNJ, letër-këmbimet me institucionet vendase por edhe akteve të brendshme të ASH lidhur me këto çështje, vlerat e vendimeve, likujdimet e kryera, mbetjet etj. Pra gjithcka që ka të bëjë me procesin gjyqësor dhe ekzekutimin e tij.

-Sa i përket çështjes Sh i i cili përbën dhe vlerën më të rëndësishme financiare ne vlerësojmë përpjekjet e ASH lidhur me çështjen dhe detyrimet në konventat ndërkombëtare, por pavarësisht të gjithave ky vendim dhe jo vetëm, krijon risk për akumulim detyrimesh financiare shtesë dhe për sa kohë ai mbetet i pazbatuar roli i institucionit të ASH sipas dispozitave ligjore aktuale është mjaft i rëndësishëm. Kalimi i çështjes për vlerësim në Këshillin Konsultativ dhe mosshqyrtimi në mbledhjen e tij të radhës, si dhe paralizimi i punës së Këshillit pas largimit të tre anëtarëve të tij nuk krijon premisa pozitive për zgjidhje të çështjes nga ky organ. Sa i përket vendimeve të shkallëve të tjera vendase mbi gjykimin e çështjes, pretendimi juaj gjendet kontradiktor me veprimet institucionale të ndërmarra si në hartimin e projektvendimit dhe relatimit të tij në MD (në ish rolin e ish organit epror) por edhe në korrespondencat tuaja të vazhdueshme drejt MD, MFE dhe KM mbi këtë çështje. *Sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.*

Gjykatat e Huaja dhe Arbitrazhi Ndërkombëtar

Legjislacioni shqiptar dhe konkretisht Kodi i Procedurës Civile nenet 393 deri 399, Konventa e Kombeve të Bashkuara ñPër njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja të arbitrazhitò, Nju-Jork 10 qershor 1958, në të cilën Shqipëria ka aderuar me ligjin nr. 8688 datë 9.11.2000 ñKonventa e Nju-Jorkutò, Konventës Evropiane mbi Arbitrazhin Tregëtar Ndërkombëtar të Gjenevës datë 21.04.1961, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin 8687, datë 09.11.2000 ñPër aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Evropiane të Arbitrazhitò, Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 6/2011, etj, përcaktojnë kuadrin ligjor për njohjen e vendimeve të gjykatave të huaja në Shqipëri, përfshirë këtu njohjen e vendimit përfundimtar të një arbitrazhi ndërkombëtar.

Në këto akte parashikohen:

a. kërkesat formal-procedurale që duhet të ndiqen nga pala kërkuese për të depozituar kërkesën për njohje dhe dhënie fuqie juridike të vendimeve të gjykatave të huaja (dhe atyre të arbitrazhit);
b. rastet kur njohja dhe dhënia fuqi juridike refuzohet;
c. investimi i Gjykatës së Apelit si gjykatë e shkallës së parë për njohje dhe dhënie fuqie juridike të vendimeve të gjykatave të huaja (dhe atyre të arbitrazhit);

Referuar të dhënave të paraqitura anga Avokatura e Shtetit, ecuria e proceseve gjyqësore në gjykatat e huaja ndërkombëtare ku shteti shqiptar është palë, (veç GJEDNJ të trajtuar më sipër), në periudhën vitet 2018-2020 paraqitet në **Aneksin IV** pjesë e këtij materiali auditimi. Sipas këtyre të dhënave gjatë kësaj periudhe nga gjykatat e huaja janë marrë gjithsej **9** vendime për çështje ku palë e paditur ka qenë shteti shqiptar ndërsa **5 çështje të tjera** presin gjykimin pranë këtyre gjykatave për marrjen e një vendimi.

Çështjet të cilat janë në proces shqyrtimi dhe ende nuk kanë vendim listohen si më poshtë:

Nr.	Numri/viti i fillimit të çështjes	Palët	Forumi i Arbitrazhit	Faza
1	Case no.CONC/16/1 V2016	X K	ICSID	Në proces
2	Case 2018-49 V2018	Shoqeria "V I " srl	UNCITRAL	Në proces
3	Case 24140/MHM V2018	Shoqeria "C D " s.p.a, JV "D K " sh.p.k.,	ICC	Në proces
4	Case ARB/20/37/ V2020	M I C T C , A D LP,Durrës K Sh SH.A. and D C T	ICSID	Në proces
5	10. ARB/20/54 V2020	A E B.V	ICSID	Në proces

Për **9 çështjet** e tjera në vendimarrjet e kryera nga këto gjykata është vendosur:
- *në 5 çështje* Shteti Shqiptar është dënuar me vlera të konsiderueshme financiare:
- *në 4 çështje* janë rrëzuar pretendimet e palës paditëse.

Më poshtë paraqiten të grupuara çështjet me vendim në favor të Shtetit Shqiptar dhe ato në disfavor të tij.

<u>Çështjet në të cilat janë pranuar pretendimet e palës paditëse në disfavor të RSH</u>

Nr.	Viti vendimit	Numri/viti i fillimit të çështjes	Palët	Forumi i Arbitrazhit	Dspozitivi i vendimit	Vlera/ konvertuar në Euro kursi datë 31.12.2020	Komenti i ASH Njohja dhe Ekzekutimi i Vendimeve
1	**2019**	600491-2017 V2017	E F T vs OSHEE	SCAI	Vendim/ Perfunduar ne disfavor te OSHEE, duke e detyruar te paguaje vlerën prej 6.139.637 Euro për mos përmbushje të kontratës, plus interesin vjetor prej 5%. Duke qenë se vendi është në Zvicër, vendimi i arbitrazhit mund të kundërshtohej në Gjykatën Federale Zvicerane, për një sërë shkaqesh shteruese brenda një afati 30-ditor. Avokatet e ceshtjes nuk verejten shkaqe te cilat te mund te perbenin baze per kundershtimin e ketij vendimi, sugjerim te cilin ia transmetuan OSHEE. Kjo e fundit bazuar ne rekomandimin e avokateve vendosi moskundershtimin e vendimit te arbitrazhit.	**6,139,637**	Avokatura e Shtetit nuk është informuar prej Gjykatës së Apelit mbi fillimin e proceduave të njohjes dhe ekzekutimit mbi këtë vendim
2	**2020**	ARB/15/28. V2015	H srl, C srl, F B , M de R , S G L C	ICSID	Vendim.dt.24.04.2019 i cili ka percaktuar ñdetyrimin e R.SH per te paguar demshperblime te tre paditesve (B , D R dhe G) per shpronesim te plote dhe perfundimtar te A , dhe nje pjese te kostove te pesuara nga paditesit ne lidhje me arbitrazhin ne nje total prej **108 milion Euro**, aplikimin e nje interesi prej **LIBOR +3%** per cdo tremujor.	**108,000,000**+	Me date 13 mars 2020, komiteti vendosi perfundimin e mases se pezullimit te ekzekutimit te vendimit Gjykata e Apelit Tirane, me vendimin nr.39, date 04.03.2020 vendosi rrezimin e kerkeses per njohje dhe ekzekutim te vendimit ne fjale.
3	**2020**	21349/GR V2015	B P A ltd	ICC	Vendimi i pjesshem (final dhe perfundimtar) nr.2139/EMT dt.01.02.2018 i cili ka vendosur të njohe vendimin e panelit të ekspertëve për auditin e 2011, i cili i ka njohur B vleren **247,397,666 USD**	**221,677,909**	Mbi kerkesen per njohjen dhe ekzekutimin e ketij vendimi Avokatura e Shtetit eshte njoftuar me Tetor 2019. Ceshtja ka vijuar te mbetet ne shqyrtim pergjate vitit 2020 prej Gjykates se Apelit Tirane.
4	**2020**	22676/GR V2017	G O C LTD vs M of I , AKBN and A	ICC	Vendim i dates 06.07.2020 i cili ka percaktuar detyrimin e palen shqiptare per demshperblim ne vleren **12,577,852 Euro** duke rrezuar pretendimet ne vleren rreth 100,000,000 Euro	**12,577,852**	Avokatura e Shtetit nuk është informuar prej Gjykatës së Apelit mbi fillimin e proceduave të njohjes dhe ekzekutimit mbi këtë vendim
5	**2020**	23998/MHM (C-24011/MHM) V2018	Bashkimi i shoqërive ñ JV C C E & A T S A ò, shoqëria ñC C E dhe ñA T S	ICC	Vendim shtator 2020 1. Të njohë vendimin e ADRB të datës 09.07.2017, lidhur me segmentin nr. 1 dhe vendimin e ADRB të datës 07.09.2017 lidhur me segmentin nr.3 si përfundimtare dhe të detyrueshme për palën e paditur (ARRSH); 2. Pala e paditur detyrohet të paguajë vlerën prej: - 25,220,016 USD të dhënë nga ADRB me vendimin e datë 09.07.2017 dhe TVSH-në për këtë të fundit (në total **30,264,019.64 USD**); - **11,665,552 USD** e dhënë nga ADRB me vendimin e datë 07.09.2017 si dhe TVSH-në	**40,084,162**	Avokatura e Shtetit nuk është informuar prej Gjykatës së Apelit mbi fillimin e proceduave të njohjes dhe ekzekutimit mbi këtë vendim

			A ò		për këtë të fundit (në total **13,998,663 USD);** - **261,556.75 Euro** si rimbursim të kostove administrative të paguara nga paditësi i parë dhe; - **161,524.38 Euro** si rimbursim të kostove ligjore të paditësit të parë.		
					Gjithsej	**388,479,560**	**EURO**

Burimi: Të dhëna të ASH, përpunuar nga grupi i auditimit:

Vendimet e mësipërme përcaktojnë një vlerë financiare të konsderueshme e cila kap shumën rreth **388.5 milion Euro.** Për njohjen e këtyre vendimeve nga gjykatat e apelit vendase nëpërmjet komenteve të saj evidentuar në tabelën më sipër, ASH trajton se nuk ka informacion të plotë mbi to.
Në çështjen e gjykuar në ICSID, ñQendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve në Fushën e Investimeveò ARB/15/28 ñH S.r.l and othersò me një vlerë prej rreth 108+ milion Euro, pavarësisht fazës në të cilën ndodhet çështja, ekziston risku që gjyqfituesi të ngrej pretendime në gjykata të shteteve të tjera ndërkombëtare anëtare të konventës, në të cilat Shteti Shqiptar zotëron të drejta. Sa më sipër, në rastin konkret por dhe në të gjitha rastet e ngjashme, Avokatura e Shtetit duhet të jetë tepër vigjilente ndaj këtyre kërkimeve, dhe të përdori në çdo rast mjete ligjore sa më efektive, bazuar në analiza të posaçme të çështjes, për të garantuar një mbrojtje sa më të plotë dhe cilësore të interesave të Republikës së Shqipërisë.

Çështjet në të cilat janë rrëzuar pretendimet e palës paditëse në favor të RSH
Në gjykatat e huaja për periudhën nën auditim janë dhënë vendime në favor të shtetit shqiptar duke rrëzuar pretendimet e palës paditëse në **4 çështje**. Pas daljes së vendimit, në **2** prej tyre nga ana e palës paditëse janë ngritur pretendime për anulim e vendimit. Më poshtë paraqiten rastet për të cilat janë marrë vendime në favor pavarësisht ankimeve të kryera:

Çështja gjyqësore	Gjykata	Vlera e vendimit në **Euro**	Ankim mbi vendimin
A ARB/14/26 V2014	ICSID	2,324,523	Po
A -A G ARB/17/6 V2016	ICSID	250,000	**Jo**
H srl 20564/EMT/GR V2014	ICC	7,343,668	**Jo**
H srl 22919/GR V2017	ICC	733,076	Po
Shuma		**10,651,267**	

Burimi: Të dhëna të ASH, faqja zyrtare e ICSID, përpunuar nga grupi i auditimit:

Sqarojmë se, vendimet e konkluduara në favor të shtetit shqiptar, në rastin më të mirë përbëjnë kthimin e të gjitha kostove të arbitrazhit, ekspertëve, të përfaqësimit dhe shpenzimet të tjera të kryera nga shteti shqiptar ndërsa në raste të tjera vetëm një pjesë e tyre.
Njohja e vendimeve të këtyre proceseve gjyqësore ndërkombëtare pranë gjykatave vendase të apelit kanë të bëjnë me njohjen e të drejtës për rimbursimin e kostove të paguara më parë nga shteti shqiptar gjatë procesit gjyqësor dhe nuk janë vlera financiare shtesë të fituara.

-Grupi i auditimit lidhur me gjykimet në ICSID, ñQendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve në Fushën e Investimeveò, verifikoi statusin e gjykimit të çështjeve të

regjistruara edhe sipas të dhënave të publikuara në faqen e saj zyrtare ku situata praqitet si më poshtë vijon.

Case No.	Claimant(s)	Respondent(s)	Status
ARB/17/6	**A -A G L**	Republic of Albania	**Concluded**
ARB/14/26	**A A Sh.p.k, M. A N and C S.r.l.**	Republic of Albania	**Pending**

Burimi: Faqja zyrtare e ICSID

Për periudhën nën auditim shteti shqiptar ka fituar **2 çështje** pranë ICSID, konkretisht:

-Për çështjen ARB/17/6 me palë paditëse A -A G L , është përfunduar gjykimi me vendimin e datës 07.02.2019, në dispozitivin e të cilit është vendosur:
Detyrimi i palës paditëse të paguajë Republikës së Shqipërisë kostot e Arbitrazhit të cilat janë parapaguar në avancë prej saj, sipas pikës 299 të vendimit paraqiten në vlerën **250,000 euro,** ndërsa shpenzimet gjyqësore janë deklaruar 1,020,000 Euro. Nga ana e ASH është lënë komenti *Duke qënë se tribunali **ka vendosur mungesën e juridiksionit** nuk ka pasur veprime të mëtejshme për njohjen dhe ekzekutimin e këtij vendimi.* Ndërkohë që ky vendim duhet të ishte njohur nga ASH me qëllim kërkimin e kostove përkatëse të paktën prej 250,000 euro.
-Për çështjen ARB/14/26 A A Sh.p.k, M. A N and C S.r.l. gjykata ka marrë vendim më datë 20.03.2020 në të cilin ka vendosur detyrimin e palës paditëse për pagesë të kostove dhe shpenzimeve të gjykimit përkatësisht, Euro 1,857,000, USD 427,488.72, GBP 106,755 me një total të llogaritur sipas kursit të publikuar të Bankës së Shqipërisë datës 31.12.2020 rreth **2,323,292 Euro.** Referuar pikës 565 të këtij vendimi evidentohet se, Shqipëria ka paguar 399,900 Euro kosto arbitrazhi nga 380,000 USD që duhet të paguante, pra një vlerë më të madhe se ajo të cilën duhet të paguante në fakt. Referuar kursit të këmbimit të datës 31.12.2020 vlera e paguar tepër llogaritet në **59,504 Euro** <u>më tepër të paguara padrejtësisht për të cilën nga ASH duhet të merren masat në vijim për rikuperim.</u> Më datë 16.07.2020 gjykata ka publikuar aplikimin e paditësit për anullim vendimi. Për këtë çështje pritet vendimi përfundimtar. Ajo çfarë vihet re në këtë rast është <u>investimi i vet ASH për njohjen e vendimit pranë Gjykatës së Apelit ndryshe nga raste</u> të tjera kur për njohjen e vendimeve institucioni shprehet se nuk ka informacion pasi nuk thirret nga këto gjykata.

-Ndërkohë, sipas të dhënave të paraqitura nga ASH mbi gjykimet e zhvilluara në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit të **ICC** me qendër në Paris, rezultoi se, Shteti Shqiptar rezulton të ketë fituar **2 çështje** në proceset gjyqësore ndërkombëtare dhe konkretisht në vitin 2018 dhe 2019 me palë paditëse H s.r.l dhe palë të paditur Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Prej grupit të auditimit u kërkua informacion pranë ASH, mbi ecurinë e njohjes dhe zbatimit të këtyre vendimeve, informacioni i disponuar prej saj është paraqitur në komentet e lëna ku evidentohet thuajse në të gjitha rastet mungesën e njoftimeve nga Gjykatat e Apelit të cilat shqyrtojnë njohjen e këtyre vendimeve.
-Në mungesë të informacioneve lidhur me ecurinë e çështjeve nga ASH, nëpërmjet auditimit paralel të KLSH-së pranë **MIE**, u arrit të merrej informacion mbi 2 vendimet e ICC, prej nga rezultoi se,

Informacioni i paraqitur nga MIE, lidhur me vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit ndërmjet H s.r.l dhe Republikës së Shqipërisë (Nr. 20564)

Ndërmjet vendimit nr.222 datë 24.05.1997, të Këshillit të Ministrave, ñ*Për miratimin e marrëveshjes koncension të formës "B.O.T" për hidrocentralin e K ",* të ndryshuar me Shtesën e Parë të Marrëveshjes Koncesionare miratuar me VKM nr. 590, datë 02.11.2000 dhe Shtesën e Dytë të Marrëveshjes Koncesionare, miratuar me VKM 363, datë 06.06.2007, qeveria shqiptare ka miratuar marrëveshjen koncesionare të lidhur midis Ministrisë së Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Ministrisë së Burimeve Minerare Energjitike sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe koncensionarit Shoqëria B. s.p.a dhe më pas Shoqëria H s.r.l, për ndërtimin e Hidrocentralit të K me koncesion të formës BOT.

Në tetor të vitit 2014, Shqipëria u padit në Arbitrazhin Ndërkombëtar të Dhomës së Tregtisë nga Shoqëria ñH ò s.r.l, e krijuar dhe kontrolluar nga Shoqëria B. s.p.a, ku u kërkua zgjidhja e marrëveshjes koncensionare midis palëve ndërgjyqëse për ndërtimin e hidrocentralit të K , për faj të Shqipërisë, dhe pagesa e një dëmshpërblimi si dhe të gjitha kostot e paditësit dhe procesit.

Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit vendosi rrëzimin e kërkesës së shoqërisë H s.r.l si dhe pranimin e kërkesës së shtetit Shqiptar duke rezervuar të drejtën që në fazën e dytë të procesit të shprehet për vlerën e plotë.

Lidhur me hapat e ndërmarra nga MIE për njohjen e vendimit të pjesshëm të datës 08.01.2018

Me qëllim njohjen dhe dhënien fuqi të vendimit të Gjykatës Ndërkombëtar të Arbitrazhi në Paris, Francë datë 08.01.2018, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në nenin 5 të Konventës së New Yorkut 1958 ñ*Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit*ò, si edhe nenit 394 të Kodit të Procedurës Civile, ka paraqitur pranë Gjykatës së Apelit Tiranë kërkesën për njohjen dhe dhënien fuqi ligjore të vendimit sipërcituar.

Gjykata e Apelit, Tiranë me vendimin nr.202, datë 16.10.2018 ka vendosur: ñ*Njohjen dhe dhënien fuqi ligjore në Republikën e Shqipërisë të vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit në Paris, Francë datë 08.01.2018, në çmimin e arbitrazhit ndërmjet H SRl dhe Republikës së Shqipërisë."*

Lidhur me hapat e ndërmarra nga MIE për njohjen e vendimit përfundimtar datë 07.09.2018:

Sikurse cituam, Gjykata e Arbitrazhit ka rezervuar të drejtën që në fazën e dytë të procesit të shprehet për vlerën e plotë, e cila është përcaktuar në vendimin nr.20564, datë 07.09.2018 dhënë në Paris, Francë.

Me shkresën nr.5595/2 prot., datë 10.12.2019 nga ana e Avokaturës së Shtetit, MIE është vënë në dijeni për vendimin përfundimtar ICC Case nr.20564/EMT/GR datë 07.09.2018 dhënë në Paris, Francë nga Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit.

Për rrjedhojë, nga ana e MIE, menjëherë është vijuar me përgatitjen e dokumentacionit, përkthimin dhe noterizimin e vendimit përkatëse për të vijuar më pas me procedurat ligjore për të njohur dhe dhënë fuqi juridike pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Në kushtet kur nuk ka rezultuar asnjë nga pengesat ligjore që parashikohen në Konventën e New Yorkut ñ*Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit*ò dhe nenin 394 të Kodit të Procedurës Civile, MIE i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë me shkresën nr.2146 prot., datë 25.02.2020.

Kërkesa është regjistruar pranë kësaj gjykate me nr.çështje 90006-00765-30-2020 dhe datë regjistrimi 2/26/2020 12:00:00 AM, me gjyqtare Zj. Z S . Në këto kushte, gjenden në pritje të përcaktimit të seancës gjyqësore.

Nga dy çështjet e mësipërme njëra prej tyre ka përfunduar me njohjen e vendimit të arbitrazhit ndërsa për çështjen tjetër pritet ende shqyrtimi gjyqësor.

Çështjet në favor të RSH të mbartura nga periudha të mëparshme

Referuar të dhënave të auditimit tematik të mëparshëm, i ushtruar nga KLSH pranë ASH-së me objekt ñAuditim tematik, përputhshmërieò me fokus, ñVlerat e detyrimeve shtetërore rrjedhojë e vendimeve të formës së prerë të gjykatave ndërkombëtare dhe çështjeve në proces gjykimi për periudhën deri më 31.08.2019ò, miratuar me vendimin nr.144 datë 14.12.2019 të Kryetarit të KLSH-së, është paraqitur ecuria e çështjeve gjyqësore të vëna në sipozicion nga ASH me komentet përkatëse. Nga këto të dhëna rezultojnë se, në **2** vendime të marra nga gjykatat e huaja megjithëse janë rrëzuar pretendimet e palës paditëse ato nuk rezultonin të ishin ekzekutuar, të cilat paraqiten si më poshtë:

Numri i Çështjes dhe viti i fillimit të arbitrazhit	Palët	Forumi i Arbitrazhit	Statusi i Procesit të arbitrazhit	Viti dhe dispozitivi i vendimit (vetëm totali i principalit në €) në favor të Shqipërisë	Komente mbi njohjen dhe ekzekutimin
ARB 11/18 **2011**	B SRL & E G SHA kundër Republikës së Shqipërisë	ICSID - Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimit	Përfunduar në favor të Republikës së Shqipërisë duke u rrëzuar pretendimet e Paditësve dhe akorduar Shqipërisë rimbursim të kostove në vlerën **$442,081.3**	Vendim/2013 **442,081 USD**	Njohur në Gjykatën e Apelit dhe **ASH i është drejtuar me urdhrin për ekzekutim** Zyrës së Përmbarimit për ekzekutimin e vendimit.
UNCITRAL ARBITRATION **2011**	S P Inc kundër METE/AKBN	UNCITRAL – Arbitrazh ad hoc	Përfunduar në favor të palës shqiptare. Tribunali ngarkoi Paditësin me pagesën e kostove të palës Shqiptare.	Vendim/2013 **382,774 USD**	Është angazhuar një firmë avokatore e huaj për ekzekutimin e vendimit në USA **nga ku rezultoi që Paditësi ishte i falimentuar.**

Burimi: Auditimi tematik i KLSH, viti 2019

Sa më sipër, evidentohet se në **një** nga çështjet cituar në tabelën më sipër, ASH është investuar vet për njohjen e vendimit pranë Gjykatës së Apelit si dhe në ekzekutimin e tij. Ndërkohë që lidhur me zbatimin e këtyre dy vendimeve nuk disponohet informacion shtesë mbi rikuperimin e shumave përkatëse të cilat **janë në fakt** shpenzime gjyqësore/përfaqësimi të kryera nga buxheti i shtetit.

Sa më lartë konstatohet se, nga ana e Avokaturës së Shtetit nuk disponohet informacion mbi ecurinë e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të gjykatave të huaja në Shqipëri. Sipas spjegimeve dhe komenteve të saj, mungesa e këtij informacioni vjen si rezultat i mosthirrjes si palë në proces nga Gjykatat e Apelit vendase si dhe nga mungesa e kërkesës prej instucioneve respektive që kanë interes të drejtpërdrejtë në çështje, të cilat thirren në gjykim nga këto gjykata. Ndërkohë në rastin *Al A Sh.p.k dhe të tjerë/2020, B Srl/2013,* shihet që ASH është investuar vetë për njohjen e vendimit në gjykatë, çka në vlerësimin tonë evidenton standarde të dyfishta veprimi lidhur me proceset e njohjes së vendimeve. Vlerat e

konsiderueshme financiare të tyre e bëjnë të domosdoshme nevojën për pjesëmarrje e ASH në gjykim. Referuar nenit 79/a të KPC ASH duhet të thirrej rregullisht nga gjykatat në këto gjykime krahas institucionit të interesuar, e megjithatë situata në realitet paraqitet ndryshe. Kryesisht institucionet palë në proces janë Ministritë e linjës pranë të cilave janë caktuar avokatë shteti të dedikuar për dhënien e asistencës ligjore, e megjithatë vihet re se bashkëpunimi i tyre me ASH lidhur me këto çështje mungon.

-Numri i çështjeve të regjistruara në gjykatat e huaja për dëmshpërbim dhe vlerat e konsiderueshme financiare të kërkuara nga subjekte të ndryshëm paraqesin nevojën për veprimeve të unifikuara nga ana e ASH mbi përfaqësimin pranë Gjykatave të Apelit.
-Gjithashtu evidentohet domosdoshmëria e një regjistri të azhurnuar të çështjeve të gjykuara/në gjykim, jo vetëm sa i përket përfundimit të gjykimit në gjykatat e huaja por edhe njohjes e zbatimit të këtyre në vendimeve në vendin tonë.

Mospërputhje midis disa akteve ligjore në fuqi mbi përfaqësimin

Referuar legjislacion të brendshëm dhe konkretisht Ligjit 10018/2008 ñPër Avokaturën e Shtetitò në nenin 2 pika 2 e tij përcaktohet se,

2. Avokatura e Shtetit është institucion qendror i administratës publike, i ngarkuar ekskluzivisht për dhënien e asistencës juridike. ***Asistenca juridike përfshin*** *shërbimin këshillimor* ***dhe të përfaqësimit*** *dhe jepet ekskluzivisht nga avokatët e shtetit për personat juridikë dhe sipas funksioneve të përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji.*

Neni 5 pika 1/b e këtij ligji përcakton se Avokatura e Shtetit kryen funksionet e mëposhtme:

b) ***përfaqëson dhe mbron*** *interesat pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave kombëtare, ndërkombëtare dhe të huaja,* ***pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit në çështjet gjyqësore,*** *në të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është palë. Në çështje të veçanta, sipas kritereve lëndore dhe sasiore, të përcaktuara në rregulloren e miratuar nga Këshilli i Ministrave, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit mund t'ia delegojë të drejtën e përfaqësimit dhe të mbrojtjes organit të interesuar të administratës;*

Në nenin 5 pika 1/1 e tij përcaktohet se,

1/1. Avokatura e Shtetit ofron ***asistencë juridike,*** *sipas parashikimeve të këtij ligji, për personat juridikë të mëposhtëm: a) institucionet shtetërore; b) entet publike;…….*
Personi juridik ***bashkëpunon me avokatin e shtetit*** *dhe* ***merr pjesë në procesin gjyqësor****, në të cilin <u>është palë ndërgjyqëse</u>….*

Nëse shohim përcaktimet e **VKM nr. 392** datë 08.04.2009, Miratimin e rregullores ñPër marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të Shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme proceduraleò, i ndryshuar, Kreu V Procedurat e posaçme për ushtrimin e aktivitetit të avokatëve të shtetit dhe roli i avokatëve të shtetit në gjykim, Neni 21 Përfaqësimi pika 1 dh 4 e tij, në të përcaktohet se,

<u>1. Interesat pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave shqiptare</u>, ndërkombëtare dhe të huaja, si dhe organeve të tjera në çështjet gjyqësore në të cilat një institucion shtetëror, ent publik ose Republika e Shqipërisë është palë <u>përfaqësohen dhe mbrohen nga Avokatura e Shtetit.</u>
4. Avokatët e shtetit pranë ministrive përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e shtetit në gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë në çështjet gjyqësore:

a) të cilat kanë për objekt mbrojtjen e interesave pasurore të ministrive, pranë të cilave janë emëruar;
b) të cilat kanë për objekt mbrojtjen e interesave pasurore të institutucioneve në varësi të ministrive, pranë të cilave janë emëruar;
c) të cilat kanë objekt të ngjashëm me fushën e ministrisë, pranë së cilës ushtron veprimtarinë. Në këtë rast të fundit, avokati i shtetit caktohet për të përfaqësuar dhe mbrojtur organin e interesuar me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.

Në nenin 24 pika 1 dhe 2 e tij përcaktohet se,

1. Në rastet e përfaqësimit dhe/apo mbrojtjes së interesave të shtetit në gjykim, Avokatura e Shtetit zbaton legjislacionin në fuqi dhe rregullat e përcaktuara në këtë rregullore në çështjet gjyqësore, në të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është palë. Në këto raste, Avokatura e Shtetit respekton rregullat për marrjen e kërkesës së motivuar nga organi i interesuar për t'u përfaqësuar në gjykim, pa qenë e nevojshme marrja e një autorizimi të posaçëm të të përfaqësuarit.
2. Avokatura e Shtetit ***mund të kryejë procedura të ndryshme*** *nga ato të përcaktuara në këtë rregullore, kur është në interes të zgjidhjes së çështjes objekt gjykimi dhe* ***me miratim të institucionit të interesuar****, por gjithmonë duke respektuar dispozitat ligjore procedurale.*

Sipas dispozitave të kësaj rregullore evidentohen disa *përcaktime jo të qarta* lidhur me përfaqësimin/mbrojten që kryhet nga ASH në proceset gjyqësore civile dhe jo në koherencë të plotë me përcaktimet e ligjit. Konkretisht sipas këtij vendimi nenit 24 pika 1 e saj, trajtohet se, në çdo rast, për tâu përfaqësuar në gjykim ASH-së i kërkohet marrja e kërkesës së motivuar nga organi i interesuar. Ndërkohë sipas Kreut VII të po kësaj rregulloreje nenet 31 deri 33 të saj, trajtohet se, institucionit i lind e drejta e delegimit të çështjeve drejt organit të interesuar të administratës publike, i cili nuk mund ta refuzojë me përjashtim të rastit të ekzistencës së konfliktit të interesit. Pra fillimisht ASH merr prej institucionit përkatës një kërkesë të motivuar për përfaqësim/mbrojtje ligjore dhe më tej, pas vlerësimit, kjo çështje për shkak të karakteristikave mund t`i delegohet sërisht institucionit përgjegjës i cili më parë ka kërkuar dhe motivuar nevojën për përfaqësim, çka përbën një ñ*non sens"* pasi nuk garantohet mbrojtja e plotë dhe profesionale e çështjes.
Më poshtë paraqesim në formë të përmbledhur përcaktimet në dispozitat e ndryshme lidhur me përfaqësimin nga Avokatura e Shtetit.

KPC (Shtuar me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 16)	**Ligji nr. 10018**	**VKM nr. 392**
Neni 79/a **Avokatura e Shtetit** Avokatura e Shtetit ushtron përfaqësimin **në rastet e parashikuara me ligj.** Gjykata, që shqyrton çështje për të cilat me ligj përfaqësimi dhe mbrojtja kryhet nga Avokatura e Shtetit, **urdhëron njoftimin e akteve kësaj të fundit, me qëllim që ajo të ketë mundësi të marrë pjesë në gjykim.**	**Neni 5** **Funksionet e Avokaturës së Shtetit** b) përfaqëson dhe mbron interesat pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave kombëtare,ndërkombëtare dhe të huaja, **pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit** në çështjet gjyqësore, në të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është palë. Në çështje të veçanta, sipas kritereve lëndore dhe sasiore, të përcaktuara në rregulloren e miratuar nga Këshilli i Ministrave, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit mund t'ia delegojë të drejtën e përfaqësimit dhe të mbrojtjes organit të interesuar të administratës; **1**/1. Avokatura e Shtetit **ofron asistencë juridike**, sipas parashikimeve të këtij ligji, për personat juridikë të mëposhtëm: a) institucionet shtetërore; b) entet publike; c) shoqëritë e krijuara ose që veprojnë sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, ku aksioneri	**Neni 24** **Procedura e përfaqësimit** 1. Në rastet e përfaqësimit dhe/apo mbrojtjes së interesave të shtetit në gjykim, Avokatura e Shtetit zbaton legjislacionin në fuqi dhe rregullat e përcaktuara në këtë rregullore në çështjet gjyqësore, në të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është palë. Në këto raste, Avokatura e Shtetit **respekton rregullat për marrjen e kërkesës së motivuar** nga organi i interesuar për t'u përfaqësuar në gjykim, **pa qenë e nevojshme marrja e një autorizimi të posaçëm të të përfaqësuarit.**

	shtetëror ka të drejtë të emërojë shumicën e anëtarëve të organeve drejtuese të shoqërisë ose zotëron më shumë se gjysmën e aksioneve apo kuotave. **Personi juridik bashkëpunon me avokatin e shtetit dhe merr pjesë në procesin gjyqësor, në të cilin është palë ndërgjyqëse**. Personi juridik vë në dispozicion të avokatit të shtetit çdo informacion të dhënë, apo dokumentacion që disponon, si dhe qëndrimin e tij me shkrim mbi çështjen në gjykim. Avokati i shtetit, në cilësinë përfaqësuesit ligjor të personit juridik, vendos lidhur me qëndrimin dhe mbrojtjen e çështjes, si dhe bën përfaqësimin në gjykim.	

Nga sa vërehet se, megjithëse ligji ka një përcaktim të qartë mbi përfaqësimin nga ASH në proceset gjyqësore ndërsa në rregulloren e miratuar me VKM nr. 392 nuk paraqitet në mënyrë të qartë dhe shteruese mënyra e bashkëveprimit midis personave juridikë publikë dhe ASH. Mungesa e qartësisë vihet re kryesisht në rastet kur gjykatat e vendit në proceset e njohjes së vendimeve të huaja njoftojnë ASH në raste të veçanta dhe në rastet e tjera ky njoftim mungon.

-Ndërkohë, në proceset penale ASH në mënyrë direkte ka të drejtë të ngrej padi civile për kërkimin e pasurisë ose shpërblimin e dëmit, që u është shkaktuar interesave të shtetit nga kryerja e veprës penale dhe kur vlera e dëmit është më pak se 2 milion lekë mund ta delegoj atë drejt institucionit respektiv. Në VKM nr. 392 nuk rezulton e ndryshuar vlera e dëmit material për ushtrimin e të drejtës së delegimit e cila sipas ligjit është 2 milion lekë.

Ligji nr. 10018	VKM nr. 392	Rregullorja e Brendshme e ASH
Neni 14 **Mbrojtja e interesave pasurorë të shtetit në gjykimin penal** **3.** Avokatura e Shtetit mund t'ia delegojë të drejtën e parashikuar në pikën 2 të këtij neni organit qendror ose vendor të administratës, që ka interes të drejtpërdrejtë, ose organit epror të personit juridik publik, në rast se vlera e dëmit është më pak se **2 milionë lekë.** Delegimi është i vlefshëm për gjykimin në shkallë të parë dhe në gjykatën e apelit.	**Neni 32** **Kriteret lëndore dhe sasiore për delegimin e të drejtës së përfaqësimit dhe të mbrojtjes** **Delegimi i të drejtës së përfaqësimit në gjykim, nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, bëhet bazuar në kriteret e mëposhtme:** **dh)** Në rastet e mbrojtjes së interesave pasurore të shtetit në gjykimin penal kur vlera e demit material është me vogël se **një milion lekë;**	**Neni 39 Mbrojtja e interesave pasurorë të shtetit në gjykimin penal** **3.** Avokatura e Shtetit mund t'ia delegojë të drejtën e parashikuar në pikën 2 të këtij neni organit qendror ose vendor të administratës, që ka interes të drejtpërdrejtë, ose organit epror të personit juridik publik, në rast se vlera e dëmit është **më pak se 2 milion lekë.** Delegimi është i vlefshëm për gjykimin në shkallë të parë dhe në gjykatën e apelit.

Sa më sipër evidentohet se, VKM nr. 392 nuk rezulton të ketë të njëjtin nivel dëmi mbi delegimin e çështjeve ndryshe nga neni 14 i ligjit organik. Ndërkohë që rregullorja e brendshme e ka përcaktuar saktë shkallën e dëmit.

Mangësitë e përmendura më sipër evidentojnë nevojën e përmirësimit të VKM me qëllim qartësimin dhe saktësimin e marrëdhënieve të Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të Shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale për tu ndjekur nga avokatët e shtetit.

-Prej grupit të auditimit nga listat e çështjeve, u kërkuan për trajtim 7 (shtatë) praktika të proceseve gjyqësore në gjykatat e huaja dhe arbitrazhin ndërkombëtar kjo lidhur me

vlerësimin e bashkëveprimit të ASH-së me institucionet shqiptare të cilët kanë ndërmarrë veprime administrative që janë objekt i shqyrtimit gjyqësor dhe mbrojtjes sa më cilësore të interesave të shtetit në gjykatat e huaja. Nga ana e institucionit pavarësisht kërkesave të vazhdueshme, pati vonesa të theksuara në paraqitjen e materialeve të cilat në pjesën dërmmuese gjendeshin jo origjinale, të papërkthyera dhe të panjehsuara. Dosjet nuk përmbanin inventarin e nevojshëm shoqërues. Thuajse të gjitha shkresat rezultonin fotokopje, pa rend kronologjik numrash protokolli, etj.
Mangësitë e theksuara në dokumentacion dhe vonesat në sjelljen e tij, nuk i krijoi siguri të arsyeshme grupit të auditimit në përdorimin e këtij materiali dhe nxjerrjen e konkluzioneve të qarta dhe të plota mbi bashkëveprimet institucionale në mbrojtjen e interesave të shtetit në këto procese.

Observacion mbi Projektraportin e Auditimit i paraqitur nga Avokatura e Shtetit me shkresën nr. 4425/15 prot, datë 30.09.2021, regjistruar në KLSH me nr. 1114/6, datë 06.10.2021.

Pretendimi i Subjektit:
Brenda kompetencave të dhëna nga ligji, Avokatura e Shtetit në kuadër të paraqitjes së raportit vjetor në Këshillin e Ministrave, në përputhje me nenin 6, shkronja "f" të ligjit 10018/2008, i ndryshuar, pasi ka analizuar të gjithë veprimtarinë e saj në asistencë të personave juridikë, kryen vlerësim të dëmit të shkaktuar dhe dëmit të shmangur ndaj interesave publikë nga veprimet e organeve të administartës publike. Lidhur me GJEDNJ është pjesë e procedurës së ekzekutimit të vendimeve të kësaj gjykate, analiza dhe adresimi i masave të posaçme dhe të përgjithshme. Avokatura e Shtetit është institucion i ngarkuar ekskluzivisht për dhënien e asistencës juridike, Ajo nuk është e ngarkuar nga kuadri rregullator në fuqi me funksione mbikëqyrëse dhe/ose audituese mbi institucionet që përfaqëson... dhe nuk mund të kryej analiza kryesisht mbi shkeljet dhe mosveprimet e tyre...

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:
Për sa ju trajtoni referuar nenit 13 të ligjit nr. 10018/2008, i ndryshuar, sjellim në vëmendjen tuaj se, në këtë nen gemat ñë)ò, ñf)ò, ñg)ò paraqet kuadrin e nevojshëm rregullator jo sikundër ju shpreheni për të ushtruar funksion mbikëqyrës por për të adresuar përgjegjësitë, mosveprimet dhe masat e nevojshme për tu marrë në kuadër të përmirësimit të punës në të ardhmen. Nëse i referohemi Rregullores së Brendshme ñPër Organizimin dhe Funksionimin e Avokaturës së Shtetitò miratuar me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr, 275/1 prot, datë 14.01.2009 (e shfuqizuar) neni 9 gërma *"ll"*, por edhe në Rregullores aktuale në fuqi miratuar me Urdhrin nr. 68 datë 28.03.2019 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit e cila ka shfuqizuar rregulloren e mëparëshme, në **nenin 9 gërma "*x*"** të saj përcakton qartë se, ASH paraqet në raportin vjetor gjithashtu:
i. shkaqet e dëmeve;
ii. personat përgjegjës;
iii. sugjerimin për masat që mund të jepen ndaj shkaktarëve;
iv. sugjerimin për masat e nevojshme për përmirësimin e punës në të ardhmen.
Pra pretendimi juaj lidhur me kuadrin ligjor e rregullator nuk qëndron.
Sa më sipër observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Titulli i Gjetjes: 1	**Bashkëpunim jo në nivele të kënaqshme midis Avokaturës së Shtetit dhe Prokurorisë**
Situata:	Referuar relacionit të përcjellë nga Avokatura e Shtetit, me e-mailin e datës 18.01.2021 rezulton se, gjatë periudhës 01.01.2018-31.12.2020 ky institucion ka patur në ndjekje **32** çështje civile në procese penale. Sipas të dhënave të publikuara në raportin vjetor të Prokurorisë së Përgjithshme mbi aktivitetin e ushtruar, rezulton se gjatë vitit **2019** ky institucion ka trajtuar **59,888** çështje, prej të cilave **30,695** çështje janë regjistruar në vitin 2019. Megjithëse, jo në të gjitha rastet që ndiqen nga Prokuroria ka dyshime që janë cënuar interesat pasurore të vendit, numri i **ulët** i çështjeve civile në procese penale të ndjekura nga Avokatura e Shtetit gjatë 3 viteve (32 çështje), krahasuar me numrin e çështjeve penale gjithsej të regjistruara vetëm për vitin 2019 (30,695 çështje), paraqet sinjal për një nivel jo të kënaqshëm bashkëpunimi midis dy institucioneve me qëllim marrjen e masave të nevojshme në kohë, për të siguruar mbrojtjen e interesave të shtetit në çdo rast. Nga analizimi i relacionit të përgatitur nga Avokatura e Shtetit mbi çështjet civile të ndjekura në procese penale, përcjellë grupit të auditimit me e-mailin e dt. 08.01.2021, është vërejtur që në **1 në 22** çështjet në ndjekje nga zyrat vendore (sjellim në vëmendje se për çështjet e tjera informacioni i përcjellë ka qenë jo i plotë për të identifikuar kohën kur këto çështje janë përcjellë nga Prokuroria), dhe **në 1 rast** të evidentuar që nuk është ngritur padi civile në proces penal të identifikuar nga zyra e inspektimit të Avokaturës, Prokuroria i ka përcjellë çështjet penale pasi ka përfunduar hetimi prej tyre, dhe kur janë dërguar materialet për shqyrtim në gjykatën e rrethit gjyqësor përkatës, duke i lënë një periudhë të shkurtër kohe A.SH për të përgatitur paditë civile.
Kriteri:	- Shkronjat b dhe ç të pikës 1 të nenit 5 të ligjit 10018, 13.11.2008 të ndryshuar, të cilat përcaktojnë se Avokatura e Shtetit ñ*përfaqëson dhe mbron interesat pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave kombëtare, ndërkombëtare dhe të huaja, pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit në çështjet gjyqësore, në të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është pale.*ò, ñ *bashkërendon punën me prokurorinë për mbrojtjen, në gjykim, të interesave të shtetit për çështjet civile, zgjidhja e të cilave bëhet gjatë një procesi penal;".* - Neni 14, i ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 të ndryshuar, si dhe neni 39 të Rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Avokaturës së Shtetit, i ndryshuar me urdhrin nr.68, dt. 28.03.2019, sipas të cilave ñ*Avokatura e Shtetit mbron interesat pasurorë të shtetit në gjykimet penal.*ò Sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 14 të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, i ndryshuar dhe pikave 1 dhe 2 të nenit 39 të Rregullores së brendshme, date 28.03.2019, ñ*Drejtuesi i prokurorisë së rrethit gjyqësor njofton Avokaturën e Shtetit brenda 7* ***ditëve*** *nga data e regjistrimit të procedimit penal për vepra penale, nga të cilat ka dyshime se janë cenuar interesat pasurorë të institucioneve shtetërore ose të personave juridikë publikë". "Avokatura e Shtetit ngre* ***padi civile*** *në procesin penal për kërkimin e pasurisë ose shpërblimin e dëmit, që u është shkaktuar interesave të shtetit nga kryerja e veprës penale"* - Marrëveshja e bashkëpunimit midis Avokaturës së Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave protokolluar në Avokaturën e Shtetit me nr. 1733 prot, dt. 31.08.2015, me objekt forcimi i bashkëpunimit për të garantuar mbrojtjen e te drejtave dhe interesave pasuror të shtetit dhe të shtetasve nga veprimtaria kriminale e kryer nëpërmjet falsifikimit dhe

	përdorimit të dokumenteve të falsifikuara. Referuar shkronjës b) dhe d) të nenit 2 të kësaj marrëveshje, Prokuroria angazhohet: - ñ*Të njoftojë Avokaturën e Përgjithshme të Shtetit, për regjistrimin dhe procedimin penal kur preken interesat shtetëror sipas objektit të kësaj Marrëveshjeje dhe vendimmarrjen në përfundim të hetimeve paraprake*ò; - ñ*Në rastin e gjykimit të çështjes, të ndjekë me përparësi ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë, për detyrimet që lindin në lidhjen me pasojat e deklarimit të falsitetit të dokumentit*ò. Referuar shkronjave b) dhe c) të nenit 5 të kësaj marrëveshje, Avokatura e Përgjithshme e Shtetit angazhohet: - ñ*Të ngrejë padi civile në proces penal kur konstatohet se preken interesat pasurore të shtetit nga veprimtaria objekt i kësaj Marrëveshjeje"*; - ñ*Me njoftimin e vendimit përfundimtar të prokurorit, të ushtrojë të drejtën e padisë në gjykatë, për mbrojtjen e interesave shtetërore*.
Ndikimi:	Cënohet efektiviteti dhe eficenca e procesit të mbrojtjes së interesave pasurorë të vendit.
Shkaku:	Nivel jo i kënaqshëm bashkëpunimi midis Avokaturës së Shtetit dhe Prokurorisë.
Rëndësia:	E lartë

Titulli i Gjetjes: 2	**Avokatura e Shtetit nuk ka ngritur padi civile në çështje penal, për 985,900 m^2 sipërfaqe toke të përfituar në kundërshtim me ligjin.**
Situata:	Me anë të shkresës nr. 2238 prot., datë 18.05.2016 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë, i ka përcjellë Avokaturës së Shtetit kopjen e kërkesës për gjykim drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, në lidhje me procedimin penal nr.36, të vitit 2014. Kallëzimi penal ishte bërë për shkak se ishin dhënë AMTP në kundërshtim me ligjin 7501, ñPër tokënò. Sipërfaqe toke që realisht janë ñtokë pa frytò, ranishte buzë detit ishin dhënë në pronësi si tokë bujqësore. Sipërfaqja e tokës përfituar në **kundërshtim** me ligjin ishte **985,900 m^2,** vlera e së cilës, sipas çmimit të hartës së tokës referuar VKM nr. 89 datë 03.02.2016 ñ*Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë*ò, Bashkia Rrogozhinë, zona Vilë-Bishtovë, ZK 3774 në zërin tokë bujqësore, arrin **371,684,300 lekë** [985,900 m^{2}x 377 lekë/m^2], ndërkohë që kjo tokë gjendet buzë detit dhe vlera e saj mund të jetë më e lartë. Gjatë hetimit, ishte vendosur sekuestro preventive në lidhje me parcelën 295 dhe 310 në Zonën Kadastrale 3774 në fshatin Vilë-Bishtovë të Njësisë Administrativë Gosë. Kallëzimi penal ishte iniciuar nga Komisioni i Vlerësimit pranë Prefekturës së Tiranës, Njësia e Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsion pranë Kryeministrit, dhe KLSH. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë me vendimin nr. 194, datë 21.10.2016 ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurve dhe **vazhdimin e sekuestros preventive** deri në zgjidhjen civilisht të konflikteve në lidhje me pronësinë e parcelave objekt sekuestroje. Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.576, datë 11.07.2017 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit penal nr. 194, datë 21.10.2016, duke ndryshuar këtë vendim vetëm për një nga të pandehurit. Me anë të urdhrit nr. 11, datë 25.01.2018, Avokati i Përgjithshëm ka urdhëruar kryerja e inspektimit tematik në lidhje me trajtimin e shkresës nr. 2238 prot., datë 18.05.2016 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Më datë 30.01.2018 Zyra e Inspektimit në Avokaturën e Shtetit i ka përcjellë Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, raportin e inspektimit tematik për trajtimin

	e këtij rasti. Referuar raportit të inspektimit, avokati i shtetit kishte kryer shkelje shume të rëndë pasi **nuk** është ngritur padia civile me objekt pavlefshmërinë e AMTP-ve të kundërligjshme, apo që janë konstatuar të falsifikuara, me vendim penal të formës së prerë. Me anë të Urdhrit nr. 11/2, datë 01.02.2018, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit mbështetur në raportin e inspektimit tematik të përgatitur nga zyra e inspektimit për këtë çështje, ka urdhëruar marrjen e masës disiplinore ñShkarkim nga detyraò për avokatin e shtetit që kishte në ngarkim çështjen. Me anë të shkresës nr. 1653 prot., datë 09.09.2020 Avokati i Shtetit në Zyrën Vendore Durrës, i ka drejtuar Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës në Kavajë, kërkesën për informacion me objekt ñ*Ekzekutimi i vendimit penal nr. 12-2016-1549/194, të datës 21.10.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë...*ò Nëpërmjet kësaj shkrese, Zyra Vendore Durrës, kërkonte informacion nëse masa e sekuestros preventive ishte ende në fuqi, dhe nëse po, sa është numri i pasurive mbi të cilat është ushtruar ekzekutimi i vendimit, si dhe gjendja juridike aktuale e këtyre pasurive. Nga komunikimet me subjektin, grupit të auditimit iu bë me dije se, nuk ka patur përgjigje nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë lidhur me këtë shkresë. Nga dokumentacionet e vëna në dispozicion grupit të auditimit, **nuk** identifikohen hapa të tjerë të ndërmarrë për rivendosjen e te drejtave pasurore mbi këto pasuri me pronar Shtetin Shqiptar. Nga sa më sipër **konstatojmë** se, me daljen e: - vendimit të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Kavajë më datë 21.10**.2016**, mbi vazhdimin e sekuestros preventive deri në zgjidhjen civile të pronësisë për 985.900 m^2 tokë në zonën Vilë-Bishtovë, të regjistruara në kundërshtim me ligjin duke, cënuar interesat pasurore të Shtetit Shqiptar, -vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës që lë në fuqi vendimin e Gjykatës së rrethit Gjyqësor Kavajë 11.07.**2017**, - raportit të inspektimit në Avokaturën e Shtetit më datë 30.01.**2018** sipas të cilit Avokatura Shtetit **nuk** ka ngritur padi civile në këtë proces penal, komunikimet shkresore të A.Sh-së për kërkimin dhe rivendosjen e të drejtave pasurore të Shtetit mbi këto prona, janë të gjysmës së dytë të vitit **2020.** Avokatura e Shtetit **nuk** rezulton të ketë ndërmarrë masat e nevojshme për të mbrojtur interesat pasurorë të shtetit në këtë çështje.
Kriteri:	- Shkronjat b dhe ç të pikës 1 të nenit 5 të ligjit 10018, 13.11.2008 të ndryshuar, të cilat përcaktojnë se Avokatura e Shtetit ñ*përfaqëson dhe mbron interesat pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave kombëtare, ndërkombëtare dhe të huaja, pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit në çështjet gjyqësore, në të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është pale.*ò, ñ *bashkërendon punën me prokurorinë për mbrojtjen, në gjykim, të interesave të shtetit për çështjet civile, zgjidhja e të cilave bëhet gjatë një procesi penal;".* - Neni 14, i ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 të ndryshuar, si dhe neni 39 të Rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Avokaturës së Shtetit, i ndryshuar me urdhrin nr.68, dt. 28.03.2019, sipas të cilave ñ*Avokatura e Shtetit mbron interesat pasurorë të shtetit në gjykimet penal.*ò Sipas pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, i ndryshuar dhe pikës 2 të nenit 39 të Rregullores së brendshme, date 28.03.2019 të A.SH *"Avokatura e Shtetit ngre **padi civile** në procesin penal për kërkimin e pasurisë ose shpërblimin e dëmit, që u është shkaktuar interesave të shtetit nga kryerja e veprës penale"* - Marrëveshja e bashkëpunimit midis Avokaturës së Shtetit, Prokuroria e

	Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave protokolluar në Avokaturën e Shtetit me nr. 1733 prot, dt. 31.08.2015, me objekt forcimi i bashkëpunimit për të garantuar mbrojtjen e te drejtave dhe interesave pasuror të shtetit dhe të shtetasve nga veprimtaria kriminale e kryer nëpërmjet falsifikimit dhe përdorimit të dokumenteve të falsifikuara. Referuar shkronjave b) dhe c) të nenit 5 të kësaj marrëveshje, Avokatura e Përgjithshme e Shtetit angazhohet: - ñ*Të ngrejë padi civile në proces penal kur konstatohet se preken interesat pasurore të shtetit nga veprimtaria objekt i kësaj Marrëveshjeje"*; - ñ*Me njoftimin e vendimit përfundimtar të prokurorit, të ushtrojë të drejtën e padisë në gjykatë, për mbrojtjen e interesave shtetërore*.
Ndikimi:	**Si rezultat se Avokatura e Shtetit nuk ka ngritur padi civile** me objekt pavlefshmërinë e AMTP-ve të kundërligjshme, apo që janë konstatuar të falsifikuara, me vendim penal të formës së prerë, ajo nuk ka siguruar mbrojtjen e interesave pasurorë të shtetit shqiptare për 985.900 m2 sipërfaqe toke. Mosndërmarrja e hapave të nevojshme për kalimin në pronësi të shtetit shqiptar të kësaj prone, nuk ka mundësuar përdorimin e saj nga shtet në të mirë dhe përfitim të qytetarëve shqiptarë.
Shkaku:	Avokatura e Shtetit **nuk** ka ngritur padi **civile** me objekt pavlefshmërinë e AMTP-ve të kundërligjshme, apo që janë konstatuar të falsifikuara për **985,900 m2 sipërfaqe toke**, me vendim penal të formës së prerë.
Rëndësia:	E lartë

Titulli i Gjetjes: 3	**Tkurrja e kuotave të shtetit shqiptar në kompaninë A ose, çështje e ndjekur në arbitrazhin ndërkombëtar**
Situata:	Në vijim të çështjes së arbitrazhit ndërkombëtar, të iniciuar nga shoqëria ñV I ò, s.r.1, me objekt mosmarrëveshje ñ*shkelje të Traktatit, "Për promovimin dhe Mbrojtjen e Investimeve", të nënshkruara ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë si dhe shpërblimin e dëmit në formën e kompensimit të plotë për humbjet e saj në investimin e kryer, për krijimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së ndërmarrjes së përbashkët "A -G* ò, grupi i auditimit ka analizuar administrimin e shoqërisë A -G , dhe problematikat e lidhura me të. Më datë 16.04.2009 është regjistruar pranë qendrës kombëtare të regjistrimit, shoqëria **M -A.** me nipt K E, me ortak fillestar 100% shoqërinë P S M d.d. Më datë 25.02.2014 është regjistruar pranë qendrës kombëtare të regjistrimit sot Q.K.B, shoqëria **P A sh.p.k**, me nipt L K, me objekt investime në kompani dhe konsulencë. Administrator dhe ortak i vetëm 100% i kuotave të kësaj shoqërie është Z. M C Më datë 07.04.2014, tek shoqëria **M -A.** me nipt K E është regjistruar shitje 100% e kuotave të cilat janë blerë nga shoqëria **P A sh.p.k.** Më datë 11.04.2014 pranë QKB-së për shoqërinë **M -A.** është regjistruar ndryshimi i administratorit dhe vendosja e administratorit të ri **po** Z. M C i cili në momentin e emërimit ishte Administrator i shoqërisë pronare të kuotave **P A sh.p.k**. Shoqëria **A sh.p.k** me nipt J F, është një shoqëri e përbashkët, ku shteti shqiptar ka zotëruar një kuotë kapitali prej 17.27% dhe pjesën tjetër të kuotave e ka zotëruar shoqëria V I . Më datë 23.06.2014 shoqëria **V I** ka shitur e kuotat e saj në

shoqërinë M -A prej 82.73%, regjistruar në ish QKR sot QKB më datë 14.07.2014. Po në këtë datë, është regjistruar dhe ndryshimi në administratorin e ri të shoqërisë A G , ku si i tillë është emëruar Z. M C

Deri në këtë moment z. K është paralelisht administrator i të 3 shoqërive të sipërcituara.

Më datë 09.02.2015 emërtimi i shoqërisë **M -A** ndryshoi dhe u bë **Am C l**.

Më datë 27.05.2015 shoqëria **A C** ka vijuar procedurën për përthithjen e shoqërisë **P A sh.p.k**. dhe po në këtë datë është regjistruar dhe shitja e 100% të kuotave të **AC** të cilat zotëroheshin nga **PA** tek pronari i ri i kuotave Z. M C .

Më datë 15.06.2017, në QKR/QKB është publikuar ndryshimi i emrit të shoqërisë **A sh.p.k** në **A F ,** ndryshimi i administratorit ku është caktuar administrator i ri z.A A sipas vendimit datë 28.04.2017.

Më datë 19.06.2017 është regjistruar pranë regjistrit tregtar vendimi sipas procesverbalit të mbledhjes të dt. **19.05.2017,** në të cilin ka qenë pjesëmarrës vetëm përfaqësuesi ligjor i ortakut A C , ndërsa përfaqësuesi i MZHETS nuk ka marr pjesë. Në këtë mbledhje është vendosur ndryshimi i kapitalit ku pjesa e MZHETS është zvogëluar në 8.24%, nga 17.27% që ishte më parë. Ndërkohë është rritur në mënyrë të njëanshme kapitali për shoqërinë A C nga financimi i dhënë nga aksioneri si borxh pa interes dhe vlera e tij deri më datë 31.03.2017 paraqitej 234,936,419 lekë sipas parashtresës datë 21.04.2017. Përfaqësuesi ligjor i kësaj shoqërie, i cili ka firmosur vendimin e ndryshimit, është Z. M C . Në këtë rast **nuk** është publikuar asnjë dokument për thirrjen e mbledhjes, orarin dhe vendin e saj. Po kështu nuk evidentohet asnjë qëndrim zyrtar nga ana e Minsitrisë mbi këtë rast.

Referuar sa më sipër, **M A** dhe **A sh.p.k** vlerësohen si shoqëri të kontrolluara/ influencuara referuar neneve 207 e vijues të ligjit 9901 dt. 14.04.2008, ñPër tregtarët dhe shoqëritë tregtareò, ndërkohë që sipas dispozitave të këtij ligji, pjesa IV, ñShoqëritë me përgjegjësi të kufizuaraò, Kreu II, Administratorët, neni 95, pika 2, ñ*Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm".*

Kjo situatë përkon edhe me lidhjen e kontratës së blerjes së kuotave të shoqërisë V sh.p.k. ku ndryshimi i kuotave në disfavor të shtetit shqiptar miratuar me vendimin e datë 19.05.2017 jo vetëm është i njëanshëm, por evidentohen parregullsi lidhur me legjitimitetin e caktimit të administratorit në shoqëritë e kontrolluara, tagrat e përfaqësuesit të ortakut i cili me datë 19.05.2017 rezulton zyrtarisht administrator i shoqërisë **A sh.p.k** dhe njëkohësisht ka firmosur si përfaqësues ligjor i **A C ortaku kryesor i A sh.p.k,** në kundërshtim me ligjit 9901, dt. 14.04.2008, ñPër tregtarët dhe shoqëritë tregtareò, pjesa IV, ñShoqëritë me përgjegjësi të kufizuaraò si dhe statutin e shoqërisë A :

-Neni 20 i **Statutit**[7] të shoqërisë A ,

-Neni 95 i ligjit 9901, dt. 14.04.2008, i ndryshuar, **Emërimi, shkarkimi, të drejtat dhe detyrimet.**

-Neni 85 i ligjit 9901, dt. 14.04.2008, i ndryshuar, **Përfaqësimi në asamble**

[7] Statuti i regjistruar në QKB më datë 18.07.2011, i cili ka qenë në fuqi deri në regjistrimin e statutit të ri, pas tkurrjes së kuotave të Shtetit Shqiptar në këtë shoqëri.

	Në dokumentacionin e publikuar në faqen e QKB mungon dokumenti i thirrjes zyrtare drejt Ministrisë Përgjegjëse ku të përcaktohet orari, vendi, rendi i ditës, etj në kundërshtim me nenin 83 të ligjit nr. 9901, dt. 14.04.2008, i ndryshuar, ku përcaktohet se: Çështja më sipër, evidenton nevojën për një vlerësim më të gjerë dhe të plotë mbi veprimet e administrative e ligjore të marra apo të munguara nga të gjitha palët e përfshira dhe legjitimitetin e tyre, për të eliminuar efektet në cenimin e interesave pasurorë të shtetit shqiptar, si dhe respektimin e kuadrin ligjor në fuqi.
Kriteri:	Shkronjat b e pikës 1 të nenit 5 të ligjit 10018, 13.11.2008 të ndryshuar, të cilat përcaktojnë se Avokatura e Shtetit ñ*përfaqëson dhe mbron interesat pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave kombëtare, ndërkombëtare dhe të huaja, pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit në çështjet gjyqësore, në të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është pale.*ò Ligji 9901 dt. 14.04.2008, ñPër tregtarët dhe shoqëritë tregtareò, ndërkohë që sipas dispozitave të këtij ligji, ñShoqëritë me përgjegjësi të kufizuaraò, Kreu II, Administratorët, neni 95, pika 2, përcaktohet se: ñ*Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm".* Neni 95 i ligjit 9901, dt. 14.04.2008, ñPër tregtarët dhe shoqëritë tregtareò i ndryshuar, ñ*Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, i cili caktohet në statut, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve, i cili hyn në fuqi në datën e përcaktuar sipas aktit të emërimit, u kundrejtohet palëve të treta sipas përcaktimeve të nenit 12 të këtij ligji. <u>Statuti mund të vendosë rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve"</u>* -Neni 20 i **Statutit** (regjistruar në QKB më datë 18.07.2011) të shoqërisë A , "**Emërimi i Administratorit "***Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, i cili caktohet në statut, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.* ***Emërimi i administratorëve, hyn në fuqi pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit****."* Neni 85 i ligjit 9901, dt. 14.04.2008, ñPër tregtarët dhe shoqëritë tregtareò i ndryshuar, **"***Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme".* Neni 83 i ligjit 9901, dt. 14.04.2008, ñPër tregtarët dhe shoqëritë tregtareò i ndryshuar, **"***1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.* *2. <u>Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.</u>*
Ndikimi:	Cenim i interesave të shtetit, rrjedhojë e veprimeve të kontrolluara dhe në mospërputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Emërimet e z.K në funksionin e administratorit të shoqërive **M** dhe **V I** referuar kritereve të mësipërme janë të pavlefshme dhe nuk prodhojnë pasoja

	juridike.
Shkaku:	Administrimi i shoqërisë së kontrolluar nga administratori i shoqërisë mëmë.
Rëndësia:	E lartë

Titulli i Gjetjes: 4	**Mosregjistrimi i çështjeve në sistemin elektronik të ASH.**
Situata:	Në pikën 1 të nenit 36, të Rregullores së Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Avokaturës së Shtetit miratuar me urdhrin nr.68, dt. 28.03.2019, përcaktohet *"Një kategori e caktuar çështjesh të cilat do të trajtohen nga Avokatura e Shtetit do të konsiderohen Kodi "A", një kod i cili do të shënohet/pasqyrohet në krah të numrit të brendshëm identifikues që do të marrë dosja/çështja \, si dhe çdo shkresë apo akt tjetër që lidhet me dosjen e kësaj çështje.* Sipas shkronjës f, të pikës 2 të këtij neni të gjitha çështjet me palë tatimet dhe doganat me vlerë mbi 10 milion do të kategorizohen Kodi ñA. Grupi i auditimit ka përzgjedhur 13 tatimpagues të cilët kanë paditur Drejtoritë Tatimore, me objekt shfuqizimin e akteve të rivlerësimit tatimor të kryera nga këto të fundit. Këto të dhëna janë filtruar nga një auditim i mëparshëm i kryer nga KLSH në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Referuar shkronjës h, të pikës 1, të nenit 11 të Rregullores së brendshme të institucionit, miratuar me urdhrin nr.68, dt. 28.03.2019, Avokati i shtetit duhet *të plotësojë të dhënat mbi çështjet në sistemin përkatës online duke përfshirë dhe ato statistikore brenda afateve të përcaktuara.* Grupi i auditimit konsultoi në sistemin elektronik të Avokaturës së Shtetit, pjesëmarrjen e kësaj të fundit në çështjet në fjalë. Nga shqyrtimi në sistem i çështjeve, rezultoi se Avokatura e Shtetit ka marrë pjesë në 12 nga 13 çështjet e mësipërme, ndërsa çështjen A S -DRT e ka deleguar. Referuar shkronjës h, të pikës 1, të nenit 11 të Rregullores së brendshme të institucionit, miratuar me urdhrin nr.68, dt. 28.03.2019, Avokati i shtetit duhet *të plotësojë të dhënat mbi çështjet në sistemin përkatës online duke përfshirë dhe ato statistikore brenda afateve të përcaktuara.* Në këtë sistem, grupi i auditimit shqyrtoi pjesëmarrjen e Avokaturës së Shtetit në gjykatën e shkallës së dytë për të 12 çështjet e mësipërme, si dhe në gjykatën e shkallës së parë për 3 prej çështjeve të mësipërme. Pra, 9 çështjet e tjera, te ndjekura në shkallë të parë nga Avokatura e Shtetit gjatë viteve 2012-2017, **nuk** ishin të regjistruara në sistemin elektronik të regjistrimit të çështjeve gjyqësore të institucionit. Sipas stafit të Avokaturës këto çështje janë më të hershme se viti 2015 kur është bërë funksional sistemi. Për shqyrtimin e këtyre çështjeve, lidhur me pjesëmarrjen e Avokaturës e Shtetit në to, grupi i auditimit ka konsultuar vendimet e gjykatës së shkallës së parë. Pra nga sa më sipër rezulton se, për 13 çështjet e marra në shqyrtim (një prej çështje është deleguar), në të gjitha rastet, ndjekja e tyre në Gjykatat e shkallës së dytë ishte e regjistruar në sistemin elektronik të regjistrimit të çështjeve (vendimi i formës së prerë ka dal në vitin 2019). Ndërsa, ndjekja e tyre në gjykatat e shkallës së parë ishte regjistruar nga avokatët e shtetit vetëm për 3 çështje, ndërsa 9 të tjera **nuk** ishin regjistruar, edhe pse vendimet e shkallës së parë në disa raste ishin pas vitin 2015, (vit në të cilin është bërë funksional sistemi referuar komunikimit me stafin e A.SH).
Kriteri:	-Shkronja h, të pikës 1, të nenit 11 të Rregullores së brendshme të institucionit, miratuar me urdhrin nr.68, dt. 28.03.2019, Avokati i shtetit duhet *të plotësojë të dhënat mbi çështjet në sistemin përkatës online duke përfshirë dhe ato statistikore brenda afateve të përcaktuara.*

Ndikimi:	Mosregjistrimi i çështjeve në sistem elektronik A.SH., vështirëson konsultimin e historikut të çështjeve të ndjekura nga avokatët e shtetit, duke ndikuar negativisht në eficiencën e tyre në punë.
Shkaku:	Edhe pasi sistemi elektronik i çështjeve gjyqësore të A.SH është bërë funksional, jo të gjitha çështjet e ndjekura nga A.SH pas vënies në funksion të tij, janë të regjistrura në sistem.
Rëndësia:	E mesme

Titulli i Gjetjes 5	**Moszbatimi në kohë i vendimeve të GJEDNJ krijon efekte negative shtesë.**
Situata:	Nga ana e institucioneve shqiptare pjesë e procesit për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), nuk rezulton të jenë zbatuar afatet 3 mujore për zbatimin e këtyre vendime parashikuar në vendimet përkatëse por edhe nenin 19/4 të Ligjin nr. 10018 datë 13.11.2008 ñPër Avokaturën e Shtetitò, i ndryshuar. Gjatë periudhës nën auditim vitet 2018-2020 janë zbatuar 3 vendime në vlerën 109,962 Euro, ndërkohë që rezultojnë të pazbatuar 7 vendime të tjerë me vlerë të pagueshme 17,956,320 Euro, pa përfshirë këtu interesat e pagueshëm në rast vonesash referuar pikes 3 të nenit 19/4 në ligjin e sipërcituar. Vendimet e pazbatuar datojnë prej vitit 2015 deri në vitin 2020. Dy prej tyre të cilët përbëjnë dhe peshën kryesore të vlerës financiare për tu përballuar nga buxheti i shtetit përkatësisht **"Sh and others v. Albania"** dhe **"Dh dhe N vs. Albania"**, me vlerat penalizuese për Republikën e Shqipërisë përkatësisht, 13,447,300 Euro dhe 4,417,750 Euro, nuk rezultojnë të jenë zbatuar brenda afateve të përcaktuara. Moszbatimi në afat i tyre krijon risk për aplikim interesash të pagueshme në vlera të konsiderueshme.
Kriteri:	-Ligji nr. 8137, datë 31.7.1996, , i ndryshuar, Për Ratifikimin e Konventës për Mbrojten e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore së bashku me protokollet shtesë. Ligji nr. 10018, datë 13.11.2008 Për Avokaturën e Shtetit, i ndryshuar, nenet 19/1 deri 19/10 të tij.
Ndikimi/Efekti	Mosveprimi ose veprimet me vonesë nga ana e institucioneve respektive në zbatimin e vendimeve të GJEDNJ krijojnë risk të lartë për efekte të tjera shtesë në dëm të buxhetit të shtetit, vlerë e cila deri më 31.12.2020 llogaritet në **1,675,938 Euro.**
Rëndësia	E Lartë

Titulli i Gjetjes: 6	**Kosto gjyqësore të parikuperuara në buxhetin e shtetit.**
Situata:	Në gjykatat e huaja ndërkombëtare dhe arbitrazhin ndërkombëtar Shteti Shqiptar ka qenë si Palë e Paditur në 14 çështje gjyqësore. Nga këto rezultoi se janë gjykuar dhe dhënë vendimet për 9 çështje ndërsa 5 prej tyre presin gjykimin pranë këtyre gjykatave. -Në 5 çështje të gjykuara, vendimi ka rezultuar në disfavor të Shtetit Shqiptar me një detyrim financiar prej rreth **388.5 milion Euro**. Thuajse për të gjitha rastet Avokatura e Shtetit nuk dispononte informacion të plotë mbi njohjen e këtyre vendimeve pranë Gjykatave të Apelit vendase, si dhe eurisë së ekzekutimin të tyre. Kjo si rrjedhojë e mosthirrjes në gjykim nga këto gjykata apo dhe nga institucionet respektive si palë e interesuar. Vendimet të cilat zënë peshën më të madhe janë çështjet e gjykuara në ICSID, ñQendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve në Fushën e Investimeveò ARB/15/28 H S.r.l and others me një vlerë prej rreth 108+ milion Euro, si

	dhe çështjes në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit të ICC me qendër në Paris, 21349/GR V2015 B P A ltd, me vlerë prej rreth 221.7 milion Euro. -Në 4 çështje të gjykuara, janë rrëzuar pretendimet e Palës Paditëse dhe vendimi ka rezultuar në favor të Shtetit Shqiptar. Edhe për këto çështje Avokatura e Shtetit nuk dispononte informacion mbi njohjen e këtyre vendimeve pranë Gjykatave të Apelit. Njohja e vendimeve të këtyre proceseve gjyqësore pranë këtyre gjykatave kanë të bëjnë me njohjen e të drejtës për rimbursimin e kostove të paguara më parë nga shteti shqiptar gjatë procesit gjyqësor dhe nuk janë vlera financiare shtesë të fituara. -Në **2 çështje**t e zhvilluara pranë ICSID konkretisht: Çështja ARB/17/6 me palë paditëse A -A G L , kostot e Arbitrazhit të cilat janë parapaguar në avancë prej saj, sipas pikës 299 të vendimit. Nga ana e ASH është lënë nuk ka pasur veprime të mëtejshme për njohjen dhe ekzekutimin e këtij vendimi. Ndërkohë që ky vendim duhet të ishte njohur nga ASH me qëllim kërkimin e kostove përkatëse. Çështja ARB/14/26 A A Sh.p.k, M. A N and C S.r.l. gjykata ka marrë vendim më datë 20.03.2020 në të cilin ka vendosur detyrimin e palës paditëse për pagesë të kostove dhe shpenzimeve të gjykimit përkatësisht, Euro 1,857,000 USD 427,488.72, GBP 106,755 me një total të llogaritur sipas kursit të publikuar të Bankës së Shqipërisë datës 31.12.2020 rreth 2,323,292 Euro. Referuar pikës 565 të këtij vendimi evidentohet se, Shqipëria ka paguar 399,900 Euro kosto arbitrazhi nga 380,000 USD që duhet të paguante, pra një vlerë më të madhe se ajo të cilën duhet të paguante në fakt. Vihet re se në këtë rast është investimi i vet ASH për njohjen e vendimit pranë Gjykatës së Apelit ndryshe nga raste të tjera që për njohjen e vendimeve institucioni shprehet se nuk ka informacion pasi nuk thirret nga këto gjykatat. -Në **2 çështje**t e tjera të zhvilluara pranë ICC, çështja, H srl 20564/EMT/GR V2014 me vlerë vendimi 7,343,668 euro e cila ka marrë formë përfundimtare dhe H srl 22919/GR V2017, me vlerë vendimi 733,076 Euro, Avokatura e Shtetit nuk dispononte informacion mbi njohjen e këtyre vendimeve pranë Gjykatave të Apelit. Nëpërmjet të dhënave të disponuara nga auditime të KLSH pranë MIE, rezultoi se, Gjykata e Apelit, Tiranë me vendimin nr.202, datë 16.10.2018 ka njohur vendimin e çështjes së vitit 2014, ndërsa sa i përket vendimit të vitit 2017 kërkesa është regjistruar në gjykatë më datë 26.02.2020 dhe pritet njohja e.
Kriteri:	-Kushtetuta e Shqipërisë, nenet 121 deri 123 të saj. -Ligji nr. 8137, datë 31.7.1996, , i ndryshuar, Për Ratifikimin e Konventës për Mbrojten e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore së bashku me protokollet shtesë. Vendimet e gjykatave ndërkombëtare lidhur me këto çështje.
Ndikimi/Efekti	Mosveprimi ose veprimet me vonesë nga ana e Avokaturës së Shtetit ka lënë pa rimbursuar kostot e parapaguara në arbitrazh që llogariten në vlerën **309,504 Euro.**
Rëndësia	E Lartë

Titulli i Gjetjes: 7	**Avokatura e Shtetit nuk disponon informacion të plotë mbi njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të dhëna nga gjykatat e huaja.**
Situata:	Thuajse në të gjitha çështjet e gjykuara pranë Gjykatave Ndërkombëtare dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar, Avokatura e Shtetit nuk dispononte informacion mbi ecurinë e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të gjykatave të huaja në Shqipëri. Sipas spjegimeve dhe komenteve të ASH mungesa e këtij informacioni vjen si rezultat i mosthirrjes si palë në proces nga Gjykatat e Apelit vendase si dhe nga mungesa e kërkesës prej instucioneve respektive që kanë interes të drejtpërdrejtë në çështje, të cilat thirren në gjykim nga këto gjykata. Ndërkohë në rastin *A Ambient Sh.p.k dhe të tjerë/2020, B Srl/2013*, shihet që ASH është investuar vetë në njohjen e vendimit në gjykatë, çka në vlerësimin tonë evidenton standarde të dyfishta veprimi lidhur me proceset e njohjes së vendimeve. Vlerat e konsiderueshme financiare të tyre e bëjnë të domosdoshme nevojën për pjesëmarrje të ASH në gjykim. Sipas nenit 79/a të KPC gjykatat rregullisht duhet të thërrisnin ASH në këto gjykime krahas institucionit të interesuar e megjithatë situata në fakt paraqitet krejt ndryshe. <u>Kryesisht institucionet palë në proces janë Ministritë e linjës pranë të cilave janë caktuar avokatë shteti të dedikuar për dhënien e asistencës ligjore, e megjithatë vihet re se bashkëpunimi i tyre me dikasteret përkatëse lidhur me këto çështje mungon.</u>
Kriteri:	Kodi i Procedurës Civile, neni 79/a i saj. -Ligjit 10018/2008 ñPër Avokaturën e Shtetitò në nenin 2 pika 2, Neni 5 pika 1/b, pika 1/1, neni 12 etj. -VKM nr. 392 datë 08.04.2009, Miratimin e rregullores ñPër marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të Shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme proceduraleò, i ndryshuar. -Rregullore e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Avokaturës së Shtetit miratuar me Urdhrin nr. 68 datë 28.03.2019 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, neni 17, 18 e vijues të saj.
Ndikimi/Efekti	Mungon një bazë e plotë të dhënash mbi vendime të dhëna nga gjykatat e huaja në regjistrin e posaçëm fizik dhe atë elektronik të ASH-së. Mungon pjesëmarrja në proceset e njohjes së vendimeve në mënyrë jo të standardizuar.
Rëndësia	E Lartë

Titulli i Gjetjes: 8	**Evidentohen paqartësi midis akteve ligjore dhe atyre nënligjore mbi përfaqësimin e ASH në gjykatat e vendit.**
Situata:	Evidentohen disa përcaktime jo të qarta ligjore mbi akteve ligjore që rregullojnë detyrimin e përfaqësimit ligjor të Avokaturës së Shtetit në Gjykatat Kombëtare dhe konkretisht. **a.** Në dispozitat e Ligjit nr. 10018/2008, i ndryshuar, neni pika 2, nenit 5 pika 1/b, dhe 1/1 të tij, përcaktohet detyrimi i ASH për përfaqësim në gjykatat vendase, mënyra e përfaqësimit si dhe pjesëmarrja e saj në procesin gjyqësor. Kjo duke vendosur theksin mbi bashkëpunimin e avokatëve të shtetit dhe personave juridikë si palë e interesuar në çështjet gjyqësore dhe bashkëpjesëmarrjen në këto gjykime. Ligji në këtë rast nuk ka vendosur kufizime sa i përket pjesëmarrjes së avokatëve të shtetit në gjykim. Ndërkohë VKM nr. 392 datë 08.04.2009, Miratimin e rregullores ñPër marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të Shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme proceduraleò, i ndryshuar, në nenin 24 pika 1 dhe 2 të tij, krijon paqartësi mbi ndjekjen e

	procesve gjyqësore prej avokatëve të shtetit pasi në të kërkohet marrja e një kërkese të motivuar nga organet përkatëse për përfaqësim. Në proceset gjyqësore të zhvilluara mbi njohjen e vendimeve të gjykatave të huaja pranë Gjykatave të Apelit, është evidentuar se nga ana e institucioneve kanë munguar kërkesat mbi pjesëmarrjen pavarësisht se për përfaqësimin prevalojnë dispozitat e ligjit. Nëse do ti referohemi Kodit të Procedurës Civile, në nenin 79/a të tij përcaktohet qartë se ñ*Avokatura e Shtetit ushtron përfaqësimin në rastet e parashikuara me ligj. Gjykata, që shqyrton çështje për të cilat me ligj përfaqësimi dhe mbrojtja kryhet nga Avokatura e Shtetit, urdhëron njoftimin e akteve kësaj të fundit, me qëllim që ajo të ketë mundësi të marrë pjesë në gjykim*ò. Sa më sipër evidenton nevojën për rishikim të dispozitave nënligjore mbi përfaqësimin me qëllim, eliminimin e paqartësive dhe garantimin e një mbrojtje cilësisht profesionale dhe moscenimin e interesave të shtetit. **b.** Ndryshe nga sa më sipër, lidhur me rastet e mbrojtjes së interesave pasurore të shtetit në gjykimin penal VKM nr. 392 nuk ka krijuar kufizime dhe ASH në mënyrë direkte ka të drejtë të ngrej padi civile për kërkimin e pasurisë ose shpërblimin e dëmit, që u është shkaktuar interesave të shtetit nga kryerja e veprës penale dhe kur vlera e dëmit është më pak se 2 milion lekë mund ta delegoj atë drejt institucionit respektiv. Ndërkohë në nenin 32 pika dh) të vendimit vlera e dëmit material për ushtrimin e të drejtës së delegimit e cila sipas nenit 14 pika 3 e ligjit nr. 10018/2008, i ndryshuar si edhe nenit 39 pika 3 e Rregullores së Brendshme të ASH-së është 2 milion lekë, pra sipas ligjit, ndërkohë në vendim referuar kritereve lëndore dhe sasiore ai paraqitet 1 milion lekë, ndryshe nga përcaktimi specifik ligjor, çka paraqet nevojën për unifikimin e aktit nënligjor me dispozitat e ligjit.
Kriteri:	Kodi i Procedurës Civile, neni 79/a i saj. -Ligjit 10018/2008 ñPër Avokaturën e Shtetitò neni 14 pika 3. -VKM nr. 392 datë 08.04.2009, Miratimin e rregullores ñPër marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të Shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme proceduraleò, i ndryshuar, Neni 21 Përfaqësimi pika 1 dh 4 e tij. -Rregullore e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Avokaturës së Shtetit miratuar me Urdhrin nr. 68 datë 28.03.2019 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, nenit 39 pika 3.
Ndikimi/Efekti	Paqartësi në dispozitat ligjore të cilat cënojnë cilësisht mbrojtjen e interesave shtetërorë. Dispozita të paunifikuara mbi paditë në proceset penale.
Rëndësia	E Lartë

(Për këtë drejtim auditimi është hartuar Akt-Konstatimi nr. 7 regjistruar në Avokaturën e Shtetit me nr. 4425/12 prot, datë 18.01.2021 mbajtur me përfaqësuesit e institucionit, Zj.E M Avokat i Përgjithshëm, dhe Z. A D (Zyra e Përfaqësimit në Gjykatat Vendase), E D (GJEDNJ), J M (Gjykatat e Huaja dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar).

- **Drejtimi 3: "Përputhshmëria ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave, realizimi i fondit të pagave, shpërblimeve, sigurimeve shoqërore e të tjera personeli"**

-Përputhshmëria ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave.

Në zbatim të nenit 4 dhe 5 të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 ñPër avokaturën e shtetitò, me urdhrin nr.257/1, datë 14.01.2009, të Ministrit të Drejtësisë, Avokati i Shtetit ka miratuar Rregulloren e Brendshme ñMbi organizimin dhe funksionimin e Avokaturës së Shtetitò. Rregullorja ka përbërë një akt normativ, i detyrueshëm për zbatim për të gjithë nëpunësit dhe punonjësit e Avokaturës së Shtetit. Ajo nuk ka pësuar ndryshime dhe ka shtrirë funksionimin e saj deri në vitin 2019. Me urdhrin nr. 68, datë 28.03.2019, të Avokatit të Shtetit, është miratuar Rregullorja e re ñPër organizimin dhe funksionimin e Avokaturës së Shtetitò.
Rregullorja është e përditësuar me ndryshimet ligjore që ka pësuar legjislacioni së cilës ajo i referohet, konkretisht ndryshimeve në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008 ñPër Avokaturën e Shtetitò, në ligjin nr. 9000/2012 ñPër organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetëroreò, ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, ñPër Parandalimin e konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publikeò i ndryshuar, në ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 ñPër rregullat e etikës në administratën publikeò, në ligjin nr. 119/2014 ñPër të drejtën e informimitò, në ligjin nr. 153/2013 ñPër nëpunësin civilò, ligjin nr. 138/2015 ñPër dekriminaliziminò.
Rregullorja është përditësuar njëkohësisht edhe me ndryshimet që ka pësuar struktura dhe organika e Avokatit të Shtetit, me urdhrat nr. 58, datë 25.03.2019 dhe nr. 171, datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave. Në nenin 6,7,8 të Rregullores, përcaktohet struktura e Avokaturës së Shtetit, ku janë reflektuar ndryshimet referuar urdhrave të sipër cituar në drejtim të organizimit në nivel qendror dhe vendor. Avokatura e Shtetit, për periudhën objekt auditimi, ka funksionuar në bazë të strukturës dhe organikës së miratuar nga Këshilli i Ministrave e konkretisht: Në vitin 2018, me strukturën dhe organikën e miratuar me urdhrin nr. 150, datë 10.11.2015, ñPër miratimin e strukturës dhe të organikës së Avokaturës së Shtetitò të KM, e cila nuk ka pësuar ndryshime, numri i punonjësve është përcaktuar 108, nga të cilët 67 punonjës i përkasin institucionit qendror, dhe 41 punonjës zyrave vendore. Në vitin 2019, struktura është miratuar me urdhrin nr. 58, datë 25.03.2019 ñPër miratimin e strukturës dhe të organikës së Avokaturës së Shtetitò të KM, ku numri i punonjësve është përcaktuar 108, nga të cilët 72 punonjës i përkasin institucionit qendror, dhe 36 punonjës i përkasin zyrave vendore. Për vitin 2020, struktura është miratuar me urdhrin nr. 58, datë 25.03.2019 si dhe ndryshimit me urdhrin nr. 171, datë 24.12.2019 ñPër disa ndryshime në Urdhrin nr.58, datë 25.03.2019, ñPër miratimin e strukturës dhe të organikës së Avokaturës së Shtetitò, ku numri i punonjësve është përcaktuar 107, nga të cilët 71 punonjës i përkasin institucionit qendror, dhe 36 punonjës i përkasin zyrave vendore.
Gjatë periudhës së auditimit struktura ka pësuar një ndryshim në vitin 2020 dhe konkretisht:
Me urdhrin nr.171, datë 24. 21.2019 ñPër disa ndryshime në Urdhrin nr.58, datë 25.03.2019ò, Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, i shkurtohet një pozicion ñspecialisti i ITò. Numri i punonjësve në këtë drejtori bëhet 12 dhe numri i punonjësve të Avokaturës së Shtetit bëhet 107. Në vitin 2019, struktura e Avokaturës së Shtetit, për sa i përket numrit gjithsej të punonjësve nuk ka pësuar ndryshime, por aparati qendror është shtuar me pesë punonjës, të cilët i janë shkurtuar Zyrës Vendore të Tiranës.
Numri gjithsej i punonjësve sipas organikës, krahasuar me faktin, në mesatare vjetore paraqiten si më poshtë:

Nr.	EMERTIMI	Viti 2018		Viti 2019		Viti 2020	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
I.	**Punonjës gjithsej**	**108**	**80**	**108**	**97**	**107**	**99**
1	Aparati Qendror	67	45	72	51	71	68
2	Zyra vendore Tiranë	12	10	7	7	7	6
3	Zyra vendore Durrës	8	8	8	8	8	8
4	Zyra vendore Vlorë	8	6	8	8	8	5
5	Zyra vendore Korçe	4	4	4	4	4	4
6	Zyra vendore Gjirokastër	5	3	5	5	5	4
7	Zyra vendore Shkodër	4	4	4	4	4	4
II.	**Punonjës të përkohshëm**	**3**	**3**	**7**	**7**	**7**	**7**

Burimi: Të dhënat e tabelës janë marrë nga specialisti i financës dhe përpunuar nga audituesi

Referuar të dhënave të mësipërme rezulton se, Avokatura e Shtetit, për periudhën objekt auditimi, pavarësisht vendeve vakant, ka respektuar strukturën dhe nuk ka asnjë rast që ta ketë tejkaluar numrin e punonjësve krahasuar me organikën e miratuar.
Për vitin 2018, organika e Avokaturës së Shtetit, sipas urdhrit të KM duket të kishte 108 punonjës, por fakti rezulton 80, me vakancë 28 punonjës. Për vitin 2019 vakanca është 11 punonjës dhe për vitin 2020 është 8 punonjës. Numri i punonjësve sipas listë pagesave mujore dhe paga bruto e tyre paraqiten në tabelën nr.1 dhe 1.1, bashkëngjitur materialit.

Të dhëna mbi numrin e punonjësve dhe paga bruto */në lekë*

	Viti	Plan	Fakt	Paga bruto	Plan me kontratë	Fakt me kontratë	Paga bruto
1	2018	108	80	74,578,033	2	3	377,897
2	2019	108	97	142,783,032	**7**	**7**	1,893,018
3	2020	107	99	124,868,103	**7**	**7**	1,432,452

Burimi: Të dhënat e tabelës janë marrë nga specialisti i financës dhe përpunuar nga audituesi

Referuar të dhënave, konstatohet se ka përputhje të të dhënave të pagës bruto, të raportuar sipas listë pagesave, me të dhënat në pasqyrat financiare si dhe me të dhënat nga situacionet,
Situacioni ka përputhshmëri me listëpagesat bruto, shtuar raportet mjekësore, shpërblimet, pagesat kalimtare të nënpunësve civilë të larguar nga detyra, shpenzimet telefonike mbi limitin e përcaktuar. Po kështu ka përputhshmëri të plotë edhe për rastet e ndalesave deri në pagën neto.

Në strukturë aktualisht 14 punonjës i rregullojnë marrëdhëniet e punës me ligjin nr. 152/2013, datë 01.10.2013 ñPër statusin e nëpunësit civilò, 84 punonjës i rregullojnë marrëdhëniet e punës me ligjin nr.7961 datë 12.7.1995 ñKodi i Punës i Republikës së Shqipërisëò i ndryshuar. Në lidhje me plotësimin dhe ruajtjen e dosjeve të nëpunësve civilë të institucionit, u konstatua se për çdo punonjës ka dosje të veçantë të plotësuar me dokumentacionin e duhur komfort legjislacionit në fuqi si Cv, diplome, listë notash, certifikatë personale, rekomandim, raport mjekësor, librezë pune, certifikatë të gjendjes gjyqësore, vlerësimi etj. Në Avokaturën e Shtetit, për vitin 2018, 2019, dhe gjashtëmujorin e parë të vitit 2020, janë depozituar vlerësimet e arritjeve vjetore individuale të punonjësve në zbatim të 152/2013 ñPër nëpunësin civilò. Regjistri i personelit është plotësuar sipas rubrikave të tij për të gjithë punonjësit ku janë regjistruar të gjitha emërimet, lëvizjet, largimet si për punonjësit në organikë dhe për punonjësit e emëruar me kontratë. Libri i pagave, për periudhën objekt kontrolli, është plotësuar për të gjithë punonjësit që janë në marrëdhënie pune, ku janë shënuar për çdo muaj të gjitha ekstraktet sipas listë pagesave nga paga bruto, shtesa e ndalesa deri në pagën neto.
- *Realizimi i fondit të pagave, shpërblimeve, sigurimeve shoqërore dhe fondit të veçantë.*

Nga auditimi u konstatua se, për të gjithë punonjësit që janë pjesë e strukturës së institucionit është respektuar struktura dhe nivelet e pagave sipas klasifikimit të funksioneve, duke përfshirë pagën bazë mujore dhe shtesat mbi pagë.
Realizimi i fondit të pagave, sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe fondit të veçantë për aparatin e Avokaturës së Shtetit, për periudhën objekt auditimi, paraqiten në tabelën si më poshtë:

Nr.	EMERTIMI	Viti 2018			Viti 2019			Viti 2020		
		Plani	Fakti	%	Plani	Fakti	%	Plani	Fakti	%
1	Pagat (600)	82,000	74,956	91%	147,286	144,676	98%	143,000	126,300	88%
2	Sigurimet Shoqërore (601)	13,000	12,026	92%	20,440	19,968	98%	21,000	17,217	82%
3	Fondi i veçantë	0	0		210	210	100%	300	60	20%

Burimi: Të dhënat e tabelës janë marrë nga Sektori i Buxhetit dhe përpunuar nga audituesi

Për sa më lart rezulton se, për vitin 2018 fondi i pagave është realizuar në masën 91%, për vitin 2019 në masën 98.% dhe për periudhën në vazhdim të vitit 2020 në masën 88%. Realizimi i fondit të pagave në vlerat e mësipërm ka ardhur si rezultat i mosplotësimit të numrit të punonjësve, pasi për vitin 2018 në krahasim me organikën institucioni ka pasur më pak 28 punonjës, ndërsa për vitin 2019 më pak 11 punonjës dhe për periudhën në vijim të vitit 2020 me 9 punonjës më pak se organika.
Sigurimet shoqërore për vitin 2018 janë realizuar në masën 92 % ndërsa për vitin 2019 në masën 98 % dhe për vitin 2020 në masën 82 %.

Fondi i veçantë, është përdorur në zbatim të VKM nr. 369, datë 13.06.2007 ñPër krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantëò e ndryshuar me VKM nr. 929, datë 17.11.2010, e ndryshuar, duke u përdorur pjesërisht, kryesisht për raste si, për fatkeqësi në familje, nga ku rezulton se për vitin 2019 janë kryer pagesa për një rast në vlerën 30 mijë lekë, për dalje ne pension dy raste me vlerë 180 mijë lekë. Për vitin 2020 për fatkeqësi në familje gjithsej dy raste me vlerë 60 mijë lekë. Fondi i veçantë, nuk është përdorur për shpërblimin e punonjësve në fund të viti ushtrimor.

Nga auditimi i kryer me zgjedhje, për respektimin e dispozitave ligjore për sigurimet shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat personale, rezultoi se për periudhën objekt kontrolli janë zbatuar dispozitat ligjore që rregullojnë këtë fushë. Nga auditimi u konstatua përputhshmëri midis vlerës në total të kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore me vlerën e paraqitur në pasqyrat financiare.

- *Mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna.*

Në vitin periudhën objekt auditimi, Avokatura e Shtetit, ka zbatuar gjithsej 7 vendime gjyqësore, për ish punonjësit, që kanë fituar procesin gjyqësor ndaj vendimit të largimit nga puna. Në gjshtë raste, është ndjekur procedura në të gjitha shkallët e gjykimit deri në lëshimin e titullit ekzekutiv. Në një rast, është kryer pagesa e 50 %, të vlerës së Vendimit Gjykatës Administrative të shkallës së parë, pa pritur vendimin e Gjykatës së Apelit Administrativ. Vlera totale e detyrimit për periudhën objekt auditimi është 8,810,568 lekë, nga e cila është trashëguar nga periudha para vitit 2018 vlera 455,013 lekë, është krijuar gjatë periudhës së auditimit vlera **8,355,555 lekë**, nga e cila është paguar vlera **7,067,190 lekë,** mbetet për tu paguar në vijim vlera.1,743,378 lekë. Vlera totale e detyrimit dhe vlera e paguar paraqiten në **Aneksin V,** pjesë e këtij materiali auditimi. Aktualisht Avokatura e Shtetit, ka katër procese gjyqësore për punonjës të tjerë të larguar nga puna.
(Për këtë drejtim auditimi është hartuar Akt-Konstatimi nr. 1 regjistruar në Avokaturën e Shtetit me nr. 4425/6 prot, datë 18.01.2021 mbajtur me përfaqësuesit e institucionit, Zj.M Sh dhe E M).

Drejtimi 4: "Auditimi i veprimeve financiare të institucionit"

Në zbatim të pikës nr. 3 të programit të auditimit ñ nr. 1114/1ò datë 06.11.2020, i ndryshuar, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
- Dokumentet bazë të kontabilitetit si: fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër-pagesat.
- Transaksionet e llogarive bankare
- Dosjet e inventarizimit

-Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve financiare të kryera nga institucioni nëpërmjet arkës dhe bankës.

Nga auditimi me zgjedhje mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër shpenzim, etj.) të realizuara në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të Avokaturës së Shtetit, rezultoi se, veprimet janë kryer konform kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò.
Dokumentacioni i bankës është mbajtur dhe kontabilizuar konform rregullave të kontabilitetit si dhe udhëzimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Urdhër-shpenzimet janë bazuar në dokumentacionin justifikues (si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, proces verbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve.) konform pikës 35, te Udhëzimit te Ministrisë Financave nr.30, date 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve ne Njësite e Sektorit Publik" dhe në çdo rast kanë nënshkrimin e personit të autorizuar në Degën e Thesarit.
- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për vitin 2018 janë në vlerën totale 141,334 mijë lekë;
- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për vitin 2019 janë në vlerën totale 180,931 mijë lekë;
- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për periudhën për vitin 2020 janë në vlerën totale 183,763 mijë lekë:

Urdhër Shpenzimet e përzgjedhura nga grupi i auditimin në bazë risku u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik*ò veçanërisht sa i takon regjistrimit të veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; *Dokumentet autorizues*, *Dokumente vërtetues*, *Dokumente të kontabilitetit, etj.*
Nga auditimi rezultoi:
-Veprimet ekonomike që kryhen nga njësia si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrime ruajtje, pasqyrohen me dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi.
- Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit është bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj.
- Marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve sipas kontratave të lidhura për mallra/shërbime përgjithësisht janë të konfirmuara dhe dokumentuara rregullisht nga një komision i ngritur nga Titullari i Avokaturës së Shtetit, në përputhje konform pikës 42, 43, 44, te Udhëzonit te Ministrisë Financave nr.30, date 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve ne Njësite e Sektorit Publik"

Nga auditimi i ditarit të shpenzimeve për vitin 2018 u konstatua se likuidimi i urdhër shpenzimeve është kryer në masën 18% të tyre në muajin Dhjetor, ndërsa në muajt e tjerë konstatohet një ekzekutim në masën mesatare 5.7%.
Për vitin 2019 likuidimet e kryera në muajin Dhjetor përbëjnë 9% të shpenzimeve të gjithë vitit, me një mesatare të muajve të tjerë prej rreth 8%. Për vitin 2020 likuidimet e kryera konstatohet një ekzekutim në masën mesatare 10% çdo muaj.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të urdhër-pagesave në lidhje me likuidimit e vendimeve gjyqësorë u konstatua se <u>për të gjitha këto vendime pagesat **nuk** janë kryer vullnetarisht nga Avokatura e Shtetit me marrjen e njoftimit të vendimit të formës së prerë</u> dhe kthimit të tij në titull ekzekutiv, por janë kryer në bazë të urdhër ekzekutimeve të lëshuara nga përmbaruesit privat, **duke paguar tarifa përmbarimore, veprime të cilat kanë sjellë kosto shtesë për buxhetin e Avokaturës së Shtetit**.

Zyra e Përfaqësimit pranë Avokaturës së Shteti i dërgon Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse vendimet gjyqësore vetëm në rastin ku ato janë për likuidim, dhe kur është bërë kërkesë nga përmbaruesi për shlyerjen e detyrimeve.
<u>Kjo zyrë nuk informon në vazhdimësi Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse për të gjitha vendimet gjyqësore, të cilat kanë kaluar shkallën e dytë të procesit të apelimit,</u> me qëllim që nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të merren masa për krijimin e provizioneve për shpenzime, të cilat janë ngjarje të ndodhura, që do të sjellin një probabilitet që do të ketë një detyrim për tâu paguar nga ana e njësisë, me qëllim njohjen e tyre në kontabilitet dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare vjetore të njësisë, duke bërë të mundur dhe planifikim në kohë të burimeve të financimit dhe një parashikim të besueshëm mbi vlerën e detyrimeve, si dhe shmangien e detyrimeve të akumuluar dhe të pagesave të tarifave përmbarimore si pasojë e mosekzekutimit vullnetar të vendimeve të cilat për periudhën nën auditim paraqiten në shumën **669,106 lekë.**

Në lekë

U.SH	Datë	Perfituesi	Gjyqefituesi	Vlera për shërbimin përmbarimor
224	11.07.2019	P B S shpk	Xh K	
423	13.12.2019	P B S shpk	Xh K	
49	19.02.2020	P B S shpk	Xh K	
75	19.03.2020	P B S shpk	Xh K	272,966
90	03.06.2020	B B	I M	71,709
97	27.03.2019	A shpk	K S	209,385
284	22.11.2018	A	S M	97,046
59	25.02.2019	ZP A K	P K	18,000
114	24.9.2018	S B S	Dh K	
SHUMA				**669,106**

Burimi: ASH, përopunuar nga grupi i auditimit.

Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:
- Kodin e Procedurës Civile, neni 130 ñRregullat e njoftimit shkresor të akteveò ku citon seé .òNë rastin e personave juridikë publikë njoftimi bëhet në qendrën e tij dhe i dorëzohet titullarit ose personave të ngarkuar për pranimin e akteveò, nenit 451/a ku citon se é . *"Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët"* dhe neni 510/a *"Titujt ekzekutivë".*
- Referuar Kodit të Procedurës Civile, neni 130 ñRregullat e njoftimit shkresor të akteveòô ku citon seé .ò*Në rastin e personave juridikë publikë njoftimi bëhet në qendrën e tij dhe i*

dorëzohet titullarit ose personave të ngarkuar për pranimin e akteve", ku institucionit i lind e drejta për ti kërkuar gjyqëfituesit paraqitjen e titullit ekzekutiv të vendimit të formës së prerë, për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, me qëllim shmangien e kostove shtesë të tarifave të përmbaruesit gjyqësore.
- Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, pika 34.

-Inventarizimi i pasurisë së institucionit

Nga auditimi u konstatua se Avokatura e Shtetit ka të dhëna mbi gjendjen fizike dhe vlerën kontabël të pronave në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, neni 26 ku citohet: ñ*Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësoj një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike që siguron të ardhur ..." dhe neni 31, citohet " ...për objektet e dhëna me qira – sipërfaqja e objektit ne m^2, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës...*
Regjistrimi i aktiveve është kryer konform Kreut III, "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre", të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik". Hyrja e aktiveve për çdo rast dokumentohet me fletë-hyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre, konforrn pikës 37, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, date 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik". Daljet e aktiveve për çdo rast, janë kryer konform pikës 38, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, date 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve ne Njësite e Sektorit Publik".

Komisioni i ngritur me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit nr. 153, datë 19.12.2018 **për vitin 2018** dhe me urdhrin nr. 361, datë 19.12.2019 **për vitin 2019**, ñPër kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të materialeve dhe aktiveve në Avokaturën e Shtetitò ka bërë verifikimin fizik të gjendjes së aktiveve në përdorim të personelit.
Nga auditimi u konstatua se, nga komisioni para fillimit të inventarit ishte fiksuar numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit, në përputhje me pikën 83 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò.
Nga auditimi u konstatua se komisioni pas verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë publike, nuk i ka pasqyruar të dhënat e inventarizimit në procesverbalin përkatës, i cili ruhet gjatë periudhës së inventarizimit. *Dokumentacioni është firmosur vetëm nga komisioni i inventarizimit dhe jo nga personat të cilët i kanë në ngarkim/ përdorim këto aktive, veprime* në kundërshtim me 85.a të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011.
Në fund të procesit të inventarizimit, komisioni kishte përpiluar një raport në lidhje me inventarizimin fizik te aktiveve, ku janë dhënë komentet në lidhje me gjendjen fizike aktuale të aktiveve (nëse janë apo jo në përdorim), si dhe për kushtet e ruajtjes se tyre dhe së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, i është dorëzuar për veprime të mëtejshme titullarit të institucionit, veprime në përputhje me pikën 85/c të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011.
Për vitet objekt auditimi u konstatua se, komisioni i inventarizimit ka bërë një vlerë totale me listë të bashkëngjitur, se sa ka gjendje fizike institucioni, për pajisje informatike, për pajisje zyre të ndarë në artikuj, si dhe mjete transporti në dispozicion etj sipas formatit të regjistrit të

aktiveve, i cili hartohet në vartësi të llojit të tyre, si dhe grupit përkatës brenda llojit dhe më pas është bërë krahasimi i gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të regjistruara në kontabilitet, veprime në përputhje me pikat 30, 73, 74 , pika 81 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò.
Vlerësimi i aktiveve është bërë gjatë procesit të inventarizimit, pasi sipas urdhrit nr. 153, datë 19.12.2018 për vitin 2018 dhe me urdhrin nr. 361, datë 19.12.2019 për vitin 2019, i ngritur me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit është cilësuar komision inventarizimi dhe vlerësimi.
Nga komisioni nuk janë dhënë shpjegime se mbi bazën e cilit kriter janë vlerësuar aktivet për nxjerrje jashtë përdorimi, veprime në kundërshtim me pikën 103 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, si dhe nuk është formuluar një relacion ku të përmbajë proçedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës, veprim në kundërshtim me pikën 106 të udhëzimit.

Për secilin aktiv të vlerësuar të dëmtuar dhe jashtë përdorimi nga komisioni nuk është mbajtur **proces verbali i vlerësimit veprime në kundërshtim me pikën 104-105.**
Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi pika 95 citon se: Është një proces që kryhet gjate ose pas procesit të inventarizimit. Mbi bazën e të dhënave kontabël për vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfitim, bëhet vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale: urdhri i ngritur nga titullari ka qene komision inventarizimi dhe vlerësimi të aktiveve të njësisë.

Respektimi i rregullave kontabël për nxjerrjen jashtë përdorimi të vlerave materiale, kryerja e veprimeve kontabël për shkarkimin nga magazina
Nga Avokatura nuk është ngritur òKomisioni i nxjerrjes nga përdorimiò për vitet objekt auditimi.
Nga institucioni nuk është dhënë asnjë koment se kush janë shkaqet e mos fillimit dhe realizimit të kësaj faze.
Në lidhje me **amortizimin e aktiveve afatgjata**, për vitin 2018 e në vazhdim normat e amortizimit janë llogaritur sipas pikës nr. 36 të udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësinë e qeverisjes së përgjithshmeò.
- Për aktivet afatgjata materiale si ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e të prodhimit, dhe makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur;
- Kompjuterat, pajisjet e ruajtjes së të dhënave, softe e sisteme informacioni të amortizohen mbi bazë grupimi me normën 25%;
- Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi; dhe
- Për aktivet afatgjata jo materiale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%.

Nga auditimi i zërave të aktiveve u konstatua se në pasqyrën e pozicionit financiar të subjektit janë regjistruar në llogarinë 24 ñ Aktive afatgjata të dëmtuaraò përkatësisht për vitin 2018 në shumën 5,076,219 lekë dhe për vitin 2019 në vlerën 5,536,165 lekë.
Për këto aktive është llogaritur amortizimi edhe pse kanë kaluar në llogarinë 24.

Aktivet të cilat duhet të kalojnë në këto llogari janë ato aktive të cilat nga komisioni i vlerësimit janë si nxjerrë jashtë përdorimi dhe pritet të asgjësohen/tjetërsohen nga komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimi dhe veprimet të cilat duhet të bëhen për këto aktive është fletë dalje nga magazinë dhe fletë hyrje rikupero ku më pas këto aktive regjistrohen në pasqyrën financiare në zërin aktive të dëmtuara, për të cilën priten që të asgjësohen.
Veprimi kontabël për kalimin në aktive afatgjata të dëmtuara, funksionimi i vlerës historike dhe amortizimit është:

- Kreditohen llogaritë 20, 21
- Debitohet 24 ñAktive afatgjata të dëmtuaraò

Observacion mbi Projektraportin e Auditimit i paraqitur nga Avokatura e Shtetit me shkresën nr. 4425/15 prot, datë 30.09.2021, regjistruar në KLSH me nr. 1114/6, datë 06.10.2021 ku trajtohet në mënyrë të përmbldhur sa vijon:

Pretendimi i subjektit të audituar
Ekzekutimi i vendimeve ka filluar me paraqitjen e shkresës përcjellë nga përmbaruesi gjyqësor, i cili ka kërkuar ekzekutim vullnetar., pra afati i pagesës ka filluar që nga momenti i njoftimit nga përmbaruesi, ku ASH nuk ka refuzuar kreditorin por është gjetur për para faktit të kryerjen së vendimit nëpërmjet përmbaruesit.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së
Ju sqarojmë se vendimi i formës së prerë ju bëhet me dije palëve ndërgjyqëse, ashtu sikurse referuar Kodit të Procedurës Civile, nenit 130, ju bëhet me dije çdo akt i paraqitur në procesin gjygjësor në të cilën jeni palë. Nga ky moment ju lind detyrimi ligjor si palë ndërgjygjëse (i paditur) të njoftoni palën fituese për paraqitjen e titullit ekzekutiv pranë institucionin për likuidimin vullnetar të detyrimit. Pretendimet e paraqitura janë thuajse identike me pretendimet e paraqitura në fazën e mëparshme (trajtuar më poshtë).
Sa më sipër obsevacioni nuk merret në konsideratë.

Observacion mbi Akt konstatimet nr. 2, date 18.01.2021, prot në KLSH me nr. 1114/4 datë 27.01.2021.
Pretendimi i Subjektit: *Ekzekutimi i vendimit ka filluar me paraqitjen e shkresës nga përmbaruesi gjyqësor i cili kërkon ekzekutimin e vendimit, afati i pagesës ka filluar që në atë moment, ku Avokatura është gjetur përpara këtij fakti. Përfaqësimi i çështjeve për largim nga puna është ndjekur nga Zyra e Përfaqësimit pranë Avokaturës së Shteti.*
Qëndrimi i Grupit të Auditimit: *Zyra e Përfaqësimit pranë Avokaturës së Shteti për të gjitha vendimet gjyqësore, të cilat kanë kaluar shkallën e dytë të procesit të apelimit, me qëllim që nga Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse merren masa për krijimin e provizionet për shpenzime, të cilat janë ngjarje të ndodhura, që do të sjellin një probabilitet që do të ketë një detyrim për t'u paguar nga ana e njësisë, me qëllim njohjen e tyre në kontabilitet dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare vjetore të njësisë, duke bërë të mundur dhe planifikim në kohë të burimeve të financimit dhe një parashikim të besueshëm mbi vlerën e detyrimeve, si dhe shmangien e detyrimeve të akumuluar dhe të pagesave të tarifave përmbarimore si pasojë e mosekzekutimit vullnetar të vendimeve në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"pika 34. Referuar Kodit të Procedurës Civile, neni 130 "Rregullat e njoftimit shkresor të akteve"' ku citon se…."Në rastin e personave juridikë publikë njoftimi bëhet në*

qendrën e tij dhe i dorëzohet titullarit ose personave të ngarkuar për pranimin e akteve", ku institucionit i lind e drejta për ti kërkuar gjyqëfituesit paraqitjen e titullit ekzekutiv të vendimit të formës së prerë, për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, me qëllim shmangien e kostove shtesë të tarifave të përmbaruesit gjyqësore
Pretendimi i Subjektit: *Urdhri për vlerësimin e aktiveve është ngritur me nr. 113 datë 13.07.2020 dhe nuk është në proces për shkak të situatës së shkaktuar nga Covid-19.*
Qëndrimi i Grupit të Auditimit: *Nga grupi i auditimit është konstatuar se urdhri i ngritur nga titullari ka qënë inventarizim dhe Vlerësimi i aktiveve, grupi i auditimit mbështetur në urdhrin dhe raportin e dalë nga komisioni ka konstatuar se nga komisioni nuk është dhënë shpjegime se mbi bazën e cilit kriter janë vlerësuar aktivet për nxjerrje jashtë përdorimi,*
Pretendimi i Subjektit: *Persa i përket zërave të aktiveve në llogarinë 24 " Aktive afatgjata të dëmtuara" përkatësisht për vitin 2018 në shumën 5,076,219 lekë dhe për vitin 2019 në vlerën 5,536,165 lekë, të cilat janë regjistruar në këto llogari është bërë sistemimi sipas konstatimit të KLSH-së, së lënë në akt konstatimin nr. 2, datë 18.01.2021.*
Qëndrimi i Grupit të Auditimit: *Observimi merret në konsideratë.*

Nga auditimi i regjistrit të aktiveve të regjistruar në kontabilitet u konstatua se, një pjesë e këtyre aktiveve të cilat vazhdojnë të jenë në përdorim dhe gjendje pune, pasi u është zbritur amortizimi i akumuluar ndër vite vlera e tyre paraqitet 0 lekë. Nga institucioni nuk është marrë asnjë masë për të ngritur grupin e punës me ekspertë të fushave, për artikujt, <u>për të shqyrtuar jetën e dobishme dhe vlerën e mbetur të këtyre aktiveve</u>, ku pas këtij shqyrtimi të bëhet rivlerësimi i vlerës së tyre nëse këto aktive vazhdojnë të jene në gjendje pune dhe nuk kanë nevojë për tu riparuar. Ndryshimet në jetën e pritshme të dobishme dhe të vlerës së tyre të kontabilizohen duke ndryshuar periudhën e amortizimit apo metodën, sipas rastit, dhe të trajtohen si ndryshime në vlerësimet kontabël.

Titulli i Gjetjes 1:	*Mosmarrja e vprimeve të duhura për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë krijon efekte financiare shtesë.*
Situata:	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të urdhër-pagesave në lidhje me likuidimin e vendimeve gjyqësorë u konstatua se, për të gjitha këto vendime pagesat **nuk** janë kryer vullnetarisht nga Avokatura e Shtetit me marrjen e njoftimit të vendimit të formës së prerë dhe kthimit të tij në titull ekzekutiv, por janë kryer në bazë të urdhër ekzekutimeve të lëshuara nga përmbaruesit privat, duke paguar tarifa përmbarimore, veprime të cilat kanë sjellë kosto shtesë për buxhetin e Avokaturës së Shtetit. Kjo zyrë i dërgon Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse vendimet gjyqësore vetëm në rastin ku ato janë për likuidim, dhe kur është bërë kërkesë nga përmbaruesi për shlyerjen e detyrimeve por nuk ka informuar në vazhdimësi Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse për të gjitha vendimet gjyqësore, të cilat kanë kaluar shkallën e dytë të procesit të apelimit, me qëllim që nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të merren masa për krijimin e provizionet për shpenzime, të cilat janë ngjarje të ndodhura, që do të sjellin një probabilitet që do të ketë një detyrim për tû paguar nga ana e njësisë, dhe planifikimin në kohë të burimeve të financimit mbi vlerën e detyrimeve. Kjo do të shmangte detyrimet e akumuluara të pagesave të tarifave përmbarimore si pasojë e mosekzekutimit vullnetar të vendimeve.
Kriteri:	Kodin e Procedurës Civile, neni 130 ñRregullat e njoftimit shkresor të akteveò nenit 451/a; neni 510/a ñTitujt ekzekutivë.

Ndikimi/Efekti:	Krijimi i kostove shtesë në dëm të buxhetit të institucionit të cilat për periudhën nën auditim paraqiten në shumën **669,106 lekë.**
Shkaku:	Mos fillimi i procedurave nga institucioni të likujdimit ndaj gjyqëfituesit që me marrjen e njoftimit nga organet kompetente.
Rëndësia:	E mesme

Titulli i Gjetjes 2:	*Procesi i inventarizimit të aktiveve paraqetet me disa mangësi*
Situata:	Nga auditimi rezultoi se, komisioni i ngritur me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit nr. 153, datë 19.12.2018 për vitin 2018 dhe me urdhrin nr. 361, datë 19.12.2019 për vitin 2019, ñPër kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të materialeve dhe aktiveve në Avokaturën e Shtetitò është cilësuar komision inventarizimi dhe vlerësimi të aktive, ku sipas urdhrit të titullarit vlerësimi i aktiveve është bërë gjatë procesit të inventarizimit, Nga komisioni nuk është dhënë shpjegime se mbi bazën e cilit kriter janë vlerësuar aktivet për nxjerrje jashtë përdorimi, veprime në kundërshtim me pikën 103 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, si dhe nuk është formuluar një relacion ku të përmbajë proçedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës, veprim në kundërshtim me pikën 106 të udhëzimit. Për secilin aktiv të vlerësuar të dëmtuar dhe jashtë përdorimi nga komisioni nuk është mbajtur proces verbali i vlerësimit veprime në kundërshtim me pikën 104-105 të udhëzimit.
Kriteri:	Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò pikën 103, 104,1 05, 106.
Ndikimi/Efekti:	Mos monitorim i gjendjes reale të aktiveve në dispozicion, si dhe nevojave të institucionit për asete shtesë.
Shkaku:	Mos njohuri apo nenglizhencë, nga komisioni i inventarizimit të pikave të përcaktuar në udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011.
Rëndësia:	E mesme

(Për këtë drejtim auditimi është hartuar Akt-Konstatimi nr. 2 regjistruar në Avokaturën e Shtetit me nr. 4425/7 prot, datë 18.01.2021 mbajtur me përfaqësuesit e institucionit, E Gj dhe A D).

Drejtimi 5: "Prokurimet e fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime"

-Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik.

Gjatë auditimit mbi procedurat e prokurimeve të realizuara në Avokaturën e Shtetit (A.SH), të periudhës 01.01.2018 deri në 30.11.2020, në bazë të Programit të Auditimit nr.1114/1 datë 06.11.2020, grupi i audituesve të KLSH-së, u fokusua në zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, VKM nr.918 datë 29.12.2014 ñPër kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronikeò, udhëzim e APP-së nr.3 datë 08.01.2018 ñMbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj në mjete elektorinkeò ndryshuar me udhëzimin Nr. 5 datë 11.01.2018 dhe çdo akti juridik që është në fuqi në lidhje mbi prokurimet publike të financuara nga Buxheti i Shtetit.

Në bazë të regjistrave të parashikimit dhe ato të realizimit që i përkasin periudhës së auditimit, janë paraqitur brenda afateve sipas viteve buxhetore të dërguara on-line, pranë Agjencisë së Prokurimit Publik (APP).

	Procedura			**Fondi**		
Viti	Parashikuar	Realizuar	% realizimit	Parashikuar	Realizuar	% realizimit
2018	31	35	113%	11,982,300	15,780,372	132%
2019	26	26	100%	12,180,000	5,388,261	44,24%
gusht 2020	19	17	89%	5,348,900	2,684,038	50%

Burimi: Të dhënat e ASH, përpunuar nga grupi i auditimit:

Me shkresën nr.154 prot. Datë 24.01.2018 miratuar nga titullari i institucionit është dërguar Ministrisë së Drejtësisë si dhe degës së thesarit regjistri i parashikimit të **31** procedura prokurimi për vitin 2018. (9 dite me vonesë)
Me shkresën nr. 171 prot. Datë 09.01.2019 miratuar nga titullari i institucionit është dërguar në Ministrisë e Drejtësisë si dhe degës së thesarit regjistri i realizimit të **35** procedura prokurimi publike, të realizuara nga ASH.

Për vitin 2018 janë kryer gjithsej 35 procedura prokurimi nga te cilat **2** procedura janë në vlerën mbi 800,000 leke pa TVSH dhe **33** procedura janë blerje me vlerë të vogël si dhe nën vlerën 100,000 lekë pa TVSH.
Me urdhrin nr.2 datë 12.01.2018 ñPër krijimin e Komisionit të Prokurimit Publik me Vlerë të Vogëlò i miratuar nga titullari i institucionit është krijuar komisioni i përbërë nga Kryetari i grupit znj.Jonida Dragoti dhë 2 anëtarë z.A D dhe znj.M S për prokurimin me vlerë të vogël nën 800,000 lekë pa TVSH ndryshuar me urdhrin Nr.02/4 datë 31.05.2018 ñPër krijimin e Komisionit të Prokurimit Publik me Vlerë të Vogëlò i mirtuar nga titullari i institucionit është krijuar komisioni i përbëre nga Kryetari i grupit z.E A dhe 2 anëtarë z.A D dhe znj.M S për prokurimin me vlerë të vogël nën 800,000 lekë pa TVSH.
Me urdhrin nr.02/01 datë 18.01.2018 *"Për krijimin e komisionit të sistemit dinamik të biletave te transportit ajror ndërkombëtar"* komisioni është i përbërë nga znj.Jonida Dragoti, Kryetar i grupit; z.A D dhe z.M S anëtare i ndryshuar me urdhrin nr.02/3 datë 31.05.2018 *"Për krijimin e komisionit të sistemit dinamik të biletave te transportit ajror ndërkombëtar"* me komision z.E A kryetar gurpit dhe z.A D dhe znj.Ma S .
Grupi i auditimit përzgjodhi për auditim disa procedura mbi bazën e vlerës më të lartë të prokuruar. Nga auditimi i procedurave të prokurimit në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) dhe dokumentacionit bashkangjitur praktikave të likuidimit, rezultoi si më poshtë vijon:

1. Me Urdhër prokurimin Nr.01 datë 18.01.2018 është filluar procedura e prokurimit blerje me vlerë të vogël për ñ***Blerje biletë udhëtimi Tiranë –Strasburg; Strasburg Tiranë, dhe rezervim hoteli ne Strasburg 25-27 Janar*"**,** me fond limit 135,000 lekë pa TVSH. Nga Ministri i Drejtësisë, me shkresën nr.403/1 datë 18.01.2018 ka autorizuar Titullarin e Avokaturës së Shtetit për pjesëmarrje në një seminar në ñGjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriutò në Strasburg në datën 26.01.2018.

Në praktikë kanë paraqitur ofertë 6 (gjashtë) operatorë ekonomik dhe është shpallur fitues operatori i 6 (gjashtë) ekonomik, pasi 5 (pesë) operatorët e parë ekonomik kanë deklaruar tërheqjen e tyre nga konkurrimi. Nga Komisioni i PP është mbajtur procesverbali ne lidhje me njoftimet e fituesve/tërheqësve si dhe fituesit të 6 (gjashtë). Operatori ekonomik ñA S ò është shpallur fitues për vlerën 128,980 lekë.
Nga auditimi u konstatua se, Në ñFtesën për Ofertëò Formulari nr.3 objekti i prokurimit ne lidhje me blerjen e biletës si dhe akomonidimit në hotel është vendosur si me poshtë vijon:
Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna:
*1.Tiranë- Stuttgart, **A S** (bagazh i përfshire)*
*Strasbourg-Tiranë, **L** (bagazh i përfshirë)*
*2.Akomodimi në hotel për data 25-27 Janar 2018, në **(Hotel M S C 4*)** për një person.....*
Grupi i auditimit konstatoi se Komisioni i Prokurimit Publik në kundërshtim me udhëzimi nr.4 datë 09.01.2018 ñ*Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin ne mjete elektronik*ò, ne Ftesën për Ofertë, ka përcaktuar linjën ajrore si dhe hotelin për destinancionin e përcaktuar si më sipërpërmendur.
Referuar pikës 6 së udhëzimit nr.04 datë 09.1.2018 APP ñ*Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar..."* citohet se ñ*Ftesa për ofertë përmban objektin e prokurimit, të dhënat sasiore e teknike të biletave të transportit ajror ndërkombëtar, grafikun e egzekutimit, afatin e paraqitjes si dhe dokumentat që duhet të dorëzojë operatori ekonomik i shpallur fitues, nëse është rasti"* KPP nuk i është përmbajtur këtij udhëzimi duke përcaktuar linjën ajrore si dhe hotelin e qëndrimit. Ky përcaktim bie ne kundërshtim me udhëzimin e sipërpërmendur.
Me urdhër shpenzimin nr.37 datë 08.02.2018 është kryer likuidimi i detyrimit të operatorit ekonomik mbi shpenzimet për blerjen e biletës së udhëtimit dhe rezervimi i hotelit më vlerën 128,980 lekë. Bashkëlidhur këtij urdhri ndodhen të gjitha dokumentacionet justifikuese të faturës së hotelit si dhe biletës se avionit.

2. Me Urdhër prokurimin Nr.21 datë 22.11.2018 është filluar procedura e prokurimit blerje me vlerë të vogël për ñ***Blerje biletë udhëtimi Tiranë –Strasburg; Strasburg Tiranë, dhe rezervim hoteli ne Strasburg 25-27 Nentor*"** për një person. Nga Ministri i Drejtësisë, me shkresën nr. 11707 datë 19.11.2018 ka autorizuar Titullarin e Avokaturës së Shtetit për pjesëmarrje në një seminar në ñGjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriutò në Strasburg në datën 26.11.2018.
Në praktikë kanë paraqitur ofertë 2 (dy) operatorë ekonomik dhe është shpallur fitues operatori i 1(parë) ekonomik, në vlerën me të ulët. Nga Komisioni i PP është mbajtur procesverbali ne lidhje me njoftimin e fituesit të operatorit ekonomik ñA S ò i cili është shpallur fitues për vlerën 113,386 lekë.
Nga auditimi u konstatua se, Në ñFtesën për Ofertëò Formulari nr.3 objekti i prokurimit ne lidhje me blerjen e biletës si dhe akomonidimit në hotel është vendosur si më poshtë vijon:
Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objket prokurirmi me këto të dhëna:
*1.Tiranë- Frankfurt, **L** (bagazh i përfshirë)*
*Strasbourg-Tiranë, **L** (bagazh i përfshirë)*
*2.Akomodimi në hotel për data 25-27 Nëntor 2018, në **(Hotel B , S 4*)** për një person.*
Grupi i auditimit konstatoi se Komisioni i Prokurimit Publik në Ftesën për Ofertë, ka përcaktuar linjën ajrore si dhe hotelin për destinancionin e përcaktuar si më sipërpërmendur në kundërshtim me udhëzimi nr.4 datë 09.01.2018 ñ*Mbi përdorimin e sistemit dinamik për*

*blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin ne mjete elektronik*ò ndryshuar me udhëzimin nr.13 datë 08.01.2018.
Referuar pikës 6 së udhëzimit nr.04 datë 09.1.2018 të APP të ndryshuar ñ*Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar..."* citohet se ñ*Ftesa për ofertë përmban objektin e prokurimit, të dhënat sasiore e teknike të biletave të transportit ajror ndërkombëtar, grafikun e egzekutimit, afatin e paraqitjes si dhe dokumentat që duhet të dorëzojë operatori ekonomik i shpallur fitues, nëse është rasti"*, KPP nuk i është përmbajtur këtij udhëzimi duke përcaktuar linjën ajrore si dhe hotelin e qëndrimit. Ky përcaktim bie ne kundërshtim me udhëzimin e sipërpërmendur.
Me urdhër shpenzimin nr.301 datë 11.12.2018 është kryer likuidimi i detyrimit të operatorit ekonomik mbi shpenzimet për blerjen e biletës së udhëtimit dhe rezervimi i hotelit më vlerën 113,386 lekë. Bashkelidhur këtij urdhri ndodhen të gjitha dokumentacionet justifikuese te faturës së hotelit si dhe biletës se avionit.

3. Me Urdhër prokurimin Nr.10 datë 21.05.2018 është filluar procedura e prokurimit blerje me vlerë të vogël për ñ***Blerje mobilje dhe orendi zyre"***. Procedure prokurimi me vlerë të vogël nën 800,000 mijë lekë pa TVSH.
Është publikuar Ftesa për Ofertë në të cilën janë paraqitur kërkesat e Autoritetit Kontraktuor, bashkëlidhur Shtojcat mbi cilësinë e produktit dhe kërkesat për dokumentacionin kualifikues si dhe data e zhvillimit, **23.05.2018** dhe afati i lëvrimit të mallit.
Në praktikë kanë paraqitur ofertë 24 (njëzetekatër) operatorë ekonomik dhe është shpallur fitues operatori i 4(katërt) ekonomik, në vlerën 548,800 lekë pa TVSH.
Më datë **23.05.2018** nga Komisioni i Prokurimit Publik me vlerë nën 800,000 lekë është mbajtur Procesverbali në lidhje me sualifikimin e operatorit ekonomik të renditur i I-ri subjektit ñG Z ò me pretendimin se...ò*OE nuk ka kontaktuar me AK, asnjë nëpërmjet telefonit kontakt, dhe as nuk është paraqitur pranë komisionit të PP*ò i ndryshuar, duke vendosur skualifikimin e tij. Grupi i auditimit konstatoi se, Komisioni i Prokurimit Publik me vlerë të vogël, në kundërshtim me pikën 15 të ushëzimit nr.3 datë 08.01.2018 ñ*Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronik*ò nuk ka respektuar afatin për lejimin e paraqitjes së dokumentacionit nga ofertuesi i renditur ne vend të parë i cili duhet të jetë minimalisht **dita e nesërme e punës** nga publikimi i njoftimit të fituesit në SPE por në kundërshtim me udhëzimin e sipërpërmendur brenda ditës kanë njoftuar OE mbi kualifikimin dhe skualifikimin e tij.
Me procesverbalin mbajtur më datë 30.05.2018 është shpallur fitues OE i 4 (katërt) N H në vlerën 548,800 lekë pa TVSH, pas skualifikimit të 2 (dy) OE të tjerë ekonomik për arsyet e konstatuara dhe dokumentuara në PV sipas afateve të Udhëzimit të sipërpërmendur.
Grupi i auditimit pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga OE fitues në AK konstatoi se, OE ka mungesa ne dokumentacion referuar Shtojces 1 dhe specifikimet teknike në shtojcën 2 e hartuar nga KPP, ku me saktësisht si më poshtë vijon:
1. Në shtojcën 1 është kërkuar ñ*OE duhet të jetë i licencuar për tregtimin dhe prodhimin e këtyre mallrave*ò.....**licence e cila ne dosje e këtij tenderi nuk ndodhet.**
2. Në specifikimet teknike shtojca 2 është kërkuar ñ*Te ketë certifikim për rezistenc nga zjarri, minimalisht CFlS1, sipas standardit CE, EN 13501-1",* **certifikimin i cili nuk ndodhet ne dosjen e tenderit, si rrjedhoje nuk është dorëzuar nga OE.**
Si rezultat i mosplotësimit të dy kritereve të përcaktuara nga KPP, ky operator ekonomik për mos përmbushje të specifikimeve teknike si dhe licensimit të t**ij nuk duhej të shpallej fitues.**
Me urdhër-shpenzimin nr.172 datë 25.07.2018 është kryer likuidimi i OE N H në vlerën 548, 800 lekë pa TVSH, ne një total 658,560 me TVSH, referuar Proces verbalit të

mbajtur më datë 12.06.2018 nga KPP mbi dorëzimin dhe montimin e materialeve të porositura nga OE. ME flet-hyrjen nr.02 datë 12.06.2018 firmosur nga magazinierja janë bërë hyrje të gjitha materialet e porositura. Bashkëlidhur këtij urdhri ndodhen të gjitha dokumentacionet justifikuese.

4. Me Urdhër prokurimin Nr.2 datë 20.03.2018 është filluar procedura e prokurimit blerje me vlerë të vogël për ñ***Blerje Toner"***. Procedurë prokurimi me fond limit në vlerën 580,000 lekë pa TVSH.
Është publikuar Ftesa për Ofertë në të cilën janë paraqitur kërkesat e Autoritetit Kontraktuor, kërkesat për dokumentacionin kualifikues si dhe data e zhvillimit, 29.03.2018 dhe afati i lëvrimit të mallit 2 (dy) ditë pas shpalljes së fituesit.
Në praktikë kanë paraqitur ofertë 21 (njëzetenjë) operatorë ekonomik dhe është shpallur fitues operatori i 1(parë) ekonomik, në vlerën 329,600 lekë pa TVSH.
Me datë 29.03.2018 nga Komisioni i Prokurimit Publik është mbajtur Proces-Verbali në lidhje me vlerësimin dhe njoftimin e ofertuesit të parë me vlerën më të vogël, OE I O në vlerën 329,600 lekë pa TVSH.
Me datë 30.03.2018 është mbajtur procesverbali mbi paraqitjen e dokumentacioneve të kërkuara referuar kritereve të vendosura nga AK nga operatori ekonomik I , në të cilin trajtohet se OE i ka paraqitur dhe dokumentuar kërkesat e trajtuara ne formularin kërkesë për ofertë.
Nga verifikimi i dokumentacioni grupi i auditimit konstatoi se, në dokumentat e paraqitura nga OE I O , *nuk është paraqitur dhe për rrjedhoje nuk ka përmbushur kërkesa si me poshtë vijon:*
1.Opertori ekonomik i renditur i pari përpara se të shpallet fitues duhet të dorëzoj pranë AK, dokumentata si më poshtë:
Certifikatën e origjinës së tonerit, formularin e ofertës si dhe nga AK d**o të behet testimi me përzgjedhje të tonerave të ofertuar".**
Nga OE nuk është paraqitur certifikata e origjinës si dhe e cilësisë së tonerit.
Si rrjedhoje e mosplotësimit të kërkesën së sipërpërmendur, KPP nuk duhet ta shpallte OE I O fitues por duhet të vazhdonte procedurën ne njoftimin mbi anulimin dhe kalimi ne operatorin e dyte te renditur sipas vlerës më të vogël.
Ne proces-verbalin mbajtur nga KPP më datë 04.04.2018 mbi marrjen në dorëzim të Tonerave nga OE I O e, referuar dy kërkesave te vendosura ne ñFtesën për Ofertò, *certifikata e origjinës së tonerave si dhe testimi me përzgjedhje për tonerat e ofertuara,* KPP nuk është shprehur mbi verifikimin dhe dorëzimin e tyre.
Me urdhër-shpenzimin nr.105 datë 23.04.2018 është kryer likuidimi i OE I O në vlerën 395,520 lekë me TVSH, referuar Proces verbalit të mbajtur më datë 04.04.2018 si dhe Faturës tatimore të paraqitur nga OE. Me fletë-hyrjen nr.04 datë 04.04.2018 firmosur nga magazinierja janë bërë hyrje të gjitha materialet e porositura. Bashkëlidhur këtij urdhri ndodhen të gjitha dokumentacionet justifikuese.

-Blerje/shërbime deri në 100,000 lekë, me formë shkresore
Blerjet ne vlerë të vogël të parashikuara në regjistrin e parashikimeve në fillimit të vitit, në krijimin e situatës emergjente, Autoriteti Kontraktor nëpërmjet një komisioni përdor procedurën e prokurorimit me vlerë të vogël sipas formularit nr.4.
Kjo procedurë përmban:
*1. Proces verbali i rasteve t*ë *emergjencës (formulari nr.4)*
*2. Proces verbali i rrethanave t*ë *ngjarjes i firmosur nga t*ë *pranishmit. (nëse ka)*

3. kuponi tatimor/fotura e tvsh e firmosur.
Nga auditimi me përzgjedhje i procedurave, blerje nën 100,000 lekë, pa procedurë prokurimi si dhe bazuar në VKM nr. 914 date 29.12.204 dhe udhëzimit të APP nr. 3 date 08.01.2018 ñ*Mbi përdorimin e procedurës se prokurorimit me vlere te vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*ò rezultoi si më poshtë vijon.

1. Me Urdhër Shpenzimin nr. 19, datë 25.01.2018 është likuiduar operatori ñPC S shpkò, për realizim e blerjes së ñ5 copë tastier, 5 copë Mause USB dhe 3 Karta rrjetiò në vlerën 16,300 lekë me fatura tatimore e shitjes nr. P377, datë 15.01.2018. Me flet-hyrjen nr.01 datë 15.01.2018 janë bërë hyrje në magazinë materiale e blera, por kjo fletë-hyrje është e pafirmosur nga magazinier si nga KVO, në kundërshtim me pikën 19 të udhëzimit nr.3 datë 08.01.2018 ñ*Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël.... "* i ndryshuar.
Praktika e procedurës së blerjes përmban kërkesën ku citohet se ñpër nevojat e punës duhet kryej blerjaò e miratuar nga titullari, si dhe një procesverbal mbi studimin e tregut dhe vendosjen e realizimit të blerjes tek subjekti me vlerë me te ulet ñPC S ò e firmosur nga KVO. Kjo praktike është proceduar në përputhje me udhëzimin nr. 3 date 08.01.2018.

2. Me Urdhër Shpenzimin nr. 316, datë 24.12.2018 është likuiduar operatori ñPC S shpkò, për realizim e blerjes së ñ2 copë Mause USB dhe 9 Patach cableò në vlerën 4,700 lekë me fatura tatimore e shitjes nr. 135, datë 04.12.2018. Me fletë-hyrjen nr.17 datë 04.12.2018 janë bërë hyrje në magazinë materiale e blera, por kjo fletë-hyrje është e pafirmosur nga KVO, në kundërshtim me pikën 19 të udhëzimit nr.3 datë 08.01.2018 ñ*Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël.... "* i ndryshuar.
Praktika e procedurës së blerjes përmban kërkesën ku citohet se ñpër nevojat e punës duhet kryer blerjaò e miratuar nga titullari, si dhe një procesverbal mbi studimin e tregut dhe vendosjen e realizimit të blerjes tek subjekti me vlerë me te ulet ñI S ò e firmosur nga KVO. Kjo prakitike është proceduar ne përputhje me udhëzimin nr. 3 date 08.01.2018.

3. Me Urdhër Shpenzimin nr. 236, datë 08.10.2018 është likuiduar operatori ñO shpkò, për realizim e blerjes së ñ5 copë Mause dhe 7 USBò në vlerën 20,800 lekë me fatura tatimore e shitjes nr. 456, datë 24.09.2018. Me fletë-hyrjen nr.12 datë 24.09.2018 janë bërë hyrje në magazinë materiale e blera, por kjo fletëhyrje është e pafirmosur nga KVO, në kundërshtim me pikën 19 të udhëzimit nr.3 datë 08.01.2018 ñ*Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël.... "* i ndryshuar.
Praktika e procedurës së blerjes përmban kërkesën ku citohet se ñpër nevojat e punës duhet kryer blerjaò e miratuar nga titullari, si dhe një procesverbal mbi studimin e tregut dhe vendosjen e realizimit të blerjes tek subjekti me vlerë me te ulet ñO shpkò e firmosur nga KVO. Kjo praktikë është proceduar në përputhje me udhëzimin nr. 3 datë 08.01.2018.

4. Me Urdhër Shpenzimin nr. 60, datë 07.03.2018 është likuiduar operatori ñB ò, për realizim e blerjes së ñSinjalistikaò në vlerën 105,600 lekë me fatura tatimore e shitjes nr. 29, datë 16.02.2018.
Praktika e procedurës së blerjes përmban vetëm kërkesën ku citohet se ñpër nevojat e punës duhet sinjalistikaò e miratuar nga titullari, si dhe një procesverbal mbi studimin e tregut dhe vendosjen e realizimit të blerjes tek subjekti me vlerë me te ulet ñB ò e firmosur nga KVO. Kjo praktikë është proceduar ne përputhje me udhëzimin nr. 3 date 08.01.2018.

5. Me Urdhër Shpenzimin nr. 21, datë 31.01.2018 është likuiduar subjekti ñY ò, për realizim e shërbimit ñshërbim pastrimiò në vlerën 119,760 lekë me fatura tatimore e shitjes nr. 684, datë 15.01.2018.
Praktika e procedurës së shërbimit përmban kërkesën ku citohet se ñpër kryerjen e shërbimit të pastrimit të ambienteveò e miratuar nga titullari, si dhe një procesverbal mbi studimin e tregut dhe vendosjen e realizimit të blerjes tek subjekti me vlerë me te ulet ñY ò e firmosur nga KVO në vlerën 119.760. Kjo praktikë është proceduar në përputhje me udhëzimin nr. 3 date 08.01.2018.,

6. Me Urdhër Shpenzimin nr. 317, datë 24.12.2018 është likuiduar subjekti ñK ò, për realizim e shërbimit ñshërbim lyerje ambientiò në vlerën 119.808 lekë me fatura tatimore e shitjes nr. 87, datë 17.12.2018.
Praktika e procedurës së shërbimit përmban kërkesën ku citohet se ñpër kryerjen e shërbimit të lyerjes së ambienteveò e miratuar nga titullari, si dhe një procesverbal mbi studimin e tregut dhe vendosjen e realizimit të blerjes tek subjekti me vlerë me të ulët ñK ò e firmosur nga KVO në vlerën 119,808 lekë me TVSH. Kjo praktikë është proceduar ne përputhje me udhëzimin nr. 3 date 08.01.2018.

7. Me Urdhër Shpenzimin nr. 20, datë 25.01.2018 është likuiduar subjekti ñV M ò, për realizim e shërbimit ñ*transport i dokumentave si dhe pajisjeve ne ASH*ò në vlerën 99.800 lekë me fatura tatimore e shitjes nr. 32, date 15.01.2018.
Praktika e procedurës së shërbimit përmban kërkesën ku citohet se ñpër kryerjen e shërbimit të transferimit të dokumentacioneveò e miratuar nga titullari, si dhe një procesverbal mbi studimin e tregut dhe vendosjen e realizimit të blerjes tek subjekti me vlerë me te ulet ñV M ò e firmosur nga KVO në vlerën 99.800 lekë. Kjo praktikë është proceduar ne përputhje me udhëzimin nr. 3 date 08.01.2018.

8. Me Urdhër Shpenzimin nr. 59, datë 07.03.2018 është likuiduar subjekti ñT e I ò, për realizim e shërbimit ñ*transport i kasafortave*ò në vlerën 80.000 lekë me fatura tatimore e shërbimi nr. 101, datë 20.02.2018).
Praktika e procedurës së shërbimit përmban kërkesën ku citohet se ñpër kryerjen e shërbimit të transferimit të kasafortaveò e miratuar nga titullari, si dhe një procesverbal mbi studimin e tregut dhe vendosjen e realizimit të shërbimit tek subjekti me vlerë me te ulet ñT I ò e firmosur nga KVO në vlerën 80.000 lekë. Kjo praktikë është proceduar ne përputhje me udhëzimin nr. 3 date 08.01.2018.

Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve te prokurimit **për vitin 2018** grupi i auditimit konstatoi problematikat e mëposhtme:

- Referuar regjistrit të parashikim të procedurave të prokurimi si dhe procedurave të realizimit për vitin 2018 grupi i auditimit konstatoi se janë planifikuar gjithsej 31 procedura prokurimi, kur referuar këtyre procedurave janë realizuar 17 prej tyre. Referuar regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit janë realizuar 35 procedura prokurimi, ku 18 procedura prokurimi janë të paparashikuara në regjistrin e parashikimit, me përjashtim të një procedure ñBlerje pajisje elektronikò e realizuar nga AKSHI. <u>Grupi i auditimit konstatoi se nga ana e Autoritetit Kontraktuor kemi një keq planifikim të nevojave dhe fondeve të subjektit.</u> Gjithashtu grupi i auditimit konstatoi se për procedura të cilat janë parashikuar me një fond limit prej 800,000, janë copëzuar sipas nevojave duke kaluar në procedura pa tenderim/blerje shkresore poshtë kufirit 100,000 lekë, të cilat në

kundërshtim me Udhëzimin nr.03 datë 08.01.2018 ñ*Mbi përdorimin e procedurës së Prokurimit me vlerë të vogël*ò si dhe udhëzimit nr.01 datë 05.05.2018 ñ*Për hartimin e regjistrit të parashikimeve te PPP*ò...;nuk i ka planifikuar si dhe nuk i është referuar këtij regjistri.

- Referua dosjes se tenderimit të dy biletave ***"Blerje bilet udhëtimi Tiranë –Strasburg; Strasburg Tiranë, dhe rezervim hoteli ne Strasburg 25-27 Janar dhe Nëntor"***, është proceduar në kundërshtim me udhëzimi nr.4 datë 09.01.2018 ñ*Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin ne mjete elektronik*ò, ne të cilën citohet se *".....ne urdhri i prokurmit përcaktohet sasia e biletave të kërkuara, destinacioni përkatës si dhe fondi limit i përllogaritur....*ò, Komisioni i prokurimit publik ka parapërcaktuar **linjën ajrore të fluturimit du**ke shmangur kështu konkurrencën ndërmjet operatoreve ekonomik, nxitjen e pjesëmarrësve të OE në këtë procedure etj.
- Grupi i konstatimit ka konstatuar së në disa raste si për shembull rasti i procedurës së 3 të trajtuat me sipër, Komisioni i Prokurimit Publik me vlerë të vogël, në kundërshtim me pikën 15 të udhëzimit nr.3 datë 08.01.2018 ñ*Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronik*ò nuk ka respektuar afatin për lejimin e paraqitjes së dokumentacionit nga ofertuesi i renditur ne vend të parë i cili duhet të jetë minimalisht **dita e nesërme e punës** nga publikimi i njoftimit të fituesit në SPE por në kundërshtim me udhëzimin e sipërpërmendur brenda ditës kanë njoftuar OE mbi kualifikimin dhe skualifikimin e tij.

Për vitin 2019 nga grupi i auditimit janë zgjedhur 15 procedura prokurimi, prej nga ka rezultuar si më poshtë vijon:
Me shkresën nr.193 prot. Datë 11.01.2019 miratuar nga titullari i institucionit është dërguar Ministrisë së Drejtësisë si dhe degës së thesarit regjistri i parashikimit të **26** procedura prokurimi për vitin 2019.
Me shkresën nr.272 prot. Datë 14.01.2020 miratuar nga titullari i institucionit është dërguar në Ministrisë e Drejtësisë si dhe degës së thesarit regjistri i realizimit të **26** procedura prokurimi publike, te realizuara nga ASH.
Me shkresën Nr.01. Prot, datë.08.01.2019 ka dalë urdhri për ngritjen e komisionit të veçantë për blerjet e vogla në Avokaturën e Shtetit me përbërjen si më poshtë vijon: J Z ,Kryetar; H Ja Anëtar; R L Anëtar
Me shkresën Nr. 01/2, datë. 19.03.2019 urdhër i Avokatit të Përgjithshëm, paraqitet zëvendësimi i dy prej anëtareve të komisionit të mëparshëm. Përbërja e komisionit të veçantë për blerjet e vogla në Avokaturën e Shtetit me përbërjen si më poshtë vijon, Znj. J Z Kryetar; Znj. J D , Anëtar; Znj.V H Anëtar.
Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve te prokurimit për **vitin 2019** grupi i auditimit konstatoi mangësi në procedurën e prokurimit si më poshtë;

1. Me Urdhër prokurimin nr. **09**, datë **03.04.2019** është filluar procedura e prokurimit blerje me vlerë të vogël ñ***Blerje karburanti."*** Fondi Limit i parashikuar **707,500 lekë**. Numri i procedures: REF-16526-04-03-2019.

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Naftë Gazoil 10ppm	Litra	5000

Komisioni i prokurimit ka mbajtur proces verbal më dt.02.04.2019 për mënyrën e përllogaritjes së fondit limit sipas përgjigjes së kthyer nga INSTAT lidhur me cmimin mesatar

të muajit Shkurt 2019, në vlerën **169,8 lekë** për litër. Në formularin nr.10, Ftesë Për Ofertë, Autoriteti kontraktor për Operatorin Ekonomik që renditet i pari, përpara se të shpallej fitues duhet të dorëzonte dokumentacionin vërtetues si vijon:
-Të jetë i regjistruar në regjistrat professional ose tregëtarë të shtetit në të cilin ata janë themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tyre ligjor;
-Të jetë i licensuar për objektin e prokurimit;
- Formularin e ofertës;
-Vërtetim bankar me numrin e llogarisë IBAN.
Për shpalljen përfundimtare të fituesit është e nevojshme paraqitja pranë AK e dokumentacionit të kërkuar si dhe specifikimeve teknike, sipas shtojcës 1.
Afati i lëvrimit të shërbimit/realizimit do të jetë brenda 3 (tre) ditëve nga momenti kur komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, nëpërmjet SPE, ka bërë njoftim fituesi. Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti ose të dokumenteve të rreme e të pa sakta do konsideroheshin si kushte për skualifikim.
Pas përfundimit të vlerësimit së proceduras së më sipërme, më datë 04.04.2019 KPVV-ja ka realizuar hapjen e e ofertave të ardhura dhe vlerësimin e tyre, janë paraqitur gjithësej 5 (pesë) oferta. Pasi është kryer vlerësimi i ofertave janë kualifikuar 3 (tre) oferta poshtë vlerës së fondit limit të përllogaritur nga AK, ndërsa 2 (dy) ofertat e tjera janë skualifikuar sepse një nga ofertat ishte paraqitur pa ofertë ekonomike kurse tjetra ishte mbi vlerën e fondit limit.
Të kualifikuar si ofertues;
1. A sha në vlerën **682,916 lekë** pa TVSH.
2. D në vlerën **683,000 lekë** pa TVSH.
3. K në vlerën **697,000 lekë** pa TVSH.
Të skualifikuar janë 2 (dy) operatorët ekonomik si më poshtë;
ñD ò nuk ka paraqitur ofertë ndërsa, ñK ò Sha, ka ofruar shumën **725,000 lekë** pa TVSH, shumë e cila ka rezultuar më e lartë se fondi limit i përllogaritur për realizimin e kësaj procedure.
Në proces verbalin e mbajtur nga KPVV më dt.05.04.2019 dhe njoftimit të marrë nga APP, Operatori ekonomik A Sha, ka kontaktuar me komisionin e prokurimit, duke paraqitur pranë këtij komisioni dokumentet e kërkuara në formularin e ftesës për ofertë. Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit konstatohet se: Në shtojcën 1ñSpecifikimet Teknikeò të dokumentave të procedurës së prokurimit kërkesat e përcaktuara kanë qenë si më poshtë:
1. Ekstrakt i regjistrit tregtar nga QKB, ku të ketë të specifikuar tregtim karburanti.
-Vërtetim se nuk ka detyrime në sigurime shoqërore e tatimore.
-Vërtetim të taksave vendore për të gjithë vendet ku ushtron aktivitetin sipas QKB.
-Vërtetim se nuk ka detyrime ndaj OSHEE.
-Të ketë pika shpërndarje të karburanteve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
-Listën e shpërndarjes së pikave të furnizimit me pakicë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
-Pikat e karburantit të furnizojnë 24 orë pa ndërprerje.
-Shërbimi i furnizimit me karburant do të kryhet vetëm nëpërmjet kartës elektronike, e cila duhet të jetë e vlefshme deri në përfundim të gjithë sasisë së karburantit të prokuruar, pra edhe gjatë vitit 2020, si dhe të mundësojë vlefshmërinë/aplikimin e kartës për të gjitha pikat e karburantit që disponon.
-Të sjellë fletë analizat e furnizimeve që të kenë të shprehura karakteristikat e karburantit.
-Afati i lëvrimit të mallit do ishte sipas përcaktimeve në kontratë, e cila për siguri do të kryhej duke e ndarë sasinë në dy fatura për vitin 2019.

-Shërbimi i mallit do të bëhej me kartë elektronike, kartat të jenë pa afat deri në përfundim të sasisë së prokuruar (deklaratë nga operatori ekonomik).
Nga verifikimet e dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe në sistemin e prokurimeve elektronike (*SPE*) konstatohet se operatori ekonomik A sha në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:
- Licencë LN-8692-11-2014 për subjektin A sha për **tregëtim me shumicë:** Benzinë kateg. II /A, Gazoil kategoria III.A
-Deklarata e përfaqësuesit ligjor të *OE* ñA ò Sha, F G , dorëzuar më dt.04.04.2019 ndër të tjera citohet se: Dorëzimi i mallit do të bëhet me fletë analizë përkatëse për Euro Diesel 10 ppm të lëshuar nga IQT. Të dhënat teknike i referohen standartit evropian EN dhe atij Shqiptar, S.SH.EN 590;2013+A1:2017 dhe S.SH.EN 228:2012+A1:2017. Garanton se pikat e furnizimit me karburant janë në punë të pa ndërprerë dhe sigurojnë shërbim sipas kërkesave të AK-së, për 24 orë në 7 ditë të javës. Poashtu Operatori Ekonomik ka deklaruar se garanton me furnizimin me karburant në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në stacionet e **B -O** në adresat e vendodhjet sipas listës së bashkëlidhur në deklarim. Deklarata përmban po ashtu garantimin e përmbushjes së të gjitha specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit duke e vërtetuar me certifikata e dokumenta.
- Kontratë Furnizim me Karburant (Tollona/Karta Elektronike) datë.11.05.2018 lidhur ndërmjet shoqërisë ñ**O** ò shpk dhe shoqërisë ñ**A** ò sha me objekt ñFurnizimi me karburant nëpërmjet tollonave sipas porosive të blerësitò. ***Kontrata ka afat dy vjecar, deri më datë 11.05.2020.***
1.Me Urdhër Shpenzimin nr. 146, datë 08.05.2019 është likuiduar subjekti ñA òsha, për realizim e kontratës ñ*Blerje karburant (Naftë)*ò në vlerën 491,700 lekë me fatura tatimore e shitjes nr. 810, date 09.04.2019, për 3000 litra naftë.

Grupi i auditimit ka dalë në konkluzion për mangësitë e evidentuara deri në këtë fazë të auditimit, si më poshtë vijon:
-Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *"Për prokurimin publik",* i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: ñ*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese".*
Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *"Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit…."*.
Referuar kërkesave të autoritetit kontraktormbi këtë procedurë së prokurimi, konstatohet se ky i fundit ka parashikuar se operatorët pjesëmarrëse duhet të paraqesin dokumnatcionin ligjor përkatësisht: ***Listën e shpërndarjes së pikave të furnizimit me pakicë në territorin e RSH.***
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori A sha rezulton se Licenca me nr. L-8692-11-2014 lëshuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik Tregëtisë dhe Sipërmarrjes është e vlefshme për tregëtim **me shumicë të naftës,** gazit, e nënprodukteve përfshi ato bio si dhe lëndët djegëse.
- Në asnjë rast nuk ka paraqitur listë me pikat e shpërndarjes me pakicë në RSH të zotruara nga vet shoqëria, e verifikuar kjo dhe në të dhënat e regjistrit tregtar në rubrikën Ekstrakti historik të QKB.

Referuar shtojcës 1 ñSpecifikimet Teknikeò të dokumentave të procedurës së prokurimit përcaktohet shprehimisht se furnizimi do te kryhet nga pika e karburantit me karta elektronike te personalizuara me targat e automjeteve te autoritetit kontraktor sipas objektit te prokurimit.
-Sa më sipër, grupi i auditimit gjykon se në rastin konkret operatori ekonomik A sha është i licensuar vetëm për tregëtim **me shumicë të karburanteve** duke dështuar në plotësimin e kërkesës së autoritetit kontraktor për **pika shpërndarje/furnizimi me pakicë** në të gjithë territorin e RSH. Akoma më tej grupi i auditimit konstaton se operatori A *Sha*, për të dëshmuar se do të furnizojë autoritetin kontraktor me karta elektronike ka paraqitur kontratën e bashkëpunimit me subjektin ñO ò shpk.
Grupi i auditimit gjykon se plotësimi i kërkesave për kualifikim në një procedurë prokurimi shtrihet vetëm ndaj operatorëve pjesëmarrës dhe <u>në asnjë rast, operatorët ekonomikë pjesëmarrës nuk mund të përmbushin kapacitetet teknike me anë të dokumentacionit të subjekteve të tjerë juridikë</u>. Dorëzimi i dokumentacionit të një subjekti tjetër i cili nuk është pjesmarrës në procedurën e prokurimit dhe as nuk shfaqet në cilësinë e njërit prej anëtarëve të bashkimit të operatoreve nuk mund të konsiderohet i vlefshëm duke u paraqitur si dokumentacion i vetë pjesmarësit. Grupi i auditimit gjykon se: Përdorimi i kapacitetit teknik të subjekteve të tjerë juridikë, pranohet në rastet e paraqitjes së ofertës në cilësinë e bashkimit të operatorëve ekonomikë BOE, në zbatim të nenit 74 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò të ndryshuar.
Gjithashtu, në nenin 75 të Vendimit Nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave, parashikohet se:
1. *Autoriteti kontraktor mund të lejojë nënkontraktimin për realizimin e një pjese të kontratës.* ***Në asnjë rast, kontraktorët nuk mund t'ua transferojnë kontratën palëve të treta.*** *Autoriteti kontraktor lejon në veçanti nënkontraktimin për të nxitur pjesëmarrjen e operatorëve të vegjël e të mesëm ekonomikë.*
2. Në dokumentet e tenderit duhet të përcaktohet qartë nëse lejohet ose jo nënkontraktimi, si dhe nëse autoriteti kontraktor do t'i bëjë pagesa të drejtpërdrejta nënkontraktorit.
3. Në asnjë rast nënkontraktimi nuk duhet të tejkalojë 40% të vlerës së kontratës.
4. Me dorëzimin e ofertave, ofertuesit duhet të deklarojnë punët/shërbimet/mallrat ose një pjesë të tyre që ata kanë qëllim të nënkontraktojnë, në rast se shpallen fitues, si dhe emrin e nënkontraktorit.
5. Përpara lidhjes së kontratës, ofertuesi i shpallur fitues duhet t'i dorëzojë autoritetit kontraktor një kopje të noterizuar të marrëveshjes së nënkontraktimit dhe dëshminë e kualifikimeve e të kërkesave teknike të nënkontraktorit, në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktor të mund të miratojë nënkontraktimin. Komisioni i vlerësimit të ofertave vlerëson nëse nënkontraktori plotëson kërkesat e ***nenit 45 të LPP-së****, si dhe zotëron kualifikimet teknike për pjesën e punës e të shërbimeve që do të kryejë ose për mallrat që do të furnizojë.*
6. Në rast të mosplotësimit nga nënkontraktori të kritereve të kërkuara, autoriteti kontraktor vijon me lidhjen e kontratës me operatorin ekonomik të shpallur fitues.
7. Gjatë ekzekutimit të kontratës autoriteti kontraktor duhet të kontrollojë nëse pjesa e kontratës, e marrë përsipër për t'u realizuar nga nënkontraktori, po realizohet nga ky i fundit. Në rast se autoriteti kontraktor konstaton se nënkontraktori nuk po realizon pjesën e kontratës së marrë përsipër i kërkon kontraktorit kryesor të ndërpresë nënkontraktimin dhe të vijojë me zbatimin e kontratës."
Referuar dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik i kualifikuar rezulton që nga ky i fundit të ketë marrë konfirmim nga autoriteti kontraktor lidhur me marrëveshjen e mundshme të nënkontraktimit. Referuar kontratës së furnizimit të lidhur midis ofertuesit dhe subjektit ñO ò shpk evidentohet se mallrat objekt prokurimi do të furnizohen nga ky

subjekt cka bie ndesh me nenin e sipërcituar i cili parashikon shprehimisht se jo më shumë se 40 % e kontratës mund të nënkontraktohet.
Kontrata e hartuar dhe e nënshkruar nga AK dhe OE më datë.16.04.2019 Nr.1336 Prot, në nenin 8 pika 8.1 ñ***Mardhënia me të tretët***ò ka të përcaktuar se: ***Çdo lloj marrëdhënie apo kontratë që operatori ekonomik ka me të tretë, nuk merret parasysh dhe nuk ka fuqi ligjore vepruese për realizimin e kësaj kontrate***. Sa më sipër grupi i auditimit vlerëson se*: Ndonëse në procedurë nuk evidentohet dëm ekonomik, kontrata e lidhur ndërmjet A Sha dhe O shpk ka përfunduar më datë.11.05.2020 dhe si e tillë ka paraqitur risk të mundshëm në realizim. Autoriteti kontraktor duhej të anulonte vendimin e KPVV-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik "A " sha. Mangësitë e evidentuara në këtë procedurë duhet të evitohen në të ardhmen.*

Me shkresën nr.4425/13 datë 26.01.2021 me objekt ñKomente dhe shpjegime mbi Akt Konstatimin Nr.4 të mbajtur nga grupi i auditimit të KLSH ñ*Mbi Procedurën Blerje karburanti, 2019*ò në kuadër të auditimit të ushtruar në ASH në bazë të programit të auditimit nr.1114/1 datë 06.11.2020 i ndryshuar, i miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, i mbajtur më datë 18.01.2021, Avokatura e Shtetit ngre pretendimet si më poshtë vijon:

Observacioni i subjektit të audituar :
Lidhur me specifikimet teknike, konkretisht pikën ku parashikon se ñ*Listën e shpërndarjes së pikave të furnizimit me pakicë në territorin e Republikës së Shqipërisë" nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE "A "* rezulton se Licenca LN-8692-11-2014 për subjektin A për tregëtim me shumicë: Benzinë kateg II/A, Gazoil kategoria III.A, vlerësojnë se në asnjë rast nuk ka paraqitur listë me pikat e shpërndarjes me pakicë në RSH të zotëruara nga vetë shoqëria, e verifikuar kjo me të dhënat e regjistrit tregtar në rubrikën Ekstrakti Historik të QKB.
Komisioni i kësaj procedure prokurimi sqaron Grupin Auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit, si më poshtë vijon:
-*Së pari*, sqarojmë se Komisioni në vlerësimin e kësaj oferte ka marr në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar nga Operatori Ekonomik fitues dhe ka konkluduar si përfundim se ai plotëson kriteret në përputhje me Ftesën për Ofertë dhe specifikimet teknike bashkëlidhur, sepse refruar objektit të veprimtarisë të Ekstraktit Historik është evidente fakti që ky subjekt ka tregtimin ***si me shumicë dhe pakicë të karburanteve dhe derivateve të tyre të tilla si naftë, benzinë, vajra etj.***

-*Së dyti,* në vijim të specifikime teknike nga ana e Autoritetit Kontraktues **nuk është kërkuar** që subjekti fitues të paraqesë ñ**licencë**ò si kritet kualifikues të kësaj procedure prokurimi edhe pse nga ana e tij u dorëzua dhe komisioni e administroi në dosje sepse nuk e konsideroj si akt kontradiktor ose problematik.
Nëse i referohemi kësaj licencë konstatohet se data e lëshimit të saj është, 04.11.2014, ndërkohë në objektin e aktivitetit të Ekstarktit Historik të QKB, më datë 11.03.2019 evidenton se ky subjekt ka në veprimtari të tij edhe ***tregëtimin me pakicë***, pra fakti që një licencë që nuk ka qënë kriter në ftesën për ofertë si dhe referuar datës së saj mund të jetë ndryshuar në vite dhe bie në kontradiktë me objektin e veprimtarisë në QKB. Nga Grupi Auditues nuk mund të konkludohet se nga ana e komisioni është kualifikuar një Operator Ekonomik që nuk plotëson kriteret e vendosur në Ftesën për Ofertë.
-*Së treti,* lidhur me konstatimin se në asnjë rast nuk është paraqitur lista me pikat e shpërndarjes me pakicë në RSH të zotëruara nga vetë shoqëria, komisioni sqaron se referuar kontratës së lidhur midis shoqërisë ñO ò sh.p.k dhe Shoqërisë ñA ò është e evidentuar

fakti se shoqëria O sh.p.k tregton me pakicë nën logon dhe Markën B , të cilat janë të shpërndara në disa qarqe të Shqipërisë, përpos kësaj, nga ana e shoqërisë u vu në dispozicionin tonë Lista e Karburanteve në RSH, ku tregon se në çdo qark pikat e karburantit me Markën B -o si dhe në fund të kësaj liste është shënimi ku citon se janë përmendur pikat e shitjes me pakicë të B -o . Gjithashtu duke marr parasysh që edhe kartat elektronike janë me logon e markës B -o , si dhe duke e njohur që Marka B -o është një nga furnizuesit më të mëdhenj në Shqipëri nuk mund të sjellë problematikë në furnizimin e makinave të Institucionin tonë.
-*Së katërti,* grupi i auditimit ka evidentuar si parregullsi edhe kontratën e lidhur midis shoqërisë ñO ò sh.p.k dhe Shoqërisë ñA ò sh.a **në afat dy vjeçar, deri më datë 11.05.2020,** komisioni sqaron se lidhur me afatin e kësaj kontrate nuk sjell problematikë në realizimin e kësaj procedurë prokurimi, për faktin se kjo procedurë i përketë vitit 2019, litrat e parashikuara janë përllogaritur për gjithë vitin 2019, pra nuk jemi në shkelje apo parregullsi të këtij fakti.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në formularin nr.10, Ftesë Për Ofertë, Autoriteti kontraktor për Operatorin Ekonomik që renditet i pari, përpara se të shpallej fitues duhet të dorëzonte dokumentacionin vërtetues si vijon:
-Të jetë i regjistruar në regjistrat profesional ose tregëtarë të shtetit në të cilin ata janë themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tyre ligjor;
-**Të jetë i licensuar për objektin e prokurimit;**
- Formularin e ofertës;
-Vërtetim bankar me numrin e llogarisë IBAN.
Ftesa për ofertë është e dokumentuar në dosjen e procedurës së prokurimit dhe disponohet fizikisht nga grupi i auditimit. Në licencën e OE e regjistruar me numrin; LN-8692-11-2014 ne objektin e veprimtarisë së subjektit nuk rezulton shitja me pakicë fakt që vërteton të kundërtën e pretendimit tuaj.
-Sa më sipër paraqitja e listës së pikave të tregëtimit me pakicë në RSH të shoqërisë B -o nuk garanton përmbushjen e kontratës për sa kohë kjo shoqëri nuk ka detyrime kontraktuale si palë kontraktore me ASH, fakt ky lehtësisht i evidentueshëm në dokumentacionin e dosjes së prokurimit.
-Institucioni ka blerë dhe likujduar vetëm 3000 litra naftë nga 5000 litra i totalit të kontratës për vitin 2019 e deri në Janar të vitit 2021. Duke marrë parasysh kontratën e bashkëpunimit të OE me të tretët e cila ka përfunduar *(de jure)* në Maj të vitit 2020, mënyra dhe forma e kësaj procedure mund të sjellë mos përmbushje të detyrimeve kontraktuale nga OE.
Theksojmë së, gjetja e grupit të auditimit është referuar : Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *"Për prokurimin publik",* i ndryshuar, Vendimit Nr.914 datë 29.12.2014 te Këshillit të Ministrave dhe çdo udhëzimi të dalë për zbatim, kontratës së lidhur e nënshkruar nga ASH me Operatorin Ekonomik me nr.1336 prot, datë16.04.2019, e cila në nenin 8 pika 8.1 ñMardhënia me të tretëtò ka të përcaktuar qartë se: *Çdo lloj marrëdhënie apo kontratë që operatori ekonomik ka me të tretë, nuk merret parasysh dhe nuk ka fuqi ligjore vepruese për realizimin e kësaj kontrate*. Sa më sipër, sqarojmë se konstatimi i grupit të auditimit është shterues në vlerësim të fakteve të sipërpërmendura.
Për sa trajtuar më sipër ky observim nuk merret parasysh.

Për vitin 2020
Me shkresën nr.272/1 prot. Datë 14.01.2020 miratuar nga titullari i institucionit është dërguar Ministrisë së Drejtësisë si dhe degës së thesarit regjistri i parashikimit të **19** procedurave të prokurimi për vitin 2020.
Me shkresën nr 3558 prot. Datë 16.09.2020 miratuar nga titullari i institucionit është dërguar në degën e thesarit regjistri i realizimit të procedura prokurimi publike, te realizuara nga ASH.
Me urdhrin nr.33 datë 11.02.2020 ñPër ngritjen e Komisionit të blerjeve të vogla në A.SH, KBV përbëhet nga: Znj.I Be , Znj.I M si dhe Znj.A T .

Nga grupi i auditimit për vitin 2020 janë zgjedhur disa procedura prokurimi prej të cilave është konstatuar si më poshtë vijon:

1- Me Urdhër prokurimin Nr.86 datë 27.05.2020 është filluar procedura e prokurimit blerje me vlerë të vogël për ñ***Blerje materiale pastrimi"***. Procedure prokurimi me vlerë të vogël nën 800,000 mijë lek pa TVSH. Fondi limit i parashikuar në regjistrin e parashikimeve për ketë zë është 200,000 leke.
Është publikuar Ftesa për Ofertë në të cilën janë paraqitur kërkesat e Autoritetit Kontraktuor, bashkëlidhur Shtojcat mbi cilësinë e produktit dhe kërkesat për dokumentacionin kualifikues si dhe data e zhvillimit, 28.05.2020 dhe afati i lëvrimit të mallit do të jetë i menjëhershëm.
Në sistem kanë paraqitur ofertë 40 (dyzet) operatorë ekonomik dhe është shpallur fitues operatori i 3(treti) ekonomik, në vlerën 74,000 lekë pa TVSH.
Me procesverbalin mbajtur më datë 03.06.2020 është shpallur fitues OE i 3 (trete) ñM Dò në vlerën 74,000 lekë pa TVSH, pas skualifikimit të 2 (dy)OE të tjerë ekonomik për arsyet e konstatuar dhe dokumentuara në PV dhe respektimin të afateve kundrejt Udhëzimit të sipërpërmendur.
Me urdhër-shpenzimin nr.180 datë 25.06.2020 është kryer likuidimi i OE ñM Dò në vlerën 88,800 lekë me TVSH, referuar Proces verbalit të mbajtur më datë 03.06.2020 si dhe Faturës tatimore të paraqitur nga OE. Me flet-hyrjen nr.08 dhe 08/1 datë 03.06.2020e *pa firmosur nga magazinierja si dhe nga KVO* janë bërë hyrje të gjitha materialet e porositura. Bashkëlidhur këtij urdhri ndodhen të gjitha dokumentacionet justifikuese.

2-Me Urdhër prokurimin Nr.140 datë 03.09.2020 është filluar procedura e prokurimit blerje me vlerë të vogël për ñ***Blerje materiale pastrimi"***. Procedure prokurimi me vlerë të vogël nën 800,000 mijë lek pa TVSH. Fondi limit i parashikuar në regjistrin e parashikimeve për ketë zë është 200,000 lekë.
Është publikuar Ftesa për Ofertë në të cilën janë paraqitur kërkesat e Autoritetit Kontraktuor, bashkëlidhur Shtojcat mbi cilësinë e produktit dhe kërkesat për dokumentacionin kualifikues si dhe data e zhvillimit, 08.09.2020 dhe afati i lëvrimit të mallit brenda 24 orëve.
Në sistem kanë paraqitur ofertë 32 (tridhjetedy) operatorë ekonomik dhe është shpallur fitues operatori i 1(parë) ekonomik, në vlerën 26,000 lekë pa TVSH.
Me procesverbalin mbajtur më datë 08.09.2020 është shpallur fitues OE i 1(pare) ñH -2012ò në vlerën 26,000 lekë pa TVSH.
Me urdhër-shpenzimin nr.322 datë 08.10.2020 është kryer likuidimi i OE ñH -2012ò në vlerën 31,200 lekë me TVSH, referuar Proces verbalit të mbajtur më datë 09.09.2020 si dhe Faturës tatimore të paraqitur nga OE. Me flet-hyrjen nr.18 datë 09.09.2020 *e firmosur nga magazinierja si dhe nga KVO* janë bërë hyrje të gjitha materialet e porositura. Bashkëlidhur këtij urdhri ndodhen të gjitha dokumentacionet justifikuese.

3- Me Urdhër prokurimin Nr.105 datë 01.07.2020 është filluar procedura e prokurimit blerje me vlerë të vogël për ñ***Blerje toner"***. Procedure prokurimi me vlerë të vogël nën 800,000 lekë pa TVSH. Fondi limit i parashikuar në regjistrin e parashikimeve për ketë zë është 800,000 lekë.
Është bërë kërkesa për blerje e 2 sete (4 cope secili set) toner Color Laser Jet Pro MFO M280 e miratuar nga titullari i institucionit.
Është publikuar Ftesa për Ofertë në të cilën janë paraqitur kërkesat e Autoritetit Kontraktuor, bashkëlidhur Shtojcat mbi cilësinë e produktit dhe kërkesat për dokumentacionin kualifikues si dhe data e zhvillimit, 07.07.2020 dhe afati i lëvrimit të mallit brenda 24 orëve.
Në sistem kanë paraqitur oferta 12 (dymbëdhjetë) operatorë ekonomik dhe është shpallur fitues operatori i 8(tete) ekonomik, në vlerën 66,000 lekë pa TVSH.
Nga Komisioni i Prokurimit Publik janë mbajtur 7 procesverbalet ne lidhje me njoftimin e kualifikimit të OE, është deklaruar se 7 OE janë tërhequr duke bërë njoftimin në SPE, por bashkëlidhur këtyre PV nuk ndodhej asnjë nga deklaratat e OE.
Me procesverbalin mbajtur më datë 17.07.2020 është shpallur fitues OE i 8 (tetë) ñI O ò në vlerën 66,000 lekë pa TVSH.
Me urdhër-shpenzimin nr.248 datë 13.08.2020 është kryer likuidimi i OE ñI o eò në vlerën 79,200 lekë me TVSH, referuar Proces verbalit të mbajtur më datë 20.07.2020 si dhe Faturës tatimore të paraqitur nga OE. Me fletë-hyrjen nr.16 datë 20.07.2020 *e pa firmosur nga magazinierja si dhe nga KVO* janë bërë hyrje të gjitha materialet e porositura. Bashkëlidhur këtij urdhri ndodhen të gjitha dokumentacionet justifikuese.

4- Me Urdhër prokurimin Nr.122 datë 05.08.2020 është filluar procedura e prokurimit blerje me vlerë të vogël për ñ***Pajisje zyre të blera"***. Procedure prokurimi me vlerë të vogël nën 800,000 lek pa TVSH. Fondi limit i parashikuar në regjistrin e parashikimeve për ketë zë është 416,666 leke. Është bërë kërkesa për blerjen e 1 (një) kondicioneri për nevojat e Zyrës Vendore Vlorë.
Është publikuar Ftesa për Ofertë në të cilën janë paraqitur kërkesat e Autoritetit Kontraktuor, bashkëlidhur Shtojcat mbi cilësinë e produktit dhe kërkesat për dokumentacionin kualifikues si dhe data e zhvillimit, 13.08.2020 dhe afati i lëvrimit të mallit brenda 1 ditë pune.
Në sistem kanë paraqitur oferta 9 (nëntë) operatorë ekonomik dhe është shpallur fitues operatori i 1(parë) ekonomik, në vlerën 42,900 lekë pa TVSH.
Me procesverbalin mbajtur më datë 14.08.2020 është shpallur fitues OE i 1 (parë) ñPc S ò në vlerën 42,900 lekë pa TVSH.
Me urdhër-shpenzimin nr.293 datë 17.09.2020 është kryer likuidimi i OE ñPC S ò në vlerën 51,480 lekë me TVSH, referuar Proces verbalit të mbajtur më datë 17.08.2020 si dhe Faturës tatimore të paraqitur nga OE. Bashkëlidhur këtij urdhri ndodhen të gjitha dokumentacionet justifikuese.

Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve te prokurimit për **vitin 2020** grupi i auditimit konstatoi problematikat e mëposhtme në kundërshtim me:
Referuar regjistrit parashikimit të procedurave të prokurimit publik për vitin kalendarik 2020 të hartuara nga Avokatura e Shtetit miratuar nga titullari me shkresën nr.272/1 datë 14.01.2020 janë renditur objekt prokurimet si dhe fondi limit. <u>Për të gjitha procedurat e sipërpërmendura Autoriteti Kontraktuor ka dalë jashtë planit duke copëzuar fondet për të njëjtin shërbim/mall, e duke kaluar kështu nga procedure prokurimi me vlerë te vogël, në procedure shkresore nën vlerën 100,000 lekë</u> (edhe pse kjo procedurë është kryer me tenderim). Në kundërshtim me udhëzimin nr.3 datë 08.01.2018 ñ*Mbi përdorimin e procedurës*

së prokurimit publik me vlerë të vogël....."i ndryshuar pika 3 e cila citon se në asnjë rast AK nuk duhet të prokurojë veçmas mallra, shërbime apo punë që përfshihen në një grup për shkak të ngjashmërisë së tyre. Gjithashtu ne kundërshtim me Udhëzimin nr.1 datë 05.05.2018 ñ*mbi hartimin e regjistrit të parashikimeve .....",* **AK** nuk ka bërë asnjë parashikim në regjistrin e APP, për mallrat/shërbimet në një vlerë deri në 100,000 lekë gjate vitit kalendarik. Nga auditimi ka rezultuar se AK ka realizuar blerje në vlerën 100,000 lekë për mallra dhe shërbime të cilat janë planifikuar me një fond limit deri në 800,000 lekë.
Në kundërshtim me nenin 8, pika 2 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*ò i ndryshuar, i cili citon se ñ*Për objektet, ku përfshihen mallra dhe shërbime të ngjashme, vlera e përllogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, nuk është më e madhe se 100 000 (njëqind mijë) lekë, autoriteti kontraktor nuk* ***i nënshtrohet procedurave të prokurimit****"* Avokatura e Shtetit edhe pse këto procedura nën vlerën e kufirit 100,000 lekë nuk kanë qenë të parashikuara, i ka kryer me procedure tenderimi dhe jo blerje direkte.

Observacion mbi Projektraportin e Auditimit i paraqitur nga Avokatura e Shtetit me shkresën nr. 4425/15 prot, datë 30.09.2021, regjistruar në KLSH me nr. 1114/6, datë 06.10.2021.
Nga shqyrtimi i observacionit, pretendimet e ngritura nga Insitucioni nuk sjellin asnjë arsyetim/apo fakt shtese, ndryshe nga trajtimi i bërë nga grupi i auditimit në fazën e mëparshme trajtuar më poshtë.
Për sa trajtuar më sipër ky observim nuk merret parasysh.

Me shkresën nr.4425/13 datë 26.01.2021 me objekt ñKomente dhe shpjegime mbi Akt Konstatimin Nr.4 të mbajtur nga grupi i auditimit të KLSH ñ*Mbi auditimin e veprimtarisë financiare në institucion*ò në kuadër të auditimit të ushtruar në ASH në bazë të programit të auditimit nr.1114/1 datë 06.11.2020 i ndryshuar, i miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, i mbajtur më datë 18.01.2021, Avokatura e Shtetit ngre pretendimet si më poshtë vijon:
Pretendimi i subjektit të audituar:
Avokatura e Shtetit vlerëson se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me një shkelje të detyrimeve nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave. Për zhvillimin e kësaj procedure janë ndjekur parashikimet e Udhëzimit nr. 4, datë 09.01.2018 ñMbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronikeò, ndryshuar me udhëzimin Nr. 10, datë 30.05 .2018 ñPër disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 4, datë 09.01.2018 ñMbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronikeò (udhëzimi nr. 4/2018 i ndryshuar).

Në pikën 5 të udhëzimit nr. 4/2018 i ndryshuar parashikohet se:

ñ*Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, nxjerr urdhrin e prokurimit ku përcaktohet sasia e biletave të kërkuara dhe destinacioni përkatës, sipas formularit Nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Në këtë urdhër nuk do të përcaktohet fondi limit për objektin konkret*ò.

- Parashikimi në ftesën për ofertë vjen në të njëjtën linjë me parashikimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò i ndryshuar, i cili kërkon që ftesat për ofertë ñ*duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e*

*ofertuesve.*ò Avokatura e Shtetit vlerëson se çdo kufizim mbi objektin e prokurimit nuk do ti shërbente procedurës dhe transparencës në këtë rast.

Vlerësohet gjithashtu se parashikimi i sa më sipër, nuk do të cënonte potencialisht në asnjë moment konkurrencën mes operatorëve në treg. Operatorët ekonomikë që operojnë në vendin tonë janë kompanitë e udhëtimeve të cilat shërbejnë si ñagjentò, të kompanive ndërkombëtare të fluturimit. Kjo do të thotë se në treg nuk operojnë direkt dhe drejtpërdrejtë kompanitë të cilat ofrojnë drejtpërdrejtë shërbimin, sepse ato nuk janë të vendosura në Republikën e Shqipërisë, por këtë shërbim e ofrojnë agjencitë e udhëtimit. Në këtë kuptim, shërbimin e kërkuar nga Avokatura e Shtetit në këtë rast, mund ta ofronin potencialisht të gjitha agjencitë që operojnë në tregun shqiptar sepse të gjitha mund të kontraktonin blerjen e një bilete nga kompanitë ndërkombëtare të udhëtimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit:
Për sa i përket pretendimit të subjektit të sipërpërmendur, theksojmë së, gjetja e grupi të auditimit është referuar Udhëzimit nr. 4 datë 09.01.2018 të APP ñ*Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar..."* të pandryshuar për procedurën e kryer Me Urdhër prokurimin Nr.01 datë 18.01.2018 ñ***Blerje bilet udhëtimi Tiranë –Strasburg; Strasburg Tiranë, dhe rezervim hoteli ne Strasburg 25-27 Janar*"**, si dhe referuar udhëzimit nr.04 datë 09.0.1.2018 të APP i ndryshuar me udhëzimin nr.10 datë 30.05.2018 për procedurën e kryer me Urdhër prokurimin Nr.21 datë 22.11.2018 ñ***Blerje bilet udhëtimi Tiranë –Strasburg; Strasburg Tiranë, dhe rezervim hoteli ne Strasburg Nëntor*".**
Ne lidhje pretendimin tuaj, sqarojmë se konstatimi i grupit të auditimit është ñ***KPP nuk i është përmbajtur këtij udhëzimi duke përcaktuar linjën ajrore si dhe hotelin e qëndrimit"*** dhe jo përllogaritja ose jo e fondit limit.
Përcaktimi i linjës ajrore për çdo lloj destinacioni përkatës, ngushtëson dhe kufizon kompanitë e agjencisë për të shpallur ofertat të cilat jo detyrimisht çdo agjenci i kanë në të njëjtën vlerë. Përcaktimi i linjës ajroe në kriteret e procedurës se prokurimit për blerje bilete udhëtimi, është kusht i paracaktuar për agjencitë e udhëtimit të cilat ofertojnë vetëm vlerën e asaj linjë ajrore dhe jo të konkurrentëve te saj.
Parcaktimi i kushteve te përcaktuara ne Ftesën për Oferte, bie ndesh me, Parimet e Përgjithshme të Mos diskriminimit, Transparencës si dhe Barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve.
Për sa trajtuar më sipër ky observim nuk merret parasysh.

-Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave punëve dhe shërbimeve.
-Procedurat e ndjekura dhe kriteret e vendosura për përzgjedhjen, kontraktimin e pagesën e avokatëve ose zyrave të avokatisë vendase ose të huaja
Në zbatim të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë.
- Pasqyrë mbi kontraktimet e studiove vendase dhe të huaja për periudhën 2018/01-2020/12.
- Praktikat mbi procedurën e ndjekur deri në lidhjen e kontratës.
- Fatura të pranuara nga Avokatura e Shtetit mbi shërbimet:

Baza ligjore:
-VKM nr.392, datë 08.04.2009, Për miratimin e rregullores ñPër marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme proceduralò.

-VKM nr. 381 datë 12.06.2019 ñPër përcaktimin e procedurave dhe të kritereve për përzgjedhjen, kontraktimin e pagesën e avokatëve ose zyrave të avokatisë vendase ose të huajaò, botuar në fletoren zyrtare nr. 86 datë 14.06.2020.
-Të tjera akte ligjore, nënligjore e rregullative:

Me ndryshimet e vitit 2018, në ligjin 10018/2008 ñPër Avokaturën e Shtetitò parashikohet se, në rast arbitrazhi ndërkombëtar në fushën e investimeve, ku palë është Republika e Shqipërisë, organi i interesuar sipas këtij ligji, konsiderohet ministria përgjegjëse, e cila mbulon shpenzimet e nevojshme për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të Republikës së Shqipërisë. Kur kjo nuk mund të identifikohet, organi i interesuar konsiderohet ministria përgjegjëse për investimet e huaja.

Nr.	*Çështja objekt kontraktimi*	*Data e zhvillimit të procedurës*	*Fituesi dhe vlera përkatese*
1	Anulimi i Vendimit të datës 24.04.2019 dhëne nga Tribunali per ceshtjen e arbitrazhit ARB/15/28 H srl, C srl, F B , M de R , S G L C .	**21 qershor 2019**	**F H LLP 449,000 USD**
2	Konsulenca dhe asistimi i interesave më të mira të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë në kuadrin e zhvillimit të negociatave për marrëveshjen koncesionare të nënshkruar me "T I P " Sh.p.k mbi aeroportin "Nënë Tereza".	**19 prill 2019**	**F B D r LLP 250,000 Euro**
3	Përfaqësimi dhe mbrojtja e Republikes së Shqipërisë në cështjen e arbitrazhit PCA Case 2018-49 V SRL vs Albania.	**14 shtator 2018**	**O S LLP 750,000 Euro**

Sipas të dhënave të paraqitura nga Avokatura e Shtetit për periudhën 2018/01-2020/12 janë zhvilluar tre procedura kontraktimi avokatësh apo zyrave të avokatisë dhe konkretisht:
1. *Procedura e kontraktimit për mbrojtjen në çështjen e arbitrazhit ARB/15/28 H srl, C srl, F B , M de R , S G , L C kundër Republika e Shqipërisë.*
Me vendimin e datës 24.04.2019 ICSID, ñQendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve në Fushën e Investimeveò ka vendosur që shteti Shqiptar të paguaj dëmshpërblimin në favor të palës paditëse në shumën rreth **108 milion Euro plus interesin LIBOR +3% prej datës 31.03.2018** deri në pagesën e plotë të shumës. Ky vendim është përcjell nga ICSID dhe është administruar pranë ASH me nr.526/1 prot, datë 20.04.2019.

Me urdhrin nr. 180 datë 17.05.2019 Avokati i Përgjithshëm i Shtetit ka ngritur grupin e punës për kryerjen e analizës së procedurës së arbitrazhit të ICSID case no.ARb/15/28 H S.R.L dhe të tjerët kundër Shqipërisë, i përbërë nga A D Kryetar, P T , E D , E Q , A T anëtar. Ky grup ndër detyrat e tij ka patur edhe verifikimin e procedurave të ndjekura nga ASH dhe organet e tjera ligjzbatuese që kanë qenë pjesë e komunikimeve, gjatë procesit të arbitrazhit, duke evidentuar rolin e secilit autoritet dhe çdo element tjetër grupi e konsideron determinues për çështjen. Sipas pikës 4 të këtij urdhri, grupi i punës duhet të dorëzoj materialin dhe rekomandimet përkatëse për ndjekje. Ky urdhër nuk rezulton të ketë përcaktuar një afat të shkruar për zbatimin e tij. (Në dosjen e paraqitur për këtë procedurë nuk gjendet një raport apo relacion mbi realizimin e këtij urdhri).

Në vijim me Urdhrin nr. 180/1 datë 18.06.2019 Avokati i Përgjithshëm i Shtetit ka ngritur komisionin për fillimin e procedurës për përzgjedhjen e avokatit ose zyrës së avokatisë vendase apo të huaj për apelimin e vendimit të arbitrazhit. Komisioni përbëhet nga, B L , Kryetar, B N , A Th , P T , V H anëtar.
Të gjithë pjesëtarët e komisonit kanë nënshkruar deklaratat e konfliktit të interesit.
Më tej nga komisoni janë mbajtur:
Procesverbal nr. 1 datë 19.06.2019 për ndarjen e detyrave.
Procesverbal nr. 2 datë 21.06.2019 veç të tjerash ka miratuar Ftesën për Ofertë dhe duke iu referuar udhërrëfyesit ndërkombëtar Chambers and Partners në të cilën rankohen zyrat e avokatisë në nivel botëror në 5 (pesë) banda, komisoni ka vendosur ti dërgoj ftesën për ofertë 3 zyrave të para për secilën bandë të miratoj dhe formatin e njoftimit Ftesë për ofertë.
Në Ftesa për ofertë të miratuar përcaktohet se ofertat duhet të paraqiten pranë ASH deri në datën 05.07.2019 ora 14:00, kriteret e kualifikimit, kriteret e vlerësimit, procedura e përzgjedhjes, etj.
Procesverbal nr. 3 datë 26.06.2019 Komisoni ka konstatuar se në adresën e e-mailit janë paraqitur disa kërkesa për sqarim nga disa studio të huaja dhe vendase mbi disa informacione më të gjera lidhur me çështjen. Nga komisoni është vendosur unanimisht njoftimi i të gjitha studiove ndërkombëtare të cilave u është paraqitur kërkesa për ofertë duke autorizuar anëtaren B N për njoftimin e tyre.
Procesverbal nr. 4 datë 27.06.2019, Komisoni ka trajtuar disa nga kërkesat për sqarime lidhur me çështjen duke autorizuar anëtaren B N për njoftimin tyre.
Procesverbal nr. 5 datë 28.06.2019, Komisoni ka trajtuar disa nga kërkesat për sqarime lidhur me çështjen duke autorizuar anëtaren B N për njoftimin tyre.
Procesverbal nr. 6 datë 01.07.2019, Komisoni ka trajtuar disa nga kërkesat për sqarime lidhur me çështjen duke autorizuar anëtaren B N për njoftimin tyre.
Procesverbal nr. 7 datë 02.07.2019, Komisoni ka trajtuar disa nga kërkesat për sqarime lidhur me çështjen duke autorizuar anëtaren B N për njoftimin tyre.
Procesverbal nr. 8 datë 03.07.2019, Komisoni ka trajtuar disa nga kërkesat për sqarime lidhur me çështjen duke autorizuar anëtaren B N për njoftimin tyre.
Procesverbal nr. 9 datë 04.07.2019, Komisoni ka trajtuar kërkesën për sqarime lidhur me çështjen duke autorizuar anëtaren B Ni për njoftimin tyre.
Procesverbal nr. 10 datë 05.07.2019, Komisoni ka trajtuar kërkesën për sqarime lidhur me çështjen duke autorizuar anëtaren B N për njoftimin tyre.
Procesverbal nr. 11 datë 08.07.2019, Komisoni ka konstatuar se, deri më datë 05.07.2019, ora 14:00 janë paraqitur 9 zarfe të pranuar por të pahapur. Pas datës dhe orës së caktuar për hapjen e ofertave Përfaqësuesja e Zyrës së Protokollit ka paraqitur më datë 08.07.2019 dy zarfa për të cilat u vendos ti kthehen dërguesit në rrugë postare. Ofertuesit e pranuar janë:
1.W &C LLP
2.C C LLP
3.F H LLP
4.H F W -H
5.C G S & H LLP
6.S & H LLP
7.G W
8.S P B
9.C s, M -P C & M LLP

Procesverbal nr. 12 datë 11.07.2019, Komisoni pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur ka përcaktuar nevojën për sqarime për 8 nga 9 ofertuesit, duke autorizuar anëtaren B N për njoftimin tyre.
Procesverbal nr. 13 datë 19.07.2019, Komisoni ka konstatuar se, në Zyrën e Protokollit janë paraqitur 6 zarfe me spjegimet shtesë dhe brenda afatit të vendosur ora 12:00,
1.W &C LLP
2.C C LLP
3.F H LLP
4.H F W -HFW
5.C G S & H LLP
6.C , M -P , C & M LLP
ndërsa 3 zarfe të tjerë janë paraqitur pas kësaj ore, nga të cilët 02 zarfe i përkasin 01 ofertuesi i cili kishte sjell më parë një zarf me spjegime si më poshtë:
1. F H LLP *(2 zarfe)*
2. G W
Më pas është shqyrtuar dokumentacioni në dosje dhe është vendosur moskualifikimi për mosplotësim dokumentacioni:
1.W &C LLP (mungese e legalizimit me vulë Opostille, dokument për dënimin me vendim të formës së prerë, dokumentacioni nuk është në formën e kërkuar).
2.C C LLP (mungese e legalizimit me vulë Opostille, dokument ndodhet jashtë afatit 3 mujor, dokumentacioni nuk është në formën e kërkuar sipas pikës 14 të VKM nr. 381 dhe Kreut III, të Ftesës për Ofertë).
3. H F W -HFW (mungesë e legalizimit me vulë Opostille, dokument për dënimin me vendim të formës së prerë, ISO 27001, mungon deklarat e konfliktit të interesit, dokumentacioni nuk është në formën e kërkuar sipas pikës 14 të VKM nr. 381 dhe Kreut III, të Ftesës për Ofertë).
4.C G S & H LLP (mungon deklarat e konfliktit të interesit, dokumentacioni nuk është në formën e kërkuar sipas sipas pikës 14 të VKM nr. 381 dhe Kreut III, të Ftesës për Ofertë).
5.G WGL (mungese e legalizimit me vulë Opostille, dokument për dënimin me vendim të formës së prerë, mungon deklarat e konfliktit të interesit, dokumentacioni nuk është në formën e kërkuar sipas sipas pikës 14 të VKM nr. 381 dhe Kreut III, të Ftesës për Ofertë)
6.S P B (dokumentacioni nuk është në formën e kërkuar sipas sipas pikës 14 të VKM nr. 381 dhe Kreut III, të Ftesës për Ofertë).
9.C , M -P , C & M LLP, (mungesë e dokumentit që vërteton se subjekti nuk është në proces falimenti apo nën fazë ekzekutimi të kapitalit, dokumentacioni nuk është në formën e kërkuar sipas sipas pikës 14 të VKM nr. 381 dhe Kreut III, të Ftesës për Ofertë).
Në vijim komsioni ka vlerësuar me 100 pikë ofertuesin e vetëm të kualifikuar F H LLP. Në këtë vendim ka mbajtur qëndrim ndryshe Kryetari i Komisionit i cili ka trajtuar se sipas dokumentacionit të paraqitur duhet të kualifikoheshin edhe 4 ofertues të tjerë si më poshtë dhe më pas të vijohej me vlerësimin.
1.W &C LLP
2.S P B
3.C , M -P , C & M LLP 2.C C LLP
4.Gowling WGL
Procesverbal nr. 14 datë 23.07.2019, Komisoni ka trajtuar kërkesat për sqarime nga disa ofertues lidhur me procedurën duke autorizuar anëtaren B N për njoftimin tyre.

Raporti përmbledhës drejtuar Avokatit të Përgjithshëm mban nr. 23/07 prot, datë 23.07.2019. Me urdhrin nr. 180/2 datë 23.07.2019 Avokati i Përgjithshëm ka miratuar fituesin e procedurës F H LLP. Më datë 25.07.2019 është firmosur kontrata nga Avokatura dhe në vlerën 449,000 USD më 25.07.2019 është dërguar kopja e nënshkruar nga shoqëria, administruar në ASH me nr. 2542/19 prot, datë 29.07.2019.
Sipas pikes 3.1 të kontratës, person kontakti për këtë kontartë është caktuar znj. B L dhe Titullari i institucionit në korrespondencën që do ndiqet. Me shkresën e ASH nr. 2542/28 prot, datë 21.11.2019 është përcjell për likujdim pranë MFE fatura nr.4011725 datë 07.11.2019 në vlerën 100,000 Euro.

Për këtë procedurë konstatohet se:
-Kontrata nuk rezulton e përkthyer në gjuhën shqipe por gjendet vetëm në gjuhën angleze.
-Duke qenë se punonjësi i ngarkuar për ndjekjen e kontratës është larguar nga puna, deri në këtë fazë nuk evidentohet të jetë amenduar kontrata në pikën 3.1.
-Nuk disponohet një inventar për dosjen për fazën e marrjes së shërbimit nga ASH.
-Mungojnë relacionet nga ana e ASH mbi marrjen e shërbimit të konsulencës përpara përcjelljes së faturave drejt Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
-Urdhrat e titullarit nr. 180 datë 17.05.2019 dhe nr. 180/1, datë 18.06.2019 në këtë procedurë nuk përmbajnë numër prokolli në kundërshtim me *Normën tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë,* neni 13 i saj.
-Kontrata nuk rezulton e protokolluar e nënshkruar në çdo faqe dhe e vulosur me vulën e institucionit.
-Grupi i auditimit deri në momentin e auditimit në terren nuk disponi një informacion të konfirmuar se çĝpjesë e kontratës ishte likuiduar dhe sa është shuma e detyrimeve ende të pa likuiduara nga shteti shqiptar ndaj studios ligjore të kontraktuar.

Observacion mbi Akt konstatimet nr. 6, datë 18.01.2021, prot në KLSH me nr. 1114/4, datë 27.01.2021.
Pretendimi i Subjektit*:* -Kushtet e marrjes së shërbimit ligjor prej studios ligjore ñF H ò, realizohet në përputhje me kontratën në tërësi, të nënshkruar midis këtij subjekti dhe Republikës së Shqipërisë dhe konkretisht nenit 4 të saj. Në këtë dispozitë kontraktore është parashikuar një skedulë e kryerjes së pagesave e cila në cdo rast kushtëzohet me plotësimin e dy kritereve. Kushtëzimi i lëshimit të faturave nuk lë hapësirë interpretimi mbi marrjen ose jo të shërbimit nga ana e kësaj studioje ligjore.
- rezulton që urdhrat 180 dhe 180/1 kanë numrat e protokollit respektiv në përputhje me Normën tekniko-profesionale.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Duke qenë se kontrata e lidhur midis studios dhe ASH në të gjitha rastet ka të përcaktuar nominalisht personat të cilët ndjekin, mbikëqyrin, koordinojnë dhe komunikojnë me studiot e kontraktuara si edhe për vet natyrën teknike të marrjes në dorëzim të këtij shërbimi, personat e ngarkuar nga ASH duhet të kishin hartuar një relacion mbi realizimin e shërbimit deri në fazën e lëshimit të faturës përpara se ASH të kryente përcjelljen e faturës për pagesë.
Sa i përket urdhrave të titullarit ASH nuk paraqet argument cila nga të dhënat mungon. numri apo data e urdhrit apo numri i protokollit. Urdhrat më sipër ishin të plotësuar në pjesën e numrit të urdhrit dhe jo atë të nr. Prot.
Sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

2. *Procedura e kontraktimit të shërbimit të konsulencës për marrëveshjen e koncesionit të lidhur me shoqërinë koncesionare "**T P ", shpk**, për aeroportin ndërkombëtar "Nënë Tereza", Tiranë.*

Ministria e **I**nfrastrukturës dhe **E**nergjisë me shkresën nr. 4310, datë 17.04.2019 protokolluar në Avokaturën e Shtetit me nr. 1384, datë **19.04.2019** i kërkon ASH bashkëpunim për të kërkuar konsulencë nga ekspertë të huaj me përvojë në këtë fushë me qëllim mbrojtjen e interesave të shtetit shqiptar në kushtet e negocimit dhe të rishikimit të mundshëm të kësaj marrëveshje koncesionare, ratifikuar me Ligjin nr. 9312, datë 11.11.2004 ñ**Për ratifikimin e marrëveshjes se koncesionit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë koncesionare "T P** " shpk për ndërtimin, vënien ne pune, operimin dhe mirëmbajtjen e aeroportit ndërkombëtar "Nenë Tereza", Tiranë dhe për dhënien e disa stimujve kësaj shoqërie koncesionareò i ndryshuar. Bashkëpunimi institucional është kërkuar mbështetur në VKM-në nr. 392, datë 08.04.2009 ñPër miratimin e rregullores ñPër marrëdhëniet e avokaturës së shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme proceduraleò.

Avokatura e Shtetit me shkresën nr. 1384/1, datë **19.04.2019** ka dërguar një projekt vendim për shqyrtim dhe miratim pranë Këshillit të Ministrave.

Projektvendimi për autorizimin e Avokaturës së Shtetit për kryerjen e procedurave të kontraktimit është propozim i zv/kryeministrit të RSH në përputhje me nenin 100 të kushtetutës, ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar të nenit 7, pika c dhe Ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 ñPër Avokaturën e Shtetitò të nenit 15, pika 8 ku citon se .....ñ*Asnjë organ i administratës publike apo ent publik nuk mund të kërkojë drejtpërdrejt ndihmë juridike nga avokatë në profesion të lirë, me përjashtim të rasteve të veçanta, sipas rregullave që do të vendosen nga Këshilli i Ministrave*ò, si dhe Ligjit nr. 99/2018, neni 13 ñPër buxhetin e vitit 2019ò.

Kërkesa për ekspertizë ka ardhur si rrjedhojë e:

- grabitjeve me armë të shumave të konsiderueshme të vlerave monetare të destinuara për tu transferuar në rrugë ajrore (një herë 2016 dhe një herë në 2019).

- pasi shoqëria nuk ka trajtuar me seriozitet shqetësimet e përcjella nga autoritetet shqiptare për pretendimet në lidhje me mos përmbushjen e marrëveshjes nga ana e saj.

Avokatura e Shtetit në bazë të Ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 ñPër Avokaturën e Shtetitò i ndryshuar neni 18, pika 2 autorizohet të kontraktoj avokatë apo zyra avokatie vendas apo të huaja për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të shtetit shqiptar, në çështje të rëndësishme, ku kontraktimi bëhet nëpërmjet një procedure konkurrimi.

Këshilli i Ministrave miraton VKM-në nr. 242, datë **19.04.2019** protokolluar në Avokaturën e Shtetit me nr. 1384/2, datë **19.04.2019**, ku autorizon ñAvokaturën e Shtetit për kryerjen e procedurave të kontraktimit të shërbimit të konsulencës për marrëveshjen e koncesionit të lidhur me shoqërinë koncesionare "T P " shpk, për aeroportin ndërkombëtar "Nene Tereza" Tiranë, si dhe përcaktimin e procedurave përkatëse të përzgjedhjesò.

Drejtoria e Zyrës së Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Ndërkombëtare dhe Arbitrazh Ndërkombëtar me memon nr. 1384/3, **datë 19.04.2019** i kërkon Avokatit të Përgjithshëm përcaktimin e kritereve të veçanta dhe pikëzimin e kritereve të përgjithshme dhe të veçanta në kuadër të VKM-së nr. 242, datë 19.04.2019.ôõPër autorizimin e Avokatit të Shtetit për kryerjen e procedurave të kontraktimit të shërbimit të konsulencës për marrëveshjen e koncesionit të lidhur me shoqërinë ñT P ò për aeroportin ndërkombëtar ñNënë Terezaò Rinas.

Nga dokumentacioni i administruar mungon urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit për përcaktimin e kritereve të veçanta dhe pikëzimin e kritereve të përgjithshme dhe të veçanta.
Personat të cilat kanë përcaktuar kriteret e veçanta dhe pikëzimin e kritereve të përgjithshme dhe të veçanta janë mbështetur në shënimet e lëna nga Avokati i Përgjithshme në memon nr. 1384/3, datë **19.04.2019**, ku po në këtë datë, pra **19.04.2019** kanë përcaktuar kriteret e veçanta dhe pikëzimin e kritereve të përgjithshme dhe të veçanta, të cilat i janë paraqitur për miratim Avokatit të Përgjithshëm.
Me urdhrin nr. 98, datë **19.04.2019** është krijuar komisioni për kryerjen e procedurës së përzgjedhjes të zyrës së avokatisë së huaj për shërbimin e konsulencës mbi marrëveshjen e koncesionit të lidhur me ñT P ò shpk për aeroportin ndërkombëtar ñNënë Terezaò dhe miratimin e kritereve të vlerësimit të ofertave.
Më datë **19.04.2019** është mbajtur procesverbali nga komisioni i ngritur me urdhrin nr. 98, datë 19.04.2019, ku është diskutuar në lidhje me hartimin e ftesës për ofertë dhe përcaktimin e afatit të fundit të dorëzimit të ofertave..
Ftesa për ofertë është hartuar dhe dërguar me nr. 1386/1, datë **19.04.2019**. Në ftesën për ofertë është përcaktuar afati i dorëzimit deri me datën 25.04.2019, në orën 16^{00}.
Me datën 24.04.2019 komisioni shqyrton kërkesës e bërë brenda afatit të përcaktuar nga firma H LLP, të cilat i ka pasqyron në procesverbalin nr. 2, ku i dërgon dhe ftesën për ofertë z. A K .
Komisioni më datën 25.04.2019 mban procesverbalin nr. 3, ku shprehet se, deri me datën 25.04.2019 ora 16^{00}, pranë Zyrës së Protokollit janë paraqitur zarfe nga 2 subjekte ofertuese:
- F B D
- H L

nga ku rezultoi që të dy firmat kishin paraqitur dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e parashtruara në Ftesën për Negociata.
Pas hapjes së ofertave komisioni ka analizuar vlerat e paraqitura nga studiot e ligjore, ku konstatoj se:
- Studioja ligjore ñF B D ò ka 8 raste të ngjashme të shqyrtuara, ku dy nga këto janë zgjidhur sipas legjislacionit anglez.

Në lidhje me eksperiencën e përfaqësimit të qeverive në ofertë referohen 8 raste, si dhe 8 raste që kanë të bëjnë me përfshirjen e kësaj studio në kontratën koncesionare.
Në fushën e aeroporteve studioja referon 9 raste përfshirje dhe që ka pasur sukses.
Grupi mbas një vlerësimi mbi përfaqësuesit që do merren me çështjen dhe skemës së paraqitur nga studioja në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes dhe hapat procedural dhe përmbajtësorë që duhet të bëjë shteti Shqiptar nga vlerësimi i përgjithshëm rezulton se ka një reputacion global dhe evropian në lidhje me fushën ekspertizës së kërkuar.

- Studioja ligjore H L ka paraqitur gjithsej 17 raste, ku vetëm njëra ka të bëjë me marrëveshjen koncesionare siç është rasti i Shqipërisë dhe rastet e tjera kanë të bëjnë me çështje të privatizimit të aeroporteve apo bashkëpunime të kompanive fluturuese, pra çka rezulton se shumica e çështjeve që kanë trajtuar janë për subjektet private dhe në të shumtën janë marrëveshje të së drejtës private dhe jo marrëveshje të natyrave të koncesionit apo partneriteti publik-privat.
Nga kërkimet e realizuara nga komisioni u konstatua se studioja nuk ka rankim në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, negociatave dhe kontratave të koncesionit. Ndërsa referuar avokatëve asnjëri nuk rezulton i rankuar në platformën ndërkombëtare të vlerësimit si, Chambers & Partners dhe 500 Legal. Gjithashtu në ofertë bën vetëm një vlerësim të përgjithshëm pa dhënë strategji apo vizionin e tyre për çështjen.

Vlerësimi i studiove në lidhje me rankimin është mbështetur në faqet zyrtare të Chambers & Partners dhe 500 Legal.
Komisioni për kryerjen e procedurës së përzgjedhjes së zyrës së avokatisë së huaj për shërbimin e konsulencës kërkimet e realizuar në këto faqe zyrtare nuk i bashkëngjit si dokumentacione dosjes së kontraktimit dhe vlerësimit të ofertave me arsyetimin se këto vlerësime ndryshojnë nga viti në vit dhe se të dhënat janë të aksesueshme lehtësisht në faqet e ëeb-it.
Nga pikëzimi i kritereve të përgjithshme dhe të veçanta ka rezultuar se studioja ligjore ñF B D ò ka marrë më shumë pikë në total 94.8, nga H L e cila ka marrë në totale 88.
Komisioni i procedurës së përzgjedhjes së studios ka përgatitur një raport mbi përzgjedhjen e studios, ku i është drejtuar Avokatit të Përgjithshëm me nr. 1386/2, datë 25.04.2019.
Me urdhrin nr. 1386/3, datë 26.04.2019 është miratuar fituesi i procedurës përzgjedhëse të zyrës së avokaturës së huaj për shërbimin e konsulencës për marrëveshjen e koncesionarit.
Afati i ankimimit ju është lënë deri në datën 28.04.2019, ora 20^{00} e cila është ditë e diel dhe ne kundërshtim me VKM-në nr. 242 datë 19.04.2019, pika 6 ku citon se.... ñofertuesit e renditur jo të parët mund të ushtrojnë të drejtën e ankimimit lidhur me procedurën e kualifikimit brenda 3 dite punë nga data e njoftimit të tyre nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetitò.
Avokatura e Shtetit me shkresën nr. 1386/4, datë 30.04.2019 dërgon studios ligjore fituese draft kontratën për komente dhe për nënshkrimin e saj.
Kontrata e lidhur mes palëve është bërë me datën 16.05.2019.
Studioja ligjore kthen kontratën e firmosur protokolluar në Avokaturën e Shtetit me nr. 1386/5, datë 07.06.2019.
Avokatura e Shtetit me shkresën nr. 1386/6, datë 25.06.2019 dërgon kontratën e lidhur mes palëve Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe me shkresën nr. 1386/7, datë 01.07.2019 i dërgon Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë kontratën e nënshkruar me studion fituese në shumën 250,000 Euro.

Lidhur me procedurën e kontraktimit kostatohet se:
- Nga auditimi i dosjes u konstatua se **brenda datës 19.04.2019** janë realizuar një sërë veprimesh procedurale, që nga paraqitja e Projekt Vendimi pranë Këshillit të Ministrave, miratimi i VKM-së, përcaktimi i kritereve të veçanta si dhe përcaktimi i pikëzimit për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, krijimi i komisionit për kryerjen e procedurës së përzgjedhjes të zyrës së avokatisë së huaj për shërbimin e konsulencës, si dhe përgatitja dhe dërgimi i ftesës për ofertë çka krijon risk lidhur me cilësinë e këtyre vendimmarrjeve.
- Grupi që ka përcaktuar kritereve të veçanta si dhe përcaktimi i pikëzimit për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta **nuk është** krijuar në bazë të një komisioni të ngritur nga titullari i institucionit, por në bazë të një shënimi të lënë nga titullari në memon nr. 1384/3, datë 19.04.2019 drejtuar nga Drejtoria e zyrës së përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Ndërkombëtare dhe Arbitrazh Ndërkombëtar.
- **Afati i ankimimit** është lënë deri në datën 28.04.2019, ora 20^{00} e cila është ditë **e diel** dhe ne kundërshtim me VKM-në nr. 242 datë 19.04.2019. pika 6 ku citon se.... ñ ofertuesit e renditur jo të parët mund të ushtrojnë të drejtën e ankimimit lidhur me procedurën e kualifikimit brenda 3 dite punë nga data e njoftimit të tyre nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetitò.
-Mungon inventari dosjes, në kundërshtim me *Normën tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.*

-Kontrata nuk rezulton e përkthyer në gjuhën shqipe por gjendet vetëm në gjuhën angleze.

Mbi ecurinë e kontratës së lidhur:
Më datë 14.06.2019 në takimin midis përfaqësuesve të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është kërkuar që komunikimi i parë midis autoriteteve shqiptare dhe shoqërisë ñT I P ò <u>të mos përmbante shkeljet e sigurisë, por të fokusohej vetëm të negocimi për rivendosjen e ekuilibrit ekonomik</u>, e cila i është përcjellë avokatëve të kontraktuar të studios ligjore ñF B D ò.
Avokatura e Shtetit me shkresën nr. 1386/11, datë 16.07.2019 dërgon në MIE dhe MFE variantin e amenduar të komunikimit me koncesionarin të përpiluar nga avokatët e kontraktuar nga studioja ligjore.
Studios ligjore ñF B De ò dërgon faturën me nr. 2201008647, datë 19.06.2019, protokolluar në Avokaturën e Shtetit me nr. 1386/8, datë 02.07.2019 për likuidimin e shumës 70,000 euro mbështetur në kushtet e kontratës së lidhur midis palëve me datën 16.05.2019, pika 4.4, ku është përcaktuar se likuidimi i kësaj shume duhet të realizohet me datën 01 qershor 2019.
Studios ligjore ñF B De ò ridërgon përsëri faturën me nr. 2201008647, protokolluar në Avokaturën e Shtetit me nr. 1386/9, datë 05.07.2019, ku kërkon plotësimin e kushteve të kontratës së lidhur midis palëve e përcaktuar në pikën 4.4 të kontratës.
Avokatura e Shtetit me shkresën nr.1386/10, datë 15.07.2019 dërgon në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë faturën e dërguar nga studioja ligjore dhe kërkon likuidimin e saj në përmbushje të kontratës së lidhur me datën 16.05.2019, pika 4.4.
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 1386/12, prot. në Avokaturën e Shtetit, datë 30.07.2019 i kërkon dërgimin e faturës origjinale të dërguar nga studioja ligjore në MFE për ekzekutimin e pagesës.
Me shkresën nr. 1386/13, datë 20.08.2019 Avokatura e Shtetit kthen përgjigje MIE, që fatura i është dërguar njëherësh Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë dhe institucionit tuaj si autoritet kontraktor në emër e për llogari të së cilës është nënshkruar kontrata për ofrimin e shërbimit të konsulencës.
Studio ligjore ñF B D ò rikërkon përsëri shlyerjen e detyrimeve sipas pikës 4.4 të kontratës me shkresën, protokolluar, në Avokaturën e Shtetit nr. 1386/14, datë 11.10.2019 likuidimin e shumës prej 35,000 euro ende të pa likuiduar, të faturës nr. 2201008647, e cila duhet të ishte likuiduar sipas afateve të përcaktuara në pikën 4.4 të kontratës së lidhur për shërbimin e konsulencës, si dhe likuidimin e faturës nr. 2201011738, datë 07.10.2019 të shumës prej 80,000 euro, ku sipas pikës 4.4 të kontratës është përcaktuar likuidimi me datën 01.10.2019.
Avokatura e Shtetit me shkresën nr. 1386/15, datë 07.11.2019 i dërgon MFE faturën e dytë të dërguar nga studioja për shërbimin e konsulencës në vlerën 80,000 euro, si dhe rikërkon likuidimin e diferencës prej 35,000 euro të faturës nr. 2201008647, ende të pa likuiduar.
Sa më sipër konstatohet se:
- Në VKM-në nr. 242, datë 19.04.2019 në pikën 9 citohet se..... ñpas nënshkrimit të kontratës dhe hyrjes në fuqi të saj, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit merr masa për të pajisur zyrën e avokatisë së huaj të përzgjedhur me autorizim përkatës për kryerjen e shërbimitò, të cilat mungojnë në dosjen e vënë në dispozicion të grupit të auditimit.
Në dosjen e vënë në dispozicion të grupit të auditimit **mungon** urdhri i Avokatit të Përgjithshëm ku cakton një avokat për ndjekjen zbatimin e kontratës. Mungojnë relacionet e

komunikimit apo raporte në lidhje me ecurinë dhe zbatimin e kontratës së lidhur me studion ligjore ñF B D ò, veprime në kundërshtim me pikën 10 të VKM-së nr. 242, datë 19.04.2019, ku është përcaktuar që ñAvokati i Përgjithshëm i Shtetit cakton me urdhër një avokat shteti për ndjekjen zbatimin e kontratës deri në përfundim të saj i cili do të ketë kryesisht funksione mbikëqyrës, koordinimin dhe komunikimin me të kontraktuarinò.
- Në pikën 4.4 të kontratës është përcaktuar dhe klauzola se për çdo vit vonesë të pagesës së prapambetur do të aplikohet 5% interes. Grupi i auditimit deri në momentin e auditimit në terren nuk ka informacion se çôpjesë e kontratës është likuiduar dhe sa është shuma e detyrimeve ende të pa likuiduara nga shteti shqiptar ndaj studios ligjore të kontraktuar.

Observacion mbi Akt konstatimet nr. 6, date 18.01.2021, prot në KLSH me nr. 1114/4, datë 27.01.2021.
Pretendimi i Subjektit*: Mungon urdhri për ngritjen e grupit që ka përcaktuar kritere të veçanta si dhe përcaktimi i pikëzimit për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, por që nuk është në shkelje të VKM-së 242/2019, dhe nuk konstatohet shkelje proceduriale. Në VKM është përcaktuar vetëm krijimi i komisionit të vlerësimit.*
- Theksojme se është respektuar afati i ankimimit pasi nga data 26 deri me datën 30.04.2019 nuk ka pasur ankesa.
- Në VKM nuk është përcaktuar mbajtja e inventarit për këtë dosje kontraktimi.
- Në lidhje me shërbimin e ofruar dhe faturat e lëshuara për periudhën 29.04.2019-31.05.2019 dhe 01.06.2019-30.09.2019 janë komunikuar me email midis Studios ligjore, MFE dhe MIE.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: *Pavarësisht nëse VKM-ja 214/2019 e përcakton apo jo është detyrim ligjor dhe administrativ që komisioni që përckaton kriteret të marrë miratimin nga titullati i institucionit me urdhër të veçantë të tij, me qëllim përcaktimin se kush janë përsonat përgjegjës të cilët do përcaktojnë këto kritere, mbi bazën e të cilave do të bëhet dhe përzgjedhja dhe vlerësimi i studiove ligjore.*
- Në dokumentet e paraqitura afati i ankimimit është lënë deri në datën 28.04.2019. dhe jo deri me datën 30.04.2019 sic pretendohet në observimin e dërguar.
- Arkivimi i dosjeve duhet të bëhet në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat".
- Grupi i auditimit ka sqaruar në material se mungojnë relacionet e komunikimit apo raporte në lidhje me ecurinë dhe zbatimin e kontratës së lidhur me studion ligjore "F B D ". Në dosjen që i është vënë në dispozicion grupit të auditimit kanë qënë vetem faturat e dërguara nga subjekti për likujdim dhe një variantin i amenduar të komunikimit me koncesionarin të përpiluar nga avokatët e kontraktuar nga studioja ligjore. Në dosje nuk kishte asnjë relacion tjetër bashkëngjitur të ecurisë së zbatimit të kontratës dhe nëse kjo kontratë ishte përmbushur sipas afateve të përcaktuar.
Observacioni nuk merret në konsideratë.

***3.** Procedura mbi përzgjedhjen e zyrës së avokatisë për Përfaqësimin dhe mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë në cështjen e arbitrazhit PCA Case 2018-49 V SRL vs Albania*
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka përcjell pranë Avokaturës së Shtetit njoftimin e Arbitrazhit me palë paditëse V dhe palë të paditur Republikën e Shqipërisë administruar në ASH me nr. 2235 datë 13.08.2018 si dhe një pjesë të dokumentacionit nga dosja që disponon MBZHR lidhur me këtë shoqëri. Njoftimi rezulton të jetë depozituar pranë

kësaj ministrie nga studio ligjore S i & P mbi bazën e UNCITRAL Rules 1976. (Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Rregullat e Arbitrazhit Ndërkombëtar).
Me shkresën nr. 2235/1 prot datë 15.08.2018 ñKthim përgjigjeò nga ana e Avokaturës së Shtetit kërkohet çdo informacion prej MBZHR mbi këtë çështje.
Me shkresën nr. 2235/2 ky njoftim është përcjell edhe nga Ministria e Drejtësisë.
Me shkresën nr. 2235/3 datë 17.08.2018 prej MBZHR është përcjell dokumentacioni.
Më tej me shkresën nr. 2235/5 prot, datë 28.08.2018 ASH ka përcjell pranë MBZHR një informacion të përgjithshëm mbi çështjen referuar raportit të ekspertit përkatës ku është konkluduar në një vlerë prej 4,800,655 Euro. Në analizë të fakteve ASH ka çmuar ndër të tjera se, çështja ka rëndësi të vecantë, krijohen premisa për **dëmtimin e imazhit të vendit** kundrejt investitorëve të huaj, përmbajtja e pretendimeve të Paditësit kërkon njohuri dhe ekspertizë të thelluar teknike, etj, duke vlerësuar që kjo çështje i plotëson kriteret për kontraktim të avokatëve në profesion të lirë. Gjithashtu është kërkuar miratimi për përballimin e kostove për kontraktimin.
Në përgjigjen e saj administruar në ASH me nr.2235/8 prot datë 03.09.2016 MBZHR ka dhënë miratimin për fillimin e kontraktimit për mbrojtjen kësaj çështje.
Me shkresën nr. 2235/10 prot, datë 04.09.2018 ASH i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë për miratimin e fillimit të procedurës.
Me shkresën nr. 2235/12 prot, datë 14.09.2018 Komisioni i ndjekjes së procedurave sipas urdhrit nr. 112 datë 12.09.2018 të Avokatit të Përgjithshëm ka hartuar modelin e Ftesës për Negociata.
Ministria e **D**rejtësisë ka kërkuar informacion më të hollësishëm me shkresën e administruar në ASH me nr. 2235/13 prot, datë 18.09.2018 duke evidentuar gjithshtu se ASH jep asistencë juridike për institucionet shtetërore dhe entet publike si dhe disponon në nivel qendror edhe një zyrë përfaqësimi në gjykatat ndërkombëtar e cila mund të përfaqësoj mbrojtjen e interesave të vendit.
Me shkresën nr. 2235/16 prot, datë 27.09.2018 ASH ka përcjell sqarime lidhur me çështjen si dhe ka evdentuar faktin se është tejkaluar afati 5 ditor për përgjigje nga MD, përcaktuar në rregullore, duke vijuar me procedurat e kontraktimit.
Me shkresën nr. 2235/17 prot, datë 05.10.2018 Komisioni Ndjekjes së Procedurave ka hartuar raportin përmbledhës i cili i referohet 5 mbledhjeve të kryera të cilat kanë janë dokumentuar me 5 procesverbalet përkatëse.
Mbledhja 1 datë 14.09.2018 me objekt Miratimi i Ftesës për Negociata, identifikimi i avokatëve/zyrave të avokatisë të cilave do t`ju dorëzohen ftesat;
Mbledhja 2 Kërkesat për sqarim dhe afati i paraqitjes së tyre;
Mbledhja 3 Marrja në dorëzim e ofertave dhe verifikimi i tyre, hapja e ofertave;
Mbledhja 4 Shqyrtimi i Ofertave;
Mbledhja 5 Vlerësimi dhe përzgjedhja për miratim nga Avokati i Përgjitshshëm.
Në këtë procedurë rzultojnë të kenë marrë pjesë 7 studio të cilat kanë depozituar ofertat përkatëse dhe konkretisht:
1.F B D LLP
2.H L
3.B M
4.A & O LLP
5.C C LLP
6.G W
7.O S LLP

Dokumentacioni i paraqitur nga këto studio ndërkombëtare është pranuar dhe në unanimitet është vendosur të kalojnë të gjitha për procesin e vlerësimit. Më tej është bërë vlerësimi i pikëve për secilën studio ku pikët më të larta sipas llogaritjeve të komisionit i ka O S LLP me një vlerë 750,000 Euro duke mos përfshirë kostot e tribunalit dhe ekspertëve. Për këtë raport ka patur mendim kundër nga një anëtar i komisonit i cili ka rankuar në mënyrë të ndryshme nga komisioni pikëzimin duke nxjerrë me pikë më të larta studion F B D LLP me ofertë në vlerën 2 milion Euro, pa përfshirë kostot në arbitrazh, ekspertët, arbitrat dhe përkthimin e dokumentacionit. Ndërkohë ky anëtar rezulton të ketë firmosur më parë në procesverbalin nr. 5 të mbledhjes rezultatin e nxjerrë nga komisioni.
Me urdhrin e Titullarit të ASH, nr.112/1 prot, datë 05.10.2018 është shpallur fitues studio O S LLP, për të cilën është dërguar urdhri pranë MD me shkresën nr. 2235/19 prot, datë 08.10.2018 dhe me nr. 2235/20 prot datë 08.10.2018 pranë MBZHR. Më tej nga MD është dërguar konfirmimi mbi procedurën me shkresën e administruar në ASH me nr.2235/23 prot, datë 16.10.2018.
Më datë 06.11.20218 është lidhur kontrata dypalëshe në vlerën 750,000 Euro me studion e cila i është përcjell edhe MBZHR me shkresën nr. 2235/27 prot, datë 07.11.2018.
Referuar pikës nr. 3.2 të kontratës person kontakti janë caktuar H J , B N dhe Titullari i institucionit në korrespondencën që do ndiqet.
Me shkresën e ASH nr. 2235/35 prot, datë 06.12.2018 është përcjell për likujdim fatura nr. 20440 datë 22.11.2018 në vlerën 200,000 Euro.
Sipas dokumentacioneve të dosjes, pas lidhjes së kontratës evidentohen një numër i konsiderueshëm kërkesash për informacion drejtuar institucioneve publike lidhur me çështjen.

Për këtë procedurë konstatohet se:
-Mungon inventari i dosjes, pjesa e dokumentacionit që përmendet në shkresën shkresën nr. 2235/3 datë 17.08.2018 si dhe dokumentacion pjesë e ofertave.
-Urdhrat e titullarit në këtë procedurë përmbajnë vetëm nr. dhe datë urdhri por jo numër prokolli në kundërshtim me *Normën tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë,* neni 13 i saj.
-Mungojnë relacionet mbi marrjen e shërbimit të konsulencës përpara përcjelljes së faturave drejt Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Ndërkohë që shkresat janë sigluar vetëm nga një prej anëtarëve zj. N . Grupi i auditimit deri në momentin e auditimit në terren nuk disponi një informacion të konfirmuar se çôpjesë e kontratës ishte likuiduar dhe sa është shuma e detyrimeve ende të pa likuiduara nga shteti shqiptar ndaj studios ligjore të kontraktuar.
-Kontrata nuk rezulton e protokolluar e nënshkruar në çdo faqe dhe e vulosur me vulën e institucionit.
-Në pikën 4.1 të kontratë përcaktohet se, tarifat do të faturohen dhe paguhen në formë neto, pa u mbajtur asnjë zbritje ose tatim në burim ndërkohë që mbajtja ose jo nuk e tatimit nuk është kompetencë e ASH por aplikohet sipas akteve ligjore e nënligjore mbi taksat dhe tatimet në Republikën e Shqipërisë.
-Avokatura e Shtetit ka një seksion të posaçëm organizativ për përfaqësimin në gjykatat e huaja ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar. Prej një periudhe relativisht të gjatë institucioni merr pjesë si përfaqësuese e Shtetit Shqiptar në institucionet publike në gjykatat ndërkombëtare. Po kështu njohuritë mbi legjislacionin vendas, ndryshimet në të, kontekstin ligjor të marrëveshjeve të lidhura, përfaqësimi në rastin konkret mund të ishte bërë direkt nga ASH dhe jo nëpërmjet kontraktimit për të mos shpenzuar vlera të konsiderueshme financiare

të cilat vetëm për përfaqësimin shkojnë në rreth 20% të vlerës së padisë pa përfshirë këtu kosto të tjera të procesit në vijim.
Gjithashtu në rastin *V SRL vs Albania,* ASH përpara vlerësimit për anagazhimin ose jo të studiove të huaja duhet të kishte mbledhur fillimisht të gjithë informacon e nevojshëm nga institucionet përgjegjëse për të gjykuar mbi çështjen dhe jo të administronte një pjesë të rëndësishme të informacionit pasi kishte përfunduar kontraktimi dhe lidhja e kontratës për përfaqësim. Intensifikimi i kërkesave për informacion vihet re në shkresat nr. 2235/29 - nr.2235/32 prot, nr.2235/34, 2235/36 - nr. 2235/39 si dhe Memot e datave 04.12.2018 dhe 05.12.2018 të zj. B N .
Nga sa vërehet, pala paditëse V I S.r.l është një shoqëri e regjistruar në Itali e cila ka zotëruar 82.73% të kapitaleve të shoqërisë A G shpk e krijuar si një bashkëpunim me kapital të përbashkët ku shteti shqiptar zotëronte 17.27% të kapitalit, ndërkohë sipas përshkrimit në akt-padi gjendet në proces likujdimi. Shoqëria V I S.r.l më datë 23.06.2014 rezulton të ketë shitur kuotat e saj në shoqërinë A G shpk një kompanie tjetër të regjistruar në Shqipëri, M R-A Shpk. Pra prej datës së shitjes V I S.r.l nuk disponon më të drejta mbi shoqërinë apo kontrata të lidhura me Shtetin Shqiptar, këto të drejta sipas akteve shkresore dhe të dhënave të QKB i atribuohen blerësit të kuotave. Sipas dokumentacioneve në dosje, të dhënave të QKB, etj, për A G Shpk evidentohen procese gjyqësore dhe administrative të cilat duhet të vlerësoheshin nga ASH përpara se të merreshin hapa prej saj për kontraktim studiosh të huaja të cilat kanë efekte financiare të konsiderueshme. Një vlerësim i ngjashëm është bërë dhe nga ana Ministria e Drejtësisë, në rolin e organit epror, e cila me shkresën nr. 2235/13 prot, datë 18.09.2018, ka evidentuar gjithashtu mundësinë e përfaqësimit nga zyra përkatëse pranë ASH.
Nëse do ti referoheshim dispozitave të VKM nr. 392, datë 08.04.2009 Për Miratimin e Rregullores ñPër Marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me Institucionet Shtetërore dhe Entet Publike, Rolin e Avokatëve të Shtetit në Gjykim, si dhe Normat e Posaçme Proceduraleò. në nenin 36 pika 1 e saj përcakton se:

*1. **Kur vendimi i gjykatës përcakton detyrimin në ngarkim të palës** kundërshtare në një proces për të paguar **shpenzimet gjyqësore**, në rastet e çështjeve të ndjekura nga Avokatura e Shtetit, shuma në fjalë, pa prekur efektet ekonomike të procesit, **do të transferohet në buxhetin e Avokaturës së Shtetit.***

Pra referuar sa më sipër, nëse Avokatura e Shtetit do të investohej në mënyrë të plotë dhe profesionale, në këto procese dhe do të fitonte ato, automatikisht do të kursente jo vetëm vlera të konsiderueshme financiare të buxhetit të shtetit por do të bëhej dhe përfituese e shpenzimeve gjyqësore të cilat kapin vlera të konsiderueshme financiare.

Gjithashtu, për tre procedurat e sipërcituara nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se:
Në dy nga tre procedurat e zhvilluara nga Avokatura e Shtetit në procedurat e kontraktimit të avokatëve/zyrave të avokatisë sipas VKM nr. 392 datë 08.04.2009, është vendosur si ñkriterò ofertimi i vlerës totale duke përfshirë të gjitha kostot e shërbimit, ndërsa në procedurë e kontraktimit ñ*Anulimi i Vendimit të datës 24.04.2019 dhënë nga Tribunali për çështjen e arbitrazhit ARB/15/28 H srl, dhe të tjerë"* të zhvilluara referuar VKM nr. 381 datë 12.06.2019, çmimi është kërkuar i ndarë nga TVSH. Në të tre rastet ofertuesit janë shoqëri të huaja, jorezidente në Republikën e Shqipërisë të cilat kanë ofertuar me TVSH në masën 0%. Nga ana e ASH **nuk** është kërkuar caktimi i një përfaqësuesi tatimor për faturimin e shërbimit, kjo mangësi nuk gjendet vetëm në kriteret e konkurimit por as në kontratën e lidhur

referuar kërkesave të legjislacionit Shqiptar mbi taksat dhe tatimet. Faturat e lëshuara nga zyrat e huaja të avokatisë janë pranuar në mënyrë të parregullt me TVSH në vlerën zero prej studiove të kontraktuara dhe janë përcjell për pagesë drejt Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Sa i përket faturimit të shërbimeve nga personat jorezidentë drejt institucioneve publike të cilat nuk janë objekt i regjistrimit në TVSH, legjislacioni fiskal përcakton si më poshtë vijon:

Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimore në RSHò, i ndryshuar neni 5 pika 1/e tij përcakton se:

1.e) ñPërfaqësues i tatimpaguesit" është personi i autorizuar ligjërisht për të përfaqësuar tatimpaguesin në çështje tatimore;

Në po këtë ligj neni 9 pika 1 e tij citohet se,

1. Tatimpaguesi jorezident emëron një përfaqësues tatimor rezident dhe regjistrohet pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore, kur kjo i kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Referuar ligjit nr. 92/2014 ñPër Tatimin mbi Vlerën e Shtuarò, i ndryshuar, neni 86 ñPersoni përgjegjës për pagesën e TVSH-sëò pika 1 dhe 2 e tij, përcaktohet se,

1.TVSH-ja paguhet nga ana e personit të tatueshëm që kryen një furnizim mallrash ose shërbimesh të tatueshëm, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe.
2.TVSH-ja është e pagueshme nga personi i tatueshëm ose personi juridik i patatueshëm, i identifikuar për TVSH- në, të cilit i janë furnizuar shërbimet, siç përcaktohet në pikën 1, të nenit 24, të këtij ligji, nëse këto shërbime furnizohen nga një person i tatueshëm që nuk është i vendosur në territorin e Republikën e Shqipërisë. Ministri i Financave përcakton me udhëzim procedurat për zbatimin e kësaj pike.

Neni 87 i po këtij ligji ñCaktimi i përfaqësuesit tatimorò përcakton se,

Në rastet që i referohen pikës 1, të nenit 86, të këtij ligji, kur personi përgjegjës për pagesën e TVSH-së është një person i tatueshëm që nuk është i vendosur në Republikën e Shqipërisë, vend në të cilin duhet të paguhet TVSH-ja, në zbatim të këtij neni, ky person duhet të caktojë një përfaqësues tatimor në Republikën e Shqipërisë si person përgjegjës për pagesën e TVSH-së, përveç kur personi, të cilit i janë furnizuar mallrat ose shërbimet, është një person i tatueshëm, i regjistruar në Republikën e Shqipërisë dhe i nënshtrohet pikës 2, të nenit 86, të këtij ligji.

Avokatura e Shtetit nuk rezulton i regjistruar për TVSH dhe rrjedhimisht i nënshtrohet pikës nr. 1 të nenit 86 të ligjit.
Në UMF nr. 6 datë 30.1.2015, neni 27 pikat b) dhe d) përcaktohet se:

1. Pagesa e TVSH-së nëpërmjet përfaqësuesit tatimor
b. <u>Nëse marrësi i këtij shërbimi nuk është një person i tatueshëm</u> i regjistruar për TVSH-në në Shqipëri atëherë personi i tatueshëm që ka kryer shërbimin cakton një përfaqësues tatimor për të paguar TVSH-në në Shqipëri.
d. Në të kundërt nëse TVSH-ja nuk paguhet prej përfaqësuesit tatimor për rastet e mësipërme, detyrohet ta paguajë TVSH-në në Shqipëri marrësi i shërbimit, i cili ka banesën e përhershme ose zakonisht banon në Shqipëri.

Po kështu në pikën 2/c të nenit 27 përcaktohet se:

2.c. Në rastin kur personi i tatueshëm marrës i furnizimit është një tatimpagues që nuk është i regjistruar për TVSH-në, për shembull është një tatimpagues që i nënshtrohet regjimit të biznesit të vogël ose është ***një institucion ose organ publik*** *që nuk është i regjistruar për TVSH-në, ose një individ, kërkohet emërimi i një përfaqësuesi tatimor për të paguar TVSH-në. Në mungesë të emërimit të një përfaqësuesi tatimor, atëherë përfituesi vendas i shërbimit është përgjegjës për të paguar TVSH-në.*

Sa më lartë shihet qartë se, caktimi i përfaqësuesit tatimor është një detyrim ligjor i cili buron nga legjislacioni fiskal në rastet kur organi publik nuk është i regjistruar në TVSH dhe si i tillë kriteri për caktimin e përfaqësuesit duhet të ishte parashikuar në vlerat e ofertuara, kontratën e lidhur me shoqërinë fituese por dhe në pranimin e faturave të shërbimit. Sipas këtyre dispozitave, kur organi publik nuk rezulton i regjistruar atëherë detyrimi për pagesën e TVSH i ngarkohet përfituesit të shërbimit.

Efekti financiar shtesë për TVSH-në detyrueshme për tu paguar nga përfituesi i shërbimit llogaritet rreth **34.5 milion lekë**.

Periudha e procedurës	Kompania Fituese	Monedha	Vlera e shërbimit	Kursi mestar i këmbimit	Vlera e tatueshme	TVSH	Vlera Totale
21 qershor 2019	F H LLP	USD	449,000	109.8	49,300,200	9,860,040	59,160,240
19 prill 2019	F B De LLP	Euro	250,000	123	30,750,000	6,150,000	36,900,000
14 shtator 2018	O S LLP	Euro	750,000	123	92,250,000	18,450,000	110,700,000
Gjithsej					**172,300,200**	**34,460,040**	**206,760,240**

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Procedurat e ndjekura nga ana e institucionit për kontraktimin e studiove të avokatisë paraqiten me mangësi e parregullsi të cilat kanë ndikime në veprimtarinë institucionale.

Observacion mbi Projektraportin e Auditimit i paraqitur nga Avokatura e Shtetit me shkresën nr. 4425/15 prot, datë 30.09.2021, regjistruar në KLSH me nr. 1114/6, datë 06.10.2021.

Pretendimi i Subjektit:

Siç jemi shprehur edhe mbi akt-konstatimin nr. 6, kuadri ligjor i mëparshëm nuk e parashikonte aplikimin e TVSH-së, ndërkaq VKM-ja e re parashikon aplikimin e saj, në rast se ajo është e aplikueshme sipas rastit konkret. Në rastin konkret, tatimi mbi vlerën e shtuar nuk mund të aplikohet, për sa kohë subjektet jorezidente dhe shërbimi i ofruar prej tyre realizohet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Observimet e paraqitura janë thuajse identike me ato të paraqitura në fazën e mëparshme të auditimit për të cilat Grupi i Auditimit ka paraqitur sqarimet përkatëse (trajtuar më poshtë). Në mungesë të shpjegimeve apo të dhënave shtesë *observacioni juaj nuk merret në konsideratë.*

Observacion mbi Akt konstatimet nr. 6, date 18.01.2021, prot në KLSH me nr. 1114/4, datë 27.01.2021.

Pretendimi i Subjektit*: Lidhur me procedurat e sipërpërmendura, kuadri ligjor i mëparshëm nuk e parashikonte aplikimin e TVSH-së, ndërkaq VKM-ja e re parashikon aplikimin e saj, në rast se ajo është e aplikueshme sipas rastit konkret. Në rastin konkret, tatimi mbi vlerën e shtuar nuk mund të aplikohet, për sa kohë subjektet jorezidente dhe shërbimi i ofruar prej tyre realizohet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.*

Ndërkohë, në akt-verifikimin nr.1 të datës 18.01.2021 të lëshuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, mbi auditimin e ushtruar në Avokaturën e Shtetit në bazë të programit të auditimit nr. 1114/1 datë 06.11.2020, i ndryshuar, mbajtur në datë 18.01.2021, lidhur me pikën C.II, Të ardhura të munguara në dëm të buxhetit të shtetit, në gjetjen 2,, Kontrolli i Lartë i Shtetit rekomandon aplikimin e Tatimit të mbajtur në burim të të ardhurave, në procedurat e përzgjedhjes së studiove të huaja të avokaktisë. Ndodhur në këto kushte, kur kemi dy rekomandime të ndryshme të lëshuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, lidhur me aplikimin e tatimit ndaj subjekteve në procedurate sipërpërmendura është e paqartë për Avokaturën e Shtetit nëse në rastin konkret, do të aplikohet tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH), tatimi i mbajtur në burim ose nëse ato do të aplikohen të dyja së bashku. Në vlerësimin e Avokaturës së Shtetit, për sa kohë që në procedurat e sipërpërmendura përfshihen subjekte jo rezidentë dhe shërbimi i ofruar prej tyre nuk realizohet në Shqipëri, në këto raste do të aplikohet tatimi në burim mbi të ardhurat dhe në këtë kontekst, lidhur me mënyrën e aplikimit të tatimit në burim të të ardhurave Avokatura e Shtetit ka mbajtur qëndrimin e saj në akt-verifikimin nr. 1 datë 18.01.2021 të lëshuar nga Kontrolli i Lartë i Shetit.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Mbajtja në burim e tatimit në masën 15%, për personat jorezidentë parashikohet në legjislacionin fiskal e konkretisht ligjin nr. 8438 datë 28.12.1998 ñPër Tatimin mbi të Ardhurató neni 33 i tij, dispozitë e cila pazbatuar nga Avokatura e Shtetit. Deri në përfundim të procedurës audituese në terren institucioni nuk rezulton të ketë zbatuar rekomandimin e mëparshëm të lënë, ndërkohë që referuar komenteve të dhëna mban qëndrim për aplikimin e tij. Ndërkohë, konstatimi aktual i referohet aplikimit të TVSH-së nga një legjislacion krejt i ndryshëm nga ai i mëparshëm i cili rregullon mënyrën e faturimit të shërbimit drejt personave jorezidentë konkretisht ligjit nr. 92/2014 ñPër Tatimin mbi Vlerën e Shtuarò dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Dispozitat ligjore të sipërcituara shprehin qartë mënyrën e veprimit lidhur me marrësin e shërbimit për efekt të TVSH. Nëse ASH ka patur paqartësi mbi dispozitat e dy ligjeve të ndryshme, mund ti ishte drejtuar në kohë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për një interpretim të hollësishëm tekniko-ligjor lidhur me këtë lloj shërbimi. *Observacioni nuk merret në konsideratë.*

Titulli i Gjetjes 1	**Parregullsi në Procedurën e blerjes në vlerë të vogël (Karburant)**
Situata:	Për vitin 2019 grupi i auditimit konstatoi se: Procedura e blerjes së Karburantit për Institucionin ka pasur mangësi gjatë procesit të shpalljes së fituesit, bazuar në kriteret ligjore e specifikimet teknike.
Kriteri:	Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñ*Për Prokurimet Publike*ò, i ndryshuar, VKM Nr.914 datë. 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò kontratës me Nr.1336 Prot, datë.16.04.2019 së lidhur nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit me Operatorin Ekonomik.

Ndikimi/Efekti	Mos respektimi i kuadrit ligjor, lidhur me ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe respektimin e parimeve të konkurencës e trajtimit jo të barbartë ndaj operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e mësipërme, ka ngushtuar konkurencën dhe ka ekspozuar risk në përmbushjen e kontratës duke u bazuar në kushtet e paraqitura nga operatori ekonomik.
Rëndësia	E Lartë

Titulli i Gjetjes 2	**Mos inventarizimi i dokumentacionit ligjor dhe administrativ**
Situata:	Për vitin 2018, 2019 grupi i auditimit konstatoi se dosjet e tenderave janë të pa inventarizuara. Dosjet e tenderave me dokumentacion ligjor dhe administrative për vitin 2020, janë inventarizuar vetëm me emërtimin e dokumentit ligjor, por nuk është bërë numërimi i fletëve dhe numërim total i tyre sipas ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 ñPër Arkivatò, Normat Tekniko-Ligjore dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor, neni 30 ñInventari i brendshëm i dosjesò Modeli nr.8 dhe VKM nr. 1 datë 10.01.2007 ñPër Miratimin e Rregullave të Prokurimit publikò Kreu V ñZhvillimi i Proceduraveò.
Kriteri:	Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 ñ*Për arkivat*ò, si dhe ñ*Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*ò, neni 30.
Ndikimi/Efekti	Mos inventarizimi i dokumentave shtetëror sjell pasiguri si dhe mungesë transparence ne lidhje me mënyrën e procedimit sipas ligjit, rreth procedurave të ndryshme të ndjekura për plotësimin e nevojave të institucionit.
Rëndësia	E Mesme

Titulli i Gjetjes 3	**Përcaktimi i padrejtë i linjës ajrore për procedurën "Blerje bilete udhëtimi" për vitin 2018**
Situata:	Për vitin 2018, janë kryer dy procedura prokurimi ñ*Blerje bileta udhëtimi Tirane Strasburg; Strasburg-Tirane, me rezervim hoteli*ò për datat 25-27 Janar dhe për të njëjtat data për muajin Nëntor. Grupi i auditimit konstatoi se Komisioni i Blerjeve të Vogla në kundërshtim me udhëzimin Nr.4 datë 09.01.2018 ñ*Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin ne mjete elektronik*ò, ne Ftesën për Ofertë, ka përcaktuar *linjën ajrore si dhe hotelin për destinancionin e përcaktuar si më sipër*.
Kriteri:	Veprime në kundërshtim me udhëzimi Nr.4 datë 09.01.2018 ñ*Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin ne mjete elektronik*ò,
Ndikimi/Efekti	Paracaktimi i kushteve në Ftesën për Oferte, bie ndesh me, Parimet e Përgjithshme të Mosdiskriminimit, Transparencës si dhe Barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve.
Rëndësia	E Lartë

Titulli i Gjetjes 4	**Copëzimi i fondeve, mosrespektimi i planifikimit te regjistrit të procedurave te prokurimit të pajustifikuara apo miratuara & mosrespektimi i blerjeve shkresore/pa tenderim në vlerën nën 100,000 lekë.**
Situata:	**a.** Referuar regjistrit të parashikim të procedurave të prokurimi si dhe procedurave të realizimit për vitin 2018 grupi i auditimit konstatoi se janë planifikuar gjithsej 31 procedura prokurimi, kur referuar këtyre procedurave janë realizuar 17 prej tyre. Referuar regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit janë realizuar 35 procedura prokurimi, ku 18 procedura prokurimi janë të paparashikuara në regjistrin e parashikimit, me përjashtim të një procedure ñBlerje pajisje elektronikò e realizuar nga AKSHI. Grupi i auditimit konstatoi se nga ana e Autoritetit Kontraktuor kemi një keq planifikim të nevojave dhe fondeve të subjektit. Gjithashtu grupi i auditimit konstatoi se për procedura të cilat janë parashikuar me një fond limit prej 800.000, janë copëzuar sipas nevojave duke kaluar në procedura pa tenderim/blerje shkresore poshtë kufirit 100.000 lekë, të cilat në kundërshtim me Udhëzimin nr.03 datë 08.01.2018 ñ*Mbi përdorimin e procedurës së Prokurimit me vlerë të vogël*ò si dhe udhëzimit nr.01 datë 05.05.2018 ñ*Për hartimin e regjistrit të parashikimeve te PPP*ò...; nuk i ka planifikuar si dhe nuk i është referuar këtij regjistri. **b.** Referuar regjistrit parashikimit të procedurave të prokurimit publik për vitin kalendarik 2020 te hartuar nga Avokatura e Shtetit miratuar nga titullari me shkresën nr.272/1 datë 14.01.2020 janë renditur objekt prokurimet si dhe fondi limit. Në kundërshtim me Udhëzimin nr.1 datë 05.05.2018 ñ*mbi hartimin e regjistrit të parashikimeve të PPP...."* **AK** nuk ka bërë asnjë parashikim në regjistrin e APP, për mallrat/shërbimet në një vlerë deri në 100,000 lekë gjate vitit kalendarik. Nga auditimi ka rezultuar se AK ka realizuar blerje në vlerën 100,000 lekë për mallra dhe shërbime të cilat janë planifikuar me një fond limit deri në 800,000 lekë. **c.** Në kundërshtim me nenin 8, pika 2 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*ò i ndryshuar, i cili citon se ñ*Për objektet, ku përfshihen mallra dhe shërbime të ngjashme, vlera e përllogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, nuk është më e madhe se 100 000 (njëqind mijë) lekë, autoriteti kontraktor nuk* ***i nënshtrohet procedurave të prokurimit****"* Avokatura e shtetit edhe pse këto procedura nën vlerën e kufirit 100,000 lekë nuk kanë qenë te parashikuara, i ka kryer me procedure tenderimi dhe jo blerje direkte.
Kriteri:	Veprime në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*ò i ndryshuarò; Udhëzimin nr.1 datë 05.05.2018 ñ*Mbi hartimin e regjistrit të parashikimeve të PPP....";* Udhëzimin nr.3 datë 08.01.2018 ñ*Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit publik me vlerë të vogël....."*
Ndikimi/Efekti	Keq planifikim i fondeve si dhe nevojave të AK, ne lidhje me planifikimin dhe realizimin e procedurave të tenderimit. Mos respektimi regjistrit të parashikimeve duke copëzuar fondin nga tenderim me vlerë të vogël nën 800,000 lekë në blerje shkresore, pa tenderim në vlerën nën 100,000 lekë.
Rëndësia	E Mesme

Titulli i Gjetjes 5	**Procedurat e kontraktimit dhe marrjes në dorëzim të shërbimit të zyrave të huaja të avokatisë paraqitet me mangësi.**
Situata:	Gjatë periudhës vitet 2018-2020 Avokatura e Shtetit ka përfunduar tre procedura kontraktimi të studiove të huaja me një vlerë gjithsej prej rreth **1.4 milion dollarë.** *-Në procedurën e kontraktimit për mbrojtjen në çështjen e arbitrazhit "ARB/15/28 H srl, C srl, F B , M de R , S G L C kundër Republika e Shqipërisë"* rezultoi se, kontrata nuk rezulton e përkthyer në gjuhën shqipe, nuk disponohet inventar për dosjen për fazën e marrjes së shërbimit nga ASH. Urdhrat e titullarit nr. 180 datë 17.05.2019 dhe nr. 180/1, datë 18.06.2019 në këtë procedurë nuk përmbajnë numër prokolli në kundërshtim me Normën tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 13 i saj. Kontrata nuk rezulton e protokolluar e nënshkruar në çdo faqe dhe e vulosur me vulën e institucionit. Duke qenë se punonjësi i ngarkuar për ndjekjen e kontratës është larguar nga puna, deri në këtë fazë nuk evidentohet të jetë amenduar kontrata në pikën 3.1 për zëvendësimin e tij. Mungojnë relacionet nga ana e ASH mbi marrjen e shërbimit të konsulencës përpara përcjelljes së faturave drejt Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. *- Në procedurën e kontraktimit të shërbimit të konsulencës për marrëveshjen e koncesionit të lidhur me shoqërinë koncesionare "**T P ", shpk**, për aeroportin ndërkombëtar "Nënë Tereza", Tiranë,* nga auditimi i dosjes rezultoi se, **brenda datës 19.04.2019** janë realizuar një sërë veprimesh procedurale, që nga paraqitja e Projekt Vendimi pranë Këshillit të Ministrave, miratimi i VKM-së, përcaktimi i kritereve të veçanta si dhe përcaktimi i pikëzimit për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, krijimi i komisionit për kryerjen e procedurës së përzgjedhjes të zyrës së avokatisë së huaj për shërbimin e konsulencës, si dhe përgatitja dhe dërgimi i ftesës për ofertë çka krijon risk lidhur me cilësinë e këtyre vendimmarrjeve. Grupi që ka përcaktuar kritereve të veçanta si dhe përcaktimi i pikëzimit për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta **nuk është** krijuar në bazë të një komisioni të ngritur nga titullari i institucionit, por në bazë të një shënimi të lënë nga titullari në memon nr. 1384/3, datë 19.04.2019 drejtuar nga Drejtoria e zyrës së përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Ndërkombëtare dhe Arbitrazh Ndërkombëtar. - **Afati i ankimimit** në këtë procedurë është lënë deri në datën 28.04.2019, ora 20^{00} e cila bie ditë **e diel** dhe ne kundërshtim me VKM-në nr. 242 datë 19.04.2019. pika 6 ku citon se.... ñ ofertuesit e renditur jo të parët mund të ushtrojnë të drejtën e ankimimit lidhur me procedurën e kualifikimit brenda 3 dite punë nga data e njoftimit të tyre nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetitò. Mungon inventari dosjes, në kundërshtim me *Normën tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.* Kontrata nuk rezulton e përkthyer në gjuhën shqipe por gjendet vetëm në gjuhën angleze. Në dosje mungojnë disa dokumentacione si urdhri i Avokatit të Përgjithshëm ku cakton një avokat për ndjekjen zbatimin e kontratës si dhe mungon një informacion i plotë mbi ecurinë e kësaj kontrate sa i përket likujdimit të saj. Mungojnë relacionet nga ana e ASH mbi marrjen e shërbimit të konsulencës përpara përcjelljes së faturave drejt Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. *-Në procedurën mbi përzgjedhjen e zyrës së avokatisë për "Përfaqësimin dhe mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë në çështjen e arbitrazhit PCA Case 2018-49 V SRL vs Albania",* rezultoi se, në këtë procedurë mungon inventari i dosjes, pjesa e dokumentacionit që përmendet në shkresën shkresën nr. 2235/3 datë 17.08.2018 si dhe dokumentacion pjesë e ofertave. Urdhrat e titullarit në këtë procedurë përmbajnë vetëm nr. dhe datë urdhri por jo

	numër protokolli në kundërshtim me *Normën tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë,* neni 13 i saj. Kontrata nuk rezulton e protokolluar e nënshkruar në çdo faqe dhe e vulosur me vulën e institucionit. Në pikën 4.1 të kontratë përcaktohet se, tarifat do të faturohen dhe paguhen në formë neto, pa u mbajtur asnjë zbritje ose tatim në burim ndërkohë që mbajtja ose jo nuk e tatimit nuk është kompetencë e ASH por aplikohet sipas akteve ligjore e nënligjore mbi taksat dhe tatimet në Republikën e Shqipërisë. Mungojnë relacionet nga ana e ASH mbi marrjen e shërbimit të konsulencës përpara përcjelljes së faturave drejt Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. -Lidhur me këtë procedurë nga ana e ASH nuk rezulton të jetë kryer një angazhim paraprak mbi çështjen për mbledhjen e informacioneve të nevojshme nga institucionet e vendit, vlerësimin e tyre si dhe nxjerrjen e konkluzioneve përkatëse nëse kjo çështje mund të mbrohej nga Avokatura e Shtetit nëpërmjet strukturës përgjegjëse në të, përpara përzgjedhjes së procedurës së kontraktimit. Angazhimi i ASH për mbledhjen e informacionit evidentohet në fazën pas përfundimit të kontraktimit dhe jo përpara saj. Avokatura e Shtetit ka një seksion të posaçëm organizativ për përfaqësimin në gjykatat e huaja ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar. Prej një periudhe relativisht të gjatë institucioni merr pjesë si përfaqësuese e Shtetit Shqiptar në institucionet publike në gjykatat ndërkombëtare. Po kështu njohuritë mbi legjislacionin vendas, ndryshimet në të, kontekstin ligjor të marrëveshjeve të lidhura, përfaqësimi në rastin konkret mund të ishte bërë direkt nga ASH dhe jo nëpërmjet kontraktimit për të mos shpenzuar vlera të konsiderueshme financiare të cilat vetëm për përfaqësimin, çka është evidentuar dhe nga ana e Ministrisë së Drejtësisë me shkresën e administruar në ASH me nr. 2235/13 prot, datë 18.09.2018. Shoqëria V I S.r.l më datë 23.06.2014 rezulton të ketë shitur kuotat e saj në shoqërinë A G shpk një kompanie tjetër të regjistruar në Shqipëri, ndërkohë që ankimi i saj në gjykatë rezulton i kryer në vitin 2018, çka në gjykimin tonë përbën element kyç në moslegjitimimin e saj si palë në proces. Megjithatë kjo çështje do të jetë objekt verifikimi dhe në auditimet vijuese të KLSH pranë këtij institucioni.
Kriteri:	-Ligjit 10018/2008 ñPër Avokaturën e Shtetitò neni 18. -VKM nr. 392 datë 08.04.2009, Miratimin e rregullores ñPër marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të Shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme proceduraleò, i ndryshuar, Kreu III dhe IV i tij. -VKM nr. 381, datë 12.6.2019 ñPër përcaktimin e procedurave dhe të kritereve për përzgjedhjen, kontraktimin e pagesën e avokatëve ose zyrave të avokatisë vendase ose të huajaò. - Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 ñPër Arkivatò, Normat Tekniko-Ligjore dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor, neni 13. -Kontratat e shërbimit të lidhura midis palëve.
Ndikimi/Efekti	Mangësi e parregullsi të cilat krijojnë risk për efekte financiare negative në dëm të buxhetit të shtetit.
Rëndësia	E Lartë

Titulli i Gjetjes 6	**Mungesë e kriterit mbi caktimin e përfaqësuesit tatimor për shërbimet e kontraktuara me efekte financiare shtesë.**
Situata:	Nga auditimi rezultoi se, në tre procedurat e zhvilluara nga Avokatura e Shtetit gjatë periudhës vitet 2018-2020, zyrat e huaja të përzgjedhura, jorezidente në Republikën e Shqipërisë kanë ofertuar thuajse në të gjitha rastet me TVSH në masën 0%. Faturimet e tyre në vijim janë realizuar në të njëjtën mënyrë me ofertimin, ndërkohë që sipas dispozitave të legjislacionit fiskal, zyrat e huaja duhet të emëronin përfaqësues tatimor në Shqipëri për shërbimin e përfaqësimit/këshillimit ligjor që ato kryejnë si dhe lëshimin e faturës tatimore shqiptare me TVSH të aplikueshme në masën 20%. Në rastet kur marrësi i shërbimit është një institucion publik që nuk është i regjistruar në TVSH, kërkohet emërimi i një përfaqësuesi tatimor për të paguar TVSH-në dhe në mungesë të tij, përfituesi vendas i shërbimit është përgjegjës për të paguar TVSH-në. Pra në kriteret e vendosura në procesin e përzgjedhjes, dispozitat e kontratës së lidhur mes palëve, apo dhe përpara përcjelljes në MFE të faturave të këtyre subjekteve jorezidente për likujdim, Avokatura e Shtetit duhet të kërkonte caktimin e përfaqësuesit tatimor nga ana e tyre. Sa më lartë, në mungesë të përfaqësuesit tatimor, përfituesit e shërbimit i ngarkohen nga legjislacioni fiskal kosto shtesë mbi vlerën e parashikuar për kontraktim, në masën prej 20% të vlerës së shërbimit që faturohet. Kjo vlerë duhet të llogaritej sipas pagesave individuale dhe duhet të paguhej në llogari të administratës tatimore.
Kriteri:	-Ligji nr. 92/2014 ñPër Tatimin mbi Vlerën e Shtuarò, i ndryshuar, nenet 86 pika 1 dhe 2, neni 87 të tij. -UMF nr. 6 datë 30.1.2015 neni 27 pika 1/b,d dhe 2/c.
Ndikimi/Efekti	Krijohen efekte financiare shtesë si rrjedhojë e mosnjohjes apo keqinterpretimit të dispozitave ligjore në fuqi për TVSH-në. Sipas vlerës së kontratave të lidhura kosto shtesë për të tre kontratat llogaritet rreth **34.5 milion lekë.**
Rëndësia	E Lartë

(Për këtë pikë të drejtimit të auditimit lidhur me procedurat e prokurimit të zhvilluara është hartuar Akt-Konstatimi nr. 4 regjistruar në Avokaturën e Shtetit me nr. 4425/9 prot, datë 18.01.2021 mbajtur me përfaqësuesit e institucionit, Avokatin e Përgjithshëm E M , E G , I B , J D , E A , J Z).

(Për procedurat e kontraktimit të avokatëve apo zyrtave të avokatisë referuar drejtimit të auditimit është hartuar Akt-Konstatimi nr. 6 regjistruar në Avokaturën e Shtetit me nr. 4425/11 prot, datë 18.01.2021 mbajtur me përfaqësuesin e institucionit, Avokatin e Përgjithshëm E M).

- **Drejtimi 6: "Mbi veprimtarinë e Zyrës së Inspektimit si strukturë përgjegjëse për kryerjen e inspektimit të veprimtarisë së avokatëve të shtetit"**

Zyra e Inspektimit, sipas nenit 10 të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 ñPër avokaturën e Shtetitò është struktura në nivel qendror, e cila kryen kontrollin e veprimtarisë së avokatëve të shtetit, në të dyja nivelet e organizimit, si dhe kryen funksione mbështetëse, në rastet kur ka pamjaftueshmëri në burime njerëzore, për ushtrimin me efektivitet të funksioneve të institucionit.

Organika e kësaj zyre përbëhet nga 3 avokat shteti, e cila funksionon efektivisht me staf të plotë. Kjo zyrë drejtohet nga kryetari i saj i komanduar nga APSH. Detyrat e kësaj zyre, në

ushtrimin e kompetencave që i jep ligji, si dhe mënyra e kryerjes së tyre, përcaktohen në rregulloren e brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit.
Kjo zyrë, sipas Rregullores së Brendshme të Avokaturës së Shtetit miratuar me urdhrin nr. 275/1, datë 14.01.2009 të Ministrit të Drejtësisë ka kompetencë gjithashtu të hartojë raporte me shkrim lidhur me vlerësimin e punës së avokatëve të shtetit, të propozojnë Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit fillimin e procedimit disiplinor në rastet kur konstaton shkelje ligjore, të propozojnë Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit kritere teknike dhe juridike për unitetin e doktrinës. Pjesë e punës së kësaj zyre është edhe përmirësimi i praktikës administrative brenda institucionit apo organizimi i aktiviteteve trajnuese, si kurse, seminare, si dhe krijimi i bibliotekës së institucionit. Një prej detyrave të inspektimit është edhe komunikimi i urdhrave dhe udhëzimeve të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit drejtuar avokatëve të shtetit në të dy nivelet, duke bërë dhe interpretimin e tyre sipas frymës së ligjit.
Detyra primare e kësaj zyre është ushtrimi i inspektimeve të planifikuara nga kjo zyrë në bashkëpunim me Avokatin e Përgjithshëm si dhe i kontrolleve tematike për çështje të veçanta kur vërehen shkelje ligjore, gjatë punës.
Në zbatim të programit të auditimit u audituan me zgjedhje praktikat e inspektimit të kryera në zyrat vendore të avokaturës së shtetit, Durrës,Vlorë, Gjirokastër,Tiranë Korçë dhe Avokaturën e Shtetit

<u>Viti 2018</u>

Me shkresën Nr.562 prot, datë.30.03.2018 Kryetarja e Zyrës së Inspektimit, J Ç ka hartuar planin e punës së inspektimeve, periudhën, objektin e inspektimit, afatin kohor dhe avokatët të cilët do kryejnë këto inspektime sipas tabelës si më poshtë:

Plani paraprak i vitit 2018

Av. shtetit Ministria përkatëse	Periudha e parashikuar për inspektim	Lloji i inspektimit	Afati i kryerjes së inspektimit	Grupi i punës
E H	2014-2016	Inspektim i përgjithshëm	10.04.18-04.05.18	J. Ç L.R
D L E H	2014-2016	Inspektim i përgjithshëm	07.05.18-30.05.18	J. Ç L.R
S V	2014-2016	Inspektim i përgjithshëm	04.06.18-29.06.18	J. Ç L.R
E B	2014-2016	Inspektim i përgjithshëm	06.07.18-20.07.18	J. Ç L.R
H M A S	2014-2016	Inspektim i përgjithshëm	06.09.18-05.10.18	J. Ç L.R
D L	2014-2016	Inspektim i përgjithshëm	09.10.18-30.10.18	J. Ç L.R
E S	2014-2016	Inspektim i përgjithshëm	05.11.18-22.11.18	J. Ç L.R
I S	2014-2016	Inspektim i përgjithshëm	27.11.18-07.12.18	J. Ç L.R
A M	2014-2016	Inspektim i përgjithshëm	12.12.18-18.12.18	J. Ç L.R

Urdhrat për kryerjen e Inspektimeve janë parashikuar të hartohen mbas miratimit të planit nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, Brenda datës, 10.04.2018. ***Për vitin 2018 nuk ka plan inspektimesh të miratuar*** *nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.*
Në këtë kuadër, Zyra e Inspektimit ka qenë e angazhuar për ushtrimin e kontrolleve, sipas urdhrave të nxjerra rast pas rasti nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit. Gjatë vitit 2018 janë ushtruar inspektime për disa zyra vendore të Avokaturës së Shtetit, si dhe për avokatë të shtetit në nivel qendror si më poshtë vijojnë;
Inspektimet e kryera gjatë vitit 2018 (deri në datë. 27.11.2018) dhe konkluzionet sipas çdo rasti të inspektuar paraqiten në **Aneksin VII**, pjesë e këtij materiali auditimi.

1.Në dokumentet e vëna në dispozicion mbi inspektimet e kryera, në dosjen e Inspektimit tematik të kryer në Zyrën e APSH rezultoi si më poshtë vijon:
1.Shkresa me nr.11 prot, datë.25.01.2018 Urdhër i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit për Inspektim.
Objekti: ñ*Ushtrim inspektimi tematik lidhur me trajtimin e shkresës nr.2238 prot, datë.18.05.2016 të Prokurorisë pranë Rrethit Gjyqësor, Kavajë, protokolluar në APSH me nr.386 prot, datë.19.05.2016 dhe me datë.20.05.2016 i është dhënë për ndjekje Avokatit të Shtetit, K S* ò. Kryerja e Inspektimit tematik lidhur me trajtimin dhe hapat e ndjekura nga Av. K S do të kryhej nga Av. Shtetit Xh K .
Pikat e Inspektimit për ndjekje, të përcaktuar në urdhër ka qenë si më poshtë vijon:
1.a. Informimi paraprak i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, në lidhje me trajtimin e praktikës së mësipërme.
1.b. Raportimi në Zyrën e Inspektimit në lidhje me hapat konkret të ndjekura nga z. S
2. Avokati i Shtetit z. K S të përcjellë pranë Avokaturës së Përgjithshme brenda datës.26.01.2018 një relacion të detajuar për sa është kërkuar më sipër.
2.a.Në datën 30.01.2018 zhvillimi i seancës dëgjimore pranë Zyrës së Inspektimit.
2.b.Urdhër nr.11/1 prot, datë.31.01.2018 i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit me objekt ñNjë ndryshim në urdhrin nr.11 datë.25.01.2018 ñ*Ushtrim Inspektimi tematik lidhur me trajtimin e shkresës nr.2238 prot, datë.18.05.2016 të Prokurorisë pranë Rrethit Gjyqësor, Kavajë, sigluar për ndjekje Avokatit të Shtetit, K S* ò. Ndryshimi i urdhrit është kryer për shkak të konfliktit të interesit të Avokatit të Shtetit Xh K , pasi ka pasur në ndjekje praktika të njëjta me praktikën objekt Inspektimi. Për kryerjen e inspektimit janë ngarkuar Avokatët e Shtetit, J Ç dhe E H , poashtu duke e ndryshuar dhe afatin e dorëzimit të materialit përfundimtar, në dt.01.02.2018.
Me shkresën Nr.166 Prot më datë. 26.01.2018, Av. K S ka dorëzuar relacionin drejtuar Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, mbi trajtimin e praktikës dërguar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë.
Më datë. 30.01.2018 është mbajtur proces verbal i seancës dëgjimore me Av. K S , lidhur me inspektimin që kryhej ndaj tij.
Më datë. 31.01.2018 është dërguar Raport Inspektimi drejtuar Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit ku është paraqitur përmbledhja dhe konkluzionet, në të cilat janë paraqitur dhe evidentimi i gjetjeve. **Konstatimi kryesor i evidentuar nga Inspektimi lidhet me mos ndjekjen e praktikës nga avokati i shtetit e cila i është ngarkuar për trajtim** që konsiston në mos informimin në mënyrë shkresore të organit të Prefekturës Tiranë, për vazhdimin e procedurave ligjore, duke qenë organi kompetent i cili kundërshton në gjykatë, titujt e pronësisë të dhëna në kundërshtim me ligjin.
Me shkresën nr.11/2 Prot, datë.01.02.2018, Urdhër i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, marrje mase disiplinore ñShkarkim nga detyraò për avokatin e shtetit K S .
Grupi i auditimit vlerëson se : Shkeljet e konstatuara dhe të paraqitura në raportin e Inspektimit janë evidente dhe të mbështetura në fakte por urdhëri i Avokatit te Përgjithshëm të Shtetit A H për shkarkim nga detyra të av.K S nuk është kryer sipas procedurës së përcaktuar në Kodin e Punës, cila duhej ndjekur në raste të tilla. Lidhur me procedurën e shkarkimit nga detyra ish/avokati K S nga ngrituar padi në gjykatën e rrethit Gjyqësor tiranë e cila me **Vendim Nr.8329** datë. 15.10.2018 ka pranuar pjesërisht padinë dhe ka detyruar Avokaturën e Shtetit të paguajë dëmshpërblim pjesor në masën (gjësmën e detyrimit) në vlerë 1,746,375 lekë, bazuar në nenin.317 të Kodit të Procedurës Civile. Ndonëse grupi i auditimit vlerëson se shkeljet e ish/Avokatit K S mund ose kanë sjellë dhe pasoja në dëm të Shtetit Shqiptar, fakt i cili nuk është evidentuar deri në këtë

fazë, procedura e ndjekur nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit ka sjellë efekte negative në buxhetin e shtetit në shumën 1,746,375 lekë.
Praktika e mësipërme nuk përmban projekt-raport dhe observacione nga Avokati ndaj të cilit është ushtruar Inspektimi. Inspektimi është kryer në një afat tepër të shkurtër dhe ka dalë me konkluzione vetëm me shkelje disiplinore por jo lidhur me cështjen dhe pasojat të cilat mund ose kanë sjellë në dëm të interesave të shtetit Shqiptar.

2.Inspektimi i kryer në ZVASH Durrës.
Bazuar në dosjen e inspektimit dhe dokumentacionit bashkëlidhur procedura e ndjekur vijon si më poshtë:
Për kryerjen e Inspektimit ka dalë Urdhër nr.38 datë 19.05.2017 i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit ñPër ushtrim Inspektimi mbi aktivitetin e Avokatëve të Shtetit pranë ZVASH Durrësò për periudhën 2015-2016. Ky urdhër është ndryshuar me urdhrin nr.38/1 datë.07.06.2017 si dhe me urdhrin nr .94 datë.03.07.2018.
Për sa evidentohet në raport inspektim, ndryshimet janë kryer për shkak të largimit nga detyra të dy avokatëve, z.K S dhe z.M S , të cilët kanë pasur si detyrë kryerjen e këtij Inspektimi dhe për shkak se raporti i Inspektimit të mëparshëm është konsideruar jo në përputhje me tematikën e përcaktuar në urdhrin nr.38, datë.19.05.2017 duke e kthyer dhe një herë për riinspektim me arsyetimin se nuk janë përmbushur detyrat e përcaktuara në urdhrin fillestar, duke e shtyrë afatin e përfundimit të inspektimit deri në datën.19.10.2018.
Grupi i auditimit deri në këtë fazë, bazuar dhe në praktikat e vëna në dispozicion ka konstatuar mangësi si më poshtë vijon:
1.Mungon inventari i dosjes së inspektimit.
2.Mungon urdhri fillestar si dhe urdhrat me ndryshime.
3.Mungon projekt raporti.
4. Mungojnë Memo apo relacione drejtuar APSH për kërkesë shtyrje afatesh.
Në përfundim grupi i inspektimit nuk ka nxjerre konkluzione mbi të cilat mund të propozoheshin masa organizative apo disiplinore.

3. Inspektimi i kryer në ZVASH Vlorë.
Bazuar në dosjen e inspektimit dhe dokumentacionit bashkëlidhur procedura e ndjekur vijon si më poshtë:
Me Urdhër Nr.08, datë.09.02.2017 , APSH ka urdhëruar Inspektimin e ZVASH Vlorë me objekt: Kryerjen e Inspektimit pranë ZVASH Vlorë, në lidhje me përmbushjen e detyrave funksionale të avokatëve të shtetit pranë gjykatave përkatëse të shkallës së parë dhe apelit. Afati për kryerjen e inspektimit është parashikuar nga dt.13.02.2017 deri më datë.10.03.2017, duke përfshirë dhe dorëzimin e raport-inspektimit (objekt observacionesh).
Periudha objekt inspektimi do mbulonte çështjet e gjykuara apo në gjykim nga ***janar 2014 deri dhjetor 2016.***
Nga raport inspektimi përfundimtar të përgatitur më date.12.09.2018 nga avokatët e shtetit E H dhe L Re , drejtuar APSH, znj.A H ecuria e inspektimit ka vijuar si më poshtë:
-Me Urdhër nr.56 datë 28.03.2018: ñPër një ndryshim në urdhrin Nr.08, datë.09.02.2017, të ndryshuar me urdhrin Nr.08/1, datë.22.05.2017, ndryshuar me urdhër Nr.08/2, datë.11.10.2017, me urdhrin Nr.08/3, datë.27.10.2017 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, në ushtrim të kompetencës së parashikuar nga neni 6, germa (e) dhe neni 10, të ligjit NR. 10018, datë.13.08.2008 ñPër Avokaturën e Shtetitò si dhe bazuar në nenin 14 të Rregullores së Brendshme ñPër organizimin dhe funksionimin e Avokaturës së Shtetitò miratuar me urdhrin Nr.275/1 Prot, datë.14.01.2009 të Ministrisë së Drejtësisë, për shkak të largimit nga detyra të

Avokatëve të shtetit z.H M , z.Xh K dhe z.K S , të caktuar për Inspektimi pranë ZVASH Vlorë, është urdhëruar:
Kryerja përsëri e Inspektimit pranë ZVASH, Vlorë pasi nuk janë përmbushur detyrat e caktuara në urdhrin e Avokatit të Shtetit të cituara më sipër. Ndryshimin e pikës 4 të urdhrit 08, datë.09.05.2017, të ndryshuar me urdhrin Nr.08/1, datë.22.05.2017, ndryshuar me urdhër Nr.08/2, datë.11.10.2017, me urdhrin Nr.08/3, datë.27.10.2017 duke caktuar Avokatët e Shtetit z. E H dhe L R për kryerjen e inspektimit pranë ZVASH, Vlorë.
Me urdhrin NR.56/1, datë.16.05.2018 për shkak të numrit të madh të çështjeve që ka në ndjekje ZVASH, Vlorë dhe pamundësisë për tu inspektuar të gjitha dosjet në mënyrë të hollësishme brenda afatit të përcaktuar në urdhrin e mëparshëm, është urdhëruar: *Ndryshimin e pikës 3 të urdhrit Nr.08, datë.25.09.2017, duke e shtyrë afatin deri më datë.01.06.2018. Paraqitja e observacioneve ka pasur për afat datën.11.06.2018 nga Avokatët e Shtetit të ZVASH të cilët janë inspektuar.* Përgatitja e raportit përfundimtar drejtuar APSH, duhej të ishte deri në datën.19.06.2018. Sa më sipër grupi i auditimt ka konstatuar se :
1.Dosja është e pa inventarizuar.
2.Mungojne urdhrat e ndryshimeve.
3. Mungojnë Memo apo relacione drejtuar APSH, për shtyrje afatesh.
4.Urdhëri fillestar i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit nuk është i protokolluar.
Grupi i auditimit konstaton se z. K S nuk evidentohet në urdhrin fillestar të inspektimit. z. K S eshtë larguar nga detyra me shkresë nr.11/2 Prot, datë.01.02.2018, urdhër i APSH dhe z. Xh K me Urdhër nr.32 datë16.02.2018, periudhë e cila nuk justifikon shtyrjet e afateve dhe kryerjen e inspektimit siç është paraqitur më lart. Periudha objekt Inspektimi në urdhrin fillestar ka qenë Janar 2014- Dhjetor 2016 por që në raport inspektimi evidentohet vetëm viti 2015-2016. Në dosje, fizikisht nuk ka shkresë, urdhër për ndryshim programi, objekti apo periudhe të cilat duhet të jenë pjesë përbërëse e dosjes.

4.Inspektimi i kryer në ZVASH, Gjirokastër. 2018
Me Urdhër Nr.48, datë.07.06.2017 , APSH ka urdhëruar Inspektimin e ZVASH Gjirokastër me objekt: Kryerjen e Inspektimit të përgjithshëm pranë ZVASH Gjirokastër. Afati për kryerjen e inspektimit duke filluar nga dt.16.07.2017 dhe raport inspektimi (objekt observacionesh) duhet të dorëzohet deri më datë.28.07.2017;
Periudha objekt inspektimi do mbulonte çështjet e përfunduara, në proces gjykimi apo të filluara nga dt.01.01.2015 deri më dt.31.12.2016.
Përbërja e grupit të Inspektimit:
1.M S , Avokat Shteti
2.K S , Avokat Shteti
Me shkresë Nr.2393 Prot, datë.25.09.2017, Avokati i shtetit z. K S i është drejtuar Avokatit të përgjithshëm të Shtetit duke i paraqitur Inspektimin e kryer deri në fazë (observacionesh).
Me shkresë Nr.2393 Prot, datë.25.09.2017, Avokati i shtetit z. Xh K i është drejtuar Avokatit të përgjithshëm të Shtetit pas siglimit për trajtim nga ky i fundit lidhur me vlerësimin e Inspektimit pasi z.M S është shkarkuar nga detyra ende pa mbyllur raporti përfundimtar i inspektimit. Avokati z.Xh K më tej ka dhënë rekomandime dhe ka vlerësuar se raporti i inspektimit mund të arkivohet.
Me shkresë Nr.260 Prot, datë.09.02.2018 është dërguar raport inspektimi ZVASH-së, Gjirokastër për observime të mundshme duke mos përcaktuar afat.
Me shkresën Nr.260/1 datë.02.03.2018 ZVASH Gjirokastër drejtuar Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit ZVASH ka pranuar raport inspektimin pa kundërshtime.

Grupi i inspektimit ka vlerësuar se nuk ka propozime për masa disiplinore.
Sa më sipër grupi i auditimit ka konstatuar se:
1.Dosja është e pa inventarizuar.
2.Mungojne urdhrat e ndryshimeve.
3.Urdhëri fillestar i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit nuk është i protokolluar.
4. Mungojnë Memo apo relacione drejtuar APSH, për shtyrje afatesh.
5. Tejkalimi i afateve nuk është i mbështetur në bazë ligjore.
6. Nuk janë ndjekur në kronologji dhe rend numerik numrin e protokollit deri në mbyllje të praktikës.

Viti 2019
Zyra e Inspektimit, në Avokaturën e Shtetit, ka draftuar dhe miratuar me urdhrin nr. 80, datë 08.04.2019 të Avokatit të Përgjithshëm p/aktin ñPër miratimin e metodologjisë proceduriale dhe materiale të kontrollit të veprimtarisë së avokatëve të shtetit nga Zyra e Inspektimitò.
Ky akt është i detyrueshëm për tu zbatuar gjatë procesit të verifikimit, inspektimit nga ana e avokatëve të shtetit, pjesë e Zyrës së Inspektimit dhe nga të gjithë avokatët e shtetit të cilët mbi bazë të urdhrit të Avokatit të Përgjithshëm për kryerjen e inspektimit, verifikimit janë objekt i saj. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit ka miratuar planin vjetor për inspektim gjithsej 6 (gjashtë) inspektime, në zyrën qendrore të Avokaturës, zyrën e përfaqësimit në gjykatat e huaja ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar, Zyrat vendore Shkodër, Gjirokastër, si dhe për avokatët e shtetit pranë Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Drejtësisë për periudhat e viteve **2016-2018**. Në realizimin e inspektimeve evidentohet se janë kryer 14 (katërmbëdhjetë), 8 (tetë) mbi planin e miratuar. Deri në këtë fazë të auditimit nuk evidentohet urdhër për ndryshim në planin vjetor të inspektimeve.
Për vitin 2019, është realizuar 100% plani i inspektimit të aprovuar nga Avokati i Përgjithshëm, ku janë lënë masa administrative dhe rekomandime.
Konkretisht janë propozuar si shkelje disiplinore për Zyrën Vendore Shkodër në shtator 2019 dy ñVërejtje me shkrimò dhe një ñVërejtje me paralajmërimò. Dosja ndodhet për shqyrtim ne Komisionin Disiplinor në zbatim të nenit 32/1 të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 ñPër avokaturën e shtetitò, i ndryshuar.
Në zbatim të urdhrit nr. 302 datë. 07.10.2019 ñPër ushtrim inspektimi tematik të avokatëve të shtetit pranë ministrive lidhur me ushtrimin në afat të mjeteve të ankimit dhe rekursitò, janë propozuar 9 masa disiplinore. 7 ñVërejtje me shkrimò dhe 2 ñVërejtje me paralajmërimò.
Përjashtimisht, planit të inspektimit për vitin 2019, janë realizuar dhe inspektime tematike në zyrat vendore, Durrës, Vlorë dhe Shkodër. ñPër ushtrim inspektimi tematik lidhur me ndjekjen e disa çështjeve gjyqësore nga avokatët e shtetit lidhur me ushtrimin në afat të mjeteve të ankimit dhe rekursitò.

1.Inspektimi i kryer në *ZVASH*, Gjirokastër
Në zbatim të Urdhrit nr. **291** me Nr.4245 Prot, datë 19.09.2019, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit ñPër ushtrim inspektimi i përgjithshëm në ZVASH Gjirokastër për periudhën 01.01.2017-31.12.2018ò. Grupi i inspektimit i përbërë nga:

1. E Q , Avokat Shteti
2. D Sh , Avokat Shteti
3. D P , Avokat Shteti
4. Sh K , Avokat Shteti

Afati për dorëzimin e raportit të inspektimit është parashikuar dt. 21.10.2019 sipas nenit 13, pika 2, e Metodologjisë procedurale për Inspektimin.

-Me shkresë **Nr. 4871** Prot, datë.17.10.2019, grupi i inspektimit ka përgatitur MEMO dhe bashkëlidhur dhe projekt raport inspektimin drejtuar Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.
Avokati i Përgjithshëm i Shtetit me shkresë Nr.5331 Prot, datë.05.11.2019 ka dërguar projekt raportin përfundimtar të inspektimit ZVASH-së Gjirokastër.
Avokatët e shtetit pranë Zyrës së Inspektimit kanë kryer inspektim të përgjithshëm sipas drejtimeve të përcaktuar në këtë urdhër.
Në raportin përfundimtar nuk janë evidentuar shkelje mbi të cilat mund merren masa disiplinore. Grupi i auditimit vlerëson se: janë respektuar afatet për kryerjen e inspektimit. Mangësi ka në rendin kronologjik e numerik të numrave të protokollit.

2.Inspektimi i kryer në ZVASH, Vlorë
Në zbatim të Urdhrit nr. **78** me Nr.1212 Prot, datë. 04.04.2019, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit ñPër ushtrim inspektimi i tematik në ZVASH Vlorë lidhur me gjendjen që ndodhen çështjet gjyqësore të ngritura nga Avokatura e Shtetit sipas rekomandimeve të Task-Forcës dhe Prokurorisë në lidhje me pronat. Afati i inspektimit deri më datë.15.04.2019.
Grupi i inspektimit i përbërë nga:

1. Ergys Qirici, Avokat Shteti
2. D S , Avokat Shteti
3. D P , Avokat Shteti

-Me shkresë **Nr. 1328** Prot, datë.15.04.2019, grupi i inspektimit ka përgatitur dhe dërguar raport inspektimin Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.
Avokati i Përgjithshëm i Shtetit me shkresë Nr.1328/1 Prot, datë.15.04.2019 ka dërguar raportin përfundimtar të inspektimit ZVASH-së Vlorë për observime të mundshme brenda datës.20.04.2019.
Avokatët e shtetit pranë Zyrës së Inspektimit kanë kryer inspektim të përgjithshëm sipas drejtimeve të përcaktuar në këtë urdhër.
Në raportin përfundimtar nuk janë evidentuar shkelje mbi të cilat mund merren masa disiplinore. Grupi i auditimit vlerëson se: Janë respektuar afatet për kryerjen e inspektimit.
Mangësi ka në rendin kronologjik e numerik të numrave të protokollit të cilat nuk ndjekin në fraksion numrin e Urdhrit fillestar e deri në përfundimin e procedurës. Dosja nuk është e inventarizuar.

Viti 2020.
Avokati i Përgjithshëm i Shtetit me Urdhër nr.13 Prot, datë. 20.01.2020 ka miratuar planin vjetor për inspektim, gjithsej 6 (gjashtë) inspektime. Zyrat e parashikuara i përkasin zyrave vendore, Korçë, Shkodër, Tiranë, Durrës, si dhe avokatëve të shtetit pranë ministrive. Deri në këtë fazë janë realizuar 5 (pesë) inspektime dhe 1 (një) është në proces. Ndryshimet e programit për vitin 2020 janë të miratuara me shkresën nr.3433 Prot, datë. 03.09.2020 nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit. Për vitin 2020 u audituan me zgjedhje dy praktika inspektimi të kryera në ZVASH Tiranë dhe Korçë.

1.Inspektimi i kryer në ZVASH, Tiranë.
Në zbatim të Urdhrit nr. **69** me Nr.1598 Prot, datë 04.05.2020, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit ñPër ushtrim inspektimi i përgjithshëm në ZVASH Tiranë për periudhën 01.01.2018-01.04.2020ò. Grupi i inspektimit i përbërë nga:

1. E G , Avokat Shteti
2. D Sh , Avokat Shteti
3. D P i, Avokat Shteti
4. Sh K , Avokat Shteti

Afati për dorëzimin e projekt raportit të inspektimit është parashikuar dt. 29.05.2020 sipas nenit 13, pika 2, e Metodologjisë proceduriale për Inspektimin.
-Me shkresë **Nr. 1598/1** Prot, datë.27.05.2020, Urdhër nr.69/1 i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit është shtyrë afati i dorëzimit të projekt raportit (objekt observacionesh) deri në datë.15.06.2020.
-Ka pasur dhe një shtyrje tjetër në afatin e dorëzimit të projekt raportit deri më dt.30.06.2020, që rezulton i miratuar me shkresë nr.**1598/2** Prot, dt.16.06.2020, Urdhër nr.69/2 i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.
Grupi i inspektimit ka përgatitur MEMO me nr. 2493 Prot, dt.30.06.2020 drejtuar Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit mbi dërgimin e projekt raport inspektimit për ZVASH-Tiranë.
Avokatët e shtetit pranë Zyrës së Inspektimit kanë kryer inspektim të përgjithshëm sipas drejtimeve të përcaktuar në këtë urdhër.

Në këtë fazë janë nxjerrë konstatimet përkatëse lidhur me çështjet objekt kontrolli dhe janë pasqyruar në këtë projekt raport bashkë me gjetjet.
Me shkresën Nr.2495/1 Prot, datë.03.09.2020 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, është dërguar projekt raport inspektimi (objekt observacionesh) në ZVASH-Tiranë.
- Mbi bazën e rezultateve të kontrollit fillimisht është hartuar projekt raport inspektimi, një kopje e të cilit iu njoftua avokatëve të shtetit të Zyrës Vendore Tiranë, nëpërmjet shkresës me nr. 2495/1 prot, datë 03.09.2020, duke iu njohur të drejtën e observacioneve brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes dijeni për të.
Ndërkohë kanë paraqitur observacionet përkatëse avokati i shtetit V Q nëpërmjet shkresës me nr. 358/4 prot, datë 09.09.2020 dhe avokati i shtetit E Gj me shkresën nr. 358/5 datë 09.09.2020.
Me shkresën nr.2495/4 dt.22.09.2020 MEMO drejtuar Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, grupi i inspektimit ka përgatitur dhe dërguar raportin e Inspektimit të kryer në ZVASH-Tiranë.
Me shkresën Nr.1598/4 Prot, dt.13.10.2020 APSH, ka dërguar bashkëlidhur kësaj shkresë dhe raportin e inspektimit të kryer në ZVASH Tiranë. Për sa më sipër nga verifikimi i dokumentacionit, *në aspektin formal dhe procedurial është zbatuar metodologjia e miratuar për Inspektimin e veprimtarisë në Avokaturën e Shtetit.* ***Në dosjen e inspektimit ndodhet i gjithë dokumentacioni mbi të cilin është kryer ky inspektim por nuk është inventarizuar praktika.***

Në zbatim të nenit 6, të ñMetodologjisë procedurale dhe materiale të kontrollit të veprimtarisë së avokatëve të shtetit nga zyra e inspektimitò, të miratuar me Urdhrin nr. 80, datë 08.04.2019, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, **grupi i inspektimit ka lënë rekomandime dhe ka propozuar masat disiplinore respektive si më poshtë vijon:**
Konkretisht grupi i inspektimit ka propozuar marrjen e masës disiplinore ndaj avokates së shtetit V Q , të parashikuar nga neni 31/3/b, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 ñ*Për Avokaturën e Shtetit*ò, të ndryshuar, ñ*Vërejtje me paralajmërim"*, për shkak të mos ushtrimit të mjeteve ligjore të ankimit për çështjet gjyqësore me palë ndërgjyqëse.
Grupi i inspektimit ka propozuar marrjen e masës disiplinore dhe ndaj avokatit të shtetit E Gj , të parashikuar nga neni 31/3/a, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 ñ*Për Avokaturën e Shtetit*ò, të ndryshuar, ñ*Vërejtje me shkrim"*, ***për shkak të mos përfaqësimit ligjor të 6 çështjeve gjyqësore dhe mos ushtrimit të një mjeti ankimi.***

2.Inspektimi i kryer në ZVASH, Korçë.

ë zbatim të Urdhrit nr. **19** me Nr.523 Prot, datë. 29.01.2020, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit ñPër ushtrim inspektimi i përgjithshëm në ZVASH Korçë për periudhën 01.01.2017-31.12.2018ò. Grupi i inspektimit i përbërë nga:

1. E G , Avokat Shteti
2. D Sh , Avokat Shteti
3. D P , Avokat Shteti
4. Sh K , Avokat Shteti

Në urdhrin e mësipërm, afati për dorëzimin e projekt raportit të inspektimit (objekt observacionesh) është parashikuar të përfundojë në dt. 03.03.2020.

-Me datë.20.02.2020, grupi i inspektimit ka përgatitur MEMO duke i paraqitur projekt raport Inspektimin (objekt observacionesh), Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.

Me shkresë Nr.1169 Prot, datë.24.02.2020, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit i ka dërguar ZVASH, Korçë projekt raportin e inspektimit (objekt observacionesh) për tu shprehur me komente ose shpjegimet përkatëse brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e projekt raportit.

Më datë.09.03.2020 mbas shqyrtimit të observacioneve dërguar nga ZVSHA- Korçë, grupi i inspektimit ka hartuar MEMO për Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit mbi dërgimin e raportit përfundimtar për miratim.

-Me shkresën Nr.523/2 Prot, datë.08.09.2020 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit është dërguar raporti përfundimtar i inspektimit, ZVASH-së Korçë.

Në zbatim të nenit 6, të ñMetodologjisë procedurale dhe materiale të kontrollit të veprimtarisë së avokatëve të shtetit nga zyra e inspektimitò, të miratuar me Urdhrin nr. 80, datë 08.04.2019, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.

Për vitin 2018, Grupi i auditimit duke u bazuar mbi këto të dhëna ka konstatuar se:

Zgjatja e afateve për kryerjen e kësaj procedure inspektimi nga data 07.06.2017 deri më. datë 03.07.2018 është i pajustifikuar çka ka sjellë dhe mos mbulimin e periudhave në kohë të cilat për pasojë kanë rritur riskun e mbulimit për periudha më të afërta. Raportet e Inspektimeve të kryera në vitin 2018 janë të mbartura nga viti 2017. Për sa kohë nuk ka pasur një akt rregullator të brendshëm apo metodologji të miratuar, afatet për kryerjen e inspektimit duhej të bazoheshin në Ligjin. Nr. 44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisëò Neni 91, Afati për përfundimin e procedurës administrative ku është e përcaktuar se:

1. Procedura administrative, e nisur me kërkesë, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, përfundon sa më shpejt të jetë e mundur dhe brenda afatit të përcaktuar nga ligji i posaçëm.
2. *Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë.*
3. Nëse ligji parashikon detyrimin e palës për të paraqitur dokumente ose prova, si pjesë ose së bashku me kërkesën për fillimin e procedurës, afatet e përcaktuara sipas pikave 1 ose 2, të këtij neni, fillojnë nga paraqitja e plotë e tyre.
4. Në rastin e gjendjes së jashtëzakonshme, procedura administrative përfundon brenda 3 muajve nga dita e përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme.
5. *Mosrespektimi i afateve kohore, të parashikuara në këtë nen, duhet të justifikohet nga organi përgjegjës para organit epror ose nga nëpunësi përgjegjës përpara eprorit të tij, brenda 10 ditëve nga përfundimi i afatit ose nga përfundimi i gjendjes së jashtëzakonshme.*

Neni 92, **Zgjatja e afatit të procedurës**
1. Përveç kur ndalohet shprehimisht nga ligji, në raste të justifikuara, për shkak të kompleksitetit të çështjes, organi publik mund të zgjasë vetëm një herë afatin e përcaktuar sipas nenit 91 të këtij Kodi.
2. Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.
3. Zgjatja e afatit dhe data e përfundimit të afatit të zgjatur i njoftohen palës brenda afatit fillestar. Njoftimi duhet të përmbajë edhe arsyetimin për zgjatjen e afatit.

Sa më sipër konstatohet se, praktikat e mësipërme të Inspektimit për vitin 2018 janë kryesisht tematike dhe të fokusuara mbi veprimtarinë e avokatëve të shtetit individualisht dhe jo mbi veprimtarinë e zyrave në tërësi.
-Në një rast praktika nuk përmban projekt-raport dhe observacione nga Avokati ndaj të cilit është ushtruar Inspektimi.
-Inspektimet për vitin 2018 janë kryer në një afat tepër të shkurtër dhe kanë dalë me konkluzione vetëm me shkelje disiplinore. Nuk ka informacion lidhur me çështjen dhe pasojat të cilat mund ose kanë sjellë në dëm të interesave të shtetit Shqiptar, veprimet apo mos verpimet e avokatëve të shtetit.
-Nga verifikimi i dokumentacionit, në aspektin procedurial grupi i inspektimit ka kryer dhe përgatitur në afat angazhimin, sipas metodologjisë së miratuar për Inspektimin e veprimtarisë në Avokaturën e Shtetit.

Për vitet 2018-2020, dosjet e Inspektimeve janë të pa inventarizuara, ato janë vetëm me emërtimin e dokumentit ligjor, por nuk është bërë numërimi i fletëve dhe numër total i tyre, veprim që bie në kundërshtim me:
1.Ligjin nr. 9154 datë. 06.11.2003 ñPër Arkivatò, Normat Tekniko-Ligjore dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor, neni 30 ñInventari i brendshëm i dosjesò ku është e përcaktuar se : Dosjet me rëndësi historike kombëtare regjistrohen për çdo vit në inventar (Mod. 7) veçmas nga ato me afat ruajtjeje të përkohshme. Në inventar dosjet renditen sipas sektorëve në përputhje me radhën që kanë në strukturën organizative të subjektit shtetëror apo joshtetëror, brenda çdo sektori sipas drejtimeve kryesore të tij dhe brenda këtij të fundit sipas rëndësisë së çështjes. *Dosjet në inventar marrin numër një pas një për gjithë vitin. Inventari përfshin këto elementë: numrin rendor, numrin e dosjes, titullin e dosjes (së bashku me shënimin kur ka të tillë), datat ekstreme, sasinë e fletëve, afatin e ruajtjes, numrin e kutisë, afatin e shfrytëzimit, shënime*. Në rastet kur pas përpunimit tekniko-shkencor dhe bërjes së inventarit të dokumenteve të një viti, evidencohen dokumente të tjera të pasistemuara, atëherë atyre u bëhet përpunimi tekniko-shkencor dhe ato trajtohen si ñshtesaò. *Dosjet ku vendosen këto dokumente marrin numër progresiv, duke vazhduar numrin e fundit të dosjes në inventarin e vitit përkatës. Në rast se në dosje ndodhen dokumente të një rëndësie të veçantë, atëherë bëhet inventari i brendshëm i dosjes (Mod. 8).*
Dosjet e inspektimit dhe dokumentacioni mbi të cilin janë kryer inspektimet kanë mangësi në, ndjekjen me fraksion sipas urdhrit fillestar të regjistruar në protokoll në kundërshtim me: **Nenin 19, pika 1** të ñNorma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisëôô ku përcaktohet se: *Të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo joshtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen*:
1. Në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1). Në të regjistrohen të gjitha dokumentet që krijohen apo që vijnë në organin shtetëror e joshtetëror, me përjashtim të atyre të përmendura

në nenin 6. *Dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre marrin në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1) një numër rendor të veçantë.* ***Dokumenti i parë që krijohet nga vetë organi apo që vjen në adresë të tij, merr numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës.*** *Nuk lejohet evidencimi në një numër i dy ose më shumë praktikave të përafërta që janë të pavarura ndërmjet tyre sipas objektit.*

Observacion mbi Projektraportin e Auditimit i paraqitur nga Avokatura e Shtetit me shkresën nr. 4425/15 prot, datë 30.09.2021, regjistruar në KLSH me nr. 1114/6, datë 06.10.2021.

Pretendimi i Subjektit*:*
Siç kemi kundërshtuar edhe mbi akt-konstatimin nr. 3 për vitin 2018 ekziston Plani i Inspektimit, fakt që konfirmohet dhe nga shkresa nr. 562 prot., datë 30.03.2018 e protokolluar në librin e protokollit të Avokaturës së Shtetit. (ASH). (kopje e fletëve ju është vënë në dispozicion). Kopja origjinale ndodhet në Arkivën e ASH.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:
Observimet e paraqitura janë thuajse identike me ato të paraqitura në fazën e mëparshme të auditimit për të cilat Grupi i Auditimit ka paraqitur sqarimet përkatëse (trajtuar më poshtë). Në mungesë të shpjegimeve apo të dhënave shtesë *observacioni juaj nuk merret në konsideratë.*

Me shkresën nr.4425/13 datë 26.01.2021 me objekt ñKomente dhe shpjegime mbi Akt Konstatimin Nr.3 të mbajtur nga grupi i auditimit të KLSH ñ*Mbi veprimtarinë e Zyrës së Inspektimit*ò në kuadër të auditimit të ushtruar në ASH në bazë të programit të auditimit nr.1114/1 datë 06.11.2020 i ndryshuar, i miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, i mbajtur më datë 18.01.2021, Avokatura e Shtetit ngre pretendimet si më poshtë vijon:

Pretendimi subjektit të audituar:
-Lidhur me gjetjen e Grupit të Auditimit, se: ñ*Për vitin 2018 nuk ka plan inspektimesh të miratuar nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit (APSH)",* (faqe 2, e Aktit).
Konstatojmë se, ky koment nuk qëndron, pasi për vitin 2018, ekziston Plani i Inspektimit, fakt që konfirmohet dhe nga shkresa nr. 562 prot., datë 30.03.2018 e protokolluar në librin e protokollit të Avokaturës së Shtetit. (ASH). Kopja origjinale ndodhet në Arkivën e ASH.
Sikundër rezulton dhe nga inspektimet e kryera për vitin 2018 të gjitha inspektimet e miratuara në Plan Inspektimin e vitit 2018, janë të realizuara po këtë vit, përveç inspektimeve të tjera, të cilat kanë dalë në rastet e urgjencës.
Kopje nga libri i protokollit të Avokaturës së Shtetit, ku pasqyrohet Plani i Punës- Zyra e Inspektimit, datë 30.03.2018 (2 (dy) fletë).
Sikundër është specifikuar dhe në Urdhrin nr. 11, datë 25.01.2018 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, ñP*ër ushtrim inspektimi tematik në lidhje me trajtimin e shkresës nr. 2238 prot, datë 18.05.2016 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë",* sigluar për ndjekje Avokatit të Shtetit Kadri Skera, ndër të tjera në pikën 3 dhe 4, të tij theksohet se:
"3. Avokati shtetit z. K S të përcjellë pranë Avokaturës së Përgjithshme, Brenda datës 26.01.2018 një relacion të detajuar për sa është kërkuar më sipër.
4. Në datën 30.01.2018 ora 14.00 do zhvillohet seanca dëgjimore pranë Zyrës së Inspektimit.".

Ashtu, siç referohet edhe në Akt konstatim, Avokati i Shtetit K S , me shkresën nr.166 prot., datë 26.01.2018, ka dorëzuar relacion në lidhje me çështjen, për të cilën është inspektuar, duke qenë dhe observacione, dhe po ashtu është zhvilluar seanca dëgjimore me Avokatin e Shtetit, i cili u pyet nga avokatët e shtetit të ngarkuar për inspektim mbi çështjen objekt inspektimi.
Sa më sipër, nga avokatët e Shtetit që kanë kryer inspektimin, janë zbatuar parashikimet e Urdhrit nr. 11, datë 25.0.01.2018, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.
Lidhur me gjetjen e Grupit të Auditimit, se**:** ñ*Në lidhje me Inspektimin e kryer nga ZVASH Durrës, ndër të tjera është konstatuar se, mungon urdhri fillestar, urdhrat me ndryshime, si dhe mungon projekt raporti., etj*.ò.
Në vijim të kësaj gjetjeje, bashkëlidhur Urdhrat, dhe dokumentet e tjera të referuara (gjithsej 35 fletë):
Urdhri nr.38, datë 19.05.2017 i APSH ñPër ushtrim inspektimi të punës së ZVASH Durrësò - 2 (dy) fletë;
Urdhri nr.38/1, datë 07.06.2017 i APSH, ñPër një ndryshim në urdhrin nr.38, datë 19.05.2017 ñPër ushtrim inspektimi të punës së ZVASH Durrësò. ï 1 (një) fletë;
Memo, datë 27.12.2017, të Z. Xh K , Avokat Shteti pranë Zyrës së Inspektimit, ku në përfundim APSH, ka kërkuar të bëhet ri inspektimi i ZVASH Durrës - 3 (tri) fletë;
Urdhri nr. 94, datë 03.07.2018, i APSH, ñPër një ndryshim në Urdhrin nr. 38, datë 19.05.2017ò, të ndryshuar me Urdhrin nr. 38/1, datë 07.06.2017, ñPër ushtrim inspektimi të punës së ZVASH Durrësò - 1 (një) fletë;
Shkresa nr. 2647/1 prot, datë 29.10.2018, e APSH, dërgim raporti inspektimi, ku theksohet se: ñ*Nëse keni kundërshtime, mund të paraqisni observacionet tuaja, brenda 5 ditësh nga marrja dijeni e këtij raport inspektimit*.ò - 27 (njëzetë e shtatë) fletë.
Gjithashtu, sqarojmë se, në datë 07.11.2018, është nxjerrë dhe raporti përfundimtar nga Avokatët e Shtetit, të cilët kanë bërë Inspektimin për ZVASH Durrës.
Lidhur me gjetjen e Grupit të Auditimit, se**:** *"Në lidhje me Inspektimin e kryer nga ZVASH Vlorë, ndër të tjera është konstatuar se, mungojnë urdhrat e ndryshimeve, urdhri fillesatar i APSH, nuk është i protokolluar, etj."*
vijim të kësaj gjetjeje, bashkëlidhur Urdhrat, dhe dokumentet e tjera të referuara (gjithsej 11 fletë):
Urdhri nr. 08, datë 09.02.2017, i APSH, ñPër ushtrim inspektimi të punës së ZVASH Vlorëò - 2 (dy) fletë;Urdhri nr. 08/1, datë 22.05.2017, i APSH, ñPër një shtesë në urdhrin nr. 08, datë 09.02.2017 të APSH, lidhur me ushtrimin e inspektimit të ZVASH Vlorëò- 2 (dy) fletë;
Urdhri nr. 08/2, datë 11.10.2017, i APSH, ñPër ushtrim inspektimi të punës së ZVASH Vlorëò- (2 (dy) fletë;
Urdhri nr. 08/3, datë 27.10.2017, i APSH, ñPër një shtesë në urdhrin nr.08/2, datë 11.10.2017 të APSH, ñPër ushtrim inspektimi të punës së ZVASH Vlorëò - 1 (një) fletëò;
Memo, datë 26.03.2018, e Kryetares se Zyrës së Inspektimit në ASH, ku është rekomanduar ri inspektimi i ZVASH Vlorë, për shkaqet e paraqitura në Memo - 1 (një) fletë;
Urdhër nr. 56 datë 28.03.2018, i APSH, ñPër një ndryshim në Urdhrin nr. 08, datë 09.02.2017, ndryshuar me Urdhrin, nr. 08/1, datë 22.05.2017, ndryshuar me Urdhrin nr. 08/2, datë 11.10.2017, ndryshuar me Urdhrin nr. 08/3, datë 27.10.2017, ñPër ushtrim inspektimi të punës së ZVASH Vlorëò - 2 (dy) fletë;
Urdhër nr. 56/1 datë 16.05.2018, i APSH, ñPër një ndryshim në Urdhrin nr. 08, datë 09.02.2017, ndryshuar me Urdhrin, nr.08/1, datë 22.05.2017, ndryshuar me Urdhrin nr.08/2, datë 11.10.2017, ndryshuar me Urdhrin nr.08/3, datë 27.10.2017, ndryshuar me Urdhrin nr. 56, ñPër ushtrim inspektimi të punës së ZVASH Vlorëò - 1 (një) fletë.

4.1 Lidhur me gjetjen e Grupit të Auditimit, se: ñ*Në lidhje me Inspektimin e kryer nga ZVASH Vlorë, ndër të tjera është konstatuar se, periudha objekt inspektimi në urdhrin fillestar ka qënë janar 2014- dhjetor 2016, por që në raport inspektimi evidentohet vetem vitit 2015-2016*ò (x). Konstatimi nga Grupi i Auditimit, se periudha e inspektimit ka qenë nga Janar 2014 deri në Dhjetor 2016, nuk qëndron pasi periudha e inspektimit ka qenë dy vjeçare Janar 2015 deri në Dhjetor 2016. Detyra e ngarkuar është kryer me korrektësi, në respektim të urdhrit të Avokatit të Përgjithshëm

Lidhur me gjetjen e Grupit të Auditimit, se: ñ*Në lidhje me Inspektimin e kryer nga ZVASH Gjirokastër, ndër të tjera është konstatuar se, mungojnë urdhrat e ndryshimeve, urdhri fillesatar i APSH, nuk është i protokolluar, etj.*ò.

-Në vijim të kësaj gjetjeje, bashkëlidhur do të gjeni:

Urdhrin nr. 48, datë 07.06.2017, të APSH, ñPër ushtrim inspektimi të punës së ZVASH Gjirokastërò - 2 (dy) fletë.

Sqarojmë se, lidhur me ekzistencën e ndryshimeve të urdhrave të kërkuara nga ana juaj, bazuar si në Projekt raportin paraprak, ashtu edhe në Raport inspektimin përfundimtar, nuk rezulton të jetë shprehur dalja e një urdhri të ri nga APSH, që të ketë ndryshuar Urdhrin fillestar nr. 48/2017, të APSH.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa i përket pretendimit të subjektit të sipërpërmendur, theksojmë së, gjetja e grupit të auditimit është referuar: Ligjit Nr.10018, datë 13.11.2008 Për Avokaturën e Shtetit, (ndryshuar me ligjin Nr. 86/2018), Rregullores së Brendshme të Avokaturës së Shtetit miratuar me urdhrin nr. 275/1, datë 14.01.2009 të ndryshuar, Ligjit Nr. 44/2015 *"Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë* dhe Metodologjisë Proceduriale dhe Materiale të Kontrollit të Veprimtarisë së Avokatëve të Shtetit nga Zyra e Inspektimit. Ligjin nr. 9154 datë. 06.11.2003 ñPër Arkivatò, Normat Tekniko-Ligjore dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor, neni 30 ñInventari i brendshëm i dosjesò.

Titulli i Gjetjes 1	**Mangësi në kryerjen e Inspektimeve dhe inventarizimin e praktikave.**
Situata:	Për periudhën nën auditim , grupi i auditimit konstatoi se: ***Për vitin 2018 nuk ka plan inspektimesh të miratuar nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit (APSH)***. Praktikat e mësipërme të Inspektimit për vitin 2018 janë kryesisht tematike dhe të fokusuara mbi veprimtarinë e avokatëve të shtetit individualisht dhe jo mbi veprimtarinë e zyrave në tërësi. Inspektimet e evaduar në 2018 kryesisht janë të vitit 2017 të mbartura pasi nuk janë evaduar dhe si të tilla janë mbartur për vitin pasardhës. Inspektimet për vitin 2018 janë kryer në një afat tepër të shkurtër dhe kanë dalë me konkluzione vetëm me shkelje disiplinore. Nuk ka informacion lidhur me cështjen dhe pasojat të cilat mund ose kanë sjellë në dëm të interesave të shtetit Shqiptar, nga veprimet apo mos verpimet e avokatëve të shtetit. **Për vitet 2018-2020**, dosjet e Inspektimeve janë të pa Inventarizuara, ato përmbajnë vetëm emërtimin e dokumentit ligjor, por nuk është bërë numërimi i fletëve dhe numër total i tyre.

Kriteri:	Veprime në kundërshtim me : Ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008 Për Avokaturën e Shtetit (ndryshuar me ligjin Nr. 86/2018), sipas Rregullores së Brendshme të Avokaturës së Shtetit miratuar me urdhrin nr. 275/1, datë 14.01.2009 të ndryshuar, Ligjit Nr. **44/2015** "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisëò, Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 ñPër arkivatò, si dhe ñNorma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisëò, neni 30 si dhe Metodologjisë Proceduriale dhe Materiale të Kontrollit të Veprimtarisë Së Avokatëve të Shtetit nga Zyra e Inspektimit.
Ndikimi/Efekti	Mos respektimi i kuadrit ligjor, lidhur me afatet e përcaktuara për kryerjen dhe evadimin në kohë të Inspektimeve, mos kryerja e Inspektimeve në kohë duke mos mbuluar për një periudhë të gjatë kohe me inspektim ZVASH-të ka rritur riskun në mos përmbushjen e detyrave funksionale nga avokatët e shtetit, pasoja të cilat janë në dëm të interesave të Shtetit Shqipëtar. Mos inventarizimi i dokumentave shtetëror sjell pasiguri si dhe mungesë transparence ne lidhje me mënyrën e procedimit sipas ligjit, rreth procedurave te ndryshme te ndjekura për plotësimin e nevojave të institucionit.
Rëndësia	E Lartë

(Për këtë drejtim auditimi është hartuar Akt-Konstatimi nr. 3 regjistruar në Avokaturën e Shtetit me nr. 4425/8 prot, datë 18.01.2021 mbajtur me përfaqësuesit e institucionit, Avokatin e Përgjithshëm E M).

Drejtimi 7: "Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit"

Në zbatim të programit të auditimit, konkretisht, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë.
- Procesverbale të mbledhjeve të Këshillit periudha 2019/02-2020/12;
- Procesverbale të mbledhjeve të Kolegjit periudha 2019/02-2020/12;

<u>Këshilli Konsultativ për çështjet e GJEDNJ</u>
Baza ligjore mbi të cilën mbështetet ngritja dhe funksionimi i tij:
-Ligji 10018 datë 13.11.2018 ñPër Avokaturën e Shtetitò, i ndryshuar, neni 19/7 dhe 19/8;
-Ligji nr.8480 datë 27.05.1999, òPër funksionimin e organeve kolegjialeò;
-Urdhri i Kryeministrit nr. 34 datë 04.02.2019, ndryshuar me urdhrin nr.51 datë 04.03.2019
-Rregullore e Brendshme e Avokaturës së Shtetit, miratuar me Urdhrin nr. 68 datë 28.03.2019, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, neni 29 i saj.
-Të tjera akte ligjore, nënligjore e rregullative:

Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve në ligjin organik nr. 10018 datë 13.11.2018 të ASH sipas ligjit nr. 86/2018 të publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 177 të vitit 2018, pranë Avokaturës së Shtetit është përcaktuar edhe ngritja dhe funksionimi i një kolegji të posaçëm për orientimin dhe konsultimin e ASH mbi masat parandaluese të cilat mund të shkaktojnë dëm financiar për shtetin si rezultat i shkeljes së KEDNJ, si dhe realizimin e ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së në mënyrë të plotë nga institucionet e ngarkuara për kryerjen e tyre. Këshilli Konsultativ përbëhet nga 5 anëtarë të cilët emërohen nga Kryeministri, me propozim të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.
Me Urdhrin e Kryeministrit nr. 34 datë 04.02.2019 ñPër Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Konsultativ për Çështje e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriutò janë miratuar

anëtarët e këtij këshilli, dhe më tej përbërja është ndryshuar me Urdhrin nr. 51 datë 04.03.2019.
Në vijim Titullari i ASH me Urdhrin nr.33 datë 08.02.2019 ka miratuar Sekretariatin Teknik të Këshillit i përbërë dhe ky nga nga 5 anëtarë punonjës të institucionit.
Pas largimeve të njëpasnjëshme të disa prej anëtarëve të emëruar të këtij Kolegji në detyra të tjera, të cilat mund të kenë konflikt me detyrën në këtë këshill, në fund të vitit 2020 ky organ nuk plotëson kuorumin e nevojshëm për veprimtarinë e tij, çka paraqet nevojën për kryerjen e propozimeve përkatëse nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit pas kryerjes së një procesi përzgjedhës transparent, për të plotësuar vakumin e krijuar në këtë organ relativisht të ri.

Mbledhjet e Këshillit janë kryer si vijon:
1.Mbledhje datë 07.02.2019 Diskutimi i çështjes, N , M P , kundër Shqipërisë. (pjesëmarrës 4 anëtarë)
2.Mbledhje datë 14.02.2019 Diskutimi i çështjes, Ni , M P , kundër Shqipërisë, tjetër. (pjesëmarrës 3 anëtarë)
3.Mbledhje datë 28.03.2019 Diskutimi i çështjes, Gj , T , H B , N , kundër Shqipërisë. (pjesëmarrës 5 anëtarë)
4.Mbledhje datë 30.05.2019 Diskutimi i çështjes, P , Sh dhe të tjerë, Gj , kundër Shqipërisë. (pjesëmarrës 5 anëtarë)
5.Mbledhja datë 19.06.2019 Diskutimi i çështjes, ñKomentet e Respublikaò, (pjesëmarrës 4 anëtarë)
6.Mbledhja datë 27.06.2019 Diskutimi i çështjes ñRespublika në çështjen N ò, X dhe të tjerë, K , N , kundër Shqipërisë. (pjesëmarrës 2 anëtar anëtarë)
7.Mbledhja datë 25.07.2019 Diskutimi i çështjes, Xh , L dhe të tjerë, M , M.P , kundër Shqipërisë dhe të tjera. (pjesëmarrës 3 anëtarë)
8.Mbledhja datë 09.10.2019 Diskutimi i çështjes, Rista dhe të tjerë pjesë e çështjes Dh N , , Sh dhe të tjerë, Xh , kundër Shqipërisë. (pjesëmarrës 4 anëtarë)
9.Mbledhja datë 26.12.2019 Diskutimi i çështjes, Th , S , Pr , T , kundër Shqipërisë. (pjesëmarrës 3 anëtarë)
10.Mbledhja datë 29.05.2020 Diskutimi i çështjes, B , kundër Shqipërisë. (pjesëmarrës 3 anëtarë)
11.Mbledhja datë 17.07.2020 Diskutimi i çështjes, Th , S , kundër Shqipërisë. (pjesëmarrës 3 anëtarë)
12.Mbledhja datë 16.10.2020 Diskutimi i çështjes, Gj B , kundër Shqipërisë. (pjesëmarrës 2 anëtarë)

Lidhur me veprimtarinë e Këshillin Konsultativ konstatohet se:
-Procesverbalet e mbledhjeve nuk rezultojnë të firmosura nga pjesëmarrësit por vetëm nga juristja e sekretariatit teknik dhe Titullari i institucionit dhe në mbledhjen e datës 19.06.2019 vetëm prej juristes. Mungesa e konfirmimeve bie në kundërshtim me ñNormën tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisëò, neni 13, ku përcaktohet se:

Dokumentet e brendshme, si: *vendimet, urdhërat, udhëzimet,* ***materialet e mbledhjeve të forumeve të subjektit shtetëror e joshtetëror****, studimet, planet e programet e punës, raportet,* ***relacionet, informacionet****, bilancet etj,* ***kanë të gjithë elementët e dokumenteve që dalin****, me përjashtim të adresës së korrespondentit e të formulës "në përgjigje" ose "në vijim të shkresës".*

Dokumentet e brendshme, kur i dërgohen një organi tjetër, shoqërohen me shkresë përcjellëse. ***Dokumentet e brendshme i paraqiten titullarit*** *për firmë apo njohje* ***vetëm pasi janë protokolluar.***

-Duke qenë se, anëtarët e Këshillit janë dhe përfitues të shpërblimeve referuar pikës nr.10 të Urdhrit nr. 34 datë 04.02.2019, i ndryshuar, por dhe rëndësisë së çështjeve të trajtuara dhe orientimeve të dhëna për ASH, nënshkrimi i pjesëmarrjes në mbledhje duhet të ishte kryer.
-Rezultoi se, për muajt Prill, Gusht, Shtator, Nëntor 2019 nuk janë zhvilluar mbledhje nga Këshilli në kundërshtim me pikën nr. 5 të Urdhrit ku përcaktohet qartë thirrja dhe mbledhja e tij të paktën një herë në muaj. Për vitin 2020 evidentohen vetëm 3 mbledhje nga 12 të tilla minimalisht të detyrueshme. Pavarësisht kufizimeve prej pandemisë Covid-19, ASH duhet të kishte gjetur mundësi alternative për këto mbledhje, për të konsultuar veprimet që do ndërmerren mbi çështjet gjyqësore të përfunduara por dhe atyre në proces.
-Rezultoi se, në mbledhjet e datës 27.06.2019 dhe 16.10.2020 nuk rezulton të jetë formuar kuorumi i nevojshëm për vijimin e mbledhjes në kundërshtim me Ligjin nr.8480 datë 27.05.1999, òPër funksionimin e organeve kolegjialeò, neni 11 ñKuorumiò.

*1. Mbledhja e organit kolegjial, eshte e vlefshme kur jane te pranishem m**e shume se gjysma e anetareve te tij**.*
2. Kur ne hapjen e mbledhjes nuk jane te pranishem shumica e anetareve, kryetari vendos thirrjen e mbledhjes ne nje dite tjeter, te pakten 24 ore pas se pares. Ne kete rast mbledhja eshte e vlefshme ne qofte se jane te pranishem se paku gjysma e anetareve me te drejte vote.

Observacion mbi Projektraportin e Auditimit i paraqitur nga Avokatura e Shtetit me shkresën nr. 4425/15 prot, datë 30.09.2021, regjistruar në KLSH me nr. 1114/6, datë 06.10.2021.

Pretendimi i Subjektit*:*
I qëndrojmë komenteve dhe shpjegimeve të dhëna mbi akt-konstatimin nr. 5 dhe parashtrojmë sa vijon:
-Anëtarët e Këshillit në kuadër të ushtrimit të detyrave të tyre, kanë marrë vendime nëpërmjet të cilave kanë orjentuar zgjidhjen e çështjeve konkrete sa i përket trajtimit të çështjeve në GJEDNJ apo marrjen e msave për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ. Vendimet janë të firmosura nga anëtarët e këshillit, që kanë marrë pjesë në mbledhjet respektive....

Neni 16 paragrafi i dytë i ligjit 8480/1999 parashikon se, "Procesverbali mbahet nga sekretari dhe duhet tu paraqitet për miratim të gjithë anëtarëve në fund të mbledhjes ose në fillim të ,bledhjes pasardhëse. Pas miratimit procesverbali nënshkruhet së bashku nga kryetari dhe sekretari". Ky parashikim siguron miratimin e procesverbalit nga anëtarët prezent në mbledhje që mund të jetë nëpërmjet e-mailit, leximit, etj, ndërkohë parashikon shprehimisht nënshkrimin nga kryetari dhe sekretari dhe jo detyrimin për nënshkrimin nga të gjithë anëtarët.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:
Sa i përket vendimeve observimet e paraqitura janë thuajse identike me ato të paraqitura në fazën e mëparshme të auditimit për të cilat Grupi i Auditimit ka paraqitur sqarimet përkatëse (trajtuar më poshtë).
Lidhur me mungesën e firmave në procesverbal nga të gjithë anëtarët ne i mbetemi qëndrimit për firmosjen e tyre për të evidentuar me korrektësi dhe transparencë, mbi datën dhe vendin e

mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe forma dhe rezultati i votimeve, të kërkuara këto dhe nga legjislacioni përkatës ligji nr. 8480/1999, neni 16 pika 2 e vijues të tij. Procesv. datë 19.06.2019 rezultonte i firmosur vetëm nga Znj. L .
Në materialet e mbledhjeve nuk disponohej asnjë informacion i cili të vërtetonte pranimin dhe miratimin e përmbajtjes së procesverbalit. Nënshkrimi gjykohet i nevojshëm dhe për pagesat që mund të bëhen drejt ekspertëve të ftuar apo atyre të pavarur, pasi ato bazohen në mbledhjet e kryera për këtë arsye nga ana jonë vlerësohet e nevojshme ekzistenca e gjurmës së auditimit. Nëse do ti referohemi mbledhjeve të organit tjetër Kolegjit pranë Avokaturës së Shtetit, përkatësisht procesverbal, datë 21.02.2019 dhe 23.07.2020, pavarësisht firmosjes nga sekretariati dhe Titullari këto procesverbale janë konfirmuar edhe nga personat e tjerë pjesëmarrës. Pra vihet re një standard i dyfishtë i aplikuar në këtë drejtim.
Në mungesë të shpjegimeve apo argumenteve *observacioni juaj nuk merret në konsideratë.*

Observacion mbi Akt konstatimet nr. 5, date 18.01.2021, prot në KLSH me nr. 1114/4, datë 27.01.2021.
Pretendimi i Subjektit*:*
-Anëtarët e Këshillit në kuadër të ushtrimit të detyrave të tyre, kanë marrë vendime nëpërmjet të cilave kanë orjentuar zgjidhjen e çështjeve konkrete sa i përket trajtimit të çështjeve në GJEDNJ apo marrjen e msave për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ. Vendimet janë të firmosura nga anëtarët e këshillit, që kanë marrë pjesë në mbledhjet respektive.
Viti 2020 ka qenë një vit i vështirë përsa i takon organizimit të mbledhjeve për shkak të masave të marra për mbrojtjen nga Covid-19. Gjatë vitit 2020 kanë dhënë dorheqjen nga Këshilli për shkak se janë emëruar në detyrë të cilat sipas vlerësimit të tyre funksioi i ri është i papajtueshëm me qënien e tyre anëtarë të Këshillit. ..Kjo ka sjell si rezultat që Këshilli të mbetet me një anëtar. Të gjitha arsyet e mësipërme kanë sjell mosmbledhjen e këshillit të paktën nje herë në muaj.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:
Lidhur me sa trajtohet për fimosjen e vendimeve sqarojmë se, nga ana jonë janë evidentuar mangësitë në procesverbalet e mbledhjeve dhe jo në firmosjen e vendimeve. Sa i përket mosmbledhjes të paktën një herë në muaj gjatë vitit 2020 të Këshillit, ndikimi i pandemisë është evident ndërsa për vitin 2019 nuk është i justifikuar. Sa i përket largimit të anëtarëve të Këshillit, këto largime kanë cënuar vendimmarrjen në fund të vitit 2020 dhe institucioni duhet të marrë masat për zëvendësimin e tyre, pasi çështjet që ky organ trajton kanë rëndësi të posaçme në vijimin e mbrojtjes por dhe ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ.
Observacioni merret në konsideratë pjesërisht.

Kolegji pranë Avokaturës së Shtetit
Baza ligjore mbi të cilën mbështetet ngritja dhe funksionimi i tij:
-Ligji 10018 datë 13.11.2018 ñPër Avokaturën e Shtetitò, i ndryshuar, neni 10/1 i tij;
-Ligji nr.8480 datë 27.05.1999, òPër funksionimin e organeve kolegjialeò;
-Ligji nr.44/2015, ñKodi i Procedurave administrative në Republikën e Shqipërisëò;
-Rregullore e Brendshme e Avokaturës së Shtetit, miratuar me Urdhrin nr. 68 datë 28.03.2019, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, neni 20 i saj.
-Rregullore e Kolegjit, miratuar me Urdhrin nr. 68 datë 28.03.2019, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.

Detyrat e këtij organi kanë të bëjnë me këshillimin për çështje të një rëndësie të veçantë për interesat e shtetit dhe miraton strategji të mbrojtjes për këto raste; dhënien e udhëzimeve të përgjithshme për bashkërendimin dhe trajtimin e çështjeve, në kuadër të dhënies së asistencës juridike; zgjidh papajtueshmëritë e opinioneve që lindin në trajtimin e çështjeve gjyqësore në proces dhe këshillimeve, ndërmjet avokatëve që ushtrojnë funksione drejtuese dhe atyre të ngarkuar me ndjekjen e çështjeve etj.
Sipas pikës 5 të nenit 10/1 të ligjit, Vendimet e Kolegjit të Avokaturës së Shtetit miratohen me shumicën e anëtarëve dhe janë detyruese për avokatët e shtetit.
Me Urdhrin e Titullarit nr. 38 datë 18.02.2019 ñPër ngritjen dhe përbërien e Kolegjit pranë Avokaturës së Shtetitò është miratuar përbëria e këtij këshilli, me 7 (1+6) anëtar, nën drejtimin e Avokatit të Përgjithshëm. Kolegji asistohet nga sekretariati teknik i cili përbëhet nga 2 anëtar të ASH. Përbëria e Kolegjit është ndryshuar në vijim me Urdhrin e Titullarit nr. 117 datë 21.07.20120.
Mbledhjet e Këshillit janë:
1.Mbledhje datë 21.02.2019 Rendi i ditës, Deklarimi i nisjes së punës të Kolegjit.
2.Mbledhje datë 08.03.2019 Rendi i ditës, Për rregulloren e organizimit të Kolegjit.
3.Mbledhje datë 28.03.2019 Rendi i ditës, Për miratimin e rregullores së organizimit të Kolegjit si dhe diskutimi mbi materialet e ZVASH Gjirokastër.
4.Mbledhje datë 17.05.2019 Rendi i ditës, Mbi materialet dhe problematikat e ngritura nga avokatët e shtetit.
5.Mbledhje datë 21.05.2019 Rendi i ditës, Mbi çështjet gjyqësore për pronat ku palë ndërgjyqëse është ATP.
6.Mbledhje datë 04.09.2019 Rendi i ditës, Kërkesë për mendim këshillimor në lidhje me çështjen V E e lënë detyrë nga KLSH.
7.Mbledhje datë 13.09.2019 Rendi i ditës, Diskutim mbi relacionin e sjellë nga A.B në lidhje me disa kërkesë padi në proces gjykimi me palë MASR dhe pjesëmarrjen e avoaktëve të shtetit në këto procese.
8.Mbledhje datë 17.09.2019 Rendi i ditës, Diskutohet në lidhje gjyqësore me paditës S.L dhe të paditur MFE.
9.Mbledhje datë 23.07.2020 Rendi i ditës, Për unifikimin e praktikës dhe qëndrimin që Avokatura e Shtetit ka mbi ligjin 2/2020 ñPër përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në republikën e Shqipërisëò, sa i takon veprimtarisë së ASH. Mbi tarifat e shërbimeve që jepen nga ASHK. Diskutim mbi ndjekjen e çështjeve në Gjykatën e Lartë.

Lidhur me Kolegjin e Avokaturës së Shtetit konstatohet se:
-Urdhri nr. 38 datë 18.02.2019, ñPër ngritjen dhe përbërien e Kolegjit pranë Avokaturës së Shtetitò rezulton pa numër protokolli në kundërshtim me *Normën tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë,* neni 13 i saj.
-Procesverbalet e mbledhjeve të datës 28.03.2019, 17.05.2019, 21.05.2019, 17.09.2019, nuk rezultojnë të firmosura nga pjesëmarrësit por vetëm nga anëtarët e sekretariatit teknik. Mungesa e konfirmimeve bie në kundërshtim me Ligjin nr.8480 datë 27.05.1999, òPër funksionimin e organeve kolegjialeò, neni 16 i tij.
-Në procesverbal nuk rezultojnë të pasqyruara votimi pro ose kundër i anëtarëve dhe çka cënon besueshmërinë e vendimmarrjeve.
-Rezultoi se, për muajt Prill, Qershor, Korrik, Tetor-Dhjetor 2019 nuk janë zhvilluar mbledhje nga ky kolegj megjithëse në pikën 3 të nenit 20 në Rregulloren e Brendshme të ASH përcaktohet zhvillimi periodik i mbledhjeve një herë në muaj apo dhe më shpesh. Ndërkohë që për vitin 2020 evidentohet vetëm 1 mbledhje nga 12 të tilla minimalisht. Edhe në këtë rast

njëlloj si në rastin e Këshillit Konsultativ, duke vlerësuar dhe kufizimet prej pandemisë Covid-19, ASH krahas pjesëmarrjes fizike mund të kishte vlerësuar edhe mundësi alternative për zhvillimin e mbledhje nëpërmjet platformave elektronike, për të mos ndalur veprimtarinë dhe arritjen e qëllimit të vendosur nga ligjvënësi për këtë strukturë në veprimtarinë e ASH.
-Kolegji ka miratuar Rregulloren e tij të Funksionimit në mbledhjen e datës 28.03.2019, ndërkohë që ligji organik nr. 10018 datë 13.11.2018 ñPër Avokaturën e Shtetitò, i ndryshuar, ne nenin nr. 10/1 pika 6 e tij përcakton se,

6. Kriteret, procedura e përzgjedhjes së anëtarëve të Kolegjit të Avokaturës së Shtetit, si dhe rregulla të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e tij ***përcaktohen në rregulloren e brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit****."*

Ndërkohë, në Rregulloren e Brendshme në nenin 20 pika 8 e saj përcaktohet se, rregullat më të detajuara të përcaktohen në rregulloren e brendshme të funksionimit të Kolegjit, pra duke i dhënë hapësirë krijimit të një rregullore të veçantë, ndryshe nga sa përcaktohet nga ligjvënësi. Në vlerësimin e audituesit të jashtëm, të pavarur, pa lënë mënjanë mangësitë e sipërcituara, hartimi i rregullave të brendshëm përbën *aspekt pozitiv* mbi veprimtarinë, por këto rregulla duhej të jenë pjesë integrale e rregullores bazë. Në ligjin organik referuar nenit 4 pika 2 të tij, përcaktohet qartë se, Kolegji i Avokaturës është pjesë e përbërjes organizative të ASH dhe organizimi e funksionimi i tij referuar nenit 10/1 pika 6 i tij, është pjesë e rregullores së brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:
Funksionimi i dy organeve kolegjiale përgjatë periudhës 2019/02-2020/12 paraqitet me mangësi, në përmbushjen e qëllimit të parashikuar nga ligjvënësi por edhe për disa aspekte procedurale të dokumentimit të veprimtarisë së kryer.

Observacion mbi Akt konstatimet nr. 5, date 18.01.2021, prot në KLSH me nr. 1114/4, datë 27.01.2021.
Pretendimi i Subjektit*:*
-Urdhri nr. 38 datë 18.02.2019 Për ngritjen dhe përbërien e Kolegjit pranë Avokaturës së Shtetit, është i arkivuar me numër dhe datë, si dhe është vendosur në website-n e Avokaturës së Shtetit, si dhe u është komunikuar të gjithë anëtarëve të Kolegjit.
-Procesverbalet e mbledhjeve janë të nënshkruara nga sekretariati teknik dhe nga Avokati i Përgjithshëm i shtetit, gjithashtu nga ana e anëtarve nuk ka patur kundërshtime dhe është votuar në unanimitet, duke mos patur mendime pakice.
-Për muajt Prill, Qershor, Korrik, Tetor,-Dhjetor 2019 nuk janë zhvilluar mbledhje nga ky Kolegj pasi nuk ka patur probleme për shqyrtim apo indicie nga avokatët e shtetit. ..Viti 2020 ka qenë një vit i vështirë përsa i takon organimit të mbledhjeve për shkak të masave Covid-19. Kolegji i Avokaturës së Shtetit nuk mund të funksiononte në mënyrë alternative të zhvillimit të mbledhjeve.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:
Lidhur me sa pretendohet sqarojmë se, Urdhri nr. 38 datë 18.02.2019 rezulton i plotësuar vetëm me numrin e urdhrit dhe datën e tij ndërkohë që mungonte numri i protokollit dhe data e regjistrimit. Mosfirmosja e procesverbaleve të mbledhjeve evidentohet në disa prej mbledhjeve të cituara në material. Sa i përket mosmbledhjes të paktën një herë në muaj të

Këshillit, është evident ndikimi i pandemisë për vitin 2020 ndërsa për vitin 2019 pretendimi juaj nuk gjendet i justifikuar.
Observacioni merret në konsideratë pjesërisht.

Titulli i Gjetjes: 1	**Rregullorja e Kolegjit duhet të ishte pjesë e Rregullores së Brendshme të institucionit.**
Situata:	Kolegji i Avokaturës së Shtetit ka miratuar Rregulloren e tij të Funksionimit në mbledhjen e datës 28.03.2019, ndërkohë që ligji organik nr. 10018 datë 13.11.2018 ñPër Avokaturën e Shtetitò, i ndryshuar, ne nenin nr. 10/1 pika 6 e tij ku përcaktohet se, *Kriteret, procedura e përzgjedhjes së anëtarëve të Kolegjit të Avokaturës së Shtetit, si dhe rregulla të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e tij* ***përcaktohen në rregulloren e brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit****."* Në Rregulloren e Brendshme të institucionit miratuar me Urdhrin nr. 68 datë 28.03.2019 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, neni 20 pika 8 e saj përcakton se, rregullat e detajuara të kësaj njësie përcaktohen në rregulloren e brendshme të funksionimit të Kolegjit, pra duke i dhënë hapësirë krijimit të një rregullore të veçantë, ndryshe nga sa përcaktohet nga ligjvënësi. Në vlerësimin e audituesit të jashtëm, të pavarur, pa lënë mënjanë mangësitë e sipërcituara, hartimi i rregullave të brendshëm përbën *aspekt pozitiv* mbi veprimtarinë, por këto rregulla duhej të jenë pjesë integrale e rregullores bazë. Në ligjin organik referuar nenit 4 pika 2 të tij, përcaktohet qartë se, Kolegji i Avokaturës është pjesë e përbërjes organizative të ASH dhe organizimi e funksionimi i tij referuar nenit 10/1 pika 6 i tij, është pjesë e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Avokaturës së Shtetit.
Kriteri:	Kodi i Procedurës Civile, neni 79/a i saj. -Ligjit 10018/2008 ñPër Avokaturën e Shtetitò, i ndryhsuar, neni 10/1 pika 6. -Rregullore e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Avokaturës së Shtetit miratuar me Urdhrin nr. 68 datë 28.03.2019 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, nenit 20 pika 8.
Ndikimi/Efekti	Hartimi i disa rregulloreve ndërkohë që ligji parashikon ndryshe, nuk i shërben transparencës dhe mirëfunksionimit të institucionit.
Rëndësia	E Mesme

Titulli i Gjetjes: 2	**Evidentohen mangësi në veprimtarinë e dy organeve kolegjiale pranë Avokaturës së Shtetit.**
Situata:	Veprimtaria e dy organeve kolegjiale të cilët funksionojnë pranë Avokaturës së Shtetit, Këshillit Konsultativ për çështjet e GJEDNJ, si dhe Kolegjit të avokatëve të shtetit, të cilët kanë një rol të rëndësishëm në veprimtarinë e saj rezultoi se: - Këshilli Konsultativ për Çështje e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut është krijuart pas ndryshimeve në ligjin organik të ASH nr. 10018 datë 13.11.2018 publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 177/2018. Ky organ ka si objekt orientimin dhe konsultimin e ASH mbi masat parandaluese të cilat mund të shkaktojnë dëm financiar për shtetin si rezultat i shkeljes së KEDNJ. Këshilli Konsultativ përbëhet nga 5 anëtarë të cilët emërohen nga Kryeministri, me propozim të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit. Me Urdhrat e Kryeministrit nr. 34 datë 04.02.2019, dhe atë 51 datë 04.03.20119 janë miratuar propozimet e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit. Në veprimtarinë e tij Këshilli gjatë vitit 2019 ka kryer gjthsej 12 mbledhje nga 22 të detyrueshme referuar pikës 5 të Urdhrit nr. 34 cituar më sipër ku përcaktohet qartë thirrja dhe mbledhja e këtij organi të paktën një herë në muaj.

	Ndërkohë në mbledhjet e datës 27.06.2019 dhe 16.10.2020 nuk rezulton të jetë formuar kuorumi i nevojshëm për vijimin e mbledhjes në kundërshtim me Ligjin nr.8480 datë 27.05.1999, òPër funksionimin e organeve kolegjialeò, neni 11 ñKuorumiò. Procesverbalet e mbledhjeve nuk rezultojnë të firmosura nga anëtarër pjesëmarrësi por vetëm nga juristja e sekretariatit teknik dhe Titullari i ASH. Mungesa e konfirmimeve bie në kundërshtim me Ligjin nr.8480 datë 27.05.1999, òPër funksionimin e organeve kolegjialeò, neni 16 i tij. Pas largimeve të njëpasnjëshme të disa prej anëtarëve të emëruar të Kolegjit në detyra të tjera, të cilat mund të kenë konflikt me detyrën në këshill rezultoi se, në fund të vitit 2020 nuk plotësohet kuorumi i nevojshëm për vijueshmërinë e veprimtarisë në të, çka paraqet nevojën imediate për kryerjen e propozimeve përkatëse nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit nëpërmjet një procesi përzgjedhës transparent, për të plotësuar vakumin e krijuar në këtë organ relativisht të ri. - Kolegji i Avokaturës së Shtetit_është miratuar me Urdhrin e Titullarit nr. 38 datë 18.02.2019 ñPër ngritjen dhe përbërien e Kolegjit pranë Avokaturës së Shtetitò, me 7 (1+6) anëtar, nën drejtimin e Avokatit të Përgjithshëm. -Urdhri nr. 38 datë 18.02.2019, ñPër ngritjen dhe përbërien e Kolegjit pranë Avokaturës së Shtetitò rezulton pa numër protokolli në kundërshtim me *Normën tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë,* neni 13 i saj. -Procesverbalet e mbledhjeve të datës 28.03.2019, 17.05.2019, 21.05.2019, 17.09.2019, nuk rezultojnë të firmosura nga pjesëmarrësit por vetëm nga anëtarët e sekretariatit teknik. Mungesa e konfirmimeve bie në kundërshtim me Ligjin nr.8480 datë 27.05.1999, òPër funksionimin e organeve kolegjialeò, neni 16 i tij. Në procesverbal nuk rezultojnë të pasqyruara votimi pro ose kundër i anëtarëve dhe çka cënon besueshmërinë e vendimmarrjeve. Për muajt Prill, Qershor, Korrik, Tetor-Dhjetor 2019 nuk janë zhvilluar mbledhje nga ky kolegj megjithëse në pikën 3 të nenit 20 në Rregulloren e Brendshme të ASH përcaktohet zhvillimi periodik i mbledhjeve një herë në muaj apo dhe më shpesh. Ndërkohë që për vitin 2020 evidentohet vetëm 1 mbledhje nga 12 të tilla minimalisht. Mangësitë e mësipërme janë në mospëputhje me përcaktimet ligjore që rregullojnë veprimtarinë kolegjiale, kriteret e përcaktuara mbi veprimtarinë e tyre administrative, etj.
Kriteri:	-Ligji 10018 datë 13.11.2018 ñPër Avokaturën e Shtetitò, i ndryshuar, neni 19/8; -Ligji nr.8480 datë 27.05.1999, òPër funksionimin e organeve kolegjialeò, neni 11 dhe 16 i tij; -Urdhri i Kryeministrit nr. 34 datë 04.02.2019, ndryshuar me urdhrin nr.51 datë 04.03.2019. -Rregullore e Brendshme e Avokaturës së Shtetit, miratuar me Urdhrin nr. 68 datë 28.03.2019, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, neni 20 i saj.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e dokumentimit tw mbledhjeve, zhvillimi mbledhjeve pa kuorumin e nevojshëm, mospërmbushja e detyrimit për numrin e mbledhjeve cënon veprimtarinë dhe vendimmarrjen e këtyre organeve të rëndësishme.
Rëndësia	E Lartë

(Për këtë drejtim auditimi është hartuar Akt-Konstatimi nr. 5 regjistruar në Avokaturën e Shtetit me nr. 4425/10 prot, datë 18.01.2021 mbajtur me përfaqësuesit e institucionit, Avokatin e Përgjithshëm E M).

IV- GJETJET DHE REKOMANDIMET

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si ***më poshtë***:

B. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultuan disa përcaktime jo të qarta në dispozitat e akteve ligjore që rregullojnë procesin e përfaqësimit ligjor të Avokaturës së Shtetit në Gjykatat Kombëtare dhe konkretisht:

a. Në dispozitat e Ligjit nr. 10018 datë 13.11.2018, ñPër Avokaturën e Shtetitò, i ndryshuar, neni pika 2, nenit 5 pika 1/b, dhe 1/1 të tij, përcaktohet detyrimi i ASH për përfaqësim në gjykatat vendase, mënyra e përfaqësimit si dhe pjesëmarrja e saj në procesin gjyqësor. Kjo duke vendosur theksin mbi bashkëpunimin e avokatëve të shtetit dhe personave juridikë si palë e interesuar në çështjet gjyqësore dhe bashkëpjesëmarrjen në këto gjykime. Ligji në këtë rast nuk ka vendosur kufizime sa i përket pjesëmarrjes së avokatësve të shtetit në gjykim. Ndërkohë në VKM nr. 392 datë 08.04.2009, Për miratimin e rregullores ñPër marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të Shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme proceduraleò, i ndryshuar, në nenin 24 pika 1 dhe 2 të tij, krijon paqartësi mbi ndjekjen e procesve gjyqësore prej avokatëve të shtetit, pasi në të përcaktohet marrja e një kërkese të motivuar nga organet përkatëse për të kryer përfaqësimin. Nga auditimi mbi proceset gjyqësore mbi njohjen e vendimeve të gjykatave të huaja pranë Gjykatave të Apelit, është evidentuar se nga ana e institucioneve përgjegjëse kanë munguar kërkesat për përfaqësim dhe rrjedhimisht ASH nuk ka qenë pjesëmarrëse në to megjithëse janë dispozitat e ligjit që prevalojnë në këtë rast. Nëse do ti referohemi Kodit të Procedurës Civile, në nenin 79/a të tij përcaktohet qartë se ñ*Avokatura e Shtetit ushtron përfaqësimin në rastet e parashikuara me ligj. Gjykata, që shqyrton çështje për të cilat me ligj përfaqësimi dhe mbrojtja kryhet nga Avokatura e Shtetit, urdhëron njoftimin e akteve kësaj të fundit, me qëllim që ajo të ketë mundësi të marrë pjesë në gjykim*ò.Sa më sipër evidentohet nevoja për rishikim të dispozitave ligjore mbi përfaqësimin me qëllim, eliminimin e paqartësive dhe garantimin e një mbrojtje konsistente dhe cilësisht profesionale.

b. Ndryshe nga sa më sipër, lidhur me rastet e mbrojtjes së interesave pasurore të shtetit në gjykimin penal VKM nr. 392 nuk ka krijuar kufizime dhe ASH në mënyrë direkte ka të drejtë të ngrej padi civile për kërkimin e pasurisë ose shpërblimin e dëmit, që u është shkaktuar interesave të shtetit nga kryerja e veprës penale dhe kur vlera e dëmit është më pak se 2 milion lekë mund ta delegoj këtë të drejtë drejt institucionit respektiv. Në nenin 32 pika dh) të kësaj VKM-je vlera e dëmit material për ushtrimin e të drejtës së delegimit referuar kritereve lëndore dhe sasiore ai paraqitet **1 milion lekë**, ndërsa sipas nenit 14 pika 3 e ligjit nr. 10018/2008, i ndryshuar ajo paraqitetë **2 milion lekë**. E njëjta vlerë përcaktohet edhe në pikën 3 të nenit 39 të Rregullores së Brendshme të ASH-së. Pra midis akteve ligjore e rregullative evidentohen ndryshime, çka paraqet nevojën për unifikimin e aktit nënligjor me dispozitat e ligjit. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 2, faqet 25-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Avokatura e Shtetit të kërkojë Këshillit të Ministrave amendimin e nenit 24 dhe 32 të VKM nr. 392 datë 08.04.2009, Për Miratimin e rregullores *"Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të Shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale"*, i ndryshuar, me qëllim eliminimin e

paqartësive mbi tagrat ligjore të përfaqësimit të avokatëve të shtetit në gjykim, garantimin e një mbrojtje konsistente dhe cilësisht profesionale në përmbushje të frymës së ligjit dhe mbrojtjes së interesit publik.

Menjëherë

2- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, Kolegji i Avokaturës së Shtetit ka miratuar Rregulloren e tij të Funksionimit në mbledhjen e datës 28.03.2019, ndërkohë që ligji organik të ASH nr. 10018 datë 13.11.2018 ñPër Avokaturën e Shtetitò, i ndryshuar, ne nenin nr. 10/1 pika 6 e tij përcakton se, *Kriteret, procedura e përzgjedhjes së anëtarëve të Kolegjit të Avokaturës së Shtetit, si dhe rregulla të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e tij* ***përcaktohen në rregulloren e brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit****."*
Në Rregulloren e Brendshme të institucionit miratuar me Urdhrin nr. 68 datë 28.03.2019 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, neni 20 pika 8 e saj përcakton se, rregullat e detajuara të kësaj njësie përcaktohen në rregulloren e brendshme të funksionimit të Kolegjit, pra duke i dhënë hapësirë krijimit të një rregullore të veçantë, ndryshe nga sa përcaktohet nga ligjvënësi. Në vlerësimin e audituesit të jashtëm, të pavarur, pa lënë mënjanë mangësitë e sipërcituara, hartimi i rregullave të brendshëm përbën *aspekt pozitiv* mbi veprimtarinë, por këto rregulla duhej të jenë pjesë integrale e rregullores bazë. Në ligjin organik referuar nenit 4 pika 2 të tij, përcaktohet qartë se, Kolegji i Avokaturës është pjesë e përbërjes organizative të ASH dhe rregullat e organizimit dhe funksionimit të tij referuar nenit 10/1 pika 6 i tij, duhet të jenë pjesë e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Avokaturës së Shtetit. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 7, faqe, 128-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Avokatura e Shtetit, në përputhje me nenin 10/1 pika 6, të ligjit nr. 10018 datë 13.11.2018 ñPër Avokaturën e Shtetitò, i ndryshuar, të marri masat e nevojshme për të kryer ndryshimet në ñRregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Avokaturës së Shtetitò, miratuar me Urdhrin nr. 68 datë 28.03.2019 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, duke përfshirë brenda saj në një seksion të veçantë rregulloren e Kolegjit, në zbatim të parashikimit ligjor.

Brenda datës 31.12.2021

C. MASA ORGANIZATIVE

1- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, për periudhën objekt auditimi Avokatura e Shtetit, ka funksionuar në bazë të strukturës dhe organikës së miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe konkretisht: Në vitin 2018, me urdhrin nr. 150, datë 10.11.2015, ñPër miratimin e strukturës dhe të organikës së Avokaturës së Shtetitò, të KM numri i punonjësve është përcaktuar 108, por fakti në mesatare vjetore, rezulton 80 punonjës, me një numër pozicionesh vakant prej 28 punonjës. Në vitin 2019, me urdhrin nr. 58, datë 25.03.2019 ñPër miratimin e strukturës dhe të organikës së Avokaturës së Shtetitò, të KM numri i punonjësve është përcaktuar 108 dhe numri i evndeve vakantë është 11 punonjës. Në vitin 2020, struktura ka pësuar ndryshime me urdhrin nr. 171, datë 24.12.2019 ñPër disa ndryshime në Urdhrin nr. 58, datë 25.03.2019, ñPër miratimin e strukturës dhe të organikës së Avokaturës së Shtetitò, ku numri i punonjësve është përcaktuar 107 dhe vakanca në mesatare vjetore është 8 punonjës, çka tregon për mungesë mbulimi të aktiviteteve apo dhe mbingarkesë të punës në punonjësit aktual. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 3, faqe, 70-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Avokatura e Shtetit, të marri masat e nevojshme për plotësimin e vendeve vakantë në strukturën organizative, me qëllim përmbushjen me efikasitet të objektivave të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve rezultoi se:
a. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga ASH, lidhur me masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna, sipas **Vendimin nr. 95 datë 30.07.2018** të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, akt-verifikimit të mbajtur ñ*Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna",* në vijim të autorizimit të KLSH nr. 450 datë 26.06.2019 që kanë rezultuar me status, *pa zbatuar* ose *në proces zbatimi*, ecuria e zbatimit të mëtejshëm të tyre paraqitet si më poshtë vijon:
-Rekomandime për Masa organizative janë lënë **2** rekomandime, janë pranuar 2, *në proces zbatimi 1* dhe *i pa zbatuar 1*.
-Rekomandime për Masa për Zhdëmtim janë lënë **2** rekomandime për shumën 31,500 lekë dhe 385 euro nga të cilat, janë pranuar 2, është *në proces zbatimi 1* dhe është *pa zbatuar 1.*
-Rekomandime të ardhura të munguara në dëm të buxhetit të shtetit janë lënë 2 rekomandime të cilat janë pranuar dhe janë *pa zbatuar 2*.
-Masa disiplinore është lënë **1** rekomandim i pranuar dhe *i pa zbatuar*.

b. Po kështu, nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ASH, lidhur me masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna, në Auditimin Tematik ñMbi përputhshmërinëò miratuar me **Vendimin nr.144 datë 14.12.2019** të Kryetarit të KLSH-së ecuria paraqitet si më poshtë vijon:
Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **3** rekomandime për Masa Organizative, të cilat janë pranuar nga të cilat, **1** rekomandim është në *proces zbatimi* dhe **2** janë me status *pa zbatuar.*
Avokatura e Shtetit, duhet të raportonte me shkrim pranë KLSH mbi ecurinë e zbatimit të masave të rekomanduara brenda një afati prej 6-muajsh nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit. Nga ana e Institucionit nuk rezulton të jetë përmbushur detyrim ligjor. Sa më sipër konstatohet se, institucioni nuk ka arritur të përmbush në kohë rekomandimet e lëna, pavarësisht veprimeve të ndërmarra, çka evidenton nevojën për vëmendje të shtuar në vijim nga ana e menaxhimit të lartë. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 1, faqe, 14-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Avokatura e Shtetit, të analizojë rezultatet e auditimit mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna dhe të nxjerrë përgjegjësitë individuale për moszbatimin e në kohë të tyre si dhe mosraportimin e ecurisë pranë KLSH-së brenda afateve të përcaktuara. Të merren masat e nevojshme administrative e ligjore për zbatimin e plotë të rekomandimeve të mbetura të pazbatuara dhe atyre në proces zbatimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

3- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, Avokatura e Shtetit, gjatë periudhës 01.01.2018-31.12.2020 referuar relacionit të përcjellë prej saj me e-mailin e datës 18.01.2021(data e përfundimit të auditimit në terren), evidenton ndjekjen nga ana e saj të **32** çështje civile në procese penale, por më herët me e-mailin e datës 08.01.2021 Institucioni kishte referuar një listë me vetëm 22 çështje.
Konstatohet se, në **1** nga çështjet e referuara të cilat paraqiten në ndjekje nga Zyrat Vendore, procedimi nr. 1440 i vitit 2019, përcjell nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr.10083 prot, datë 25.06.2019 dhe **në 1 rast** të evidentuar të identifikuar nga Zyra e Inspektimit të ASH në vitin 2018, trajtuar në vijim, nuk është ngritur padi civile në procesin

penal, në kundërshtime me pikën 2 dhe 3 të nenit 14, i ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 ñPër Avokaturën e Shtetitò, i ndryshuar si dhe nenit 39 të Rregullores së Brendshme ñPër organizimin dhe funksionimin e Avokaturës së Shtetitò. Këto çështjet penale ishin përcjellë nga Prokuroritë pasi kishte përfunduar hetimi dhe materialet ishin dërguar për shqyrtim në gjykatën e rrethit gjyqësor përkatës, duke i lënë një periudhë të shkurtër kohe A.SH për të përgatitur paditë civile. Për çështjet e tjera informacioni i paraqitur nga Avokatura e Shtetit për auditim ka qenë jo i plotë për të identifikuar kohën kur këto çështje janë përcjellë nga Prokuroria. Midis institucioneve është lidhur edhe një marrëveshje bashkëpunimi, për të garantuar mbrojtjen e te drejtave dhe interesave pasuror të shtetit dhe të shtetasve nga veprimtaria kriminale e cila daton prej vitit 2015.
Referuar të dhënave të publikuara në raportin vjetor të Prokurorisë së Përgjithshme mbi aktivitetin e ushtruar, rezulton se vetëm gjatë vitit **2019** ky institucion ka trajtuar 59,888 çështje penale, prej të cilave janë regjistruar **30,695** çështje. Megjithëse, jo në të gjitha rastet që ndiqen nga Prokuroria ka dyshime që janë cenuar interesat pasurore të vendit, numri i **ulët** i çështjeve civile në procese penale të ndjekura nga Avokatura e Shtetit gjatë 3 viteve (32 çështje), krahasuar me numrin e çështjeve penale gjithsej të regjistruara vetëm për vitin 2019 (30,695 çështje), paraqet sinjal për një nivel jo të kënaqshëm bashkëpunimi midis dy institucioneve me qëllim marrjen e masave të nevojshme në kohë, për të siguruar mbrojtjen e interesave të shtetit në çdo rast. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 2, faqet 25-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandimi: Avokatura e Shtetit, mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi si dhe marrëveshjen ndërinstitucionale të lidhur, të kërkojë bashkëpunimin e Prokurorisë së Përgjithshme, mbi marrjen e masave të nevojshme për përcjelljen në kohë të çështjeve penale, në të cilat ka dyshime se janë cenuar interesat pasurorë të Shtetit Shqiptar, me qëllim sigurimin e efektivitetit dhe eficencës së procesit të mbrojtjes së tyre.

Në vijimësi

3.2 Rekomandimi: Avokatura e Shtetit, nëpërmjet Zyrës së Inspektimit, referuar informacioneve të përcjella nga Prokuroria për periudhën nën auditim vitet 2018-2020 në të cilat ka cenim të interesave pasurorë të institucioneve shtetërore ose të personave juridikë publikë, të evidentojë të gjitha rastet për të cilat nuk janë ngritur paditë civile dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme administrative e ligjore, për kërkimin/rikuperimin e tyre referuar legjislacionit në fuqi, duke nxjerrë për çdo rast përgjegjësitë individuale të punonjësve të ngarkuar me këtë detyrë.

Menjëherë dhe në vijimësi

4- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me shkresën nr. 2238 prot., datë 18.05.2016 i ka përcjellë Avokaturës së Shtetit kopjen e kërkesës për gjykim drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, në lidhje me procedimin penal nr.36, të vitit 2014. Kallëzimi penal ishte bërë për shkak se ishin dhënë AMTP në kundërshtim me ligjin 7501, ñPër tokënò. Sipërfaqe toke që realisht janë *"tokë pa fryt",* ranishte buzë detit ishin dhënë në pronësi si tokë bujqësore. Sipërfaqja e tokës përfituar në **kundërshtim** me ligjin ishte **985,900 m^2.**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë me vendimin nr. 194, datë 21.10.2016 ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurve dhe **vazhdimin e sekuestros preventive** deri në zgjidhjen civilisht të konflikteve në lidhje me pronësinë e

parcelave objekt i sekuestros. Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.576, datë 11.07.2017 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit penal nr. 194, datë 21.10.2016.
Më datë 30.01.2018 Zyra e Inspektimit në Avokaturën e Shtetit i ka përcjellë Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, raportin e inspektimit tematik për trajtimin e këtij rasti. Referuar raportit të inspektimit, avokati i shtetit kishte kryer shkelje shume të rëndë pasi **nuk** është ngritur padia civile me objekt pavlefshmërinë e AMTP-ve të kundërligjshme, apo që janë konstatuar të falsifikuara, me vendim penal të formës së prerë. Me anë të shkresës nr. 1653 prot., datë 09.09.2020 Avokati i Shtetit në Zyrën Vendore Durrës, i ka drejtuar Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës në Kavajë, kërkesën për informacion me objekt ñ*Ekzekutimi i vendimit penal nr. 12-2016-1549/194, të datës 21.10.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë...*ò Nëpërmjet kësaj shkrese, Zyra Vendore Durrës, kërkonte informacion nëse masa e sekuestros preventive ishte ende në fuqi, dhe nëse po, sa është numri i pasurive mbi të cilat është ushtruar ekzekutimi i vendimit, si dhe gjendja juridike aktuale e këtyre pasurive. Nga dokumentacionet e vëna në dispozicion grupit të auditimit, **nuk** identifikohen hapa të tjerë për rivendosjen e te drejtave pasurore mbi këto pasuri me pronar Shtetin Shqiptar. Sa më sipër, Avokatura e Shtetit **nuk** rezulton të ketë ndërmarrë masat e nevojshme për të mbrojtur interesat pasurorë të shtetit në këtë çështje. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 2, faqet 25-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandimi: Titullari i Avokaturës së Shtetit, të ndërmarrë masat e nevojshme për analizimin e rastit të mësipërm me qëllim identifikimin e shkaqeve të cilat kanë ndikuar në mos ngritjen në vijim të padisë civile për mbrojtjen e interesave pasuror të shtetit në këtë çështje penale edhe pas daljes së vendimit penal të formës së prerë me qëllim adresimin e përgjegjësive konkrete dhe mos përsëritjen e tij në të ardhmen.

Brenda datës 31.12.2021

5- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi dokumentacionin e administruar në vijim të çështjes së arbitrazhit ndërkombëtar, të iniciuar nga shoqëria ñV I ò, s.r.1, me objekt mosmarrëveshje ñ*shkelje të Traktatit, "Për promovimin dhe Mbrojtjen e Investimeve", të nënshkruara ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë si dhe shpërblimin e dëmit në formën e kompensimit të plotë për humbjet e saj në investimin e kryer, për krijimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së ndërmarrjes së përbashkët "A i-G* ò, rezultuan problematika lidhur me administrimin e shoqërisë së përbashkët me kapital pjesërisht shtetëror Agri-Gose shpk , si më poshtë vijon:
Më datë 16.04.2009 pranë qendrës kombëtare të regjistrimit është regjistruar shoqëria **M -A.** me Nipt K E dhe ortak 100% të kuotave, shoqërinë P S M d.d.
Më datë 25.02.2014 është regjistruar pranë qendrës kombëtare të regjistrimit sot Q.K.B, shoqëria **P A sh.p.k**, me Nipt L K, me objekt investime në kompani dhe konsulencë. Administrator dhe ortak i vetëm 100% i kuotave të kësaj shoqërie është Z. M C .
Më datë 07.04.2014, tek shoqëria **M -A.** me Nipt K91616024E është regjistruar shitje 100% e kuotave të cilat janë blerë nga shoqëria **P A sh.p.k.** Më datë 11.04.2014 pranë QKB-së për shoqërinë **M -A.** është regjistruar ndryshimi i administratorit dhe vendosja e administratorit të ri **po** Z. M C i cili në momentin e emërimit ishte Administrator i shoqërisë pronare të kuotave **P A sh.p.k**.

Shoqëria **A sh.p.k** me Nipt J F, është një shoqëri e përbashkët, ku shteti shqiptar ka zotëruar një kuotë kapitali prej 17.27% dhe pjesën tjetër të kuotave e ka zotëruar shoqëria V I .
Më datë 23.06.2014 shoqëria **V I** ka shitur e kuotat e saj në shoqërinë M -A prej 82.73%, regjistruar në ish QKR sot QKB më datë 14.07.2014. Po në këtë datë, është regjistruar dhe ndryshimi në administratorin e ri të shoqërisë A G , ku si i tillë është emëruar Z. M C .
Deri në këtë moment z. K është paralelisht administrator i të 3 shoqërive të sipërcituara.
Më datë 09.02.2015 emërtimi i shoqërisë **M -A** ndryshoi dhe u bë **A C** .
Më datë 27.05.2015 shoqëria **A C** ka vijuar procedurën për përthithjen e shoqërisë **P A sh.p.k**. dhe po në këtë datë është regjistruar dhe shitja e 100% të kuotave të **AC** të cilat zotëroheshin nga **PA** tek pronari i ri i kuotave Z. M C .
Më datë 15.06.2017, në QKR/QKB është publikuar ndryshimi i emrit të shoqërisë **A sh.p.k** në **A Farm,** ndryshimi i administratorit ku është caktuar administrator i ri z.A A sipas vendimit datë 28.04.2017.
Më datë 19.06.2017 është regjistruar pranë regjistrit tregtar vendimi sipas procesverbalit të mbledhjes të dt. **19.05.2017,** në të cilin ka qenë pjesëmarrës vetëm përfaqësuesi ligjor i ortakut A C , ndërsa përfaqësuesi i MZHETS nuk ka marr pjesë. Në këtë mbledhje është vendosur ndryshimi i kapitalit ku pjesa e MZHETS është zvogëluar në 8.24%, nga 17.27% që ishte më parë. Ndërkohë është rritur në mënyrë të njëanshme kapitali për shoqërinë A C nga financimi i dhënë nga aksionari si borxh pa interes dhe vlera e tij deri më datë 31.03.2017 paraqitej 234,936,419 lekë sipas parashtresës datë 21.04.2017. Përfaqësuesi ligjor i kësaj shoqërie, i cili ka firmosur vendimin e ndryshimit, është Z. M C . Në këtë rast **nuk** është publikuar asnjë dokument për thirrjen e mbledhjes, orarin dhe vendin e saj. Po kështu nuk evidentohet asnjë qëndrim zyrtar nga ana e Ministrisë mbi këtë rast.
Referuar sa më sipër, **M A** dhe **A sh.p.k** vlerësohen si shoqëri të kontrolluara/ influencuara referuar neneve 207 e vijues të ligjit 9901 dt. 14.04.2008, ñPër tregtarët dhe shoqëritë tregtareò, ndërkohë që sipas dispozitave të këtij ligji, pjesa IV, ñShoqëritë me përgjegjësi të kufizuaraò, Kreu II, Administratorët, neni 95, pika 2, ñ*Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm"*.
Kjo situatë përkon edhe me lidhjen e kontratës së blerjes së kuotave të shoqërisë V s.r.l ku ndryshimi i kuotave në disfavor të shtetit shqiptar miratuar me vendimin e datë 19.05.2017 jo vetëm është i njëanshëm, por evidentohen parregullsi lidhur me legjitimitetin e caktimit të administratorit në shoqëritë e kontrolluara, tagrat e përfaqësuesit të ortakut i cili me datë 19.05.2017 rezulton zyrtarisht administrator i shoqërisë **A sh.p.k** dhe njëkohësisht ka firmosur si përfaqësues ligjor i **A C ortaku kryesor i A sh.p.k. Sa më sipër, bie në** kundërshtim me përcaktimet e nenit 95 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008, i ndryshuar, ku përcaktohet se, *"Statuti mund të vendosë rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve",* dhe **Statutit[8] të shoqërisë A shpk,** sipas të cilit ñ*Emërimi i administratorëve, hyn në fuqi pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"*. Pra veprimet e administratorit në këtë rast legjitimohen vetëm pas regjistrimit të emërimit të tij pranë QKB çka nuk përkon në rastin konkret.

[8] Statuti i regjistruar në QKB më datë 18.07.2011, i cili ka qenë në fuqi deri në regjistrimin e statutit të ri, pas tkurrjes së kuotave të Shtetit Shqiptar në këtë shoqëri.

Gjithashtu, procedura e ndjekur për ndryshimet e kuotave bie në kundërshtim edhe me nenet 83, të ligjit të sipërcituar i cili përcakton se,
1. "Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë" 2. "Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë, si 85 e vijues **Përfaqësimi në asamble** ku citohet se, ñ*Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme".*
Çështja më sipër, evidenton nevojën për një vlerësim më të gjerë dhe të plotë mbi veprimet e administrative e ligjore të marra apo të munguara nga të gjitha palët e përfshira dhe legjitimitetin e tyre, për të eliminuar efektet në cenimin e interesave pasurorë të shtetit shqiptar, si dhe respektimin e kuadrin ligjor në fuqi. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 2, faqet 25-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandimi: Avokatura e Shtetit të analizojë rastin e mësipërm, të identifikojë veprimet në kundërshtim me dispozitat ligjore lidhur me kontrollin/influencimin e vendimmarrjeve në shoqërinë A G shpk dhe të ndërmarrë masat e nevojshme ligjore për të eliminuar efektet në cenimin e interesave pasurorë të shtetit shqiptar.

Menjëherë

5.2 Rekomandimi: Avokatura e Shtetit, të informojë ministrinë përgjegjëse e cila është përfaqësuesja e shtetit shqiptar në shoqërinë A F /A G shpk, mbi problematikën e konstatuar nga KLSH, me qëllim ndërmarrjen e masave të nevojshme lidhur me çështjen.

Menjëherë

5.3 Rekomandimi: Avokatura e Shtetit të dërgojë një informacion të hollësishëm mbi konstatimin e KLSH-së pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për verifikimet të mëtejshme fiskale lidhur me rastin.

Menjëherë

6- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, gjatë periudhës vitet 2018-2020 Avokatura e Shtetit ka përfunduar tre procedura kontraktimi të studiove të huaja me një vlerë gjithsej prej rreth **1.4 milion dollarë.**
-Në procedurën e kontraktimit për mbrojtjen në çështjen e arbitrazhit "ARB/15/28 H srl, C srl, F B , M de R , S G , L C kundër Republika e Shqipërisë" rezultoi se, kontrata nuk rezulton e përkthyer në gjuhën shqipe, nuk disponohet inventar për dosjen për fazën e marrjes së shërbimit nga ASH. Urdhrat e titullarit nr. 180 datë 17.05.2019 dhe nr. 180/1, datë 18.06.2019 në këtë procedurë nuk përmbajnë numër prokolli në kundërshtim me Normën tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 13 i saj. Kontrata nuk rezulton e protokolluar e nënshkruar në çdo faqe dhe e vulosur me vulën e institucionit. Duke qenë se punonjësi i ngarkuar për ndjekjen e kontratës është larguar nga puna, deri në këtë fazë nuk evidentohet të jetë amenduar kontrata në pikën 3.1 për zëvendësimin e tij. Mungojnë

relacionet nga ana e ASH mbi marrjen e shërbimit të konsulencës përpara përcjelljes së faturave drejt Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

- *Në procedurën e kontraktimit të shërbimit të konsulencës për marrëveshjen e koncesionit të lidhur me shoqërinë koncesionare "**T P ", shpk**, për aeroportin ndërkombëtar "Nënë Tereza", Tiranë,* nga auditimi i dosjes rezultoi se, **brenda datës 19.04.2019** janë realizuar një sërë veprimesh procedurale, që nga paraqitja e Projekt Vendimi pranë Këshillit të Ministrave, miratimi i VKM-së, përcaktimi i kritereve të veçanta si dhe përcaktimi i pikëzimit për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, krijimi i komisionit për kryerjen e procedurës së përzgjedhjes të zyrës së avokatisë së huaj për shërbimin e konsulencës, si dhe përgatitja dhe dërgimi i ftesës për ofertë çka krijon risk lidhur me cilësinë e këtyre vendimmarrjeve. Grupi që ka përcaktuar kritereve të veçanta si dhe përcaktimi i pikëzimit për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta **nuk është** krijuar në bazë të një komisioni të ngritur nga titullari i institucionit, por në bazë të një shënimi të lënë nga titullari në memo nr. 1384/3, datë 19.04.2019 drejtuar nga Drejtoria e zyrës së përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Ndërkombëtare dhe Arbitrazh Ndërkombëtar.

- **Afati i ankimimit** në këtë procedurë është lënë deri në datën 28.04.2019, ora 20^{00} e cila bie ditë **e diel** dhe ne kundërshtim me VKM-në nr. 242 datë 19.04.2019. pika 6 ku citon se.... ñ ofertuesit e renditur jo të parët mund të ushtrojnë të drejtën e ankimimit lidhur me procedurën e kualifikimit brenda 3 dite punë nga data e njoftimit të tyre nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetitò. Mungon inventari dosjes, në kundërshtim me ñNormën tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisëò. Kontrata nuk rezulton e përkthyer në gjuhën shqipe por gjendet vetëm në gjuhën angleze. Në dosje mungojnë disa dokumentacione si urdhri i Avokatit të Përgjithshëm ku caktohet një avokat për ndjekjen zbatimin e kontratës si dhe mungon një informacion i plotë mbi ecurinë e kësaj kontrate sa i përket likuidimit të saj. Mungojnë relacionet nga ana e ASH mbi marrjen e shërbimit të konsulencës përpara përcjelljes së faturave drejt Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

-*Në procedurën mbi përzgjedhjen e zyrës së avokatisë për "Përfaqësimin dhe mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë në cështjen e arbitrazhit PCA Case 2018-49 V SRL vs Albania",* rezultoi se, në këtë procedurë mungon inventari i dosjes, pjesa e dokumentacionit që përmendet në shkresën shkresën nr. 2235/3 datë 17.08.2018 si dhe dokumentacion pjesë e ofertave.

Urdhrat e titullarit në këtë procedurë përmbajnë vetëm nr. dhe datë urdhri por jo numër protokolli në kundërshtim me *Normën tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë,* neni 13 i saj. Kontrata nuk rezulton e protokolluar e nënshkruar në çdo faqe dhe e vulosur me vulën e institucionit. Në pikën 4.1 të kontratë përcaktohet se, <u>tarifat do të faturohen dhe paguhen në formë neto, pa u mbajtur asnjë zbritje ose tatim në burim ndërkohë që mbajtja ose jo nuk e tatimit nuk është kompetencë e ASH</u> por aplikohet sipas akteve ligjore e nënligjore mbi taksat dhe tatimet në Republikën e Shqipërisë. Mungojnë relacionet nga ana e ASH mbi marrjen e shërbimit të konsulencës përpara përcjelljes së faturave drejt Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

-Lidhur me këtë procedurë nga ana e ASH nuk rezulton të jetë kryer një angazhim paraprak mbi çështjen për mbledhjen e informacioneve të nevojshme nga institucionet e vendit, vlerësimin e tyre si dhe nxjerrjen e konkluzioneve përkatëse nëse kjo çështje mund të mbrohej nga Avokatura e Shtetit nëpërmjet strukturës përgjegjëse në të, përpara përzgjedhjes së procedurës së kontraktimit. Angazhimi i ASH për mbledhjen e informacionit evidentohet në fazën pas përfundimit të kontraktimit dhe jo përpara saj.

Avokatura e Shtetit ka një seksion të posaçëm organizativ për përfaqësimin në gjykatat e huaja ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar. Prej një periudhe relativisht të gjatë

institucioni merr pjesë si përfaqësuese e Shtetit Shqiptar në institucionet publike në gjykatat ndërkombëtare. Po kështu njohuritë mbi legjislacionin vendas, ndryshimet në të, kontekstin ligjor të marrëveshjeve të lidhura, përfaqësimi në rastin konkret mund të ishte bërë direkt nga ASH dhe jo nëpërmjet kontraktimit, çka është evidentuar dhe nga ana e Ministrisë së Drejtësisë me shkresën e administruar në ASH me nr. 2235/13 prot, datë 18.09.2018. Shoqëria V I S.r.l më datë 23.06.2014 rezulton të ketë shitur kuotat e saj në shoqërinë A G shpk një kompanie tjetër të regjistruar në Shqipëri, ndërkohë që ankimi i saj në gjykatë rezulton i kryer në vitin 2018, çka në gjykimin tonë përbën element kyç në mos legjitimimin e saj si palë në proces. Megjithatë kjo çështje do të jetë objekt verifikimi dhe në auditimet vijuese të KLSH pranë këtij institucioni. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 5, faqet 79-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandimi: Nga ana e Avokaturës së Shtetit të merren masat e nevojshme që të metat dhe mangësitë e konstatuara në tre procedurat e kontraktimit më sipër lidhur me hartimin dhe miratimin e akteve/kontratave, inventarizimin e dosjeve, përkthimin e tyre në gjuhën zyrtare, marrjes në dorëzim të shërbimit përpara pagesës, ndryshimit të personave të kontaktit në kontrata të rikuperohen për aq sa është e mundur si dhe të merren masa për mos përsëritjen e tyre në të ardhmen.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.2 Rekomandimi: Avokatura e Shtetit përpara se të kryej vendimmarrje mbi zgjedhjen e përfaqësimit nga studio e huaja në proceset gjyqësore, në çdo rast të bëj një analizë e hollësishme të dokumentacionit dhe informacionit të marrë nga institucionet e vendit për vlerësimin e qartë dhe të plotë të situate me qëllim eliminimin e kostove të panevojshme në buxhetin e shtetit.

Në vijimësi

7- Gjetje nga auditimit: Nga auditimi rezultoi se, thuajse në të gjitha çështjet e gjykuara pranë Gjykatave Ndërkombëtare dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar, Avokatura e Shtetit nuk dispononte informacion mbi ecurinë e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të gjykatave të huaja në Shqipëri. Sipas shpjegimeve dhe komenteve të ASH mungesa e këtij informacioni vjen si rezultat i mos thirrjes si palë në proces nga Gjykatat e Apelit vendase si dhe nga mungesa e kërkesës prej institucioneve respektive që kanë interes të drejtpërdrejtë në çështje, të cilat thirren në gjykim nga këto gjykata. Ndërkohë në rastin A A Sh.p.k dhe të tjerë/2020, B i Srl/2013, shihet që ASH është investuar vetë në njohjen e vendimit në gjykatë, çka në vlerësimin tonë evidenton standarde të dyfishta veprimi lidhur me proceset e njohjes së vendimeve. Vlerat e konsiderueshme financiare të tyre e bëjnë të domosdoshme nevojën për pjesëmarrje të ASH në gjykim. Sipas nenit 79/a të KPC gjykatat rregullisht duhet të thërrisnin ASH në këto gjykime krahas institucionit të interesuar e megjithatë situata në fakt paraqitet krejt ndryshe. Kryesisht institucionet palë në proces janë Ministritë e linjës pranë të cilave janë caktuar avokatë shteti të dedikuar për dhënien e asistencës ligjore, e megjithatë vihet re se bashkëpunimi i tyre me dikasteret përkatëse lidhur me këto çështje mungon. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 2, faqet 25-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1 Rekomandimi: Nga ana e Avokaturës së Shtetit të merren masat e nevojshme administrative e ligjore për unifikimin dhe garantimin e përfaqësimit ligjor pranë Gjykatave të Apelit vendase, me qëllim mbrojtjen sa më efektive të interesave të Shtetit në proceset gjyqësore për njohjen e vendimeve të dhëna nga gjykatat e huaja.

Brenda datës 31.12.2021

7.2 Rekomandimi: Nga ana e Avokaturës së Shtetit të miratohet formati tip i regjistrit fizik dhe elektronik të çështjeve gjyqësore në gjykatat e huaja, ku Republika e Shqipërisë është palë, me qëllim regjistrimin të gjithë hapave procedurale të ndërmarra në këto procese si dhe ecurinë e njohjes dhe zbatimit të këtyre vendimeve në vendin tonë.

Brenda datës 31.12.2021

8- Gjetje nga auditimit: Nga auditimi mbi veprimtarinë e dy organeve kolegjiale të cilët funksionojnë pranë Avokaturës së Shtetit, Këshillit Konsultativ për çështjet e GJEDNJ, si dhe Kolegjit të avokatëve të shtetit, të cilët kanë një rol të rëndësishëm në veprimtarinë e saj rezultoi se:

- Këshilli Konsultativ për Çështje e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut është parashikuar të krijohet pas ndryshimeve në ligjin organik të ASH nr. 10018 datë 13.11.2018 të publikuara në Fletoren Zyrtare nr. 177/2018. Ky organ ka si objekt orientimin dhe konsultimin e ASH mbi masat parandaluese të cilat mund të shkaktojnë dëm financiar për shtetin si rezultat i shkeljes së KEDNJ. Këshilli Konsultativ përbëhet nga 5 anëtarë të cilët emërohen nga Kryeministri, me propozim të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit. Me Urdhrat e Kryeministrit nr. 34 datë 04.02.2019, dhe atë 51 datë 04.03.20119 janë miratuar propozimet e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit. Në veprimtarinë e tij Këshilli gjatë vitit 2019 ka kryer gjithsej 12 mbledhje nga 22 të detyrueshme referuar pikës 5 të Urdhrit nr. 34 cituar më sipër ku përcaktohet qartë thirrja dhe mbledhja e këtij organi të paktën një herë në muaj. Ndërkohë në mbledhjet e datës 27.06.2019 dhe 16.10.2020 nuk rezulton të jetë formuar kuorumi i nevojshëm për vijimin e mbledhjes në kundërshtim me Ligjin nr.8480 datë 27.05.1999, òPër funksionimin e organeve kolegjialeò, neni 11 ñKuorumiò. Procesverbalet e mbledhjeve nuk rezultojnë të firmosura nga anëtarët pjesëmarrës por vetëm nga juristja e sekretariatit teknik dhe Titullari i ASH. Mungesa e konfirmimeve bie në kundërshtim me Ligjin nr.8480 datë 27.05.1999, òPër funksionimin e organeve kolegjialeò, neni 16 i tij.

Pas largimeve të njëpasnjëshme të disa prej anëtarëve të emëruar të Kolegjit në detyra të tjera, të cilat mund të kenë konflikt me detyrën në këshill rezultoi se në fund të vitit 2020 nuk plotësohet kuorumi i nevojshëm për vijueshmërinë e veprimtarisë, çka paraqet nevojën imediate për kryerjen e propozimeve përkatëse nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit nëpërmjet një procesi përzgjedhës transparent, për të plotësuar vakumin e krijuar në këtë organ relativisht të ri.

- Kolegji i Avokaturës së Shtetit_është miratuar me Urdhrin e Titullarit nr. 38 datë 18.02.2019 ñPër ngritjen dhe përbërjen e Kolegjit pranë Avokaturës së Shtetitò, me 7 (1+6) anëtar, nën drejtimin e Avokatit të Përgjithshëm. Kolegji asistohet nga sekretariati teknik anëtar të ASH.

-Urdhri nr. 38 datë 18.02.2019, ñPër ngritjen dhe përbërjen e Kolegjit pranë Avokaturës së Shtetitò rezulton pa numër protokolli në kundërshtim me *Normën tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë,* neni 13 i saj.

-Procesverbalet e mbledhjeve të datës 28.03.2019, 17.05.2019, 21.05.2019, 17.09.2019, nuk rezultojnë të firmosura nga pjesëmarrësit por vetëm nga anëtarët e sekretariatit teknik. Mungesa e konfirmimeve bie në kundërshtim me Ligjin nr.8480 datë 27.05.1999, òPër funksionimin e organeve kolegjialeò, neni 16 i tij. Në procesverbal nuk rezultojnë të pasqyruara votimi pro ose kundër i anëtarëve dhe çka cënon besueshmërinë e vendimmarrjeve. Për muajt Prill, Qershor, Korrik, Tetor-Dhjetor 2019 nuk janë zhvilluar mbledhje nga ky kolegj megjithëse në pikën 3 të nenit 20 në Rregulloren e Brendshme të ASH përcaktohet zhvillimi periodik i mbledhjeve një herë në muaj apo dhe më shpesh. Ndërkohë që për vitin 2020 evidentohet vetëm 1 mbledhje nga 12 të tilla minimalisht.

Mangësitë e mësipërme janë në mospërputhje me përcaktimet ligjore që rregullojnë veprimtarinë kolegjiale, kriteret e përcaktuara mbi veprimtarinë e tyre administrative, etj. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 7, faqet 128-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)..*

8.1 Rekomandimi: Nga ana e Avokaturës së Shtetit të merren masat e nevojshme që të gjitha mbledhjet e Këshilli Konsultativ për çështjet e GJEDNJ dhe Kolegjit të Avokatëve, të dokumentohet e gjithë veprimtaria dhe vendimmarrjet e kryera me nënshkrimet e të gjithë anëtarëve pjesëmarrës, kjo në përmbushje të detyrimit ligjor dhe në funksion të transparencës së vendimmarrjeve që kryhen.

Në vijimësi

8.2 Rekomandimi: Avokati i Përgjithshëm i Shtetit pas një procesi përzgjedhës transparent të kandidaturave për vakancat në Këshillin Kosultativ, të dërgojë propozimet e kandidaturave pranë Kryeministrit të Shqipërisë me qëllim vënien në funksion të tij dhe përmbushjen e qëllimit të parashikuar nga ligjvënësi.

Menjëherë

9- Gjetje nga auditimit: Nga auditimi rezultoi se, në pikën 1 të nenit 36, të Rregullores së Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Avokaturës së Shtetit miratuar me urdhrin nr.68, dt. 28.03.2019, përcaktohet *se, "Një kategori e caktuar çështjesh të cilat do të trajtohen nga Avokatura e Shtetit do të konsiderohen Kodi "A", një kod i cili do të shënohet/pasqyrohet në krah të numrit të brendshëm identifikues që do të marrë dosja/çështja, si dhe çdo shkresë apo akt tjetër që lidhet me dosjen e kësaj çështje.* Sipas shkronjës f, të pikës 2 të këtij neni të gjitha çështjet me palë tatimet dhe doganat me vlerë mbi 10 milion do të kategorizohen Kodi ñAò. U audituan me përzgjedhje 13 tatimpagues të cilët kanë paditur Drejtoritë Tatimore, me objekt shfuqizimin e akteve të rivlerësimit tatimor të kryera nga këto të fundit. Këto të dhëna janë filtruar nga një auditim i mëparshëm i kryer nga KLSH në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Referuar shkronjës h, të pikës 1, të nenit 11 të Rregullores së brendshme të institucionit, miratuar me urdhrin nr.68, dt. 28.03.2019, Avokati i shtetit duhet *të plotësojë të dhënat mbi çështjet në sistemin përkatës online duke përfshirë dhe ato statistikore brenda afateve të përcaktuara.* Auditimi konsultoi në sistemin elektronik të Avokaturës së Shtetit, pjesëmarrjen e kësaj të fundit në çështjet në fjalë. Nga shqyrtimi në sistem i çështjeve, rezultoi se Avokatura e Shtetit ka marrë pjesë në 12 nga 13 çështjet e mësipërme, ndërsa çështjen A S -DRT e ka deleguar.
Referuar shkronjës h, të pikës 1, të nenit 11 të Rregullores së Brendshme të institucionit, miratuar me urdhrin nr.68, dt. 28.03.2019, Avokatura e Shtetit duhet *të plotësojë të dhënat mbi çështjet në sistemin përkatës online duke përfshirë dhe ato statistikore brenda afateve të përcaktuara.* Në këtë sistem, auditimi evidentoi regjistrimin e pjesëmarrjes së Avokaturës në gjykatën e shkallës së dytë për të 12 çështjet e mësipërme, si dhe në gjykatën e shkallës së parë për 3 prej çështjeve të mësipërme, ndërsa 9 çështjet e tjera të ndjekura në shkallën e parë gjyqësore nga Avokatura e Shtetit gjatë viteve 2012-2017, **nuk** rezultuan të regjistruara në sistemin elektronik të çështjeve gjyqësore të institucionit edhe pse vendimet e shkallës së parë në disa raste ishin pas vitin 2015, vit në të cilin është bërë funksional sistemi. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 2, faqet 25-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1 Rekomandimi: Avokatura e Shtetit të ndërmarrë masat e nevojshme që avokatët e shtetit të regjistrojnë në sistemin elektronik të gjitha çështjet e ndjekura prej tyre në të gjitha shkallët e gjykimit pavarësisht periudhës së nisjes së tyre.

Në vijimësi

10- Gjetje nga auditimit: Nga auditimi rezultoi se, institucioni për vitin 2018 nuk ka plan inspektimesh të miratuar nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit (APSH). Praktikat e inspektimeve të kryera për vitin 2018 janë kryesisht tematike dhe të fokusuara mbi veprimtarinë e avokatëve të shtetit individualisht dhe jo mbi veprimtarinë e zyrave në tërësi. Inspektimet e evaduara gjatë kësaj periudhe i përkasin inspektimeve të mbartura, të paevaduara, në vitin 2017. Inspektimet janë kryer në një afat tepër të shkurtër dhe kanë dalë me konkluzione vetëm me shkelje disiplinore. Në raportet e inspektimit nuk disponohet informacion lidhur me çështjet dhe pasojat të cilat kanë /mund të kenë sjellë dëm të interesave të shtetit Shqiptar, nga veprimet apo mos veprimet e avokatëve të shtetit.
Për vitet 2019-2020, praktikat e inspektimeve janë të pa inventarizuara, ato përmbajnë vetëm emërtimin e dokumentit ligjor, por nuk është bërë numërimi i fletëve dhe numri total i tyre. Mos respektimi i kuadrit ligjor, lidhur me afatet e përcaktuara për kryerjen dhe evadimin në kohë të Inspektimeve, mos kryerja e Inspektimeve në kohë duke mos mbuluar për një periudhë të gjatë kohe me inspektim ZVASH-të ka rritur riskun në mos përmbushjen e detyrave funksionale nga avokatët e shtetit, pasoja të cilat janë në dëm të interesave të Shtetit. Mos inventarizimi i dokumenteve shtetëror sjell pasiguri si dhe mungesë transparence në lidhje me mënyrën e procedimit sipas ligjit, rreth procedurave të ndryshme te ndjekura për plotësimin e nevojave të institucionit, kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi të cilat rregullojnë veprimtarinë institucionale e procedurale. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 6, faqe 115-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1 Rekomandimi: Avokatura e Shtetit të marrë masat e nevojshme për hartimin e planeve vjetore të inspektimit, programeve të plota të inspektimit, hartimin e raporteve me informacionet përkatëse të çështjeve në të cilat mbrojtja e interesave të shtetit nuk është kryer në përputhje me përcaktimet ligjore, për të vlerësuar përmbushjen e detyrave funksionale nga avokatët e shtetit si dhe efektet e mospërmbushjes apo keqpërdorimit të detyrës publike.

Në vijimësi

10.2 Rekomandimi: Avokatura e Shtetit të përfundojë inventarizimin e të gjitha dosjeve të inspektimit për periudhën nën auditim referuar ligjit nr. 9154 datë. 06.11.2003 ñPër Arkivatò, si dhe Normave Tekniko-Ligjore dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor.

Brenda datës 31.12.2021

11- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, komisioni i ngritur me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit nr. 153, datë 19.12.2018 për vitin 2018 dhe me urdhrin nr. 361, datë 19.12.2019 për vitin 2019, ñPër kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të materialeve dhe aktiveve në Avokaturën e Shtetitò është cilësuar komision inventarizimi dhe vlerësimi të aktive, ku sipas urdhrit të titullarit vlerësimi i aktiveve është bërë gjatë procesit të inventarizimit,
Nga komisioni nuk është dhënë shpjegime se mbi bazën e cilit kriter janë vlerësuar aktivet për nxjerrje jashtë përdorimi, veprime në kundërshtim me pikën 103 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, si dhe nuk është formuluar një relacion ku të përmbajë procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës, veprim në kundërshtim me pikën 106 të udhëzimit. Për secilin aktiv të vlerësuar të dëmtuar dhe jashtë përdorimi nga komisioni nuk është mbajtur proces verbali i vlerësimit veprime në kundërshtim me pikën 104-105 të udhëzimit. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 4, faqe 73-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1 Rekomandimi: Avokatura e Shtetit të marrë masat e nevojshme që në përpilimin e urdhrit për ngritjen e komisioneve të mirë përcaktojë detyra e komisionit të ngritur nëse janë për inventarizimin e aktiveve apo vlerësimin e aktiveve. Gjithashtu të merren masa që procesi i vlerësimit dhe më pas i tjetërsimit/nxjerrjes jashtë përdorimit, të realizohen menjëherë pas procesit të inventarizimit, në përputhje kuadrin ligjor në fuqi.

Në vijimësi

12- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, për vitin 2018, janë kryer dy procedura prokurimi ñ*Blerje bileta udhëtimi Tirane Strasburg; Strasburg-Tirane, me rezervim hoteli*ò për datat 25-27 Janar dhe për të njëjtat data për muajin Nëntor. Konstatohet se, Komisioni i Blerjeve të Vogla në kundërshtim me udhëzimin Nr.4 datë 09.01.2018 ñ*Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin ne mjete elektroniko*ò i ndryshuar, ne Ftesën për Ofertë, ka përcaktuar linjën ajrore si dhe hotelin për destinancionin e përcaktuar si më sipërpërmendur. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 5, faqe 79-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1 Rekomandimi: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në mënyrë që të sigurojë eficencë dhe efikasitet në procedurat e prokurimit publik, të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomik si dhe pjesëmarrjen e tyre duke siguruar një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues, nuk duhet të kufizojë OE duke parapërcaktuar linjën ajrore në procedurën e prokurimit për ñ*Blerje bileta udhëtimi*ò.

Në vijimësi

13- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi regjistrin e parashikimit të procedurave të prokurimit si dhe procedurave të realizimit për vitin 2018 rezultoi se, janë planifikuar gjithsej 31 procedura prokurimi dhe referuar këtyre procedurave janë realizuar vetëm 17 prej tyre. Referuar regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit janë realizuar 35 procedura prokurimi, ku 18 procedura prokurimi janë të paparashikuara në regjistrin e parashikimit, me përjashtim të një procedure ñBlerje pajisje elektronikò e realizuar nga AKSHI. Konstatohet se, nga ana e Autoritetit Kontraktor kemi një keq planifikim të nevojave dhe fondeve të subjektit. Gjithashtu grupi i auditimit konstatoi se për procedura të cilat janë parashikuar me një fond limit prej 800,000, janë copëzuar sipas nevojave duke kaluar në procedura pa tenderim/blerje shkresore poshtë kufirit 100,000 lekë, të cilat në kundërshtim me Udhëzimin nr.03 datë 08.01.2018 ñ*Mbi përdorimin e procedurës së Prokurimit me vlerë të vogël*ò si dhe udhëzimit nr.01 datë 05.05.2018 ñ*Për hartimin e regjistrit të parashikimeve te PPP*ò...; nuk i ka planifikuar si dhe nuk i është referuar këtij regjistri.
Referuar regjistrit parashikimit të procedurave të prokurimit publik për vitin kalendarik 2020 të hartuar nga Avokatura e Shtetit miratuar nga titullari me shkresën nr. 272/1 prot, datë 14.01.2020 janë renditur objekt prokurimet si dhe fondi limit. Në kundërshtim me Udhëzimin nr.1 datë 05.05.2018 ñ*mbi hartimin e regjistrit të parashikimeve të PPP...."*AK ka bërë disa parashikime ne regjistrin e PPP, për mallrat/shërbimet në një vlerë deri në 100,000 lekë gjatë vitit kalendarik. Nga auditimi ka rezultuar se AK ka realizuar blerje në vlerën 100,000 lekë për mallra dhe shërbime të cilat janë planifikuar me një fond limit deri në 800,000 lekë. Edhe pse këto procedura janë nën vlerën e kufirit 100,000 lekë ato nuk kanë qenë të parashikuara dhe Avokatura e Shtetit i ka kryer me procedurë tenderimi dhe jo me blerje direkt, veprime këto në kundërshtim me nenin 8, pika 2 të VKM nr.914, datë 29.12.2014. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 5, faqe 79-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1 Rekomandimi: Avokatura e Shtetit të marrë masa për mirë planifikimin e nevojave dhe fondeve për procedurat e tenderimit, duke përcaktuar saktësisht objektin e prokurimit, fondin limit, kohën e planifikimit për shpalljen e procedurës, llojin e procedurës së prokurimit etj, referuar përcaktimeve ligjore në fuqi. Gjithashtu, ASH nuk duhet të copëzojë fondet për ti kryera si blerje shkresore/pa tenderim deri në vlerën 100,000 lekë pasi këto të fundit duhet të parashikon si zë me vete ne regjistrin e parashikim të prokurimeve publike.

Në vijimësi

14- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, për vitin 2019 në procedurën e prokurimit, ñBlerje e Karburantiò me fond limit 707,500 lekë, janë evidentuar mangësi në procesin e shpalljes së fituesit, pasi Operatorin Ekonomik fitues ka plotësuar kërkesat për kualifikim me anë të dokumentacionit të një subjekti tjetër juridik të kontraktuar prej tij. Kualifikimi dhe shpallja fitues e OE me kapacitete teknike jo të vetat, dhe pa një ofertë të paraqitur në formën e një BOE, bie në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñ*Për Prokurimet Publike*ò, i ndryshuar, VKM nr.914 datë. 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò si dhe Kontratës me nr.1336 prot, datë.16.04.2019 së lidhur midis Avokaturës së Shtetit dhe Operatorit Ekonomik. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 5, faqe 79-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1 Rekomandimi: Avokatura e Shtetit, të marri masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit në përputhje me kërkesat e LPP të mos kualifikojë operator ekonomik të cilët nuk përmbushin kriteret e përcaktuara lidhur me furnizimin e mallit/shërbimit me qëllim trajtimin e barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë dhe garantimin e transparencës në procedurat e prokurimit publik.

Në vijimësi

15- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, për vitin 2018, 2019, dosjet e prokurimeve të zhvilluara janë të pa inventarizuara ndërsa për vitin 2020 dosjet me dokumentacion ligjor dhe administrative, janë inventarizuar vetëm me emërtimin e dokumentit ligjor, por nuk është bërë numërimi i fletëve dhe numërim total i tyre sipas ligjit nr. 9154 datë. 06.11.2003 ñPër Arkivatò, Normat Tekniko-Ligjore dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor, neni 30 ñInventari i brendshëm i dosjesò Modeli nr.8 dhe VKM nr. 1 datë. 10.01.2007 ñPër Miratimin e Rregullave të Prokurimit publikò Kreu V ñZhvillimi i Proceduraveò. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 5, faqe 79-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1 Rekomandimi: Avokatura e Shtetit të marrë masa, për inventarizimin e dosjeve për të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluar gjatë periudhës vitet 2018, 2019 si dhe të përfundojë procedurën e inventarizimit të dosjeve për vitin 2020 në përputhje me ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003 ñPër Arkivatò dhe Normat Tekniko-Ligjore dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor, për të garantuar transparencë dhe siguri për dokumentacionin shtetëror.

Brenda datës 31.12.2021

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me shkresën nr. 2238 prot., datë 18.05.2016 i ka përcjellë Avokaturës së Shtetit kopjen e kërkesës për gjykim drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, në lidhje me procedimin penal nr.36, të vitit 2014. Kallëzimi penal ishte bërë për shkak se ishin dhënë AMTP në kundërshtim me ligjin 7501, ñPër tokënò. Sipërfaqe toke që realisht janë *"tokë pa fryt",* ranishte buzë detit ishin dhënë në pronësi si tokë bujqësore. Sipërfaqja e tokës përfituar në **kundërshtim** me ligjin ishte **985,900 m^2,** vlera e së cilës, sipas çmimit të hartës së tokës referuar VKM nr. 89 datë 03.02.2016 ñ*Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë*ò, Bashkia Rrogozhinë, zona Vilë-Bishtovë, ZK 3774 në zërin tokë bujqësore, arrin **371,684,300 lekë** (985,900 m^{2}x 377 lekë/m^2), ndërkohë që kjo tokë gjendet buzë detit dhe vlera e saj mund të jetë më e lartë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë me vendimin nr. 194, datë 21.10.2016 ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurve dhe **vazhdimin e sekuestros preventive** deri në zgjidhjen civilisht të konflikteve në lidhje me pronësinë e parcelave objekt sekuestroje. Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.576, datë 11.07.2017 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit penal nr. 194, datë 21.10.2016.

Më datë 30.01.2018 Zyra e Inspektimit në Avokaturën e Shtetit i ka përcjellë Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, raportin e inspektimit tematik për trajtimin e këtij rasti. Referuar raportit të inspektimit, avokati i shtetit kishte kryer shkelje shume të rëndë pasi **nuk** është ngritur padia civile me objekt pavlefshmërinë e AMTP-ve të kundërligjshme, apo që janë konstatuar të falsifikuara, me vendim penal të formës së prerë.

Me anë të shkresës nr. 1653 prot., datë 09.09.2020 Avokati i Shtetit në Zyrën Vendore Durrës, i ka drejtuar Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës në Kavajë, kërkesën për informacion me objekt ñ*Ekzekutimi i vendimit penal nr. 12-2016-1549/194, të datës 21.10.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë...*ò Nëpërmjet kësaj shkrese, Zyra Vendore Durrës, kërkonte informacion nëse masa e sekuestros preventive ishte ende në fuqi, dhe nëse po, sa është numri i pasurive mbi të cilat është ushtruar ekzekutimi i vendimit, si dhe gjendja juridike aktuale e këtyre pasurive. Nga dokumentacionet e vëna në dispozicion grupit të auditimit, **nuk** identifikohen hapa të tjerë të ndërmarrë për rivendosjen e te drejtave pasurore mbi këto pasuri me pronar Shtetin Shqiptar.

Nga sa më sipër **konstatojmë** se, me daljen e:

- vendimit të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Kavajë më datë 21.10**.2016**, mbi vazhdimin e sekuestros preventive deri në zgjidhjen civile të pronësisë për 985,900 m^2 tokë në zonën Vilë-Bishtovë, të regjistruara në kundërshtim me ligjin duke, cenuar interesat pasurore të Shtetit Shqiptar,
- vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës që lë në fuqi vendimin e Gjykatës së rrethit Gjyqësor Kavajë 11.07.**2017**,
- raportit të inspektimit në Avokaturën e Shtetit më datë 30.01.**2018** sipas të cilit Avokatura Shtetit **nuk** ka ngritur padi civile në këtë proces penal,

komunikimet shkresore të ASH-së për kërkimin dhe rivendosjen e të drejtave pasurore të Shtetit mbi këto prona, janë të gjysmës së dytë të vitit **2020.** Avokatura e Shtetit **nuk** rezulton të ketë ndërmarrë masat e nevojshme për të mbrojtur interesat pasurorë të shtetit në këtë çështje. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 2, faqet 17-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Avokatura e Shtetit të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar kalimin në pronësi të shtetit të 985 900 m^2 sipërfaqe toke, e cila referuar regjistrimit në zërin tokë bujqësore arrin vlerën **371,684,300 lekë** dhe përdorimin e saj në interes të qytetarëve shqiptarë.

Brenda datës 31.12.2021

2- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, nga ana e institucioneve shqiptare pjesë e procesit për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), nuk rezulton të jenë zbatuar afatet 3 mujore për zbatimin e këtyre vendime parashikuar në vendimet përkatëse por edhe nenin 19/4 të Ligjin nr. 10018 datë 13.11.2008 ñPër Avokaturën e Shtetitò, i ndryshuar. Gjatë periudhës nën auditim vitet 2018-2020 janë zbatuar 3 vendime në vlerën 109,962 Euro, ndërkohë që rezultojnë të pazbatuar 7 vendime të tjerë me vlerë të pagueshme 17,956,320 Euro, pa përfshirë këtu interesat e pagueshëm në rast vonesash referuar pikës 3 të nenit 19/4 në ligjin e sipërcituar. Vendimet e pazbatuar datojnë prej vitit 2015 deri në vitin 2020. Dy prej tyre të cilët përbëjnë dhe peshën kryesore të vlerës financiare për tu përballuar nga buxheti i shtetit përkatësisht **"Sh and others v. "** dhe **"D dhe N vs. Albania"**, me vlerat penalizuese për Republikën e Shqipërisë përkatësisht, 13,447,300 Euro dhe 4,417,750 Euro, nuk rezultojnë të jenë zbatuar brenda afateve të përcaktuara. Moszbatimi në afat i tyre krijon risk për aplikim interesash të pagueshme në vlera të konsiderueshme. Deri më datë 31.12.2020 interesat e pagueshme llogariten në vlerën rreth **1,675,938 Euro** dhe përbëjnë efekt financiar potencial në dëm të buxhetit të shtetit. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 2, faqet 25-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Avokatura e Shtetit në rolin e njësisë përgjegjëse për mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ por dhe të përfaqësuesit përpara Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për ekzekutimin e këtyre vendimeve, të informojë Këshillin e Ministrave për vendimet ende të paekzekutuar, si dhe vlerën e interesave financiarë të llogaritur për moszbatimin në afat të tyre, të cilat e ekspozojnë në vijimësi buxhetin e shtetit me vlera të konsiderueshme financiare.

Menjëherë

2.2 Rekomandimi: Avokatura e Shtetit për dy çështjet kryesore **"Sh and others v. Albania"** dhe **"Dh dhe N vs. Albania",** të cilat kanë penalizuar taksapaguesit shqiptarë me një barrë mjaft të lartë financiare, të analizojë dosjet gjyqësore dhe vendimet e GJEDNJ dhe të informojë Këshillin e Ministrave për të gjitha shkeljet dhe mosveprimet e institucioneve respektive vendase, të cilat duhen adresuar, me qëllim nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse dhe evitimin e veprimeve të padrejta dhe/ose abuzive në të ardhmen.

Brenda datës 31.12.2021

3- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, në gjykatat e huaja ndërkombëtare dhe arbitrazhin ndërkombëtar Shteti Shqiptar ka qenë si Palë e Paditur në 14 çështje gjyqësore. Nga këto rezultoi se janë gjykuar dhe dhënë vendimet për 9 çështje ndërsa 5 prej tyre presin gjykimin pranë këtyre gjykatave.
-Në 5 çështje të gjykuara, vendimi ka rezultuar në disfavor të Shtetit Shqiptar me një detyrim financiar prej rreth **388.5 milion Euro**. Thuajse për të gjitha rastet Avokatura e Shtetit nuk dispononte informacion të plotë mbi njohjen e këtyre vendimeve pranë Gjykatave të Apelit

vendase, si dhe ecurisë së ekzekutimin të tyre. Kjo si rrjedhojë e mos thirrjes në gjykim nga këto gjykata apo dhe nga institucionet respektive si palë e interesuar. Vendimet të cilat zënë peshën më të madhe janë cështjet e gjykuara në ICSID, ñQendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve në Fushën e Investimeveò ARB/15/28 H S.r.l and others me një vlerë prej rreth 108+ milion Euro, si dhe çështjes në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit të ICC me qendër në Paris, 21349/GR V2015 B P A ltd, me vlerë prej rreth 221.7 milion Euro. Në këto raste ekziston risku për kërkime për njohjen e vendimit edhe në gjykata të tjera ndërkombëtare ku Shteti Shqiptar gëzon të drejta.

-Në 4 çështje të gjykuara, janë rrëzuar pretendimet e Palës Paditëse dhe vendimi ka rezultuar në favor të Shtetit Shqiptar. Edhe për këto çështje Avokatura e Shtetit nuk dispononte informacion mbi njohjen e këtyre vendimeve pranë Gjykatave të Apelit. Njohja e vendimeve të këtyre proceseve gjyqësore pranë këtyre gjykatave kanë të bëjnë me njohjen e të drejtës për rimbursimin e kostove të paguara më parë nga shteti shqiptar gjatë procesit gjyqësor dhe nuk janë vlera financiare shtesë të fituara.

-Në **2 çështje**t e zhvilluara pranë ICSID konkretisht:

Çështja ARB/17/6 me palë paditëse An -Ad G Limited, kostot e Arbitrazhit të cilat janë parapaguar në avancë prej saj, sipas pikës 299 të vendimit paraqiten në vlerën **250,000 Euro,** ndërsa shpenzimet gjyqësore janë deklaruar 1,020,000 Euro. Nga ana e ASH është lënë nuk ka pasur veprime të mëtejshme për njohjen dhe ekzekutimin e këtij vendimi. Ndërkohë që ky vendim duhet të ishte njohur nga ASH me qëllim kërkimin e kostove përkatëse të paktën prej 250,000 euro.

Çështja ARB/14/26 Al A Sh.p.k, M. A N and C S.r.l. gjykata ka marrë vendim më datë 20.03.2020 në të cilin ka vendosur detyrimin e palës paditëse për pagesë të kostove dhe shpenzimeve të gjykimit përkatësisht, Euro 1,857,000 USD 427,488.72, GBP 106,755 me një total të llogaritur sipas kursit të publikuar të Bankës së Shqipërisë datës 31.12.2020 rreth 2,323,292 Euro. Referuar pikës 565 të këtij vendimi evidentohet se, Shqipëria ka paguar 399,900 Euro kosto arbitrazhi nga 380,000 USD që duhet të paguante, pra një vlerë më të madhe se ajo të cilën duhet të paguante në fakt. Referuar kursit të këmbimit të datës 31.12.2020 vlera e paguar tepër llogaritet në **59,504 Euro** më tepër të paguara padrejtësisht për të cilën nga ASH duhet të merren masat në vijim për rikuperim. Ajo çfarë vihet re në këtë rast është investimi i vetë ASH për njohjen e vendimit pranë Gjykatës së Apelit ndryshe nga raste të tjera që për njohjen e vendimeve institucioni shprehet se nuk ka informacion pasi nuk thirret nga këto gjykatat.

-Në **2 çështje**t e tjera të zhvilluara pranë ICC, çështja, H srl 20564/EMT/GR V2014 me vlerë vendimi 7,343,668 euro e cila ka marrë formë përfundimtare dhe H srl 22919/GR V2017, me vlerë vendimi 733,076 Euro, Avokatura e Shtetit nuk dispononte informacion mbi njohjen e këtyre vendimeve pranë Gjykatave të Apelit. Nëpërmjet të dhënave të disponuara nga auditime të KLSH pranë MIE, rezultoi se, Gjykata e Apelit, Tiranë me vendimin nr.202, datë 16.10.2018 ka njohur vendimin e çështjes së vitit 2014, ndërsa sa i përket vendimit të vitit 2017 kërkesa është regjistruar në gjykatë më datë 26.02.2020 dhe pritet njohja e tij. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 2, faqet 25-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandimi: Nga ana e Avokaturës së Shtetit të merren masat e nevojshme për rikuperimin e kostove të paguara në këto procese gjyqësore, përkatësisht çështja ARB/17/6 me palë paditëse An -A G Limited në vlerën **250,000 Euro** dhe vlerën e kostove gjyqësore të paguara më tepër çështja ARB/14/26 A A Sh.p.k në vlerën **59,504 Euro**, veç vlerave të tjera që rrjedhin nga vendimi për këtë çështje.

Menjëherë

3.2 Rekomandimi: Nga ana e Avokaturës së Shtetit të merren masat e nevojshme për t`u njohur dhe reaguar në kohë në rastet kur gjyqfituesit e vendimeve të gjykatave të huaja apo arbitrazhit ndërkombëtar kërkojnë zbatimin e vendimit në vende ku Shteti Shqiptar gëzon të drejta, duke analizuar në çdo rast përdorimin e mjetit ligjor më efektiv për mbrojtjen sa më të plotë dhe cilësore të interesit të vendit.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.3 Rekomandimi: Avokatura e Shtetit për çështjet e humbura në arbitrazhin ndërkombëtar dhe gjykatat e huaja, të cilat kanë penalizuar taksapaguesit shqiptarë me një barrë mjaft të lartë financiare, të analizojë dosjet gjyqësore dhe të informojë Këshillin e Ministrave për të gjitha shkeljet dhe mosveprimet e institucioneve respektive vendase, të cilat duhen adresuar, me qëllim nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse dhe evitimin e veprimeve të padrejta dhe/ose abuzive në të ardhmen.

Menjëherë dhe në vijimësi

4- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, në tre procedurat mbi përzgjedhjen e studiove ligjore të avokatisë të zhvilluara nga Avokatura e Shtetit gjatë periudhës vitet 2018-2020, zyrat e huaja të përzgjedhura, jorezidente në Republikën e Shqipërisë kanë ofertuar thuajse në të gjitha rastet me TVSH në masën 0%. Faturimet e tyre në vijim janë realizuar në të njëjtën mënyrë me ofertimin, ndërkohë që sipas dispozitave të legjislacionit fiskal, zyrat e huaja duhet të emëronin përfaqësues tatimor në Shqipëri për shërbimin e përfaqësimit/këshillimit ligjor që ato kryejnë si dhe lëshimin e faturës tatimore shqiptare me TVSH të aplikueshme në masën 20%. Caktimi i përfaqësuesit tatimor është një detyrim ligjor i cili buron nga nenet 86 pika 1 dhe 2, neni 87, të ligjit nr. 92/2014 ñPër Tatimin mbi Vlerën e Shtuarò, i ndryshuar, si dhe UMF nr. 6 datë 30.1.2015 neni 27 pika 1/b,d dhe 2/c, dispozita të cilat përcaktojnë se, <u>në rastet kur marrësi i shërbimit është një institucion publik që nuk është i regjistruar në TVSH, kërkohet emërimi i një përfaqësuesi tatimor për të paguar TVSH-në dhe në mungesë të tij, përfituesi vendas i shërbimit është përgjegjës për të paguar TVSH-në.</u> Pra në kriteret e vendosura në procesin e përzgjedhjes, dispozitat e kontratës së lidhur mes palëve, apo dhe përpara përcjelljes në MFE të faturave të këtyre subjekteve jorezidentë për likuidim, Avokatura e Shtetit duhet të kërkonte caktimin e përfaqësuesit tatimor nga ana e tyre. Sa më lartë, në mungesë të përfaqësuesit tatimor, përfituesit e shërbimit i ngarkohen nga legjislacioni fiskal kosto shtesë mbi vlerën e parashikuar për kontraktim, në masën prej 20% të vlerës së shërbimit që faturohet. Kjo vlerë duhet të llogaritej sipas pagesave individuale dhe duhet të paguhej në llogari të administratës tatimore. Efekti financiar shtesë i cili vjen nga mosnjohja apo keqinterpretimi i dispozitave ligjore në fuqi për TVSH-në sipas vlerës së kontratave të lidhura për të tre kontratat llogaritet rreth **34.5 milion lekë,** të cilat klasifikohen vlera shpenzimesh që kryhen jo në përputhje me parimet e efektivitetit, efiçencës dhe ekonomicitetit së fondeve publike. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 5, faqet 79-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandimi: Avokatura e Shtetit, të kërkojë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, si njësi e specializuar dhe kompetente për taksat dhe tatimet, interpretim teknik lidhur me aplikimin e TVSH-së apo dhe tatimeve dhe taksave të tjera për rastet e faturimit të shërbimeve të përfaqësimit/konsulencës nga personat jorezidentë drejt organeve publike. Pas përgjigjes së DPT, të ndërmerren masat e nevojshme administrative e ligjore për eliminimin e kostove shtesë të panevojshme në buxhetin e shtetit.

Menjëherë

5- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, për periudhën objekt auditimi, Avokatura e Shtetit, ka zbatuar gjithsej 7 vendime gjyqësore për ish punonjësit që kanë fituar procesin gjyqësor ndaj vendimit të largimit nga puna. Në gjashtë raste është ndjekur procedura në të gjitha shkallët e gjykimit deri në lëshimin e titullit ekzekutiv ndërsa në një rast, është kryer pagesa e 50 % të vlerës së Vendimit Gjykatës Administrative të shkallës së parë, pa pritur vendimin e Gjykatës së Apelit Administrativ.
Vlera totale e detyrimit për periudhën objekt auditimi është 8,810,568 lekë, nga e cila është trashëguar nga periudha para vitit 2018 vlera 455,013 lekë dhe është krijuar gjatë periudhës së auditimit vlera **8,355,555 lekë**, nga e cila është paguar vlera 7,067,190 lekë, mbetet për tu paguar në vijim vlera.1,743,378 lekë. Aktualisht Avokatura e Shtetit, ka katër procese gjyqësore për punonjës të tjerë të larguar nga puna. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 3, faqet 70-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandimi: Avokatura e Shtetit, të marrë masat e nevojshme, për të eleminuar kostot me efekt financiar në buxhetin e shtetit, të krijuara si pasojë e largimit nga puna të punonjësve në kundërshtim me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 ñKodi i Punës i Republikës së Shqipërisëò, si dhe ligjin nr. 152/2013 ñPër nëpunësin civilò.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi me zgjedhje i dokumentacionit të urdhër-pagesave për periudhën objekt auditimi rezultoi se, pjesa më e madhe e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore ekzekutohen nëpërmjet përmbaruesve privat dhe jo vullnetarisht nga Avokatura e Shtetit, me marrjen e njoftimit të vendimit të formës së prerë dhe kthimit të tij në titull ekzekutiv, por janë kryer në bazë të urdhër ekzekutimeve të lëshuara nga përmbaruesit privat, duke paguar tarifa përmbarimore, veprime të cilat kanë sjellë kosto shtesë për buxhetin Avokaturën.
Veprime në mospërputhje me Kodin e Procedurës Civile, neni 130 ñRregullat e njoftimit shkresor të akteveò ku citon se *"...Në rastin e personave juridikë publikë njoftimi bëhet në qendrën e tij dhe i dorëzohet titullarit ose personave të ngarkuar për pranimin e akteve*ò, nenit 451/a ku citon se é . ñ*Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët*ò dhe neni 510/a ñTitujt ekzekutivëò.
- Referuar Kodit të Procedurës Civile, neni 130 ñRregullat e njoftimit shkresor të akteveòô ku citon se ñé *Në rastin e personave juridikë publikë njoftimi bëhet në qendrën e tij dhe i dorëzohet titullarit ose personave të ngarkuar për pranimin e akteve*ò, ku institucionit i lind e drejta për ti kërkuar gjyqëfituesit paraqitjen e titullit ekzekutiv të vendimit të formës së prerë, për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, me qëllim shmangien e kostove shtesë të tarifave të përmbaruesit gjyqësore.
Zyra e Përfaqësimit pranë Avokaturës së Shtetit i dërgon Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse vendimet gjyqësore vetëm në rastin ku ato janë për likuidim, dhe kur është bërë kërkesë nga përmbaruesi për shlyerjen e detyrimeve.
Zyra e Përfaqësimit pranë Avokaturës së Shtetit nuk informon në vazhdimësi Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse për të gjitha vendimet gjyqësore, të cilat kanë kaluar shkallën e dytë të procesit të apelimit, me qëllim që nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të merren masa për krijimin e provizionet për shpenzime, të cilat janë ngjarje të ndodhura, që do të sjellin një probabilitet që do të ketë një detyrim për tôu paguar nga ana e njësisë, me qëllim njohjen e tyre në kontabilitet dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare vjetore të njësisë, duke bërë të mundur dhe planifikim në kohë të burimeve të financimit dhe një parashikim të besueshëm mbi vlerën e detyrimeve, si dhe shmangien e detyrimeve të akumuluar dhe të pagesave të tarifave përmbarimore si pasojë e mosekzekutimit vullnetar të vendimeve të cilat për periudhën nën auditim paraqiten në shumën **669,106 lekë.** *(Më*

hollësisht trajtuar në drejtimin 4, faqet 73-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)..

6.1 Rekomandimi: Zyra e Përfaqësimit pranë Avokaturës së Shtetit të marrë masat që me marrjen e njoftimit të vendimit të formës së prerë nga gjykata, t`i kërkojë gjyqfituesit paraqitjen e titullit ekzekutiv të vendimit pranë Avokaturës së Shtetit, për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, si dhe për të gjitha vendimet gjyqësore, të cilat kanë kaluar shkallën e dytë të procesit të apelimit, të vërë në dijeni Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të Avokaturës së Shtetit, me qëllim që të merren masa për krijimin e provizionet për shpenzime dhe shmangien e kostove shtesë të ekzekutimit të këtyre vendimeve.

Në vijimësi

E. TË ARDHURA TË MUNGUARA NË DËM TË BUXHETIT TË SHTETIT

Në vijim të verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në dy auditimet e mëparshme për Avokaturën e Shtetit të cilët kanë rezultuar të pazbatuar dhe që kanë impakt të lartë për financat publike, ri-kërkojmë zbatimin e tyre:

1. Gjetje nga auditimi (e përsëritur) : Nga auditimi për zbatimin e rekomandimeve të mëparshme të KLSH (me shkresë të KLSH me nr.264/8, datë 12.10.2015), në lidhje me arkëtimin e garancisë së ofertës së paraqitur nga shoqëria ñV E P Ltdò për procedurën e zhvilluar për privatizimin e shoqërisë ñA ò sha, Patosò, KLSH ka rekomanduar:*"Të vazhdojë me përparësi ndjekja e procedurave ligjore brenda dhe jashtë vendit, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në bashkëpunim të ngushtë me Avokaturën e Shtetit, për të mundësuar arkëtimin e kësaj shume, duke e detyruar subjektin përkatës të respektojë kushtet e tenderit dhe të gjitha detyrimet rrjedhojë e këtij procesi.* Nga verifikimi pranë Avokaturës së Shtetit mbi statusin e zbatimit të këtij rekomandimi, rezultoi se midis Avokaturës së Shtetit dhe ish-(MZHETTS), sot Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka pasur korrespondencë në lidhje me këtë problematikë, sikurse shkresat me nr. 8276/2, datë 30.10.2015, me nr. 8291/2, datë 20.11.2015, nr. 2564/1 datë 30.05.2016 dhe nr. 7992/1, datë 14.10.2016, mirëpo në to Avokatura e Shtetit ka kërkuar thjesht marrje informacioni mbi dosjen e privatizimit të A sh.a, dhe nuk ka këmbëngulur të dijë mbi ecurinë për të përshpejtuar dhe mundësuar nga ana ligjore arkëtimin e garancisë së ofertës.

Institucioni i Avokaturës së Shtetit ka pasur dijeni për ***mos arkëtimin e garancisë së privatizimit, në vlerën prej 85 milionë Euro nga kompania* V E PTE Ltd**ò që nga viti 2012. Deri tani, ky institucion, ende nuk ka marrë asnjë veprim ligjor, në bashkëpunim me ish- METE, ish-MZHETTS, tashmë Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për arkëtimin e kësaj vlere, në bazë të ligjit 10018 ñPër Avokaturën e Shtetitò datë 13.11.2008 neni 5 pika 1 germa ñëò.

Gjithashtu, Avokatura e Shtetit me shkresa zyrtare, duhej të kishte sensibilizuar dhe tërhequr vëmendjen, që strukturat e larta shtetërore të përfshira në këtë çështje, të mos humbnin kohë, duke iu propozuar atyre mundësitë ligjore për arkëtimin e garancisë së ofertës të paraqitur nga kompania ñV E PTE Ltdò. Kjo mënyrë veprimi nga Avokatura e Shtetit, ka sjellë tejkalimin e të gjitha afateve procedurale deri në atë fazë që çështja të kalojë në heshtje dhe të bëhet e pakërkuar, me justifikimin e artificave procedurale administrative të burokracisë së brendshme të institucioneve të Shtetit Shqiptar. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 1, faqet 14-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Ri-Rekomandojmë: Avokatura e Shtetit të marrë masa, dhe të analizojnë me grup pune të veçantë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mosveprimin me qëllim arkëtimin e të ardhurave në favor të buxhetit ***në vlerën 85 milionë Euro***, si dhe të investohet tërësisht dhe urgjentisht në këtë çështje.

Menjëherë

1.1 Ri-Rekomandojmë: Avokatura e Shtetit të veprojë urgjentisht në përmbushje të detyrimeve të saj si dhe në zbatim të rekomandimeve të mëparshme të lëna nga KLSH me shkresën nr.478/5, datë 05.09.2013. Për mos arkëtimin e vlerës prej 85 milionë euro të njoftohet Këshilli i Ministrave, në mënyrë që Avokatura e Shtetit, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të marrin masa dhe të përshpejtojnë finalizimin e hapave dhe procedurat ligjore për të mundësuar arkëtimin e garancisë së kontratës nga ñV.E.PTEò Ltd, për llogari të Buxhetit të Shtetit. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 1, faqet 14-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi (e përsëritur): Nga auditimi për respektimin e dispozitave ligjore për përzgjedhjen e 3 studiove avokatie të huaja, me objekt mbrojtjen e interesave të shtetit shqiptar me oferta në vlerën prej 2,340,000 euro (nga të cilat 1 kontratë nuk është lidhur), konstatohet se në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 ñPër tatimin mbi të ardhuratò, i ndryshuar, neni 8 të ardhurat e tatueshme, kreu IV ñTatimi i mbajtur ne burimin e te ardhurave, neni 33 ñMbajtja në burim e tatimit mbi të ardhuratò pika 1, nuk është parashikuar ndalesa e tatimit në burim në masën 15% në shumën **351,000 Euro** mbi të ardhurat që do realizohen, duke sjellë si pasojë evazion fiskal për të ardhurat tatimore në RSH.

2.1 Ri-Rekomandojmë: Avokatura e Shtetit të marrë masa, dhe të analizojnë me grup pune të veçantë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos arkëtimin e të ardhurave në favor të buxhetit ***në vlerën 351,000 Euro***.

Menjëherë

F. MASA DISIPLINORE

Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me statuse të parashikuar në ligje të veçanta.

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 ñTë drejtat dhe detyrat e KLSH-sëò, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, nenit 37 ñMasa disiplinoreò të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë, si dhe neneve 29 deri 32, e vijues, të ligjit nr. 10018 datë 13.11.2018 ñPër Avokaturën e Shtetitò, i ndryshuar, ***i rekomandojmë*** **Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit**, që nëpërmjet një grupi pune, të vlerësojë shkeljet e evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të nis menjëherë procedurat për dhënien e masës disiplinore përkatëse ñ*Vërejtje me shkrim"* deri në *"Shkarkim nga detyra/Zgjidhje e kontratës së punës",* për punonjësit të cilët referuar parregullsive të konstatuara rezultojnë me shkelje në kryerjen e veprimtarisë së tyre administrative e ligjore.

G. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit do të ndjek me vëmendje të veçantë dhe do të vlerësoj marrjen e masave, nga Avokatura e Shtetit, për zbatimin e rekomandimeve të lëna në këtë auditim si dhe atyre të lëna në auditimet e mëparshme që kanë rezultuar me status, i pazbatuar, i zbatuar pjesërisht, apo në proces zbatimi, me qëllim përmirësimin e punës, përmbushjen e objektivave institucional në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efektivitetit dhe efiçencës së fondeve publike dhe në dobi të qytetarëve shqiptar.

V- ANEKSE

-Aneksi I- ñStrukturat e miratuar e Avokaturës së Shtetit me urdhrin nr. 58, dt. 25.03.2019 të Kryeministritò;
-Aneksi II- ñPaditë civile të ngritura në procese penale dhe të ndjekura nga Avokatura e Shtetit, për periudhën 01.01.2018- 31.12.2020 sipas informacionit të datës 08.01.2021, vënë në dispozicion nga institucioniò;
-Aneksi III- ñÇështjet civile në procese penale në ndjekje nga Avokatura e Shtetit gjatë periudhës 01.01.2018-31.12.2020 sipas informacionit të datës 18.01.2021 të vënë në dispozicion nga institucioni;
-Aneksi IV- ñÇështjet gjyqësore të regjistruara në gjyktatat të Huaja për vitet 2018-2020 (veç GJEDNJ)ò;
-Aneksi V- ñMbi marrëdhëniet e punës dhe të pagave, realizimi i fondit të pagave, shpërblimeve, sigurimeve shoqërore e të tjera personeliò;
-Aneksi VI- ñUdhër shpenzimeò:
-Aneksi VII- ñInspektimet e kryera gjatë vitit 2018 (deri në datë. 27.11.2018) dhe konkluzionet sipas çdo rasti të inspektuarò:

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT